

**NDIKIMI I ELITËS POLITIKE NË NDËRTIMIN E
MARRËDHËNIEVE
SHTET-SHOQËRI GJATË TRANZICIONIT**

Luljeta Hasani

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale, me profil
Shkenca Politike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqësi shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraj

Numri i fjalëve 72, 718

Tiranë, korrik 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale. Punimi është shkruar prej meje. Nuk është paraqitur, asnjëherë, pranë ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

MIRËNJOHJE

Familjes sime.

FALENDERIME

Për angazhimin, mbështetjen, stimulimin, kohën, vlerësimin dhe bashkëpunimin në paraqitjen e këtij punimi doktoral, falenderoj Prof. Dr Tonin Gjuraj, rektor i UET i cili ishte udhëheqësi im prej tre vitesh në punimin doktoral.

Falënderoj gjithë stafin e Departamentin të Shkencave Sociale të Aplikuara UET, për bashkëpunimin në përgatitjen e punimit.

Në mënyrë të veçantë falenderoj familjen time për mbështetjen.

TABELA E PËRMBAJTJES

Deklarata autorsisë -----	fq 2
Mirënjohje-----	fq 3
Falenderime -----	fq 4
Tabela e përmbajtjes-----	fq 5- 8
Shkurtesa -----	fq 9-10
Abstrakti -----	fq 11-14
Parathënie -----	fq 15- 18
Metoda dhe Metodologjia -----	fq 19-24

KAPITULLI I

Kuadri teorik-----	fq25- 46
--------------------	----------

KAPITULLI II

Rënia e sistemit komunist në Shqipëri, problematikat e elitës së re politike

2.1 Lëvizja studentore , lindja e pluralizmit shqiptar-----	fq 47-54
2.2 Disidentët në sistemin komunist-----	fq 54-56
2.3 Koncepti shqiptar për elitën politike -----	fq 56-58

2.3.1	Problematikat e elitës politike të tranzicionit -----	fq 58-69
2.3.2	Sfidat e elitës politike shqiptare të tranzicionit -----	fq 70-74
	Analizë -----	fq 74-80

KAPITULLI III

Kriza e vitit 1997 pasojë e mungesës së eksperiencës politike për shtetformim, dhe mentalitetit të vjetër të klasës politike

3.1	Kriza e vitit 1997 pasojë e paaftësisë së elitës së re postkomuniste në shtetformim-----	fq 81-86
3.2	Përpyjekjet e Presidentit për të zgjidhur situatën-----	fq 86-91
3.3	Qëndrimi ekstermist i elitës politike në ngjarjet për zgjedhjet e 1997-----	fq 91-96
3.4	Pastrimi i parave dhe firmat piramidale, krimi godet shtetin-----	fq 97-98
3.4.1	Demokracia shqiptare në rrezik, përpjekjet për të stabilizuar situatën----	fq 98-105
	Analizë -----	fq 105-109

KAPITULLI IV

Formësimi politik i klasës politike shqiptare karakteristikat e saj

4.1	Reformimi i komunistëve me Nanon, ardhja në krye të PS e Edi Ramës-----	fq 110-116
4.2	Tiparet e klasës politike gjatë tranzicioni, statusi i elitës dhe i parlamen- -----	fq 116-128

4.3 Statusi i elitës politike, dhe kontributi i tyre në jetën politike të shqiptarëve- -----	-----fq 129-132
4.4 Formësimi i klasës politike gjatë tranzicionit , karriera politike e saj---fq 133-138	
4.5 Reminishencat e vjetra politike të klasës politike në tranzicion-----fq 138-148	
4.6 Performanca e elitës politike gjatë tranzicionit-----fq 148-159	
4.7 Prurjet e reja në politikë, përpjekjet për ta rideminisuar atë elitën politike -----	-----fq-160-161
4.8 Funksionimi i partive politike si bashkëudhëtare në formimin e elitës politike dhe shtetit të ri demokratik -----	-----fq 162- 171
Analizë-----	-----fq 171- 191

KAPITULLI V

Kultura politike dhe efektet e saj në ndërtimin e marrëdhënies shtet shoqëri

5.1 Mungesa e kompromisit politik mes klasës politik shenjë e mungesës së vizionit politik të elitës politike -----	-----fq 192-199
5.2 Vrazhdësia e gjuhës politike, si shenjë e mungesës së njohjes së komunikimit politik-----	-----fq199-205
5.3 Procesi zgjedhor si pikënisje e ndërtimit të shtetit demokratik dhe elitë së re politike-----	-----fq 205-217
5.4 Raporti i munguar mes elitës politike dhe shoqërisë civile-----	-----fq 217-221

5.5 Politika dhe politikanët shqiptarë në përpjekje për të ndërtuar shtetin modern

-----fq 222-228

Analizë -----fq 228-237

Përfundime-----fq 238-247

Literatura -----fq 248-256

SHKURTESA

PD - Partia Demokratike

PS - Partia Socialiste

LSI - Lëvizja Socialiste për Integrim

PPSH - Partia Punës Shqipërisë

PSD - Partia Social Demokrate

PDS - Partia Demokracia Sociale

PLL - Partia Lëvizja e Legalitetit

PBK - Partia Balli Kombëtar

PBDNJ - Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PR - Partia Republikane

BE - Bashkimi Europian

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

KQZ- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

NATO - *Nation Atlantic Tractat Organisation*

OJF - Organizata Joqeveritare

KOP - Komiteti i Orientimit të Politikave

IRI - Instituti Republikan Amerikan

OSBE - Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

Abstrakti

Studimi ka si objekt të trajtimit vlerësimin e ndikimit që elita politike ka patur në ndërtimin e marrëdhënies shtet shoqëri si dhe analizën e faktorëve që kanë ndikuar në këtë drejtim. Nisur nga perceptimi i përgjithshëm se besimi qytetar ka pësuar ulje tek klasa politike është ndërmarrë dhe ky studim.

Me anë këtij studimi jemi përpjekur që ti japim përgjigje pyetjes se se, përse elita politike ndikoj në uljen e besimit qytetar tek ajo dhe cilët ishin faktorët që ndikuan në këtë drejtim. Punimi është i përqëndruar kryesisht në analizën dhe vlerësimin e drejtimit të ndikimit që ka patur elita politike në ndërtimin e raportit social shtet shoqëri.

Objekti i punimit është vetëm aspekti social i ndikimit, vlerësimi i kufinjve të këtij ndikimi bëhet nga prespektiva sociale e kulturore. Analiza e studimit është kufizuar gjithashtu duke mos u shtrirë në çështje të tjera që lidhen me politikat ekonomike apo institucionale. Për të bërë të mundur realizimin e studimit i gjithë punimi është i mbështetur mbi idenë se, modeli altimetrik mbi bazën e të cilit i formësua dhe u jetësua elita e re politike e pas viteve 90' i dha tiparet dhe problematikat të cilat klasa politike i ka prezantuar gjatë gjithë tranzicionit, pra një elitë jo fleksibël me tendencë të ngurtësisë ndaj problematikave dhe trysnive të kohës duke efektuar marrëdhënien mes shtetit dhe shoqërisë.

Synimi përfundimtar i analizës së bërë në këtë studim nuk është arritja përfundimtare e konkluzioneve, por është një përpjekje për të evidentuar standardin dhe modelin që u

zhvillua nga klasa politike, model i cili kërkon shqyrtim të mëtejshëm të praktikës së tij.

Fjalët kyçe, elitë politike, raport social, marrëdhënie shtet shoqëri, drejtim i ndikimit, prespektiva social kulturore

Abstract

The subject of this study is to evaluate the impact the political elite has had over the building of the relation state society, as well as to analyse the factors that have impacted in this direction.

Seeing that the civil faith on the political class has decreased this study started. Through this study we have tried to give an answer to the question, the political elite affected in the decrease of the civil faith on it and which were the factors that affected this direction. This study has been mainly concentrated with the analysis and evaluation of the impact that the political elite has had over the social report state society.

The main objective of this work is simply the social aspect of the impact, the evaluation of the borders of this impact is done by the social and cultural perspective. Study analysis is limited, not extended on other issues that are related with the economic politics or institutional ones. To enable this study, all the work was based on the idea that, the Bailey model on the new political elite after the 90' was based, showed its features and problems which the political class has presented during the transition, so this a non flexible elite with stiff trends toward problems and pressure of the, reflecting on the relation between the state and society.

The final goal of the analysis done on this study is not the final achievement of the conclusions, but it is an effort from the political class, requires a further review of the practice.

Key words: political elite, social report, relations state society, the impact's direction, the social and cultural perspective

PARATHËNIE

Është e dukshme tendenca e uljes së besimit qytetar tek klasa politike, pasi pothuajse përgjatë dy dekadave e më shumë klasa politike ka shfaqur papërgjegjshmëri në raport me kontratën sociale që ka me qytetarët e saj. Formimi i elitës politike të tranzicionit duhet parë e lidhur ngusht me zhvillimet dhe ndryshimet e mëdha që ka pësuar realiteti social dhe politik pas futjes së vendit tonë në zhvillimin e proceseve demokratike.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i ndikimit që klasa politike ka patur në marrëdhënies mes shtetit dhe shoqërisë, si dhe analizën e faktorëve që kanë ndikuar në këtë fenomen.

Duhet theksuar gjithashtu se dhe studimet e kryera e kanë vendosur më shumë në qëndër të vëmëndjes funksionimin e shtetit demokratik, por pa theksuar rolin e rëndësishëm që luan klasa politike parlamentare në këtë kuadër, si grupi i kontrollit të cilit i jepet pushteti politik. Aspekt tjetër që ka rëndësi është dhe vlerësimi i faktorëve që kushtëzuan formësimin e jetësimin e elitës së re politike.

Problematika kryesore apo çështja themelore në këtë studim është vlerësimi i kahut të ndikimit që ka patur klasa politike në ndërtimin raportit social shtet shoqëri.

Hipoteza e studimit. Mentaliteti i vjetër politik i mbartur dhe tek elita e re e pas viteve 90', çoi në ndërtimin e një elite politike konfliktuale, duke efektuar marrëdhënien shtet shoqëri.

Pyetja kërkimore. Përse elita politike e pas viteve 90' ndikoj në uljen e besimit qytetar tek klasa politike. Cilët ishin faktorë që ndikuan në këtë drejtim?

Në fushën e studimeve të shkencave politike apo të sociologjisë politike në Shqipëri ka pak studime të thelluara për të studiuar proceset e transformimit dhe të ndërtimit të

institucioneve, duke i shpjeguar nga perspektiva e rolit të aktorëve politikë, të profilit të tyre ideologjik, trajektorës në karrierë dhe të strategjive të tyre. Besoj se ndërmarrja e një studimi të tillë në këtë lëmi të studimeve të deritanishme është mjaft në kohë dhe me vlerë. Shume prej studuesve të proceseve të pas viteve 1990-të, preferojne të gjejnë dhe të paraqesin shpjegime strukturore që lidhen me mungesën e kulturës demokratike, me trashëgiminë e mbartur apo të supozuar osmane dhe më pas me trashëgiminë komuniste ose kulturore. Edhe në këtë punim disertacioni ka një prirje të tillë, por kontributi kryesor i këtij disertacioni lidhet me rolin e elitave politike, dinamika e zanafillës dhe transformimeve apo vazhdimësisë në kohë të këtyre elitave në kombinim me mënyrën e drejtimit të personalizuar të partive politike. Është më rëndësi të paraqitet dallimi dhe transformimi në kohë nga proceset e para të konsensusit apo njëtrajtshmërisë/kohezionit ideologjik midis partisë opozitare dhe ish-PPSH (PS) në vitet 1991-1992 dhe fillimet e konfliktit dhe të politizimit të institucioneve demokratike që sollën krizën e legjitimitetit dhe ndarjen mes shtetit dhe shoqërisë, 1994, 1996-1997. Mendoj se është e rëndësishme të jepet e plotë dinamika e këtyre ndryshimeve, jo vetëm vazhdimësia, pasi mund të mendohet se nëse elitat politike nuk janë efikase për të sunduar në mënyrë demokratike, atëherë është çështje mentaliteti, kulture apo trashëgimie.

Për të shpjeguar dinamikën e marrëdhënies mes variablave kryesor të studimit, ku marrëdhënia shtet shoqëri është variabli i varur i cili është efektuar nga variabli i pavarur që është elita politike, janë analizuar ngjarje e fenomene të cilat kanë ndikuar në këtë raport duke i dhënë përgjigje pyetjes se përse elita politike ndikoi në uljen e besimit qytetar tek shteti e klasa politike, ku klasa politike dhe shteti janë parë si një entitet i vetëm në këtë marrëdhënie, pasi shteti përbëhet dhe u besohet individëve.

Perceptimi i përgjithshëm për këtë fenomen ka disa faktorë që e kushtëzuan lindjen e tij, zbatimi i modelit alitimetrik që ndoqi klasa politike në jetësimim dhe funksionimin e saj, model i cili i bazua në vendosjen e faktit se kush është në majë është në majë, e kush është në majë është i pushtetshëm dhe e ushtron pushtetin, model i cili u kushtëzua nga rrethana historike, politike e shoqërore që gjeti zbatim gjatë gjithë tranzicionit. Ky model uli meritokracinë dhe prodhoi si rezultat një klasë politike konfliktuale, abuzuese me shtetin dhe qytetarët e saj.

Mungesa e institucionalizimit të vlerave demokratike si, kompromisi, dialogu, nga ana e klasës politike është një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikoi në uljen raportit social mes shtetit dhe qytetarëve, dhe solli si pasojë një klasë politike me tendencë jo të zbatimit të ligjit, por të qënurit mbi ligji, model ky që deformoi klasën politike, institucionet duke dhënë impakt dhe në këtë marrëdhënie.

Në këtë pikëpamje një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe zhvillimi i një politike pa moral në kuptimi e moralit politik të kthimit të fjalës në veprimtari. Nga ana e klasës politike, ku kultura politike është shprehur në një gjuhë politike radikale, dhe jo si një mjet për të arritur argumentin politik, por si mjet për të zhvilluar konfliktualitetin politik.

Formësimi i një klase politike tradicionale që dominohet nga individë me kohëzgjatje të madhe në politikë, është një tjetër faktor që ka ndikuar në këtë raport, pasi ndikoj në funksionimin e partive politike, të parlamentit si dhe në qarkullimin e elitës politike.

Mungesa e zhvillimi të proceseve zgjedhore të rregullta e të lira si një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon në besueshmërinë e qytetarëve tek klasa politike, si dhe raporti i munguar i shoqërisë civile me klasën politike kanë ndikuar në ujlen e këtij raporti apo

të marrëdhënies mes shtetit dhe shoqërisë së vet. Pasi një shoqëri që nuk lufton përditë që të ketë shtetin e vet, nuk mund të ketë një shtet të moralshëm, prandaj nuk duhet hequr dorë nga përpjekja për ta patur atë. Por një gjëndje e caktuar shoqërore nuk qëndron përgjithmonë, pasi shoqëritë kanë pika të ndryshme të reagimit shoqëror, momente të cilat nuk janë të parashikueshme, pasi natyra e pushtetit të një vendi është e varur dhe nga historia e reagimit shoqëror.

Ndërtimi i një klase pokitike mospërfillëse ndaj kontratës sociale me qytetarët e vet për shkak të përsëritjes së shpeshtë të mosregimit qytetar e ka zbehur këtë kontratë e për pasojë ka prodhuar impakt negativ në këtë raport.

MODELI ANALITIK I TEZËS

Metodologjia

Meqënëse studimi synon që të shpjegojë një specifikë historike të rastit studimor që është elita parlamentare, punimi i bërë është më tepër një përpunim cilësor i materialeve të cilat janë përdorur. Nga reflektimi dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara i është dhënë punumit kompaktësia dhe rigoroziteti metodologjik. Duke qënëse në një studim cilësor studiuesi është i çliruar nga detyrimi për të ndjekur me rigorozitet hipotezën, por që sërish duhen ndjekur idetë dhe konceptet që rrjedhin nga përpunimi i të dhënave, që këtij rezulton se qëllimi kryesor i përpunimit të dhënave është evdencimi i koncepteve, ideve, gjetjeve të japin rezultatin kërkimit shkencor. Informacioni i grumbulluar nga studimet cilësore kryesisht është ai i teksteve, fjalime, ditare, artikuj shtypi, dokumente të ndryshme, të cilat përcjellin më mirë përvojat e gjalla jetësore.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është një gërshetim i disa metodave si, deduktive, historikja logjikja dhe analiza, me anë të të cilave synohet të realizohet nxjerrja në pah e të veçantës së ndikimit të elitës politike në marrëdhënien shtet shoqëri dhe proceseve që këtij ndikimi.

Duke u bazuar në ndërthurjen e këtyre metodave, pra nisur nga idea e perceptimit të uljes së besimit qytetar tek klasa politike, si ide e përgjithshme me interpretimin historik të fenomenit se si lindi dhe u zhvillua ky fenomen, duke ruajtur lidhjen logjike të fakteve me fenomenin është bërë analizë tematike e ku është bërë ndarja e tematikës në disa nivele të analizës për të bërë të mundur vlerësimin se si elita politike ka ndikuar në marrëdhënien shtet shoqëri. Për të bërë të mundur realizimin e objektit

të studimit janë marrë në studim dhe analizuar disa fenomene si mungesa e kompromisit e dialogut politik ku si pikë kulmore e këtij tipari që është marrë në shqyrtim kriza e vitit 1997, janë analizuar funksionimi i partive politike, parlamentit, si dhe karriera politike e elitës, raporti i saj me shoqërinë civile, se cilët janë faktorët që kushtëzuan formatimin në këtë mënyrë të elitës politike të pas viteve 90'. Janë analizuar me qëllim për të bërë të mundur vlerësimin e drejtimit të këtij ndikimi, pra nëse elita politike ka ndikuar në kah të forcimit apo të uljes së besimit qytetar në marrëdhënien e tij me shtetin.

Modeli teorik i përdorur për të arritur qëllimin e studimit është ai i perspektivës funksionaliste , ku referuar sistemit vertikal të demokracisë, elita politike si pjesa e cila është rezultat i procedurave demokratike dhe janë një grup kontrolli, dhe ky kontroll është politik, kur është në një funksion politik, pra studiohet elita parlamentare që është rezultati këtyre procedurave demokratike. Për ta kryer dallimin e këtij grup kontrolli Xh. Sartori thekson dy kriteret kryesore, altimetrik ku një grup kontrolli është i tillë pasi në strukturimin vertikal të shoqërisë ndodhet në majë, dhe se në çdo shoqëri pushtetin e ka klasa politike që është në majë të pushtetit. Kjo sipas autorit mbështetet në supozimin se po të kesh pushtet je në majë, kush ka pushtet është në majë, ke pushtet se je në majë, dhe kriteri meritokarcisë që do të thotë se struktura vertikale e shoqërisë i besohet atij që ka aftësinë më të lartë. Nga kjo rrjedh ideja se, nuk je në majë se ke pushtet por përkundrazi, kë pushtet dhe je në majë se e meriton atë. Kjo sipas autorit elitat altimetrike de facto zhvendosen nga elitat e të aftëve, dhe sipas radhës ajo që del fitimtare gjatë zhvillimit të historisë është elita e të aftëve dhe jo elita e atyre që janë në pushtet. Ku elitat e afta do të sigurojnë mirëqënie dhe më shumë

ndikim pozitiv në vendimmarrjen politike në të mirë të qytetarëve dhe të fuqizimit e funksionimit të demokracisë dhe institucioneve demokratike që garantojnë këto elita.

Metoda e studimit

Metodat e përdorura në këtë punim është deduktive, historike, logjike dhe analiza. Metoda deduksionit ka shërbyer për të bërë të mundur vëzhgimin e fakteve që duke u mbështetur tek hipoteza e punimit të nxirret një përfundim i nisur nga perceptimi i përgjithshëm për fenomenin.

Metoda e historike është përdorur për të interpretuar kontekstin e lindjes dhe të zhvillimit të fenomenit që në etapat e para të tij e deri në shfaqjen dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë rrjedhes jetësore të tij.

Metoda logjike është përdorur të bërë të mundur pasqyrimin e rezultatit të zhvillimit të historisë së fenomenit, pra duke bërë të mundur dallimin e elementëve thelbësor të fenomenit.

Metoda e analizës është përdorur me qëllim që të bëjmë të dukshëm faktorët që kanë ndikuar në marrëdhënie mes shtetit dhe shoqëri gjatë tranzicionit, duke u nisur nga ngjarje dhe fenomene të ndryshme që janë të ndara në katëgori të ndryshme të analizës për të dalë në një ide konkrete (sintezë e kategorive të analizës).

Metoda analiza ndodhi e historisë është përdorur në kapitullin e dytë, analiza e ndodhisë historike si njësi e analizës historike, në rastin ëshë konkret rënia e sistemit komunist në Shqipëri, vendosja e sistemit demokratik dhe formësimi i elitës së re politike. Analiza ndodhi e historisë përfaqëson një mënyrë studimi në të cilën njësi e analizës nuk është individi apo grupi shoqëror në rastin konkret situata në të cilën

ndodhi procesi i zëvendësimit të elitës politike, por ndodhia ose ngjarja me rëndësi shoqërore dhe në rastin konkret është analiza historike pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri është formësimi i elitës së re politike dhe ndikimi i kësaj ngjarje në procesin që u zhvillua më pas. Cila ishte origjina e nga ku buronte kthesa historike që më vonë ndikoi në procesin e zëvendësimit të elitës tradicionale me elitën e re politike, prejardhja e së cilës vinte nga rrethet intelektuale të kohës, pavarësisht nivelit elitar të cilit i përkisnin, ky proces pati ndikimin e vet jo vetëm në ndryshimin e regjimit por dhe në origjinën e elitës politike, cila ishte përfshirja grupeve të ish të përndjekurve, diasporës në elitën e re politike . Kjo kthesë historike pati ndikim dhe shërbeu si parakusht për formimin e elitës së re postkomuniste pasi nga kjo kthesë dhe levizje me rëndësi historike dolën disa nga figurat kryesore politike të tranzicionit shqiptar. Kjo metodë e përqëndron konceptin e saj të analizës në atë të analizës së “rrjedhës jetësore “ (L.Sokoli,2011, fq 285) në kryqëzimin e përvojave të individit dhe atyre që përkojnë me kohën historike siç ishte dhe ndryshimi i sistemit dhe formësimi i elitës së re politike. Duke qënë se është një metodë që ndjek dinamikën e ngjarjes pra të vendosjes së sistemit demokratik në lidhje me zhvillimin e formësimin e elitës së re politike si cili ishte modeli që zbatua në këtë proces.

Analiza biografike si metodë analitike që konsiston në studimin e situatës dhe të faktorëve që patën ndikimin e tyre në ngjarjet politike dhe shoqërore që rrodhën më pas është përdorur në kapitullin e tretë. Prandaj në analizën e krizës së vitit 1997 dhe të reagimit të klasës politike ku me klasë politike është kuptuar roli i anëtarëve të parlamentit të kohës, ndaj saj, kjo metodë është më e përshtatshme pasi merret me studimin e elitave politike dhe të aktorëve të tjerë të jetës publike (Potuche në L.Sokoli 2011, faqe 352). Në analizë të qëndrimit të klasës politike ku përpjekjet për të

mbajtur apo dhe marrë me çdo kusht pushtetin është faktori që duhet analizuar. Kjo metodë analizon ndikimin e kontekstit, të krizës së vitit 1997 në ngjarjet politike e shoqërore që e pasuan atë.

Analiza faktoriale e përdorur si metodë e përshtatshme në shkencat sociale, që ka të bëjë me analizën e variablave. Kjo metodë është faktorizim i variablit ose i ndryshoreve që rezultojnë në kërkimin shkencor. Si parim i kësaj metode është përcaktimi apo identifikimi i variablit “faktor”, pra është një mënyrë shpjeguese për të identifikuar faktorin kryesor që ka ndikuar ndër variablat e tjerë të ndryshëm. Gordon Marshall (në L.Sokoli, 2011, fq287) e konsideron analizën faktoriale si një teknikë për zëvendësimin e një numri të madh të variablave, në një numër më të vogël të faktorëve që e pasqyrojnë atë që një sërë variablash kanë të përbashkët me njëra tjetrën. Nisur nga kjo pikëpamje, analiza e kristalizimit të klasës politike shqiptare gjatë tranzicionit, është bërë mbi pasqyrimin e një sërë faktorësh të përbashkët si mentaliteti, kultura politike dhe trashëgimia politike, të cilët pasqyrojnë elementët e përbashkët në të dy kahet e politikës gjatë tranzicionit, ku karakteristika e përbashkët e tyre është ndikimit negativ i klasës politike në ndërtimin e marrëdhënieve shtet shoqëri është identifikuar si argumenti kryesor. Duke qënë se demokracia shqiptare nuk është cilësuar si një demokraci e konsoliduar në ndërtimin e marrëdhënies shtet shoqëri vihen re diferencimet dhe të përbashkëtat e klasës politike në ndikimin e saj në ndërtimin e kësaj marrëdhënie në raport me ndërtimin e funksionimin institucioneve demokratike, efëçente në shërbim të qytetarëve, funksionimi i partive politike si komponent shumë i rëndësishëm në funksionimin e sistemit politike dhe të përformancës së elitës politike, ku partitë politike shikohen si burimi kryesor i origjinës së elitës politike dhe si elementi i cili me funksionimin e tyre i japin sistemit politik tiparet autentike.

Analiza korrelative si metodë studimore që shërben për të përcaktuar shkallën dhe drejtimin e marrëdhënies mes ndikimit të elitës politike dhe ndërtimit të marrëdhënies shtet shoqëri gjatë tranzicionit. Analiza korrelative reflekton rastet kur ndryshimi i madhësisë së njërit variabël pra i besueshmërisë së elitës tek politike nga ana e shoqërisë shoqërohet me uljes e besimit qytetar tek elita politike dhe shteti që është variabli tjetër, pra se si elita politike me performancën e saj ka ndikuar në marrëdhënien shtet shoqëri, dhe që ky korrelacion mes këtyre variablave ka si kusht që, ndryshimi i variablit elita politike, nuk mund të ndodhë në mungesë të ndryshimit të madhësisë së variablit raporti shtet- shoqëri. Nisur nga kjo pikëpamje marrëdhënia shtet shoqëri është shoqëruar nga ndikimi i elitës politike. Ndikimi i elitës politike në ndërtimin e marrëdhënies shtet shoqëri ka një lidhje shkakësore mes tyre, ku duhet përcaktuar drejtimi në të cilin vepron, të përmirësimit apo të uljes së këtij raporti. Analiza korrelative na ndihmon të japim shpjegim se si, kur njëra madhësi ndryshon dhe tjetrën, pra kur elita politike me performancën e saj ndryshon në mënyrë negativ apo pozitive, ndryshon dhe marrëdhënia shtet me shoqërinë, pra me qytetarët e tij. Pra ndikimi i elitës politike në marrëdhënien shtet shoqëri gjatë bashkëveprimit të tyre herë largohen e herë afrohen, por gjithmonë shoqërojnë njëra tjetrën. Kur me rritjen e njërit variabël, kemi dhe rritjen e variablit tjetër atëherë korrelacioni mes tyre është pozitiv, pra në rast se do të kishim ndikim pozitiv të elitës politike, normalisht dhe marrëdhënia mes shteti dhe shoqërisë do të ishte pozitive, dhe për pasojë do të kishim demokraci më të konsoliduar, në rast të uljes së këtij raporti atëherë kjo jep shkak për qarkullim të elitës.

KAPITULLI I

Përkufizimet teorike për termin elitë

Në përpjekjet për të përcaktuar termin elitë padyshim që veprat e Pareto-s, Mosca-s, S.W. Milles mbeten klasikët e teorive elitiste. Klasikët në përgjithësi, në veprat e tyre shqyrtojnë ekzistencën dhe natyrën e elitës së përbashkuar në shoqëri e cila i sundon punët në shoqëri. Sikurse shprehet dhe G. Parry në studimin e tij Elitat Politike “Thelbi i doktrinës elitiste është se, në shoqëri mund të ekzistojë një pakicë popullsie që merr vendimet e mëdha” (në G. Parry, 2010, fq 48).

Teoritë elitiste konvergojnë të gjitha mbi faktin që në shoqëri është një minorancë në pushtet dhe një mazhorancë që i nënshtrohet asaj. Midis studiuesve më të rëndësishëm të kësaj rryme janë: Gaetano Mosca, Vilfredo Pareto, Robert Michels. Me interes të vecantë janë studimet e kryera nga Michels mbi partitë politike dhe organizimin e tyre. Duke analizuar strukturën e partive ai formuloi “ligjin e hekurt të oligarkisë”, nëpërmjet të cilit ai vuri në dukje se si partitë tentojnë të koncentrojnë pushtetin në një rreth të kufizuar njërzish, duke krijuar një shkëputje gjithmonë e më të madhe midis drejtuesve të partisë dhe anëtarëve të saj. Një distancë e tillë, sipas Michels, provokon një organizim oligarkik të partisë. Forma oligarkike bën që drejtuesit të ndjekin në fakt interesat e tyre dhe vetëm formalisht interesat e masës së partisë. Michels tregoi se si organizimi oligarkik i partive lejon të koncentrohet pushteti në duart e pak drejtuesve, duke penguar që kandidaturat politike të bëhen nga poshtë. Kjo ndodh kur partitë janë një organizatë komplekse, që për t’u drejtuar ka nevojë për kompetenca specifike ata që zotërojnë këto kompetenca formojnë atë oligarki që duke u strukturuar në mënyrë

burokratike, vë në duart e drejtuesve pushtetin vendimmarrës, që duhet ta kishin bashkë me antarësinë e partisë.

Nëse përcaktimi i termit shikohet nga ky këndvështrim klasik, vendimet që merren nga kjo pakicë kanë një ndikim të madh në shoqëri, në të gjitha aspektet e përgjithshme të saj dhe, në të shumtën e rasteve, merren si vendime politike; pra, të marra nga ajo pakicë e shoqërisë të cilët quhen “*politikanë*” dhe, në kuptimin e zakonshëm të saj, kjo pakicë duhet të jetë pjesë e një qeverie apo legjislativi.

Duke iu referuar qasjes psikologjike të Pareto-s në lidhje formimin e elitës, në teorinë e tij, kjo elitë është parë në këndvështrimin gjithëpërfshirës më shumë sesa nga studiuesit e tjerë të elitave. Për Pareton, teoria e elitës duhet parë si pjesë e një sociologjie shumë të përgjithshme, që mund të shpjegohet duke iu referuar disa faktorëve sociologjikë themelorë ku, si rrjedhim i kësaj, elitat shihen si një produkt jo vetëm i forcave ekonomike dhe i atyre që kanë arritur të vënë aftësitë e tyre organizative për të sunduar, por duhet të shihen si rezultat i vetive njerëzore të pandryshueshme përgjatë historisë. Bazuar në këtë pikëpamje, Pareto sugjeroi krijimin e një klase me persona që kanë treguesit më të lartë në çdo fushë të veprimtarisë dhe e quajti elitë. Në vijim kjo elitë ndahet në elitë qeverisëse dhe joqeverisëse.

Bazuar në pikëpamjet e tij organizative, Mosca shprehet: “*Në të gjitha shoqëritë shfaqen dy klasa njerëzish, një klasë që sundon dhe një që sundohet. Klasa e parë gjithmonë është e paktë në numër dhe kryen të gjitha funksionet politike, monopolizon pushtetin dhe gëzon të mirat që sjell ky pushtet. Ndërsa e dyta, që është dhe klasa më e madhe në numër, drejtohet dhe kontrollohet nga e para në mënyrë herë-herë legale dhe herë-herë pak a shumë të dhunshme dhe arbitrare. Gjithashtu furnizon të parën, të*

paktën në dukje, me mjete materiale e të mbijetesës dhe me instrumente që janë thelbësore për mbijetesën e organizmit politik” (në G. Parry, 2010, fq 55).

Këtë arsyetim Mosca e bazon në të gjitha periudhat e historisë, dhe kjo vjen për shkak të uniformitetit të natyrës njerëzore dhe suazës sociale që rrjedh prej saj. Referuar pikëpamjes së Mosca-s të qasjes organizative, kontrolli i elitës qëndron në aftësinë e një pakice për t’u organizuar. Pozicionimi i elitës varet nga ajo se sa anëtarët e kësaj elite e zotërojnë këtë fakt në vlerësimin e njerëzve dhe të disa vetive që çmohen në shoqëri. “Një pakicë ka përparësi, thjesht se është pakicë”, theksonte Mosca në (G. Parry, 2010, fq 56).

Për Michels-in argumenti elitist është se, çfarëdolloj mekanizmesh demokratikë që të përdoren, pakica mbizotëruese nuk mund të kontrollohet nga shumica. Ai shprehet: “Evolucioni historik tallet me të gjitha masat profilaktike që janë përdorur për parandalimin e oligarkisë. Nëse vihen ligje për të kontrolluar sundimin e krerëve, është ligji ai që është dora-dorës zbehet, dhe jo krerët (në G. Parry, 2010, fq 74).

Parë nga këndvështrimi i qasjes ekonomike të Burnham, i cili në veprën e tij “Revolucioni menaxherial” pretendon se sistemi kapitalist është në bjerrje dhe se do të zëvendësohet nga një shoqëri e kontrolluar ekonomikisht dhe politikisht në një elitë menaxheriale. Sipas tij, kriza e kapitalizmit vjen nga fakti se, “pronarët“ formalë të forcave prodhuese, që janë kapitalistët, largohen gjithnjë e më shumë nga operacionet e sotme të prodhimit. Në këtë mënyrë, ata të cilët në krye të herës ishin menaxherë të sipërmarrjeve të tyre, e lanë këtë veprimtari në duart e menaxherëve të tyre dhe u përqendruan te financimi - nivel ky i shkëputur nga procesi prodhues. Kjo fazë e bjerrjes së sistemit kapitalist, sipas Burnham krijoi një “klasë të ngeshme” (në G.Parry, 2010, po aty).

Në këndvështrimin e Burnham-it qeverisja do të vijë duke u bërë një çështje e veprimit ekzekutiv më tepër sesa e legjislacionit dhe do të drejtohet nga burokratët kudo qofshin ata - pra, njerëz më të ngjashëm me “menaxherët” sesa me “politikanët” e kohës kapitaliste - dhe dikotomi mes shtetit dhe kapitalizmit do të reshtë atëherë kur industria të bëhet drejtpeshuese dhe kur personeli menaxherial e burokracia shtetërore t’i zënë vendin njëra-tjetrës, për shkak të ngjashmërive të funksioneve dhe metodave të tyre. Këtë lloj të ri të sundimit të elitës Burnham e cilëson “elitizëm me aromë marksiste” (në G. Parry, 2010, fq76). Por në rastin shqiptar për elitën e pas viteve 90’ nuk mund të flitet për një elitë autonome teknokrate e menaxheriale që të ketë patur ndikimin apo peshën e vet në proceset e marrëdhënieve mes shtetit e shoqërisë, pasi fraksioni i cili ka patur më shumë dominancë ka qënë elita politike që e ka dominuar këtë marrëdhënie pas viteve 90’. Por duhet theksuar që në vitet e fundit vihet re një zbehje e rolit të elitës politike me origjinë në fillim të viteve 90’ dhe një shtim i ndikimit të elitave ekonomike e teknokratike. Kjo ka ardhur si pasojë e zhvillimit ekonomik e shoqëror që po përjeton vendi, pavarësisht niveli të tyre.

C.W. Right Milles beson se statusi dhe përbërja e elitës nuk shpjegohet saktë nëpërmjet talentit apo edhe psikologjisë së individëve të cilët janë anëtarë të një shoqërie, por duhet të studiohet edhe konteksti i strukturës ekonomike dhe sociale të një shoqërie të dhënë. Milles e sheh pushtetin të bashkëlidhur jo me mjetet e prodhimit, si Burnham, por me një suazë më të gjerë institucionesh, që përfshijnë ushtarakët, korporatat e mëdha dhe ekzekutivin politik (rasti i SHBA-ve, ku ai u përqendrua në studimin e tij).

Teoritë “neELITISTE” pohojnë se si pushteti politik-administrativ, ashtu dhe pushteti social në përgjithësi janë të lidhur me pasurinë ekonomike të një rrethi të kufizuar personash. Floyd Hunter, një eksponent i rëndësishëm i kësaj rryme mendimi, pasi kreu studimet mbi një qytet amerikan, arriti në konkluzionin se burimi kryesor i pushtetit

është pasuria ekonomike. Fenomen ky që ka filluar dhe në shqipëri dhe që mund të ilustruhet nëpërmjet qeverisjes së fundit me aplikimin e partenritetit publik privat (PPP). Ai vuri në dukje që jeta politike e një qyteti është e përcaktuar nga interesat e sipërmarrësve. Sipas Hunter, vendimet e rëndësishme për një qytet merren nga ata që zotërojnë pasurinë ekonomike. Vendime të tilla nuk formalizohen në brendësi të një pallati politik, por janë rezultat i mbledhjeve të “nivelet të lartë” që zhvillohen në klubet ose banesat private.

Një studjues tjetër i rëndësishëm i kësaj rryme është Charles Wright Mills. Sipas Mills kjo përputhje e interesave bën që pushteti politik të jetë vetëm formalisht dhe në dukje demokratik, ndërsa në realitet ai është thjesht oligarkik. Tezat e Mills mund të sintetizohen si më poshtë: është vetëm një klasë drejtuese e përbërë nga sipërmarrës, politikanë dhe ushtarakë, një klasë e tillë drejtuese merr lirisht vendimet pa iu nënshtruar një kontrolli efektiv popullor. Dominimi i kësaj elite mbi shoqërinë është pothuaj total.

Xhovani Sartori, 1993, një nga studiuesit më të rëndësishëm të teorive të demokracisë, përcaktimin e kuptimit të termiit “elitë “ e sheh në shumëllojshmërinë e emërtimeve të saj, si elitë politike, elitë sunduese, elitë në pushtet apo edhe pakicë udhëheqëse. Por kjo shumëllojshmëri, sipas tij, në asnjë mënyrë nuk tregon epërsinë e kësaj “pakice“ kundrejt shumicës – pra, të pasjes së një emri për çdo kuptim. Sipas tij, përdorimi i shumë emërtimeve për të treguar të njëjtin koncept apo koncepte të ndryshme, mbulohet nga i njëjti emërtim. Referuar sistemit të demokracisë vertikale Sartori thekson se “pastrimi i terrenit nga këto emërtime që përmenden më lart, ka të bëjë me faktin se ato janë një pjesë e vogël konkrete, dhe jo më një pakicë, si rezultat i procedurave demokratike. Gjithashtu ka të bëjë edhe me faktin se, kur kryet një analizë demokracisë, studiuesi nuk interesohet në asnjë mënyrë për një pakicë substantive, por

vetëm për pakicat të cilat, të gjitha së bashku, përbëjnë një grup kontrolli. Natyrisht duhet përcaktuar objekti i hulumtimeve që janë gjerësia dhe mënyra e pushtetit të kontrollit politik të grupeve më të vogla sesa gjysma e mbi të cilët ushtrohet pushteti, ku tiparet e këtij grupi kontrolli në vendin tonë janë ato të një elite të mbyllur ndaj aktorëve të tjerë, tipa i cili argumentohet me jetëgjatësinë apo kohëzgjatjen e madhe të individëve në politikë me afro dy dekada, si dhe një elitë e cila nuk prezanton një traditë të njëjtë të arsimit, çka ul efikasitetin e prezantimit të problemeve sociale dhe përfaqësimin e tyre.

Autori thekson se, një pushtet kontrolli është politik kur baza e tij është një funksion politik, kurdoherë vepron nëpërmjet kanaleve të politikës dhe ka të bëjë me vendimet e atyre që bëjnë politikën (në G. Sartori, 1993, fq 155).

Sartori, për përcaktimin apo edhe dallimin e një pakice kontrolli, siç i quan ai, thekson dy nga kriteret kryesore: a) *ai altimetrik*, që ka të bëjë me faktin se, një grup kontrolli është i tillë pasi, në strukturimin vertikal të shoqërisë ai ndodhet në majë, (në G. Sartori, 1993: fq po aty) themi se në çdo shoqëri pushtetin e ka klasa që është në majë të pushtetit. Kjo, sipas autorit, është mbështetur në hamendësimet: po të kesh pushtet je në majë; kush ka pushtet është në majë; ke pushtet, sepse je në majë. Kjo vlen përderisa kemi të bëjmë me një piramidë pushteti, por nuk funksionon aq mirë kur kemi të bëjmë me një konfiguracion të pushtetit pa kulm. Autori argumenton se kriteri altimetrik i përshtatet dhe një stratarkie, vetëm se duhet të përcaktojmë se secila shtresë ka majën e vet, b) kriteri tjetër, sipas autorit, është ai i *meritokracisë* që do të thotë se, struktura vertikale e shoqërisë duhet t'i besohet atij që ka aftësitë më të lartë. Nga kjo pikëpamje nuk je në majë se ke pushtet, përkundrazi ke pushtet dhe je në majë sepse e meriton atë. Termi elitë, sipas Pareto, ka fituar pasi ka shkuar afër përcaktimit të plotë. Ai shprehet sikurse vijon:

“Këto klasa njerëz të radhitur sipas shkallës së ndikimit dhe të pushtetit të tyre politik dhe shoqëror, dhe të ashtuquajturat klasa superiore përbëjnë një elitë. Gjersa ekuilibri shoqëror është i qëndrueshëm, shumica e pjesëtarëve që e përbëjnë atë dalin të pajisur më shumë se të tjerët me veti, të mira ose të këqija, që sigurojnë pushtetin “(në G.Sartori 1993, fq 156).

Pra koncepti i Pareto, sipas Sartorit, në radhë të parë është një koncept cilësor dhe bëhet altimetrik vetëm si rrjedhim dhe që, sigurisht, ky rrjedhim altimetrik jep çelësin për qarkullimin e elitave, për të cilin flet Pareto. Kur merita dhe pushteti bëhen bashkë, kemi një gjendje të qëndrueshme shoqërore; kur ato ndahen, kemi një çekuilibër, që jep shkas për qarkullim. Elitat altimetrike ose *de facto*, zhvendosen nga elitat e të aftëve - pra, nga elitat e vërteta. Sipas autorit, të dy konceptet lidhen sipas radhës dhe që, sipas Pareto, ajo që del fitimtare në fund të fundit gjatë zhvillimit të historisë është elita e të aftëve dhe jo elita e atyre që janë në pushtet.

Përveç konceptit cilësor Pareto në lidhje me zëvendësimin e elitave apo qarkullimin e tyre, ku sipas tij procesi i zëvendësimit të elitës ndodh në dy mënyra a) përmes një revvolucioni të dhunshëm që sjell përmbysjen e zëvendësimit të plotë të një elite nga një tjetër b) përmes një procesi të përshkallëzuar të depërtimit. Këtë model ai e perceptoi përmes dy kategorive të elitës, ku sipas të cilit ekziston një alternim i pandërprerë mes një elite me mbetje mbizotëruese të kategorisë së parë që ai i quan “dhelprat” që janë mendje buta ose dinakët politikë , dhe kategoria e dytë një elitë me një mbizotërim të mbetjeve të kategorisë së dytë “ luanët” mendje forta elitat e ngurta ndaj ndryshimeve në (G.Perry, 2010 fq 86). Në Shqipëri ka ndodhur procesi i përshkallëzimit të elitës intelektuale të niveleve të dyta e të treta të ish administratës komuniste në fillim të viteve 90’, dhe elitat e viteve 90 janë elita që burojnë nga një përmbysje jo e dhunshme e pushtetit , por nga një transformim i sistemit politik dhe

ekonomik, pasojë kjo e ndryshimeve që ndodhën në gjithë Bllokun e Lindjes së europiane. Të dyja këto tipa të elitave sipas autorit shpjegohen me termat psikologjikë, dhe që i bëjnë të paafta të dy elita në mënyrat e tyre që të qeverisin. Duke qënë se elita e dhelprave etiketohet nga mprehtësia dhe zotësia për manivrat politike, formimi i koalicioneve partiake, aftësi për të formuluar politika afatshkrutëra që puqen me krizat e përnjherëshme. Aftësia e kësaj kategorie shfaqet në përligjen ideologjike që ajo sajton për shumë nga pozicionet e saj politike. Ndaj autori sugjeron se në politikë dinakëria nuk mjafton në vetvete, por nuk mjafton dhe forca dhe respekti për rendin si tipar i “luanëve”, pasi tendënca e një elite luanesh është që të bëhet i ngurtë ndaj ndryshimeve dhe mosreaguese ndaj ndryshimeve. Ndaj zgjidhja është që të pranojë individët që i përkqsin kategorisë së parë të elitës në mënyrë që të plotësojë apo ndreqë mungesat e saj intelektuale dhe ekonomike. Ky proces do të mundësojë qarkullimin shoqëror, ku hyrja e kategorisë së parë të “dhelprave” në elitë bëhet përmes këtij procesi të qarkullimit shoqëror, përmes ripërtëritjes molekulare kategoria e dhelprave shndërrohet në elitë me një hyrje të shkallëzuar, ndërsa luanët e fitojnë pushtetin nga revolta e beftë revolta revolucionare.

Arsimimi padyshim që ka një lidhje shumë të ngushtë me elitën e një vendi. Por gjithnjë sipas elitistëve duhet bërë dallimin e atij arsimimi që formon dhe edukon jashtë politikës dhe edukimit që është politik. Studiuesi elitist Ralph H. Turner në (G.Perry, 2010 fq 115) thekson se janë dy tipa idealë të cilëve u afrohet sistemi arsimor dhe që veprojnë si rregullator të sistemit të cilin ndjekin njëzëit, ku tipi i parë është ai i qarkullimit garues ku elita është e hapur ndaj çdo personi që është i suksesshëm dhe ku të gjithë mund të kyjnë dhe të mbahe në garë. Ky tip çmon ambicien dhe përpjekjen dhe elita përbëhet nga ata që kanë shansin për ta arritur, ndërsa tipi dytë është ai alternativ qarkullim i mbështetur dhe kriteret e pjesëmarrjes

kuptohet plotësisht nga ata që janë ndërkaq anëtarë. Të dy këto tipe janë të dallueshme për nga natyra dhe përmasat e tyre, ku sipas autorit për tu bërë pjesë e elitës të dy këto tipe kanë modelin e tyre që aspirantit duhet të plotësojë.

Sartori mendon se, më shumë se të tjerët, ai që arriti të përcaktojë termin “elitë” është Lasuelli. Elitën, si kategori e përgjithshme, Sartori e quante “modeli i elitës sunduese”. Në ndryshim nga Pareto i cili kishte konceptin, Lasuelli adoptoi vetëm fjalën pasi, sipas G.Sartori 1993, te Lasuelli konotacioni cilësor i termit “elitë” zhduket. Në një nga përcaktimet e Lasuelli-it, sipas autorit, ai shprehet: “Elita politike është maja e klasës në pushtet”. Pra, sikurse vërehet, konotacioni është thjesht altimetrik, ndërsa në pasazhe të tjera konotacioni i termit është thjesht ai i “pasjes së pushtetit”. Për shembull, “elitat janë ato që kanë më shumë pushtet në një grup të dhënë”. Në ndryshim nga Pareto, Lasuelli thekson një transformim rrënjësor të konceptit, ku merita zëvendësohet nga mungesa e meritës. Ky transformim i termit ka të bëjë me semantikën e termit “elitë”, pasi merita ka vlera analitike dhe, sipas autorit, shtrembërimi semantik i termit sjell edhe shtrembërim të konceptit. Sipas Sartorit, thelbi i analizës së përcaktimit të termit qëndron në përpjekjen për t’u dhënë koncepteve një strukturë të përgjithshme për formulimet e koncepteve. Subjekti i parë janë grupet e kontrollit, formulim që e shpreh çështjen më mirë se çdo formulim tjetër. Subjekti dyti, përmirësimin e koncepteve të Pareto dhe Lasuellit, thekson (Sartori,1993), duhet ta bëjmë si nga ana terminologjike ashtu edhe nga ajo konceptuale - strukturës së pushtetit nga struktura e elitës. Pra sipas tij, jo të gjitha grupet e kontrollit janë detyruesisht “pakica në elite” - bazuar kjo në këndvështrimin e Pareto - ato mund të jenë thjesht “pakica në pushtet”, sipas Lasuellit.

Një tjetër model i elitës sunduese që autori i referohet, është edhe R. Dahli. Në këtë model, sipas autorit, nënkuptohet dhe diskutohet ligji i klasës politike të Mosca-s, që

autori parapëlqen ta quajë “modeli i klasës sunduese“ (në *G. Sartori, 1993*). Këtu autori si të rëndësishëm thekson nocionin e sundimit. Ky nocion konceptohet në substancën e vet si sundim faktik, pasi jo të gjitha sundimet janë të njëjta pra se cili nga nocionet i përshtatet objektit të studiuar. Ndërsa kur kemi të bëjmë me “sundimin e pakicës“, nuk është fjala për një kriter, por për një udhëheqje të mirëfilltë. Sipas autorit, duhet shqyrtuar se çfarë nënkuptohet me nocionet: a) pushtetit kontrollues, b) udhëheqje dhe c) sundim.

Autori sqaron se, me nocionet “grupe kontrolli” dhe “pushtet” duhet të kemi parasysh vënien e theksit mbi mënyrat dhe mjetet konkrete të ushtrimit të pushtetit, pavarësisht se janë të konkretizuara ose të formalizuara, institucionalizuara, pavarësisht intencitetit të tyre, pra të shtrirjes në funksion të shoqërisë. Udhëheqjen e pakicës ose pakicat sunduese autori i lidh me atë të klasës sunduese, por duke theksuar se kuptimi semantik kryesor është ai i komandimit ose i drejtimit. Ndërsa me nocionin e sundimit, që i përshtatet klasës sunduese, ka parasysh përdorimin e aparatit shtetëror, që nënkupton një përdorim të fortë të komandimit pra, një lloj më intensiv të ushtrimit të pushtetit. Ky lloj ushtrimi i pushtetit në Shqipëri mund të ilustruhet me qeverisjen e periudhës 1993-1996, ku aparati shtetëror ndërmori një proces të zhvendosjes së individëve që i ciësonte si jo besnik ndaj regjimit demokratik, dhe duke përfshirë në administratë individës që përbënin mbështetje politike për regjimin, proces nga i cili ka zanafillën dhe politizimi i administratës publike në këto vite të tranzicionit. A mund të flasim për sundim, a mund të përdorim këtë term në këtë rast? Sigurisht që mund të argumentohet se procesi i mos pasjes së një administrate neutrale ëbeberiane është sa çështje politike edhe kulturore. Po në studimin e Anna-Grzymala Busse argumentohet se mospasja e një administate efikase dhe ligjeve të posaçme të shërbimit civil rrjedh edhe si pasojë e një konkurrence politike të dobët midis partive politike ku partia qeverisëse nuk vëren

ndonjë kërcënim për alternim qeverisës nga opozita dhe nuk funksionojnë mekanizma kontrolli dhe llogardhënieje. Nga ana tjetër, politizimi i administratës nuk është tipar i vetëm një partie.

Në diskutimet rreth modelit të elitës sunduese Sartori parapëlqen të theksojë se, për të përcaktuar një ligj rreth klasës sunduese si hap i parë duhet të formohet një sfond, në të cilin së pari grupet e kontrollit duhen marrë në shumës ose në njëjës, së dyti, dhe nëse këto grupe të karakterizohen nga parime si, vetëdija e grupit, koherenca dhe bashkëveprimi dhe së treti, përcaktimi i pakicave në pushtet në një sfond të dhënë.

Si përfundim autori thekson se, sipas anës në të cilën kalon prova e vërtetimit të këtyre alternativave, në njërin rast të konstatimit përmbledhet fare mirë në përcaktimin e klasës sunduese në njëjës dhe, në rastin tjetër, në cilësimin e udhëheqjes dhe të pakicave udhëheqëse në shumës. Në fund të fundit, sipas tij, në konstatimet që ne nxjerrim duhet bërë dallimi themelor midis qeverisjes me sundim dhe qeverisjes me udhëheqje. Po cili prej këtyre tipeve të sundimit ka gjetur zbatim në mjedisin politik shqiptar, gjatë tranzicionit? Natyrisht, për përgjigjen e kësaj pyetje do të duhen edhe studime të tjera, por bazuar në pikëpamjen e (Sartorit, 1993) do të përpiqemi të analizojmë ose operacionalizojmë në analizën konceptuale të çështjes.

Sipas Sartorit, modeli i Dahlit përcakton kushtet e provës për t'u siguruar që një sistem politik është i kontrolluar ose jo nga një grup në pushtet i vetëm dhe koheziv, nga një elitë sunduese (sipas modelit të Dahlit), apo nga një klasë sunduese. Për të operacionalizuar analizën konceptuale, në radhë të parë duhet të supozojmë se, nëse ka një klasë sunduese - një shoqëri në fakt, është e kontrolluar nga një klikë në pushtet atëherë një supozim i tillë nuk mund të mos i nënshtrohet provës. Në këtë rast, një klasë politike nuk është thjesht një kategori (klasë) që del nga një klasifikim, përkundrazi,

atribuojmë një ekzistencë operative konkrete. Dhe nëse ekziston në këtë mënyrë, duhet provuar që ekziston. Prandaj, thekson autori, është e domosdoshme dhe imperative të njëjtësojmë se kush është klasa sunduese, në rastin konkret elita politike parlamentare, në rast të kundërt nëse se nuk vërtetohet, supozimi bie poshtë.

Së dyti, nocionet e pushtetit dhe të kontrollit duhen operacionalizuar në mënyrë që të kenë kuptim. Dhe, sipas argumentimit të Dalit, pushteti ushtrohet sepse çështja e pushtetit lind konkretisht vetëm kur një vendim është i diskutueshëm. Kushti i provës, sipas autorit referuar pikëpamjes së Dalit është, për të provuar se një klasë sunduese ekziston, duhet të provojmë se në lidhje me një varg vendimesh të diskutueshme, një grup i njëjtësuar dhe i qëndrueshëm (grupi sundues apo ai në pushtet) fiton rregullisht, ndryshe do t'i jepej pushtet burimeve ose potencialeve të pushtetit dhe do të krijohej konfuzion.

G. Sartori paralajmëron që po të mos studiohen kriteret e ekselencës për elitën, do të humbiste atë që është thelbësore për elitën, që do të thotë që, të plotëfuqishmit ekzistojnë vetëm nëse pushteti politik është plural, në fund të fundit ata që kanë pushtetin përfaqësojnë elitat autentike të pavarura –thekson ai.

Parametrat e vlerave të elitës mund të ilustrohen duke konsideruar rekrutimin e elitës dhe cilësinë kualitative të saj. Është bindëse që rekrutimi i zgjedhur me kujdes e me cilësi të larta në pozicionet e elitave, kontribuojnë në ekselencën e efektivitetin e elitës.

Këto kushte të Dahlit, sipas autorit, janë kundërshtuar nga argumenti i Bahrah-ut dhe i Barac-it, sipas të cilëve pushtet do të thotë edhe pushtet për të mbyllur çështjet dhe për t'i zhdukur ato nga fushëkërkimi, kjo referuar edhe pikëpamjes së Shtatnaidërit i cili shprehet se, “disa çështje hyjnë në politikë ndërsa disa të tjera eliminohen prej saj” (në

G. Parry, 2010, fq 159). Mirëpo sipas autorit, kjo lidhet me njëanshmërinë, pikëpamja më e anshme është ajo që e quan gjithçka të anshme.

Megjithatë, po sipas të njëjtit autor, pikëpamja e Dahlit dhe dy kërkesat e tij: 1) një klasë sunduese (nëse merret si e tillë) duhet njëjtësuar konkretisht, dhe 2) atributet e pushtetit duhen vërtetuar, u qëndrojnë kritikave se kushtet e Dahlit janë krejt të zaptueshme në një numër sistemesh politike diktatoriale dhe në të gjitha regjimet komuniste, tek të cilat do të gjenim një grup sundues që do t'i plotësonte të gjitha kushtet e tij. Dahli i drejtohet një modeli, atij të strukturës së pushtetit, dhe jo të gjitha modeleve të strukturës së pushtetit. Sipas tij, ai demonstroi në mënyrë bindëse se përcaktimet elitë sunduese dhe elitë në pushtet në njëjës, të dyja janë të gabuara.

Të dyja keqparaqesin dhe keqkonceptojnë atë lloj strukture të pushtetit që ekziston në SHBA dhe në vendet demokratike në përgjithësi, pavarësisht se edhe demokracitë kanë një strukturë pushteti. Kjo pikëpamje sipas autorit (në G. Parry, 2010), referuar dhe ligjit të Moskës, që thotë: *“çdo shoqëri politike në strukturimin e saj vertikal merr formën e piramidës, apo kur kemi të bëjmë me një stratarki - një formë e rrafshët - atëherë ligji i Moskës, sipas autorit, është absurditet. Të gjithë e dinë se thuhet që do të ketë gjithnjë sundues dhe të sunduar, qeverisës dhe të qeverisur, por për t'i shpëtuar këtij absurdi autori thekson se duhet kuptuar, pasi ligji i Moskës nënkupton diçka më shumë, “të gjitha shoqëritë politike, në fund të fundit, kontrollohen nga një pakicë dhe këtu çështja qëndron në faktin sesi duhet kuptuar (një)”*.

Prespektivat teorike brënda të cilave mund të interpretohet tranzicioni shqiptar, janë prespektiva voluntariste dhe prespektiva institucionaliste.

Qasja voluntariste duke qënë se thekson rolin e elitës politike në proceset e demokratizimit mendojmë se në këtë pikëpamje duhet studiuar dhe ndikimi që ka luajtur elita politike shqiptare e postkomunizmit në tranzicionin shqiptar dhe në marrëdhënien mes shtetit dhe shoqërië . Kjo qasje si e tillë thekson se elita politike duke u përfshirë në proceset e gjithanëshme të njohjeve të zhvillimeve politike, dhe të zotërimit të disa shprehive demokratike si kompromisi, dialogu, konsensusi, përshtatja me situata të reja etj. Tranzicioni si një proces i tillë kërkon që të karakterizohet nga një shkallë e lartë dialogu, kompromisi, ku padyshim elita politike ka rolin e saj në këtë proces. Përveç këtyre cilësive faktor tjetër që ndikon në këtë proces janë dhe personliteti, kultura, talenti dhe nuhatja politike e elitës politike, argument i cili është i mbrojtur me forcë nga shumë studiues dhe politologë (në Gjuraj,Tonin 2015,fq 24).

Punimi mbështetet në rolin e aktorëve politikë: cilat janë botëkuptimet e tyre, cilat ideologji mbështesin, çfarë modelesh institucionale kanë krijuar? A kanë preferuar konfliktin apo konsensusin? Pse? A kanë një trajektore apo trashëgimi demokratike të ushtrimit të pushtetit apo të kundërshtimit të regjimit të shkuar në disidenca publike?

Qasja institucionaliste vlerëson dhe thekson rolin se janë institucionet, kushtet ekonomike dhe politika që formësojnë prespektivat për demokraci në shoqëritë që janë në tranzicion. Sipas tanzitologëve institucionet janë mekanizmat që ndryshojnë mjedisin shoqëror dhe politik, duke luajtur një rol përcaktues në tranzicionin dhe në konsolidimin e shtetit demokratik (në Gjuraj,Tonin 2015, fq26). Në shoqëritë tranzicionale ku bën pjesë dhe Shqipëria, institucionet janë përcaktuese në konsolidimin e një sistemi të qëndrueshëm social dhe politik, dhe në këtë pikëpamje theksohet rëndësia e tyre në këtë raport. Sipas T.Parsons (në Gjuraj,Tonin 2015, po aty) institucionet si një strukturë me një komplet rolesh, janë strategjikisht të

rëndësishme në këtë sistem, ku studiuesi i vlerëson si shtylla kurrizore e një sistemi shoqëror. Në këtë pikëpamje në analizë të performancës së tyre mund të tregohet se sa në përputhje me shoqëritë demokratike janë institucionet shqiptare gjatë tranzicionit.

Pra a janë institucionet e regjimit demokratik të qëndrueshme në rastin e Shqipërisë?
A kemi të bëjmë me një proces të konsolidimit të sistemit demokratik?

Këtu mund të thuhet se elitat politike me strategjitë e tyre, tiparet e tyre shpjegojnë më mirë dobësinë e institucioneve demokratike sesa shpjegimet kulturore si (trashëgimia otomane, trashëgimia komuniste) apo shpjegimet e tjera që lidhen me rolin e vaktët të shoqërisë civile. Vitet 1996, 1997, 1998, 2011 tregojnë për periudha të pastabilitetit të regjimit politik, mos pranimit dhe funksionimit të rregullave të konkurrencës politike, konflikteve midis elitave politike dhe vizioneve të ndryshme për shtetin, ndarjet dikotomike.

Teoria strukturore funksionaliste në qendër të kësaj rryme të mendimit është Talcott Parsons. Ai përpunoi një teori shumë komplekse mbi sistemin social. Sipas autorit, sistemi social përbëhet nga disa nënsisteme funksionale. Nënsistemet funksionale janë katër: ai ekonomik, ai kulturor, ai integrativ dhe ai politik. Teoria e Parsons kërkon të spjegojë funksionin që kryejnë nënsistemet e ndryshme të shoqërisë. Sistemi social i teorizuar nga sociologu është në një zhvillim dhe rinovim të vazhdueshëm, pra edhe funksionet e nënsistemeve tentojnë të ndryshojnë. Nënsistemi politik, i menduar nga Parsons, përdor pushtetin për të ndërvepruar me nënsistemet e tjera të shoqërisë. Në analizën e Parsons pushteti ka funksion transformimi, zhvillimi dhe integrimi të shoqërisë. Struktura politike (Shtetit) vë në punë vendimet përmes përdorimit të pushtetit. Si konkluzion, Parson pohon që pushteti politik duhet të përdoret për të

mbajtur rendin social dhe për bërë të mundur që nënsistemet e tjerë të veprojnë sa më mirë.

Tek Marksizmi prespektiva elitiste përmban udhëzime për një shoqëri të mirë në të cilën elitat efektive do të prodhonin dinjitetin individual në masë dhe mirëqënie e stabilitet politik. Në vend të saj ofroi një prognozë të matur që rrjedh nga krahasimi dhe analizat historike në të cilën organizimi social hierarkik, dhe shoqërimi me pushtet të përqëndruar shikohen si të pashmangshme. Zhvillimet politike bëhen nga interesi vetiak i elitës, dhe idealet duhet që gjithmonë të jenë të kontrolluara nga këto realitete.

Vilfredo Pareto e ruajti kuptimin evolutativ të termit elitë për të treguar individët që janë më të shkëlqyer në të gjitha rrugët e jetës si artistike, ekonomike, sociale, intelektuale etj. Ai gjithashtu etikitoj ata që zotëronin shumë pushtet e pasuri të shkëlqyer ose jo.

Elitat janë të diferencuara në mënyrë strukturore. Diferencimi ndodh parimisht në sektorë të funksional apo strategjik të shoqërisë dhe është ekonomik, politik, administrativ, ushtarak (Keller, 1963. fq 3).

Ndërkohë që këto sektorë fuqizohen apo dobësohen në fuqi dhe në rëndësinë funksionale, lidhja mes tyre dhe elitës drejtuese ndryshon, në (Putnam, 1976, fq 3). Për më tepër kontigjenti historik i krizave ndonjëherë ndryshon thellësisht lidhjet me elitën në (Dogan & Higley, 1999: fq 3).

Elitat janë të shtresëzuara në rrathë qendror, bërthama ekzekutive, udhëheqje të brendëshme, ose në “elitë brenda elitës” të cilat janë të dukshme.

Megjithatë në ditët e sotme kompleksiteti i çështjeve, shtimi i zgjedhjeve, mediat elektronike 24 orëshe dhe interneti i bëjnë elitat objekt të sulmeve dhe paralizave të

menjëherëshme që kushtëzojnë mendimin e Schumpeterit (Shumëpeterit). Vëzhgimi i mprehtë i demokracisë së sotme i përshkruajnë ato si të rrezikuara nga autonomia e ngushtuar elitike, në (Sartori 1987: 131, Hobsbawm 1994: 579, Zakaria 2003: 240-241). Ata e lidhin dështimin e elitës dhe krizat që kanë ardhur si rezultat, të lidhura me kolonizimin e fushave politike nga interesa të ndryshëm, dhe lëvizjet sociale që i lënë pak mundësi apo hapsirë elitave për të vepruar.

Dy janë çështjet që duhen theksuar, studimi fokusohet fillimisht në konsensusin ideologjik si manifestim kryesor i integritit elitar. Ky ekzaminon empirikisht se deri në çfarë shtrirje janë në konsensusin elitar, janë të lidhura me një set faktorësh që trajtohen si shkaktarë të mundshëm të këtyre variacioneve. Ndër faktorët e konsideruar janë ngjashmëritë e profileve sociale dhe edukimit në grupet individuale elitike, po ashtu dhe shtrirja e eksperiencave të ndara brënda sektorëve të veçantë të elitës, të matura nga ngjashmëria e moshës dhe qëndrimi.

Integrimi elitar në formën e konsensusit ideologjik mund të vijë se, pjestarë të një grupi të veçantë të elitës kanë ndarë eksperiencë socializimi të përbashkëta. Këto lloje eksperiencash të përbashkëta mund të jenë krijuar në fëmijëri, si rezultat i rritjes në familje që i parkasin të njëjtës klasë sociale.

Në sistemin e karrierave të hapura ose konkurruese pozicionet ose punët janë të hapura për çdo kandidat që përmbush kërkesat e cilësi të veçanta. Punët në një sistem të tillë janë të lidhura me njëra tjetrën në shkallë karriere dhe kërkesat janë “laterale”. Kështu ndërsa në sistemet e mbyllura të karrierave punonjësit e të njëjtut nivel kanë prirjet të jenë të njëjtës moshë, në sistemet e karrierave të hapura një ngjashmëri e tillë është e rrallë.

E njëjta pjesë elitare qëndroi të krijonte instirucione të reja demokratike dhe të përfitonte prej aksesit të tyre në resurset e shtetit, një mundësi e konsiderueshme ekzistonte për të mbajtur avantazhet e pozicionit ose të detyrës publike. Duke lënë sa më shumë liri veprimi që është e mundur në akseset dhe shpqrndarjen e burimeve apo të resurseve të shteittë tillësi, punët, kontratat, ose mosmarrëveshjet e privatizimit. Tentativa ose përpjekja për të ndërtuar administrata neutrale dhe institucionet mbikqyrëse , ose për të shpërndarë autoritetin në rënie, qëndronte në konflikt potencial me dëshirat e partisë për të ndërtuar bazën materiale për veten.(fq 287)

Disa studiues sugjerojnë se tranzicionet demokratike dhe dështimet në fund të fundit janë produkt i historisë së zgjedhjeve të elitës në (O'Donell& Schmitter1986: Lopez-Pintor 1987: Malloy 1987). Megjithëse ky ndryshim në fokusin normal është një hap përpara, kjo mund të çojë në një rrugë pa krye në qoftë se nuk është i përpunuar thellësisht.

Një elitë kombëtare e përçarë e cila është tipi më i zakonshëm, prodhon një seri të regjimeve të paqëndrueshme, të cilat tentojnë të lëkunden midis autoritarizmit dhe formave demokratike në intervale të ndryshme. Një elitë kombëtare e bashkuar konsensualisht e cila historikisht është më e rrallë, prodhon një regjim të stabilizuar i cili mund të evoluojë në një demokraci moderne, si në Suedi, Britani, SH.B.A, e Norvegji.

Paaftësia për të parë këtë faktor ka çuar shumë studiues në ekzagjerimin e kuptimit afatgjatë të tranzicioneve të tilla dhe të dështimeve, dhe i ka lënë ata të papërgatitur për të shpjeguar anullimet në formën e regjimeve që zakonisht pasojnë.

Interesi kryesor është të shpjegimi se si marrëdhëniet ndërmjet elitës ndikojnë në stabilitetin e regjimit.

Brënda kësaj kornize të referimit autorët konceptojnë elitat kombëtare si persona të cilët janë në gjëndje që me anë të pozicioneve të fuqishme autoritare në organizatat e fuqishme dhe organizata të çfarëdo lloji tjetër ndikojnë në rezultatet e politikës kombëtare rregullisht dhe thelbësisht.

Studiuesit të cilët fokusohen në variacionet e elitave kombëtare nëpërgjithësi dallojnë tre tipe bazë: 1) pluralistët ose tipi i bashkuar konsensualisht që ekziston më së shumti në shoqëritë përëndimore sot dhe që ekzistonte në disa prej tyre dhe më përpara, 2) totalitaristët ose tipi i bashkuar ideologjikisht në shtetet kombëtare të organizuara përkrah komunistëve, fashiste, dhe teokratike, 3) elitat e përçara ose të ndara të pabashkuara të shume vendeve edhe në kohët më parpara dhe tani në (Aron 1950, Dahrendorf 1967, Putnam 1976, Welsh 1979, Burton & Higley 1987).

Një elitë kombëtare është konsensuale dhe e bashkuar kur anëtarët e saj ndajnë 1)konsensus të pashprehur rreth rregullave dhe kodeve të sjelljes politike në një partishmëri të përmbajtur (Preëitt &Stoune 1973, Di Palma 1973, fq 248), 2) marrin pjesë në një strukturë pak a shumë tërësisht të integruar të ndërveprimit që iu mundëson ose siguron ata me besueshmëri dhe akses efektiv tek njëri tjetri dhe tek vendimmarrësit më kryesor (Kadushin 1979 , Higley & Moore 1981).

Kjo shpjegon se përse personat elitar dhe fraksionet të cilët rregullisht marrin pozicione ideologjike kundërshtuesenë publik, vazhdimisht përmbahen për të mos i çuar kundërshtimet e tyre deri në konflikt të dhunshëm. Prandaj autorët tipik të elitave vlerësojnë konsiderueshëm sigurinë personale në shumë, ata nuk presin që të vriten,

burgosen, ose të penalizohen ashpër sepse përfunduan në krahun humbës të një diskutimi politik. Nga kjo rrjedh që sapo ky tip i elitës kombëtare të jetë krijuar, dhe për sa kohë që ajo vazhdon, përvetësimi me forcë i pushtetit qeveritar nga një ose tjetër fraksion i pakënaqur nuk do të ndodhë.

Për më shumë akomoduar dhe përshtatur ndryshimet duke kundërshtuar në mënyrë të vazhdueshme interesat e këtyre fraksioneve, në një elitë të tillë politike institucionet politike do të jenë të strukturuar përkrah përfaqësuesve të paktën linjat parademokratike. Megjithatë shtrirja e përfaqësuesve mund të varë në të tjerë kushtet lehtësuese.

Në të kundërt një elitë kombëtare është e pabashkuar kur 1) autorët ndajnë pak ose nuk kuptohen aspak për vetitë e sjalljeve politik, 2) autorët angazhohet në ndërveprime sporadike nëpër kufinj të fraksional ose sektorial. Situata themelore e individëve që përbëjnë këtë tip elite është një , e një pasigurie të madhe, frika zakonisht e rreënjosur në eksperiencë që gjithçka humbet në qoftë se një person ose një fraksion tjetër merr drejtimin.

Në përputhje me rrethanat autorët e një elite të përçarë në mënyrë rutinë marrin masa ekstreme për të mbrojtur veten dhe interesat e tyre “ duke vrarë, burgosur, duke larguar ose penguar kundërshtarin, duke nxitur rebelime kundrejt fraksioneve, duke u hequr kundërshtarëve burimet e kështu me radhë.

Studimi Mc Donoughs(fq 249) portretizon një elitë të ndarë në, qeveri ushtarake, ekonomike, kishës, klasës punëtore , të cilat u polarizuan mbi bazat e lojës politike, kjo përfshinte që faktorët e jashtëm të elitës kombëtare franceze ishte mungesë e

marrëveshjenë politikat bazë të “institucioneve shtetërore “ dhe një mungesë e kontakteve të gjëra personale ndërmjet faktorëve kryesor të elitës.

Pasoja kryesore politike e përçarjes së elitës është destabiliteti i regjimit. Si provë e regjimit destabiliteti ka disa kuptime (Sanders 1981) identifikon 3 kuptime: 1) incidente të mëdha të dhunës politike në formën e revoltave, trazirave, grevave, shkatërrimet në masë dhe veprimet individuale, 2) ndryshimet frekvente në përbërjen e koalicioneve dhe kabineteve qeveritare , 3) dukuritë e grushteve të shtetit ose forma të tjera të rrëzimit të qeverive . Kjo çon në propozimin që të ndodhë një tranzicion i gjatë demokratik elita kombëtare sëpari duhet të transformohet nga përçarja në një bashkim konsensual. Shkurt kur analizojmë ndryshimet e regjimeve kërkimet duhet të përqëndrohen në strukturën themelore të elitës, duke kërkuar prova të kohëve të fundit ose historike të një transformimi elitar. Fatkeqësisht sociologjistët politikë nuk e kanë eksploruar akoma këtë çështje në thellësinë (Burton& Higley 1987). Së fundmi kanë analizuar një lloj transformimi elitar: zgjedhja e elitës në të cilën faktorët elitar konkurrentë , papritur ose qëllimisht riorganizojnë marrëdhëniet e tyre duke negociuar kompromiset në bazë të mosmarrveshjeve të tyre temelore, në këtë mënyrë arrijnë bashkimin konsensual dhe shtrijnë bazat për një regjim demokratik të qëndrueshëm. Kështu në Prusi, Belgjikë, Gjermani,mbas 1871 dhe në Itali mbas 1870, elitat nuk ranë dakort tërësisht për kushtetutat dhe institucionet në të cilat kombi i tyre shtrihej dhe ato mbrojtën ose përmbysën qeveritë sipas interesave të tyre të ngushtë.

Kështu gjatë 1950 dhe fillimit të 1960 kur shumë vende të sapo shpallura të pavarura e në zhvillim e sipër, dukshëm ishin duke konsoliduar regjimet e tyre demokratike, dhe kur shumica e vendeve latino- amerikane dukej që po lëviznin drejt demokracisë, komparativistët dukej se ishin të shqetësuar ose të preokopuar me teoritë e kushteve

socio-ekonomike të regjimit demokratik (Lipset 1959, Cutright 1963), kulturat politike në të cilat ato gjoja janë rrënjësuar (Lipset 1963, Almond & Verba 1963), dhe aspekte të tjetër të zhvillimit apo të evoluimit politik drejt demokracisë (Huntington 1968, Huntington & Dominges 1975). Në vend të kësaj ata u mbështetën në koalicione të brishta dhe në rrugë qorre përkrah elitave të përçara në parim, dhe zgjatja e tyre mundësisht varet në një pjesë të mirë të fatit. Herët apo vonë ato kishin të ngjarë të thyhenpërballë një krize politike.

Për tranzicionet demokratike si rrethanë kritike shumë studiues kanë sugjeruar se argumenti Linzian shkon shumë larg, dhe me asgjë tjetër përveçse korrelacioneve empirike, ndërmjet sistemit presidencial dhe ndryshimeve demokratike (Cheibub 2007, Horowitz 1990, Poëer & Gasiorowski 1997).

KAPITULLI II

Rënia e sistemit komunist në Shqipëri, vendosja e sistemit demokratik dhe formimi i elitës së re politike

2.1 Lëvizja studentore, dhe lindja e pluralizmit politik

Në fillim të viteve '90 filloj veprimtaria antiqeveritare e qarqeve studentore dhe intelektuale dhe po përhapej gjithnjë e më shumë mes studentëve të Universitetit të Tiranës. “Pavarësisht se shumica e këtyre studentëve vinin nga familje komunistësh, pasi jo të gjithë kishin të drejtë në Arsimit të Lartë, element që tregon se kjo ishte pjesa e zgjedhur e shoqërisë shqiptare që po e kundërshtonte regjimin¹”. Ata ishin më të predispozuar për veprime të hapura antiqeveritare sesa intelektualët apo masat popullore në përgjithësi. Pas kundërshtive që vinin nga Universiteti i Tiranës, në gjirin e të cilit kishte studentë nga e gjithë Shqipëria, qeveria e Adil Çarçanit u detyrua të takohet me një grup studentësh, të cilët paraqitën kërkesat e tyre për përmirësimin e kushteve të studentëve. Por qeveria nuk iu përgjigj këtyre kërkesave dhe më datë 8 dhjetor studentët organizuan një demonstratë që detyroi Adil Çarçanin të shkonte në Qytetin Studenti. Ky takim dështoi për shkak të qëndrimit që mbajti kryeministri i asaj kohe. Si pasojë e këmbënguljes së studentëve në kërkesat e tyre, presidenti i asaj kohe, Ramiz Alia, u detyrua të presë një përfaqësi të studentëve, prej katërmbëdhjetë vetash, e kryesuar nga Azem Hajdari (E. Biberaj, 2001). Përplasja mes studentëve dhe forcave të Sigurimit të Shtetit ishte një tregues i përpyekjeve të dëshpëruara të komunistëve për të penguar studentët të marshonin drejt qendrës së Tiranës. Megjithatë shumica e qytetarëve të Tiranës qëndruan indiferentë për këto ngjarje, jehona e tyre bëri që t'u bashkohen edhe intelektualët. Ishte pikërisht përkrahja popullore me anë të

demostratave popullore që iu dha mbështetjen e duhur lëvizjes studentore e cila me iniciativën e saj bëri reale dhe të mundur lindjen e pluralizmit politik shqiptar me themelimin e partisë së parë opozitare në Shqipëri PD, ndaj dhe kjo lëvizje shënon një pikë tepër të rëndësishme në procesin e vendosjes së demokracisë në Shqipëri, dhe që e vuri pushtetin e kohës në një pozitë të vështirë përballë kërkesave të studentëve dhe intelektualë për vendosjen e pluralizmit politik në vend. Në përbërje të Komisionit nismëtar të themelimit të PD krahas studentëve si Azem Hajdari, Shinas Rama, Alma Bendo, Arben Meçe, Blendi Gonxhe etj, në të u zgjodhën dhe Sali Berisha, Gramoz Pashko, Eduard Selami, Genc Ruli, Arben Demeti, Mitro Çela, Merita Zaloshnja, Sokrat Nesturi, Edmond Budina Ilir Myftari, Bardhyl Reso dhe Preç Zogaj (në P. Zogaj, 2014 fq 93) sipas autorit kompozimi ishte rastësor dhe që përfshinte grupimet që kishin sensibilitet dhe që kishin rënë në sy në atë kohë të ndryshimeve. Nga ana tjetër po të vërehet përbërja e Komisionit dallohet një ndërthurjen në përbërjen e tij ndërmjet studentëve dhe intelektualëve të cilët ishin formuar nga ana profesionale dhe intelektuale nga ish regjimi, element i cili në jëtësimin e PD do të prodhonte brënda saj dhe fraksione të elitës së saj si antikomunistët radikale dhe ata të moderuar. Që në momentet e para të jetës së saj në PD kishte përplasje të vazhdueshme element të cilin Preç Zogaj e pohon në librin e tij në (P.Zogaj, 2014 fq 131) ku shprehet se sidomos mes Shinas Ramës dhe Sali Berishës “ një herë pashë duke debatuar, ndoshta ka qënë debati kur Shinas iku dhe nuk u kthye më”, tjetër fakt që e pohon fraksionimin në PD është dhe shkarkimi i A.Hajdarit si kryetar i PD,debatë të ashpra në lidhje me rrjedhën që do të merrte PD janë zhvilluar nga Edi Rama në momentet e para të themelimit të saj lidhur me kritikën që u kishte bërë për individët të organizuar në krey të partisë, por dhe me mënyrën e organizimit e të konceptimit të lëvizjes politike. Në një intervistë dhënë studiueses Luljeta Progni (2013, fq 90) shprehet se “ atë ditë kur hyra në PD ose më

saktë kur shkova në PD, e cila aspo ishte krijuar, u largova menjherë sepse pata një konflikt me ata që gjeta aty. Ne ishim shumë më përrara sepse në bisedat tona kishim strategjidhe pritshmëri tjetër për të ardhmen. Për ne Ramiz Alia ishte kundërshtari. Për ne Ramiz Alia nuk ishte njeriu që po sillte demokracinë , por ishte thjesht regjimi komunist në Shqipëri. Ky është konflikti me ata që gjeta aty” . Më tej Rama thotë se në një takim me Arben Imamin i cili këmbëngulte që të kthehesha në PD , ndërsa unë këmbëngulja që të largonin më parë komunistin që kishin në PD sepse do ti merrte të gjithë në qafë. Imami kishte këmbëngulur se kishin nevojë për intelektualë në zë, qëti jepnin peshë dhe seriozitet asaj çfarë po bënin pasi ishte fillimi dhe s’kishin eksperiencë. Ndërsa unë i thashë, se Sali Berisha është komunisti tipik dhe ka gjithë eksperiencën si sekretar partie të ju eliminojë të gjithëve”.

Në takimin e 11 dhjetorit 1990, presidenti Alia pranon në takimin me përfaqësinë e studentëve vendosjen e pluralizmit politik dhe fundin e regjimit komunist në Shqipëri. Pavarësisht kësaj, krerët komunistë u angazhuan që të konkurronin në zgjedhjet e para pluraliste ishin individë të cilët, së bashku me subjektet që përfaqësonin, të ishin mbështetës të lojës politike të ish-komunistëve siç ishte konkurimi i R.Alisë përballë Franko Krroqit si deputet demokrat , F.Nano etj në (Zogaj, Preç. 2014 fq 254), kjo në analizë të subjekteve politike që morën pjesë në zgjedhjet e vitit 1990 si PD,organizata politike Omonia.

Influenca e komunistëve në krijimin e partive opozitare në Shqipëri në fillim të viteve ’90 është e kuptueshme, pasi edhe vetë liderët e këtyre partive që u krijuan, pas përplasjes së studentëve me sistemin, vinin nga radhët e ish-komunistëve. Në një intervistë të dhënë për gazetarin Apostol Duka (2006) në vitin 1995, Sofokli Lazri, studiues dhe pedagog i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike në UT, lidhur me

krijimin e Partisë Demokratike dhe zërat se kjo parti u krijua nën ndikimin e Ramiz Alisë rrëfen se :

“Që të krijohet një parti, dhe veçanërisht një parti e madhe si ajo demokratike, kërkohet një grumbullim i konsiderueshëm nismëtarësh, me formim dhe bindje të caktuara, me një program të caktuar dhe një mbështetje të caktuar tek masat. Të gjitha këto nuk mund t’i realizojë një prapaskenë dhe as një person që nuk ka lidhje të drejtpërdrejta me këta njerëz, qoftë ky dhe numri një, siç qe në atë kohë Ramiz Alia”.

Sipas autorit, është një detaj që gjithnjë është lënë pas dore ose është keqinterpretuar me qëllim. PD as nuk mund të formohej në fshehtësi dhe as nuk u krijua në fshehtësi. Sapo grupi i nismëtarëve që vendosi për krijimin e saj mori lejen zyrtare, ishte e nevojshme dhe e natyrshme që grupi të hynte në kontakte me forca dhe grupime të tjera, me pushtetin që ishte në Shqipëri dhe me Ramiz Alinë. Por edhe pushteti i kohës kishte nevoja për të krijuar pikat e kontaktit me këtë forcë të re politike që sapo ishte krijuar, e cila ishte dhe forca që do të vinte shumë shpejt në pushtet, ndaj nuk mund të nënvlerësohej. Dhe natyrisht, bisedimet do të zhvilloheshin me R. Alinë, pasi ishte president në atë kohë. Për këtë qëllim ai (presidenti i asaj kohe R. Alia), thekson autori, veçoi Sali Berishën, dhe kjo jo pa ndonjë arsye. Pasi vetë ish Presidenti Alia theksonte se S. Berisha kishte mbështetjen e emigracionit dhe të pinjollëve të tyre që zunë pikat kyçe në udhëheqjen e PD, në Parlamet e qeverinë (Alia, Ramiz 1998, fq 9).

Elita sunduese të regjimit autoritar e prirur për të fituar pandërshkueshmëri pas ndryshimit të regjimeve për krimet apo abuzimet me pushtetin kur në qeverisje vjen opozita kishte PD ka kryer disa raunde diskutimi me përfaqësues të regjimit megjithëse këto nuk ishin formalizuar në pakte midis elitave kundërshtare përmes insitucionalizimit të këtyre rundave të tryezave të bisedimit. Një pjesë e çështjeve për

50

të cilat opozita ra dakord ishte mbrojtja e monumenteve, pra mos mbështetja e qëndrimeve radikale për përmbysje totale apo konfrontime fizike midis policisë, ushtrisë dhe qytetarëve kundër regjimit. Një tjetër marrëveshje paraprahe lidhet me sistemin kushtetues ku një pjesë e grupimit të moderuar në PPSH me mbështetje të PD arriti të kalojë një pjesë të ndryshimeve kushtetuese sipas modelit demokratik. Në këtë pikpamje Ramiz Alia u mundua ta përfaqësonte veten sipolitikan liberal, pasi pozicioni që kishte i jepte mundësinë e përdorimit të strukturave të regjimit për ta shtypur lëvizjen antikomuniste që kishte filluar. Por në referencë të situatës dhe zhvillimeve në Lindje ku komunizmi kishte rënë Ramiz Alia nuk mund ta mbante më tej situatën nën kontroll, pasi ngjarjet në Rumani e vendet e tjera ia bënë të qartë se përdorimi i dhunës çfarë rezultati mund të sillte. Në këto kushte Alia zgjodhi rrugë tjetër të veprimit duke bërë lëshime graduale dhe marrëveshje me PD që ishte krijuar si parti opozitare në vend në funksion të ruajtjes së stabilitetit. Kryerja e kalimit të pushtetit pa dhunë dhe gjakderdhje ishte sfida kryesore që Alia do të përballej me të dhe që realizimi i saj do ti shërbente si një alibi në zhvillimet e mëvonshme që do të ndodhnin me vendosjen e pluralizmit në vend. Por deri në marsin e 1991 Alia konsiderohej si aleat nga PD dhe studentët, por që shumë prej protagonistëve të ngjarjeve të kohës e paraqesin si strategji dhe levizje taktike nga ana e tij për të shmangur shtypjen me dhunë dhe transformimin e lëvizjes studentore në një lëvizje apo parti politike opozitare. Gjatë kësaj kohe raporti I tij me drejtuesit e lëvizjes demokratike kishte nuance bashkëpunimi, element të cilin studiuesja Progni (2013 fq 139) shprehet se “ aq bashkëpunues ishte me drejtuesit PD sa ata ishin duke shkuar drejt vendimit që në zonën ku do të kandidonte për deputet në zgjedhjet e 31 marsit Ramiz Alia të mos kishte kundërshtar nga PD, pra t’i lihej zonë e lirë “.

Duke qenë se Sali Berisha ishte ndër intelektualët e shquar të mjekësisë së kohës, njëkohësisht edhe “Sekretar Byroje në organizatën bazë të partisë së fakultetit” (në A. Duka, 2006, fq 271), ishte dalluar për vendosmërinë në luftën kundër burokracisë dhe mediokritetit, gjë që, sipas autorit, pëlqejë nga Alia, por padyshim një rëndësi të madhe kishte dhe fakti që sipas P.Zogaj pavarësisht konkurimit të zhvilluar për kreun e PD, ai shprehet se “ isha i bindur se Berisha do të fitonte dhe balotazin, pasi gjithashtu Berish kishte rreth e rrotull vetes një Shqipëri më mazhoritare se Mexi- Pashko, dhe se Shqipëritë e tyre priteshin në një sektor të elitës , por që në tërësi Shqipëria populiste – intelektuale e Mexi – Pashkos ishte më e vogël numerikisht se se Shqipëri populiste popullore e Berishës” (2014, fq 141). Natyrisht, Alia nuk priste të formohej një parti komuniste, socialiste apo socialdemokrate, por një parti opozitare. Dhe Partia Demokratike e tillë do të shfaqej që në fillim dhe, shumë shpejt, do të synonte të merrte pushtetin. Pikërisht duke bërë këtë analizë, po sipas autorit, Alia preferonte që në krye të një partie të tillë, si ajo Demokratike, udhëheqësi i saj të ishte një njeri me të cilin mund të merreshë vesh. Sali Berisha i plotësonte këto kushte më së miri, ndërsa të tjerët ishin të panjohur dhe nuk e kishin treguar veten asnjëherë, deri atëherë. Madje, s’kishin asnjë biografi minimale politike apo shoqërore.

Përveç këtyre fakteve, një tjetër element ndikues ishte edhe presioni i ngjarjeve që rrodhën me një shpejtësi të paparashikuar. Njohjet, konsideratat dhe këshillat e miqve të Alisë bënë presionin e vet. “Gjykoj se Alia ka vepruar i kushtëzuar nga rrethanat, por është tjetër gjë se si rrodhën ngjarjet më vonë”, shprehet autori(në A. Duka, 2006, po aty).

Kjo shpjegon faktin se PD-në nuk e krijoj Ramiz Alia. Në analizë të fakteve se programi i saj nuk u krijua në zyrat e Komitetit Qendror, dhe se Sali Berishën nuk e

zgjodhi ai kryetar, por duke spikatur nga të tjerët, për aftësitë e tij intelektuale dhe bisedat që bëri me presidentin, ndikoi në autoritetin e Berishës mes të tjerëve, dhe kjo ishte një kartë e pazëvendësueshme kredibiliteti. Pra, e përmbledhur, Berisha u “promovua” në politikë, mësoi shpejt artin e të bërit politikë dhe nuk e pati të vështirë të zgjidhej kryetar i Partisë Demokratike . Një tjetër lehtësi në rrugën e Berishës ishte se, nismëtarët krijimit të PD-së kishin ende nevojë të dinin se sa e madhe ishte forca e tyre, se ç’lëshime duheshin bërë dhe se deri ku e kishin hapin. Kjo i jepte përparësi Berishës kundrejt të tjerëve, pasi ishte gjithmonë një hap përpara tyre. Kjo, sepse kishte informacionin që të tjerët nuk mund ta siguronin (në A. Duka, 2006, fq 271).

Ndërsa në krijimin e Partisë Socialiste Ramiz Alia kishte më peshë, pasi drejtuesit e saj vinin nga radhët e Partisë së Punës, nga nivelet e dyta e të treta të administratës shtetërore . Udhëheqësit e saj ishin kuadro, të cilët i zgjodhi dhe i afroi rreth vetes Alia në periudhën e vështirë të tranzicionit. Sipas autorit, ai ishte iniciuesi për krijimin e rrethanave dhe kushteve të caktuara që në krye të Partisë Socialiste të vinin “udhëheqës që sot janë jo ekstremistët e majtë”. Këta do të ishin njerëzit që do ta rinovonin dhe transformonin Partinë Socialiste (A. Duka, 2006, fq 272). Zgjedhja e kryetarit të partisë zgjodh F.Nano ishte propozimi i ish Sekretarit të arë të komitetit Qëndror të PPSH R. Alia në kongresin e 10 të saj. Gjithashtu dhe në propozimet për KPD dallohet influenca e Alisë siç ishte rasti i përfshirjes së D.Agollit KPD nën kujdesin e Aliaë, pavarësisht se ai kishte bërë kritikë ashëpr ndaj figurës së E. Hoxhës, në (Proгри, Lujeta, 2009, fq 93).

Vlen të theksohet se autori vë në dukje një kategori individësh të cilët, si në kohën e komunizmit edhe sot, nuk linin gur pa lëvizur për të qenë sa më afër pushtetit. Madje

sot ata janë shndërruar në demokratë “të thekur”. Këta individë autori i etiketon si “njerëz dekor” (A. Duka, 2006), që përdoren për të sulmuar kundërshtarët.

Zgjedhjet u zhvilluan më 22 mars 1992. Nga këto zgjedhje dolën deputetët e Parlamentit Shqiptar, me Pjetër Arbnorin si Kryetar të Kryesisë së Kuvendit Popullor. Lista e deputetëve sipas zonave zgjedhore nga data 4. 4. 1992 – 29. 3. 1996 ishte:

Nga zgjedhjet parlamentare të 22 marsit 1992 PD e Shqipërisë fitoi 62% të votave, ndërsa PS fitoi 25% të votave. Në raundin e dytë të zgjedhjeve, PD-së iu shtuan edhe 11 vende të tjera në Parlamentin e kohës.

Në këtë parlament, PD siguroi 92 vende nga 140; PS - 28 vende; Socialdemokratët - 7 vende; PBDNJ - 2 vende .

2.2 Disidentët në sistemit komunist

Intelektualët pro perëndimorë janë vrarë ose kanë ndërruar jetë në burgje përpara viteve '50 në vitet e më vonë shme sistemi pë rratiti intelektualët e tij duke me frymë dhe shkollim lindor, dhe pavarësisht kësaj dhe kjo shtresë intelektualësh nuk i shpëtoj persekutimit nga ana e regjimit komunist . Institucionet fetare janë nxjerrë jashtë ligjit dhe kleri u eliminua. Vitet e pasluftë u shoqëruan me inskenime dhe gjyqe ndaj intelektualëve dhe jo vetëm pro perëndimorë, por edhe të atyre që dolën nga vetë sistemi komunist. Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë i dha mundësinë sistemit të eliminonte të gjithë ata individë që mund të kishin mundësinë e lidhjes me Perëndimin.

Me Lëvizjen e Postrribës pushteti komunist gjeti mundësinë të eliminonte gjithë veprimtarët që ai i cilësonte të rrezikshëm, rrëfen At Zef Pëllumbi në librin e tij ”Rrno vetëm me tregue” (vëllimi I).

Eliminimi i këtyre veprimtarëve si dhe i Lëvizjes së Postrribës u hoqi çdo mundësi veprimtarëve të Dukagjinit, Pukës dhe Mirditës për të vazhduar përgatitjet kundër pushtetit komunist në Shkodër. Përfshirë vitet 1950-1967 kur u bë mbyllja e kishave dhe xhamive në vendin tonë, që përkon me valën e dytë të eliminimit nga sistemi komunist të intelektualëve dhe klerit në Shqipëri.

Gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij sistemi komunist ka sajuar dhe thurur intriga dhe komplete për të eliminuar intelektualët dhe disidentët shqiptarë. Në fund të viteve '80 pothuajse e gjithë disidenca shqiptare ose ishte burgosur, ose ishte eliminuar nga sistemi komunist, duke i shkaktuar një dëm shumë të madh shoqërisë shqiptare - atë të zëvendësimit të intelektualit të kulturuar dhe të pavarur me njeriun e bindur dhe servil ndaj sistemit dhe partisë.

Nga intervistat e botuara nga gazetari Apostol Duka me ish-anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës në librin “Udhëkryqe të historisë”, rrëfyer nga miqtë dhe armiqtë e Enver Hoxhës, tipari kryesor që del nga të gjitha intervistat e protagonistëve të sistemit dhe ish-të dënuar nga sistemi komunist është, “Të gjithë janë kundër të gjithëve” (në At Z. Pëllumbi, 1995) në një luftë të egër për t'i mbijetuar sistemit, ku pjesa më e goditur e kësaj lufte janë intelektualët. Kjo luftë e sistemit nuk ka kursyer dhe vetë krijesat e tij.

E gjithë motoja e kësaj lufte të sistemit komunist ishte nxjerrja e intelektualëve jashtë lojës, dhe gjatë gjithë jetës së tij sistemi komunist e ka bërë duke thurur gjyqe të rreme, intriga e prapaskena ndaj gjithë intelektualëve, të cilët i etiketonte si tradhtarë dhe shërbëtorë të kapitalizmit. Në fund të viteve '70 pjesa elitare dhe intelektuale e shoqërisë shqiptare pro perëndimore , ose ishte eliminuar, ose gjendej e burgosur. Pas

kësaj periudhe sistemi komunist filloj të gërryente vetveten duke eliminuar dhe intelektualët që vet kishte përgatitur, me gjyqe politike dhe pushkatime të tyre.

2.3 Koncepti shqiptar për elitën post-komuniste

Rënia e sistemit komunist dhe vendosja e sistemit të ri, normalisht do të shoqërohej dhe me implementimin e politikave që luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Po cili është aktori kryesor dhe me influencë që do të kishte përgjegjësinë e vendimmarrjes dhe këta përgjegjës ishin? Elita kombëtare. “Elitat kombëtare janë ato individë që mbajnë postet më të larta në organizatat më të rëndësishme politike, qeveritare, ekonomike, ushtarake, mediatike dhe kulturore. Në sajë të autoritetit që kanë, këto organizata të pushtetshme dhe lëvizjet e çdo lloji që janë në gjendje të influencojnë rregullisht dhe thellësisht në vendimet politike kombëtare“ në (M. Bogdanit, 2000, fq 89). Bëhet fjalë për elitat në kuptimin pozitiv të këtij termi, pasi përbëhen nga një grup njerëzish që i japin udhëheqjen e duhur një shoqërie që ndodhet në procesin e ndryshimeve historike. Në rastin e elitës shqiptare të pas viteve 90’ profili i elitave politike është ai i elitave konfliktuale dhe të fragmentarizuara, duke iu referuar dhe faktit që shtresa e mesme në Shqipëri ka qënë shumë e dobët dhe si pasojë nuk ka qënë aktive në proceset e demokratizimit dhe të industrializimit, dhe si rrjedhojë elita politike që erdhi në pushtet u cilësuan si elitë kombëtare

Shoqëria shqiptare në çastin e rënies së sistemit komunist, ndodhej në nevojën e një udhëheqjeje të rëndësishme nganan elitës kombëtare në procesin historik në të cilin po hynte. Që një grup njerëzish të konsiderohet elitë që drejton kombin apo shtetin, duhet që të zotërojë një nga këto cilësi: dijen, fisnikërinë, pasurinë ose pushtetin në (M. Bogdani, 2010, fq 89). Në periudhën e ndryshimeve të rëndësishme, siç ishte rënia e sistemit komunist në Shqipëri, apo dhe gjatë gjithë tranzicionit, roli i elitës merr

një rëndësi të veçantë, pasi shoqërisë dhe shtetit i nevojiten dijet, ekspertiza profesionale, në kuptimin e përkushtimit dhe të sakrificës së saj për ta ndihmuar një popull të përparojë apo dhe të futet në regres.

Autorja thekson se i një rast i tillë janë elitat në vendet e Europsës Qendrore e Lindore të cilat i udhëhoqën popujt dhe vendet e tyre drejt progresit, demokratizimit dhe BE-së, dhe si të tilla janë të respektuara nga popujt e tyre. Fatkeqësisht, nuk është ky rasti me elitën shqiptare post-komuniste. Shinasi Rama (1994) e përshkruan elitën e sotme shqiptare në këtë formë “Paria apo elita e sotme shqiptare është paria më e përçudnuar në të gjitha drejtimet që ka ekzistuar ndonjëherë në historinë e kombit shqiptar. Ajo nuk përmbush asnjë kritere për të qenë pari, përkundrazi, ajo është kthyer në një kancer për gjithë kombin dhe shtetin” në (M. Bogdani, 2010, fq 90). Nga sa kuptohet lehtë, studiuesi ëshë fakti se ushtrimi i pushtetit nga elitat politike nuk është efektiv.

Elitën politike studiuesi e cilëson me termin “hiena politike” në (M. Bogdani, 2000, fq. 90) nisur nga fakti që nuk ndalen para përdorimit të fuqisë që i jep pushteti për të rrjepur dhe zhvatur shqiptarët. Ardhja në pushtet e këtij grupimi njerëzish në një mjedis anarkik, si ai i tranzicionit shqiptar, u jep në mënyrë të menjëhershme privilegje të jashtëzakonshme materiale, si dhe një status të lartë social. Për pasojë pas një kohe të shkurtër, kjo lloj kategorie individësh e sheh veten “artificialisht të konvertuar në elitë“.Po aty . Elita jo vetëm përfaqëson pjesën më të vlefshme të një kombi, por ajo është udhëheqëse e ideve, e shoqërisë për ndryshime, gjykime, për jetën kolektive, tendencat historike, për besim dhe filozofinë e tij.

Parë në pikëpamjen e analizës së elitës postkomuniste, në opinionin publik shqiptar mbizotëron mendimi se klasat politike janë “hiena që ushqehen me politikë” (në B. Gjongecaj, 2010, fq 201).

Në një artikull të shkruar në “Gazeta Shqiptare,”ⁱⁱ autori tregon “se si politikanët shqiptarë, me mënyrën e tyre të të bërit politikë, krijojnë marrëdhënien me qytetarin shqiptar. Po të depërtosh në thellësi të politikës shqiptare, dallohet lehtësisht se si kësaj politike i mungon përmbajtja demokratike. Një tjetër mënyrë e konceptimit është se, vendimet politike nuk merren në interes të qytetarit, por në interes të individit. Nëse nuk do të kishte mundësi për të përfitur padrejtësisht prej saj, askush nuk do të merrte mundimin të hynte në politikën shqiptare. Politika shqiptare konsiderohet si një politikë pa moral dhe, shpeshherë, është bërë shkak permanent krizash, pasigurie duke sjellë si pasojë drejtësi të inkriminuar, vjedhje votash, ndarje pushteti si në kohën e “pashallarëve të kuq” (në B. Gjongecaj, *po aty*) dhe moskontroll të saj. Ndaj politika është bërë pre e hienave që copëtojnë trupin e kësaj politike, me gjithë ndryshimet e ngadalta që ajo po përjeton, edhe pse simbolike. Gati 25 vjet më pas, në retorikën e klasës politike dhe të partive politike ende vazhdojnë të akuzojnë njëri-tjetrin se kush është më komunist se tjetri, edhe pse e gjithë kjo klasë politike është me prejardhje nga kjo e shkuar komuniste.

2.3. 1 Problematika e elitës politike të tranzicionit .

Pas analizës së teorive elitiste, ndoshta do të ishte e gabuar po të flisnim për një teori të vetme të tranzicionit postkomunist apo për një teori të vetme të riprodhimit të elitës në postkomunizëm. Në këtë këndvështrim do të shikohet dhe rasti shqiptar i formësimit të elitës politike postkomuniste.

Duke mbajtur në konsideratë transformimet dhe problematikat të ndodhura gjatë këtyre viteve të tranzicionit, pas ndryshimeve rrënjësore të sistemit politik konfigurimi i elitës politike shqiptare merr një vlerë të veçantë. Çasti më i rëndësishëm në formimin e

figurave të reja politike është, padyshim, ai i evidentimit dhe lidhjes së këtyre figurave me lëvizjen studentore të viteve '90, ku shumica e figurave kryesore të kësaj lëvizje në rrjedhën e formësimit të elitës politike nuk u bënë pjesë e saj. Sipas shumë studiuesve, politikanëve dhe protagonistëve të lëvizjes studentore, rëndësia e saj në realizimin e ndryshimeve politike në vend ishte tejet e lartë. Lëvizja, në vetvete, identifikonte dëshirën e heshtur të shqiptarëve për ndryshimin e regjimit politik në Shqipëri.

Trajtesa dhe kanalizimi i fuqisë së lëvizjes studentore nga ish-regjimi mbetet ende një temë e diskutueshme. Mbështetja e lëvizjes studentore nuk erdhi në mënyrë natyrale nga intelektualë, të cilët të kundërshtonin hapur regjimin apo për shkak të kultivimit të tyre me vlerat e demokracisë së vërtetë. Pas spastrimeve të vazhdueshme ndaj intelektualëve, regjimi komunist kishte arritur që në Shqipërinë e viteve '90, më në fund, të krijonte një inteligjencë vendase të arsimuar dhe të përshtatur për sistemin e saj politiko-ekonomik. Kjo pjesë e shoqërisë shqiptare, e cila rëndom njihej si ajka e saj, atëherë kjo elitë krijuar merr e saj rolin në momentin e krizës së legjitimitetit të regjimit komunist në vitet 1980 të shoqëruar dhe me krizë ekonomike, humane dhe kulturore në të cilën ndodhej Shqipëria e kohës. Për shumë arsye, kjo shtresë pseudo-intelektuale (përveç problemeve të mungesës së formimit) ishte njëkohësisht, dhe e paafte për t'iu kundërvënë sistemit. Si një produkt i saj, intelektualët, ishin kultivuar me të gjithë mekanizmat për të garantuar respekt ndaj udhëheqjes dhe regjimit në tërësi. Shumica e drejtuesve gëzonin status, privilegje dhe lidhje të ngushta me pushtetarët e regjimit, të cilët ishin promovuar shpeshherë për besnikëri e devotshmëri ndaj Partisë, dhe jo për shkak të meritës dhe vlerave.

Këtu e ka origjinën dhe fenomeni i *intelektualëve të promovuar* mund të thuhet se këta intelektualë të cilë u promovuan kanë këto tipare: a) autonomi të kufizuar të

mendimit, b) lidhje indirekte me regjimin pasi vinin nga nivele të ndryshme të administratës së ish regjimit, c) tendenca për të qënë në krye të reformave apo ndryshimit të regjimit në krye të kundërvënies, të atyre figurave që iu bashkuan me studentët dhe kauzën e tyre për liri dhe demokraci, të elementëve të cilët jo vetëm u bënë protagonistët kryesorë të ndryshimit, por përvijuan jetën politike të vendit për më shumë se dy dekada. Siç pohon dhe studiuesi (Shinasi Rama:1994) *“Në rast se rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri do të ishte në normalitetin e zhvillimit europiano-lindor, bota nuk do të çuditej aspak nëse intelektualët tanë do të ishin në krye të opozitës së sotme demokratike.”* Duke qënë regjimi më i egër në krejt vendet ish-komuniste ishte ai shqiptar, dhe ishte unik pasi karakterizohej nga me mungesën pothuajse të plotë të një disidence intelektuale, e domosdoshme kjo për të mobilizuar shoqërinë në luftën për mposhtjen e regjimit, siç ndodhi në vendet e Europës Lindore . Pikërisht kushtet paradoksale në të cilat ndodhej Shqipëria dhe shqiptarët e bënë të pamundur një ndryshim politik jashtë kontrollit të nomenklaturës së vjetër. Duke qënë në dijeni të ndryshimeve që po ndodhnin në të gjithë bllokun komunist, nomenklatura e lartë komuniste vështirë të besohet se ka qënë e papërzier ose kanë bërë përpjekje për të shmangur gjakdedhjen në rrjedhën e ngjarjeve të ndodhura në vitet 1990.

Nga zhvillimet e këtyre viteve të pluralizmit, një nga tezat që ka më shumë argumente është ajo sipas së cilës drejtuesit e lartë komunistë jo vetëm monitoruan ndryshimin (lëvizjen studentore), por ndoshta arritën ta vinin nën kontroll atë, e madje t’u imponoheshin edhe drejtuesve të rinj politikë. Për vetë historikun e raporteve të regjimit me intelektualët, vihet në pikëpyetje dhe urrejtja e tyre për të përmbysur një orë e më parë regjimin e vjetër. Ka shumë mundësi që në një pjesë të madhe të reagimit të ashpër të *intelektualëve të promovuar* kundrejt regjimit të ishte një

urrejtje e sajuar. Pasi është vështirë të besohet dhe nga ana psikologjike që te njerëzit në moshë madhore, brenda disa orëve apo qoftë edhe ditëve, mund të shembnin përnjëherë bindjet dhe vlerat politike të krijuara për një jetë të tërë, duke ditur se lëvizja disidente dhe organizatat e ndryshme politike kritike dhe kundërshtare në Shqipëri iu dha fund me represionin komunist ndaj tyre që në fillimet e vendosjes së tij.

Morali dhe bindja politike është një proces i ngadaltë dhe vështirësisht i ndryshueshëm, pasi edukimi i marrë ndër vite i bën individët të papërgatitur që të konceptojnë ndryshe ekzistencën e tyre, domethënë si njohës apo përkrahës të kulturës demokratike perëndimore. Mungesa e një përvoje demokratike të mëparshme, apo mungesa e hapjes ndaj botës perëndimore, mungesa e kontakteve, dhe e solidaritetit midis elitave antikomuniste në rajon, nisur nga kjo premisë, vështirë të pranohet që njerëz të cilët i kanë shërbyer apo kanë gëzuar privilegje e të mirat materiale të atij regjimi politik të tjetërsohen në parimet dhe vlerat e tyre politike aq shpejt dhe egër, sa që nga komunistë të ktheheshin në demokratë. Kjo nuk ka të bëjë me procedurën në vetvete, pasi me procedurë njeriu mund të zgjedhë t'i përkasë cilësdo partie. Këtu, çështja shtrohet në ndryshimin e sistemit të vlerave dhe besimeve që kanë individët e aq më tepër vlerat dhe besimet e individëve intelektualë që përfshihen në politikë. Tashmë nuk ka dyshim se besueshmëria rreth iluminimit të tyre me vlera demokratike brenda një kohe të shkurtër ishte në pikëpyetje, pasi në partitë e formuara pas vendosjes së pluralizmit politik në Shqipëri u angazhuan në drejtimin e tyre individë të cilët kishin patur më herët lidhje të ngushta me ish-regjimin, çka e vërteton promovimi i tyre nga drejtuesit e lartë të sistemit komunist.

Termi *intelektualë të promovuar* përfshin intelektualët, të cilët u përfshinë në lëvizjet politike të ish-presidentit Alia, qoftë përmes takimit të intelektualëve, qoftë me

pedagogët e dërguar për të negociuar me studentët. Studimet kanë treguar se nisma e intelektualëve ishte e organizuar nga regjimi, pasi në takimin i me intelektualët që u zhvillua me kërkesën e R. Alisë në 1990 për shkak të ndryshimeve që po ndodhnin në Bllokun komunist, (Preç Zogaj, 2014, fq 27) në rrëfimin e tij shprehet se një pjesë e intelektualëve e donin pluralizmin si një standart të Europës së re dhe kaq, pa e fshehur drojën ndaj të panjohurave të sistemit të ri. Ideja e pluripartitizmit ishte realisht e vagëllt për të mos thënë e pakconceptueshme për mëndjet e formuara në regjimin njëpartik. Nëse i qëndrojmë kësaj linje argumentimi, arrijmë në konkluzionin se, pengesa kryesore e fillimit të tranzicionit demokratik është krijimi i stisur i drejtuesve të rinj politikë. Të gjitha gjasat dëshmojnë për një konfigurim politik problematik, në të cilin aktorët e rinj të politikës ishin aty jo për shkak të idealit dhe aspiratave liridashëse. Drejtuesit e partive të krijuara pas shpalljes së pluralizmit rezultuan në shumë drejtime si të lidhur ngushtë me ish-regjimin. Nga kjo premisë evidentohen disa tipare të elitës politike të pas viteve '90, të renditura si më poshtë vijon.

Mungesa e përvojës demokratike ishte tipari dhe sfida kryesore e klasës së re politike të viteve '90 e cila paraqitej e ndarë në synimet dhe vizionet e saj, në mentalitetin dhe konceptin që kishte për politikën si profesion dhe përgjegjësi. Krijimi i shtetit shqiptar të 1912 nuk shënon ngritjen reale të shtetit shqiptar, pasi u desh kohë që të shfaqeshin institucionet dhe që shteti shqiptar të ishte pjesë e hartës së Ballkanit dhe Europës.

Për shkak të kushteve në të cilat lindi shteti shqiptar, situatës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, nuk u arrit të krijohet modeli i suksesshëm i shtetit. Shekujt e sundimit osman bënë që në Shqipëri të krijohet një model politik, social dhe kulturor i ndryshëm nga ai europian, duke i sjellë Shqipërisë një izolim nga vlerat dhe modeli i organizimit të shtetit dhe shoqërisë sipas modelit europian. Distanca kulturore dhe historike e

krijuar la pasojat e veta në shoqërinë shqiptare në të gjitha aspektet, pasi u identifikua si një nga shtetet dhe shoqëritë me mungesë të madhe të traditës dhe të normave demokratike, politike e shoqërore. Krijimi i elitave dhe i klasës politike është një proces i gjatë, i varur nga një sërë faktorësh, si: sistemi i edukimit, mundësitë e informimit publik, niveli i shkëmbimeve me vendet e tjera dhe mjedisi social e politik (në A. Krasniqi, 2008, fq 225). Klasa politike dhe figurat historike që dhanë kontributin në krijimin dhe forcimin e shtetit shqiptar përpara vendosjes së demokracisë në Shqipëri kanë qënë kryesisht produkt i kulturave dhe i mjediseve politike joshqiptare, si ato turke, austriake, italiane dhe pas viteve 50' nga ajo ruse.

Krizat politike në historinë e re shqiptare janë arsye që shoqëria dhe shteti shqiptar kanë vuajtur nga mungesa e kulturës ligjore, politike, si dhe nga mungesa e traditës dhe elitave politike.

Referuar (Krasniqit, 2008) ende nuk ka një analizë të qartë dhe profesionale, të paanshme dhe të besueshme të mendimit politik shqiptar, të mangësive dhe problematikës së saj, si dhe të raporteve mes shtetit, elitës politike, qytetarëve dhe vlerave perëndimore të pranuar si vlera themelore për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. E parë në këndvështrimin e një analize kohore të traditës së një shoqërie demokratike, është pranuar se Shqipëria nuk është një vend me traditë të qëndrueshme, pasi historiku i organizimit fisnor, krahinor, më pas, ajo e organizimit të shtetit nuk ka qenë e bazuar në zgjedhjen konkurruese të individëve apo nga një legjislacion, kod etik i pranuar nga instrumente, hierarki që del nga ndërveprimi i dy faktorëve. Elemente, si: ndërtimi patriarkal i familjes, zakonet e detyruara, pozitat e pafavorshme politike, konfliktet dhe mungesa e kapitalit politik e qytetar kanë ndikuar që të ndërtohet një

traditë e cila, me gjithë drejtimin demokratik, nuk ka qenë asnjëherë garanci e plotë për evoluimin e vlerave demokratike.

Aleks Luarasi, vëren se shqiptarët kanë përjetuar pushtimet e huaja me shekuj dhe e kanë parë vazhdimisht shtetin dhe institucionet e tij me një sy armiqësor. Sa herë këto institucione kanë rënë, ata i janë sulur t'u japin shkelmin e fundit dhe të grabitin pasuritë e tyre. Ka ndodhur kështu pas rënies së Perandorisë Osmane, pas luftës italo-greke, pas largimit të nazistëve, pas rënies së sistemit komunist dhe pas rënies së pushtetit të PD-së, në 1997-n. Për këto arsye krahasuar me vendet e tjera për nga vlerat demokratike që mbartën dhe trashëguan në periudhën moderne, shqiptarët nuk kanë një periudhë të referueshme dhe të krahasueshme me këto vende në këtë rrafsh. Kjo lidhet më tepër me shpjegimin strukturor të shtetit se sa me trashëgiminë kulturore të marrëdhënieve midis shtetit si (autoritetit politik) dhe shoqërisë shqiptare. Argumenti është se institucionet kanë qënë të dobëta dhe se mungesa e një elite politike unitare dhe me kohezion ideologjik është një nga shkaqet e këtyre proceseve, (në këtë rast rimerret argumenti i trajtuar nga Higley dhe Burton 2012).

Elita politike e pas viteve '90 për më shumë se dy dekada është udhëhequr jo nga respektimi dhe zbatimi i ligjit, por nga tendenca për të qenë mbi ligjin. Ky model drejtimi deformoi, së pari, partitë si institucione dhe së dyti, drejtimin e shtetit dhe të institucioneve të tij (në G. Tushi, 2010, fq 440). Në të gjitha krahët e politikës vihet re një lloj deformimi militant i shtetit, që vjen si pasojë e konceptimit që ka politika në lidhje me të drejtën politike për të ndarë postet sui generis Kjo ka çuar në një dukuri që politika jonë nuk ka mundur të bëjë dallimin mes postit politik dhe atij publik.

Tipari dallues me krijimin e demokracisë në vend, është klanizimi i elitës politike. Elita e re vijoi me mbështetjen e pushtetit të vet në bazë klanesh dhe krahinizmash. Baza e

64

deformuar e legjitimitetit politik e thelloi edhe më tej këtë tipar. Për pasojë, përçarja e klasës politike vijoi të prodhonte probleme si në drejtimin e vendit, duke përçarur mesazhe negative në popullatë. Pra kë tu kemi të bëjmë me dimensionin e ushtrimit të pushtetit dhe bazat e legjitimitetit (në bazë klanore) që nuk ndihmon në marrëdhënie të qëndrueshme midis shtetit dhe shoqërisë apo në institucione të qëndrueshme të regjimit demokratik.

Një efekt i kësaj politike ishte formimi i një shërbimi civil sipas vlerave të elitës drejtuese duke forcuar sundimin e ri me mekanizmat shtetërorë. Pikërisht zhvillimet shtetformuese nën politikën e elitës së re ishin faktori kryesor për krijimin dhe thellimin e këtij tipari gjatë viteve të tranzicionit dhe që, për fat të keq, ende dhe sot politika e klaneve vijon si në qarqet politike, ashtu edhe në administratën shtetërore e në promovimin e individëve në të.

Vijon një luftë e ashpër për pushtet si ndaj kundërshtarit politik, ashtu edhe brenda partive politike. Gjendja e konfliktualitetit të vazhdueshëm për marrjen dhe gëzimin e sa më shumë pushteti bëri që drejtimi i organizatave politike në fillim (dhe i shtetit në vijim) nga liderët e rinj të realizohej me disiplinë dhe autoritarizëm të lartë. Pothuajse në të dyja partitë kryesore Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, eliminimi i mendimit ndryshe dhe vijimi me politika përçarëse krijoi një lojë politike të pabarabartë, sidomos brenda radhëve të partisë, duke eliminuar figura të reja potenciale për drejtimin e mëtejshëm të saj dhe duke vonuar riprodhimin e elitës së re në vend.

Drejtimesit e partive kryesore politike PS dhe PD vijuan me modelin e njëshit të padiskutueshëm, autoritar deri në tirani duke monopolizuar pushtetin (partiak dhe ekzekutiv. Ata mbanin qëllimisht pranë vetes individë që nuk mund të ishin konkurrentë të denjë duke lënë përshtypjen se ata dhe vetëm ata mund të drejtonin. Ky

tipar ka bërë që drejtuesit politikë të pas viteve '90 të qëndrojnë shumë gjatë në pushtet, goftë edhe pas shumë dështimeve në politikë.

Në kushtet e reja politike dhe duke shijuar fuqinë e pushtetit, drejtuesit e rinj politikë dhanë të parët shembullin e abuzimit me pronën shtetërore dhe deformimin institucional duke qëndruar, vetë ata dhe interesat e tyre personale, mbi shtetin, ligjin dhe rregullin duke i dhënë si tipar kësaj klase politike atë të dëshirës për pasurim me anë të abuzimit me pushtetin, për pronat shtetërore, privatizimet apo dhe të administratës shtetërore.

Një tjetër fenomen që vihet re është dhe tranzicioni politik që shpreh një mungesë të qytetarisë dhe problemet që lë pas ky tranzicion politik. Sipas analistëve Minxhozi (2010) dhe Stefani(2015), politika e pas viteve '90 e ka shpërfytyruar intelektualin shqiptar. Shpjegimin e vështirësive të këtij tranzicioni nuk mund ta bëjmë vetëm me reduktimin apo pë rrëzim në një shkak të vetëm. Janë një sërë faktorësh që lidhen kryesisht me klasën politike shqiptare dhe politikën e saj. Shteti i së Drejtës e bazon politikën e tij në ekzistencën e pashmangshme të shoqërisë dhe diversitetit.

Ndërtimi i shtetit modern shqiptar paraqet probleme që kanë të bëjnë me zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe të pakontestueshme nga palët, ndërtimin e një pushteti autokratik dhe nevojën e konsolidimit të institucioneve demokratike. Shoqëria shfaqet hera-herës konfliktuale deri dhe në ekstreme, sidomos në fushat zgjedhore, pasojë kjo e luftës politike që ka sjellë ngërçe në zhvillimin e vendit. Këto problematika të cilat pavarësisht arritjeve që janë bërë për të vendosur një funksionim normal të shtetit të së drejtës e gjejnë pohimin e tyre dhe në fjalimin që ish presidenti Moisiu ka mbajtur në ceremoninë e marrjes së detyrës në Pallatin e Brigadave me 24 korrik 2002 ku shprehet se, *“për të vendosur normalitetin në politikën shqiptare duhet që të kemi*

66

një proces konkurimi të pandërprerë shkëmbimin idesh nëpërmjet alternativave. Në këtë mënyrë normaliteti në jetën politike shqiptare nuk do të jetë i përkohshëm thjesht vullnet prijësish partiakë, por një dukuri që nuk çudit askënd në marrëdhëniet midis partive politike, që reflektihet në veprimtarinë e përditëshme të piramidës shtetërore, në çdo institucion e komunitet. Forcimi i shtetit të së drejtës, krijon klimë dhe kushte që konkurrenca politike të jetë luajale, që e ardhja dhe largimi nga pushteti të kuptohet si diçka e zakonshme, se ai që fiton nga vota ka të drejtë të qeverisë vetëm në shërbim të interesave publike dhe, ai që humb ka detyrë të kontrollojë e të bëjë oponencën e tij”.

Ndaj vëmendja e gjithë shoqërisë shqiptare duhet drejtuar nga politika në kërkim të një klase politikanësh të rinj. Kjo klasë e re politikanësh, me veprimtarinë e tyre, duhet të kontribuojnë në ndërtimin e një mjedisi politik që synon ushtrimin e pushtetit dhe jo sundimin me anë të pushtetit.

Një klasë politike e cila konfliktohet në funksion të interesave klanore e politike iu shtohet faktorëve të përmendur më lart dhe sjell një situatë të atillë që, sipas pikëpamjes së Arendt për pushtetin, në Shqipëri pushteti mbetet i paushtruar duke sjellë që, rrjedhimisht edhe politika të zhvillohet në distancë dhe shkëputje nga vullneti i popullit, që institucionet të mbeten të dobëta dhe joproductive, larg funksionimit të tyre normal në shërbim të asaj për të cilën janë krijuar. Mbështetja popullore, u jep pushtet institucioneve të një vendi dhe kjo mbështetje s’është veçse vijimi natyror i mirëpranimit fillestar që u dha jetë ligjeve ekzistuese. Në këtë mënyrë, distanca ndërmjet politikës dhe shoqërisë në Shqipërinë e pas viteve ’90, bëri që institucionet të mbeten larg ushtrimit të pushtetit dhe funksionimit të tyre, me gjithë hiperpolitizimin e jetës publike që mbzotëron në Shqipëri. Dhe në këtë mënyrë, klasa politike shqiptare ka krijuar mosbesim dhe zhgënjim të madh te qytetarët.

Në Shqipëri, dëshira për ndryshimin e regjimit politik lindi nga mjerimi ekonomik. Shumë studiues Ngjela (2010) dhe Krasniqi (2008) pranojnë se, faktori kryesor i dështimit të regjimit komunist ishte dështimi i politikave ekonomike. Problemet ekonomike në Shqipëri ishin të përmasave të jashtëzakonshme. Problemi është se gjatë regjimit komunist gjendja materiale ka qenë aq e keqe dhe shtypja ka qenë aq ndrydhëse, saqë çdo gjë që mund të ndodhte mbas vitit 1990 do të ishte një përmirësim i pakrahasueshëm. Në këtë kuptim, ndryshimet që do të vinin pas viteve '90 nuk ishin rezultat i mirëqeverisjes, përkundrazi, ishin rezultat i zhvillimeve që ndodhën brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kontekst, klasa e re politike jo vetëm shfrytëzoi mjerimin ekonomik të shqiptarëve, por dhe dëshirën e tyre për rimëkëmbje. Ajo zhvilloi një lojë të pandershme politike, duke deformuar vlerat demokratike dhe, rrjedhimisht, edhe dëshirën e shqiptarëve për një Shqipëri evropiane.

Duke ardhur pothuajse në një masë të madhe në krye të partive politike nëpërmjet influencës së regjimit komunist, drejtuesit e rinj vijonin zbatimin e një politike të mbushur me demagogji, pa moral dhe aspak realiste. Vështirësitë e jetës së përditshme, shoqëruar me frikën dhe pasigurinë për të ardhmen, ia shuan klasës politike entuziazmin dhe aftësinë fillestare për të mbajtur në lartësinë e duhur rolin e saj për realizimin e proceseve transformuese. Njëkohësisht, shkarja drejt zhgënjimit apo besimit fanatik në partitë politike e ka penguar shoqërinë shqiptare të transformojë vetveten. Ajo ka ndjekur ritmin e transformimit të bërë nga klasa politike pa realizuar funksionin e saj të përfshirjes reale në proceset e ndryshimit dhe transformimit të vendit. Mosmarrja në konsideratë e realizimit të një analize të thellë dhe të plotë për vlerësimin e kapaciteteve të vendit për rimëkëmbjen e ekonomisë, do të bënte që drejtuesit e rinj politikë të anashkalonin mbajtjen e përgjegjësiave për thellimin e krizës

në vend, madje edhe pas ndryshimeve politike, gjë që ka çuar në uljen e besimit tek elita politike dhe institucionet shtetërore. Pikërisht ky fakt, pra, shthurja e sistemit komunist si pasojë e dështimit të ekonomisë së centralizuar dhe gjendjes në të cilën ndodhej vendi, do të ndikonte negativisht jo vetëm në ndërtimin dhe funksionimin e elitës së re politike, por mbi të gjitha, në mungesën e llogaridhënies dhe moralit përpara zgjedhësve, pasi e gjeti vendin pa një elitë politike të mirë filltë dhe eksperte për t'ë përballuar me nevojat që kishte vendi.

Elementët potencialë dhe realisht kontribues, shumë shpejt nuk do ta gjenin më veten në mjedisin e ri politik. Kundër politikave të gabuara të drejtimit të shtetit prej klasës së re politike mungonte opoenca e intelektualëve dhe ekspertëve të paanshëm. Bashkë me largimet masive të popullatës, kishin lënë vendin një numër i madh profesionistësh duke krijuar boshllëk në shumë drejtime në fushën ekonomike, politike dhe shoqërore. Në këtë pikë mund të themi se vështirësitë ekstreme ekonomike kontribuan në formimin e një elite politike problematike. Decentralizimi i ekonomisë së vendit u pa si mundësi për përfitim personal dhe jo si një mundësi reale për rimëkëmbjen e qytetarëve dhe të vendit. Asnjëra nga të dyja partitë kryesore PD dhe PS në vend nuk e menaxhuan si duhet situatën ekonomike që kishte pllakosur vendin. Ato shfrytëzuan çdo mundësi për të përfituar nga prona shtetërore duke lënë ende të pazgjidhura probleme të mprehta të pronësisë. Këto probleme mbeten të tilla edhe sot.

2.3.2 Sfidat e elitës politike gjatë tranzicionit

Në procesin e demokratizimit elita politike është një aktor shumë i rëndësishëm. Elita politike “përballet gjatë procesit të tranzicionit me tri sfida kryesore në konsolidimin e shtetit: alternimi i pushtetit, aleancat partiake dhe roli i opozitës, dhe marrëdhëniet ndërmjet elitës dhe masave”(në M. Bogdani & J. Loughlin, 2000, fq 91). Për shkak të rolit të madh të rëndësishëm që kanë partitë kryesore politike, veçanërisht PS dhe PD, dhe të njëjtësimit të partisë më shtetin, është e vështirë të bëhet dallimi se ku mbaron shteti e ku fillojnë partitë. Të dyja këto parti, gjatë jetës së tyre politike, janë shquar për marrëdhënie të ashpra dhe konfrontime me sjellje jo të civilizuar politike, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, për mungesë të dialogut politik dhe frymës së bashkëpunimit. Konsiderimi i kundërshtarit politik si armik, është shprehje e marrëdhënieve të acaruar dhe të vështira të elitës politike shqiptare, mungesës së kulturës konsensuale demokratike, si dhe një harxhim energjish në konflikte politike, që nuk kanë prodhuar asnjë zgjidhje të problemeve, përkundrazi, kanë vonuar proceset demokratike në vend, tipar ky i një mentaliteti, kulture dhe trashëgimie politike të vjetër. Në dallim nga modelet e tjera zgjedhor që zhvilluan vendet e Europës Lindore, në Shqipëri sipas studiuesit (Krasniqi 2009, fq 352) zgjedhjet iu dhanë legjitimitet mazhorancave “ vrasëse” , të cilat sapo erdhën në pushtet shpallën platformën e “ vitit zero” dhe punuan për të krijuar mjetet e nevojshme të përfitimit të ligjit, administrativ dhe social për në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe lokale të radhës. Tipar tjetër i rëndësishëm i zgjedhjeve shqiptare është dhe politizimi i skajshëm i mekanizmave dhe institucioneve zgjedhore, pavarësisht garantimit të funksionimit të tyre të lirë me anë të Kushtetutës, duke mos i shndërruar në organe të balancuara politikisht. Në 2008

KQZ me ndryshimet kushtetuese që iu bënë u shndërrua në një organ thellësisht partiak dhe jo imun ndaj mazhorancave politike të radhës të partive kryesore në vend duke vendosur rotacionin bipartizan mes tyre në këtë institucion.

Kultura politike paraqitet ende patriarkale, pasi mbizotërohet nga numri më i madh i meshkujve në politikë, dhe akoma vazhdohet të kërkohet plotësimi i kuotës së 30% të përfaqëimit të gruas, dhe procesi politik paraqitet arkaik, ndërsa vlerat liberale dhe demokratike nuk janë të rrënjosura në kulturën politike shqiptare.

Në procesin e rritjes së tyre, partive politike shqiptare u kanë munguar alternativa të mira dhe politika të qarta, gjë që është shoqëruar me një abuzim sistematik të pushtetit, është reflektuar me qeverisje të dobëta dhe joefektive dhe në mosrealizimin e reformave të premtuara.

Gjatë gjithë viteve të pluralizmit demokratik, me të ardhur në pushtet partitë politike janë përpjekur të përjashtojnë partitë opozitare nga procesi politik, duke harruar se roli i elitës politike ndahet ndërmjet atyre që janë në pushtet dhe atyre që janë në opozitë. Ekzistenca mentalitetit se, “opozita në Shqipëri ka si detyrë të kundërshtojë” dhe jo të ofrojë paketa të zgjidhjeve, alternativash, duke u zhvilluar një opozitë konstruktive dhe koherente, e aftë të konkurrojë pushtetin.

Gjatë gjithë kohës armët kryesore të opozitës kanë qenë bojkotet e vazhdueshme, organizimi dhe zhvillimi i mitingjeve dhe protestave në rrugë, shpesh të dhunshme dhe me pasoja mjaft të rënda. Objekti i përpjekjeve opozitare nuk ka qenë përmirësimi i situatave, por zëvendësimi i njerëzve. Një alternativ normal i pushtetit, është tregues i një demokracisë konkurruese dhe të balancuar të partive, si dhe një indikator për një

demokrati të shëndetshme, funksionale, që stimulon rivitalizimin e lidershit dhe rinovimin e politikës. Për fat të keq, në politikën shqiptare kjo ka munguar.

“Institucioni i dorëheqjes“, si një vlerë demokratike, në politikën shqiptare nuk është aplikuar përveçse në ato raste kur qeverisja ka dështuar. Partitë dominohen nga kryetarët e tyre dhe shpeshherë, vendimet që ata marrin janë jo transparente, madje përdorin autokracinë për t’i sunduar partitë e tyre. Ideologjia dhe programet politike janë gjithnjë e më pak tiparet thelbësore të partive dhe jetës së tyre të brëndshme. Ky devijim ka çuar në pakësimin e numrit të anëtarëve të përkushtuar ideologjikisht, si dhe në rritjen e numrit të pragmatikëve për të cilët, vlerat dhe bindjet politike kanë më pak rëndësi sesa përfitimet materiale dhe personale.

Në klasën politike shqiptare ende mbizotërojnë burrat, gratë kanë një përfaqësim më të ulët në partitë politike, Parlament apo në pozicionet vendimmarrëse. Politika shqiptare, referuar studimit të “Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut“, të vitit 2004, mbeten ende të mbërthyera nga një karakter konfliktual dhe abuziv, që në asnjë mënyrë nuk mund të pranohet nëse do të flasim seriozisht për një integrim të shpejtë dhe me vlerë drejt familje së madhe Europiane (në M. Bogdani & J. Loughlin, 2000, fq 93).

Fakt është se e gjithë klasa politike “integrimin në BE” e ka përdorur më shumë si slogan, si një qëllim për të fituar kredibilitet, për të siguruar mbështetje të elektoratit, si dhe për të larguar vëmendjen e tij nga dëmet e shkaktuara nga krizat e shpeshta politike të klasës politike. Integrimi në BE dhe orientimi i elitës politike shqiptare nuk ka ardhur si rezultat i një idealizmi apo i një motivimi filozofik. Duke luajtur me këtë kartë, klasa sunduese politike ka synuar të legjitimojë dhe zgjatë sa më shumë qëndrimin në pushtet, argumenton Ardian Vehbiu, në vitin 2003 (në M. Bogdani & J. Loughlin, 2000, po aty).

Në një intervistë për VOA autori Fred Abrahams (2015) në librin e tij i ka bërë një kritikë të thellë elitës politike shqiptare postkomuniste. Sipas tij, ajo është më e prirur për interesat e veta sesa për interesat në shërbim të vendit. Nga një studim tepër i gjatë, gati 15-vjeçar, bazuar në dokumente të Departamentit të Shtetit Amerikan (CIA), autori ofron një këndvështrim të brendshëm, parë nga pikëpamjet dhe analizat e qeverisë amerikane, duke patur mundësinë të marrë kontakte me ambasadorë që kanë shërbyer në Shqipëri apo dhe zyrtarë të tjerë amerikanë.

Autori kritikon të gjithë protagonistët e politikës shqiptare të 25 vjetëve të fundit, veçanërisht, dy drejtuesit kryesorë të partive të tyre. Sipas tij, si qeverisja demokratike dhe ajo socialiste e kanë keqmenaxhuar qeverisjen duke e zhytur në korrupsion. Kritikohen për mungesë vizioni në politikë dhe për tiparin më thelbësor që e ka dalluar elitën politike postkomuniste: politikën e kanë parë më shumë si mundësi për të arritur poste e për t'u pasuruar, sesa si përgjegjësi ndaj vendit dhe qytetarëve të tyre.

Sipas (F. Abrahams, 2015) të dyja palët politike e kanë keqmenaxhuar shtetin dhe elita politike ka përgjegjësinë e saj për këtë. Elita politike postkomuniste nuk e ka parë asnjëherë aktivitetin e saj si mundësi në shërbim të publikut, por si mundësi për t'u pasuruar apo për t'i shërbyer një pjese të shoqërisë pra, klaneve apo përkrahëse të tyre element që përbën të metën më të madhe dhe themelore të të gjithë elitës politike të tranzicionit. Elita politike nuk ka qenë e aftë të marrë përgjegjësitë për të cilat ka patur nevojë vendi, në mënyrë që të ecë përpara.

Lufta dhe konfliktualiteti janë partiakë dhe e kanë zhvendosur vëmendjen e elitës politike nga strategjitë e zhvillimit politik, ekonomik dhe shoqëror, duke u karakterizuar nga mungesa e vizionit për zhvillimin e këtyre politikave. Konfliktualiteti, në dukje politik, mes dy partive të mëdha në Shqipëri, është një lloj

pakti apo konsensusi i të dyja palëve për të mbizotëruar sistemin dypartiak. Në një farë mënyre ky konfliktualitet i ka ndihmuar ato që të mund të zotërojnë pushtetin dhe ta shkëmbejnë atë me njëra-tjetrën. Për arritur një emancipim të pjekurisë dhe për të shmatur vazhdimin e ndërtimit nga ana e politike klasa politike të një elite të përçarë dhe joefektive ajo duhet t'i nënshtrohet një kritike të rreptë edhe nga ana e opinionit publik për mënyrën se si e konceptojnë politikën. Klasa politike shqiptare duhet të vihet në shërbim të shoqërisë dhe jo vetëm të përkrahësve të vet dhe të partisë. Ajo duhet të marrë përgjegjësitë dhe të bëjë që vendi të ecë përpara me zhvillimin e strategjive vizionare dhe të largojë vëmendjen nga lufta dhe konfliktualiteti politik.

Për të dalë nga kjo gjendje klasa politike duhet të veprojë në të mirën e të gjithë vendit dhe kjo është përgjegjësia kryesore që duhet të marrë. Reagimi qytetar duhet të jetë më i madh, në mënyrë që të vendimet që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve të mos merren gjithmonë nga lart. Qytetarët nëpërmjet aktivizimit të tyre, duhet të marrin përgjegjësitë që demokracia u garanton.

Analiza . Rënia e sistemit komunist në Shqipëri, dhe problematikat e elitës së re politike

Në analizën e dinamikës së rrjedhës jetësore të ngjarjeve të cilat shoqëruan lëvizjen studentore të vitit 90', rezulton se kjo ngjarje u shfrytëzua nga një pjesë e intelektualëve për të kërkuar vendosjen e pluralizmit politik në Shqipëri. Lëvizja studentore në korrelacion me zhvillimet historike të kohës i dha mundësinë intelektualëve të kohës për t'u bërë pjesa ushëheqëse në ato momente.

Lëvizja Studentore e analizuar si një ngjarje me rëndësi historike dhe shoqërore, në zhvillimin e saj në lidhje me zhvillimet politike të kohës, ishte ngjarja nga e cila u

promovuan në politikë individë të cilët nuk kishin qënë pjesë e nomenklaturës së lartë komuniste, dhe ngjarja e cila i dha jetës politike shqiptare të tranzicionit disa nga figurat më të spikatura politike, por që ishin teknokratë dhe jo profesionistë të fushës së politikës, pasi artin e politikës e mësuan në rrugën politike të këtyre viteve të tranzicionit.

Në procesin e rënies së sistemit komunist dhe të vendosjes së sistemit demokratik, intelektualët me prirje pro perëndimore, nga analiza e studimeve rezulton se sistemi komunist i kishte eliminuar pothuajse të gjithë ose i kishte burgosur, element që në lidhje me zhvillimet politike që po ndodhnin, nuk iu dha mundësia që të ishin pjesë e këtyre zhvillimeve politike, duke i shkaktoar një dëm të madh shoqërisë shqiptare, në krijimin e një shtrese të intelektualëve të pavarur dhe të kulturuar.

Kështu në analizën e rrjedhës jetësore të ngjarjes mbi elitën postkomuniste në korrelacion dhe me rëndësinë e kësaj ndodhie për shoqërinë shqiptare, dhe me rolin e rëndësishëm të kësaj elite në zhvillimin e proceseve politike ku elita duhet të zotërojë disa shprehje demokratike si, kompromisi, dialogu del në dukje se, elita politike postkomuniste ka demonstruar se në ngjarje të caktuara në lidhje me dinamikën e zhvillimeve politike, të rënies së sistemit komunist, të vendosjes së sistemit demokratik dhe të formësimit të elitës së re postkomuniste, ka qënë ndërtimi i tipareve të drejtuesve të rinj politikë, ku të gjitha tiparet tregojnë për një konfigurim problematik të drejtuesve të rinj politik, pasi zbatimi i kriterit altimetrik në zëvendësimin apo dhe në qarkullimin e elitës politike vendosi gjëndjen faktike se kush është në majë është i pushtetshëm, dhe se ka dhe ushtron pushtetin.

Mbështetur në këtë pikëpamje ku tranzitologët mbrojnë idenë se, institucionet mund të ndryshojnë mjedisin shoqëror dhe politik, ku institucionet luajnë një rol të

rëndësishëm e përcaktues në tranzicion dhe në konsolidimin e shtetit demokratik, evidentohen disa tipare problematike të elitës së re politike.

Mungesa e përvojës demokratike, ku padyshim një ndikim të madh kanë patur dhe pushtimet e huaja , nga ku rezulton se dhe figurat historike që kanë dhënë kontribut në krijimin dhe forcimin e shtetit shqiptar, kanë qënë produkt i kulturave dhe i mjedisve politike jo shqiptare.

Parë në këndvështrimin e analizës kohore të traditës së një shoqërie demokratike, Shqipëria është pranuar se nuk ka paraqitur traditë të qëndrueshme, pasi historiku i organizimit të shtetit nuk ka qënë i bazuar mbi zgjedhjet konkurruese të individëve, apo nga një legjislacion apo kod etik i pranuar nga instrumenta që dalin nga ndërveprimi i dy faktorëve, ndikimi patriakal i familjes konfliktet pozita e pafavorëshme politike, dhe nga ana tjetër mungesa e kapitalit politik qytetar, kanë ndikuar në ndërtimin e një tradite e cila me gjithë drejtimin demokratik, nuk ka qënë asnjëherë garanci e plotë për evoluimin e institucionalizimin e vlerave demokratike.

Mungesa e institucionalizimit të vlerave demokratike në drejtimin e shtetit dhe të shoqërisë, në krahasim me vendet e tjera që i mbartën dhe i trashëguan dhe në periudhën moderne, shqiptarët nuk kanë një periudhë të referueshme dhe të krahasueshme të këtyre vlerave.

Mungesa e një qasje institucionaliste ku për vendet që janë në tranzicion , institucionet kanë një rol të rëndësishëm dhe përcaktues në krijimin dhe në ndërtimin e qëndrueshëm të realitetit social dhe politik, përvoja historike e tranzicionit demokratik shqiptar identifikon elementë të cilët Freeman .R. Buts (në T.Gjuraj. 2015, fq 27) i cilëson si “armiq të demokracisë “ janë, një elitë politike e udhëhequr nga tendenca e të qënurit

mbi ligjin, dhe mos zbatimin e tij, model i cili deformoi institucionet e shtetit shqiptar dhe partitë politike.

Klanizimi i elitës politike, ku baza e deformuar e thelloi dhe me tepër këtë tipar, e për pasojë përçarja e politikës prodhoi probleme në drejtimin e vendit dhe ku mesazhe negative përçohen tek qytetarët.

Lufta e shpër për pushtet ndaj kundërshtarit politik por dhe brënda partive politike . Kjo gjëndje prodhoi mungesë të meritokracisë, konfliktualitet të vazhdueshëm, duke sjellë për pasojë pengimin e mendimit ndryshe si dhe vijimin e një politike përçarëse, konfliktuale, e në krijimin e një loje politike jo të barabartë brënda partive politike, duke penguar potencialet e reja për të kontribuar në drejtimin e mëtejshëm dhe për pasojë vonimin e riprodhimit të elitës së re politike në vend.

Abuzimi me pushtetin e pronën shtetërore, dhe deformimin e institucional duke qëndruar mbi shtetin e ligjin për interesat personale, çka i dha tiparin elitës për t'u pasuruar.

Ndërtimin i shtetit modern paraqet probleme që kanë të bëjnë me zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të pakontestueshme, ndërtimi i një shteti autokratik, si dhe nevojën e konsolidimit të institucioneve demokratike.

Një klasë politike e cila konfliktohet në funksion të interesave klanore politike, ku si pasojë pushteti në Shqipëri mbetet i pa ushtruar, duke sjellë rrjedhimisht që politika të zhvillohet në distancë dhe e shkëputur nga qytetari dhe institucionet të mbeten të dobëta, jo produktive larg synimit të funksionimit për të cilin ato janë krijuar, tipar ky i një mentaliteti të vjetër politikduke ulur efikasitetin e elitës politike duke krijuar mosbesim dhe zhgënjim duke sjellë një polarizim të jetës politike në Shqipëri.

Referuar pikëpamjes voluntariste ku roli i klasës politike e cila përfshihet në proceset e gjithëanëshme të zhvillimeve politike, dhe ku tranzicioni demokratik kërkon që të karakterizohet nga vlerat e dialogu kompromisi, dhe ku personaliteti dhe kultura politike kanë një vlerë mjaft të rëndësishme, mosmarrja në konsideratë e realizimit të një analize të thellë dhe të plotë për vlerësimin e kapaciteteve të vendit për rimëkëmbjen ekonomike, do të bënte që drejtuesit e rinj politikë të anashkalonin përgjegjësinë, gjë që ka çuar në uljen e besimit qytetar tek elita politike dhe tek institucionet shtetërore.

Në përshkrimin dhe analizën e efikasitetit të elitës politike të tranzicionit, korrelacioni pra krahu i ndikimit, mes kryqëzimeve të përvojave personale të individit dhe të atyre që përkojnë me kohën historike, rezulton se elita politike në procesin e demokratizimit të elitës dhe shtetit ndeshet me tre sfida të rëndësishme e përcaktuese në këtë proces të cilat janë, a) alternimi i pushtetit, dhe i aleancave partiake, b) roli i opozitës, c) marrëdhënia e elitës me masën e qytetarëve. Pra ende nuk ka një pranim reciprok të rregullave të lojës demokratike nga na e saj.

Përvoja politike e tranzicionit veçanërisht ajo dy partive kryesore politike PD-PS, janë karakterizuar marrëdhënie të ashpra e konflikte politike me sjellje jo të civilizuar politike, me mungesë dialogu politik dhe të frymës së bashkëpunimit duke e konsideruar kundërshtarin politik si armik, shenjë kjo e një marrëdhënie të acaruar e të vështirë të elitës politike. Mungesë të kulturës konsensuale dhe demokratike, duke harxhuar energji në konflikte politike, në vënd që të hartonin strategji për zgjidhjen e problemeve, duke vonuar proceset integruese të vendit në BE.

Në këto procese elitës politike i ka munguar alternativa dhe politikat e qarta, duke u shoqëruar me abuzim sistematik të pushtetit, i cili është reflektuar në qeverisje të dobëta, jo efektive dhe me mos realizim të reformave të premtuara.

Paaftësia e elitës politike për të kryer një alternim normal të pushtetit, është shenjë që tregon se demokracia konkurruese dhe e balancuar politike mungon në politikën shqiptare. Alternimi normal i pushtetit qoftë partiak dhe politik është tregues i demokracisë konkurruese dhe të barabartë, si dhe një e dhënë për një demokraci funksionale dhe të shëndetëshme që nxit rinovimin e lidershit dhe të politikës.

Duke qënë se partitë politike dominohen nga liderët politikë, madje duke përdorur autokracinë në vendimet që marrin, të cilat shpeshherë janë jo transparente.

Ideologjia dhe programet politike bëhen gjithnjë e më pak tiparet thelbësore të jetës politike të tyre të brëndëshme, duke çuar në uljen e antarësisë së përkushtuar ideologjike, ku pragmatistët shtohen dhe vlerat dhe bindjet politike kanë më pak rëndësi se përfitimet personale . Përfaqësim i ulët i grave në politikë në krahasim me meshkujt. Etiketimi i elitës postkomuniste shqiptare si një, elitë e prirur më shumë për nga interesat personale politike dhe ekonomike se sa në shërbim të vëndit, duke keqmenaxhuar qeverisjen dhe duke e zhytur atë në korrupsion.

Kritikat për mungesë vizioni politik si tiparin thelbësor që e ka dalluar politikën shqiptare, si dhe për faktin që asnjëherë aktivitetin e saj si një mundësi që i jepet në shërbim të publikut, por e kanë parë më shumë si mundësi për t'u pasuruar, se sa përgjegjësi ndaj qytetarëve të cilët i kanë mandatuar.

Konfliktualiteti politik i ka ndihmuar apo është përdorur nga të dy partitë e mëdha politike PD-PS si një lloj pakti për të zgjatur pushtetin apo për të mbizotëruar mjedisin

politik duke e shkëmbyer atë ndërmjet njëra tjetrës, duke prodhuar si pasojë shbalancim të raportit shtet shoqëri, duke prodhuar institucione demokratike të dobata dhe joefiçente. Përvetësimi dhe përqafimi i vlerave demokratike properëndimore nga ana e klasës apo i tipareve të cilat përfaqëson qasja voluntariste, për të vepruar në të mirë të vendit dhe të qytetarëve, është përgjegjësia kryesore që elita politike duhet të marrë. Zbatimi i kriterit të meritokracisë në funksionimin e qarkullimit të elitës, do të kishte si pasojë që elitat altimierike do të zvëndësohen nga elitat e të aftëve. Reagimi qytetar duhet të jetë më i madh, duke ndikuar, që vendimet që merr klasa politike të mos jenë eskuzivitet vetëm i vullnetit të tyre . Bazuar në pikëpamjen e Pareto-s se kur merita dhe pushteti bëhen bashkë atëherë kemi një gjëndje të qëndrueshme të ekuilibrit shtetëro, institucional dhe shoqëror, dhe kur ato ndahen atëherë kemi një ç'ekuilibër dhe kjo jep shkas për qarkullim të elitës.

KAPITULLI III

Kriza e vitit 1997 pasojë e mungesës eksperiencës politike për shtetformim, reagimi i klasës politike

3.1 Kriza e vitit 1997 pasojë e paaftësisë së elitës së re postkomuniste në shtetformim

Periudha e zhvillimit të ngjarjeve politike të vitit 1997 nga shumë studiues është cilësuar si shansi i humbur i politikës shqiptare. Kjo periudhë u shoqëruar edhe me ngjarje të cilat, në mënyrën se si ato u zhvilluan, ndikuan që Shqipëria t’iu largohej proceseve demokratike dhe rrugës së integritetit drejt BE-së. Lind pyetja. Cilat ishin shkaqet dhe arsyet që e çuan klasën politike dhe shoqërinë shqiptare drejt destabilizimit dhe anarkisë që përfshiu vendin? Natyrisht, të bësh një analizë të kësaj situate nuk është e lehtë. Madje, çdo lloj analize që do t’i bëhej kësaj periudhe do të ketë kritika dhe rezerva, kryesisht ndaj klasës politike si aktori kryesor, përfshirë dhe shumë aspekte që janë jashtë mundësisë së saj.

Në analizë merren disa nga ngjarjeve që i paraprinë krijimit të kushteve dhe premisave për të arritur në një situatë të tillë, së pari ishte dështimi i qeverisë demokratike për miratimin e Kushtetutës në vitin 1994. Bërja e vendit me një kushtetutë demokratike, element i cili ishte premtuar nga demokratët se do të realizohej shumë shpejt – një kërkesë kjo edhe e Bashkimit Europian, që kishte caktuar si afat datën 30 dhjetor 1994 në. (M. Vicker, 2008, fq 372)

Mosmiratimi i Kushtetutës së vitit 1994, u dha mundësinë klasë politike që të qeverisnin në një vakum institucional dhe u krijoi mundësinë të vazhdonin drejtimin e

vendit sipas modelit partiak element që dëmtoi shumë jo vetëm institucionet që do të garantoheshin nga Kushtetuta, por u krijoi mundësinë këtyre drejtuesve politikë të mos shkëputeshin nga modeli i “partisë-shtet”, pasi partia në pushtet ishte mbi ligjin. Pavarësisht disa reformave demokratizuese ekonomike që ishin ndërmarrë, vonesa në hartimin dhe miratimin e Kushtetutës tregon për një klasë politike përgjithësisht pasive, pasi rënia e sistemit komunist paraqiste detyra imediate përpara klasës politike shqiptare, ndërtimin e shtetit të ri demokratik mbi baza të shëndosha dhe kushtetuese. Kjo situatë e pasivitetit të klasës politike shqiptare që u krijua si pasojë e mungesë së llogaridhënies dhe efektivitetit në ushtrimin e pushtetit në këtë periudhë, krijoi mundësinë që administrata shtetërore të bëhej militante, të rritej korrupsioni dhe pandëshkueshmëria në radhët e zyrtarëve të rinj, pasi mungesa e kushtetutës krijoj hapsira për abuzimin me shtetin nga ana e klasës politike.

Studiuesja Miranda Vickers vitin 1994 e cilëson si “viti ogurzi për politikën shqiptare, pasi qeveria e PD-së po akuzohej rëndë për korrupsion dhe autoritarizëm patriarkal, duke përdorur gjithnjë e më shumë metoda kundërvënëse me opozitën”(në M. Vicker, 2008, fq 369).

Mënyra me të cilën qeveriste Berisha, si dhe tendenca e tij për të grumbulluar sa më shumë pushtet në duart e presidentit, u duk qartë edhe në projektkushtetutën e 1994-s. Ndaj edhe hasi në kundërshti të forta. Disa nga arsyet ishin:

Së pari, projektkushtetuta kishte kundërshti të forta në lidhje pushtetin që i takonte institucionit të Presidentit.

Së dyti, procedura për miratimin e projekt kushtetutës u deformua. Shmangia e institucionit të Parlamentit nga kjo procedurë ishte një deformim, pasi projektkushtetuta

duhet të miratohej paraprakisht nga parlamenti, pastaj të kalonte me referendum popullor. Shmangia e parlamentit ishte pasojë e mungesës së 2/3 të deputetëve, të cilët nevojiteshin për të arritur maxhorancën prej 94 deputetësh për miratimin e saj në Parlament në (S. Ngjela, 1994). Socialdemokratët, deputetët e Aleancës Demokratike dhe ata të minoritetit grek, kishin deklaruar se do të votonin kundër miratimit të projektkushtetutës.

Së treti, burgosja e liderit socialist Fatos Nano, të cilën socialistët e quanin të padrejtë, u dha mundësinë që të gjithë luftën e tyre politike socialistët ta bazonin në diskreditimin e projektkushtetutës. Sipas A. Çejkut “Fushatën antikushtetutë opozita e majtë e shfrytëzoi për qëllime të mirëfillta politike, duke i shkaktuar vendit një vonesë në procesin e demokratizimit” (A. Çejku, 116).

Si përfundim, mosmiratimi i projektkushtetutës pati një impakt negativ jo vetëm në elektorat: ishte një dështim i klasës politike, sidomos i Partisë Demokratike. Mënyra autoritare e qeverisjes nga ana e Berishës, i cili kishte vënë nën diktatin e tij institucionet e vendit, por edhe mënyra se si u konceptua, dëshmoi se kishte pakënaqësi në elektorat. Kjo i dha mundësinë Berishës të rriste autoritarizmin e tij, gjë që u dëshmuar në krijimin e një sistemi gjyqësor që pësoi deformime të rënda, duke rritur në këtë mënyrë shkallën e pandëshkueshmërisë, kryesisht te zyrtarët e lartë, pasi sistemi gjyqësor krijoi varësi nga institucioni i Presidentit.

Ky deformim prodhoi dhe mungesën e dhënies së drejtësisë te qytetarët e thjeshtë, deformim që ekziston edhe sot në sistemin gjyqësor, pas pothuaj 25 vjetësh sistem demokratik. Ky është një deformim që i ka rrënjët në dështimin që pati klasa politike e këtyre viteve të para të tranzicionit. Klasa politike e këtyre viteve në vend që të

kontribuonte në krijimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ndikoi në rrënimin e tij.

Studiuesi Brenard Fischer regjimin politik të vendosur në këto vite demokracie e cilësonte si një “demokraci iluzive“, pasi mënyra autoritariste me të cilën qeveriste Berisha e dëshmonte këtë po kështu, edhe ekzistenca e një opozite të dobët dhe drejtimi i shtetit nga një “administratë gjerësisht e politizuar“.

Analisti Andrew Gumbell shprehet se, “Presidenti Berisha dhe qeveria e tij kanë më se dy vjet që e kanë humbur popullaritetin. Reputacioni i mëparshëm si kampionë të demokracisë dhe të tregut të lirë, është njollosur tanimë nga represioni në rritje kundër opozitës politike, shtypit të pavarur, kundër institucioneve shtetërore duke filluar nga organet e drejtësisë“ (në A. Gumbell, 1997. 11-12, 14). E gjithë kjo situatë krijoi probleme jo vetëm në ndërtimin e një shteti të dobët dhe të nënshtruar nga politika, por gjithashtu përbën edhe rrënjët e dy prej problemeve më madhore me të cilat është përballur demokracia shqiptare. Ato janë vënia e sistemit gjyqësor nën varësinë e politikës dhe manipulimi e kontestimi i zgjedhjeve.

Një tjetër arsye që situata precipitoi drejt anarkisë së 1997-s ishte zhvillimi i zgjedhjeve të 26 majit 1996. Këto zgjedhje patën rëndësi të madhe jo vetëm për mënyrën se si u zhvilluan, por dhe për mënyrën se si klasa politike i shfrytëzoi ato. Këto zgjedhje patën një rëndësi tejet të madhe, pasi do të konfirmonin dy aspekte themelore të demokracisë së vendosur në Shqipëri. Së pari, zgjedhjet e 26 majit 1996 ishin testi i parë më të cilin do të testohet klasa politike shqiptare në angazhimin e tyre ndaj demokracisë dhe integritetit të vendit. Dhe së dyti, prekja e votës së lirë të këtyre zgjedhjeve prodhoi pasoja të rënda për demokracinë shqiptare.

Organizimi i zgjedhjeve të rregullta, të lira dhe të ndershme ishte jo vetëm një detyrë, por do të është garanci themelore për të dëshmuar se sistemi i ri politik po funksiononte me gjitha tiparet dhe vlerat e tij. Polarizimi, kontradiktat dhe përçarja e klasës politike shqiptare deri në ekstremka krijuan një gjendje mosbesimi tejet të lartë në të gjitha partitë politike. Mesa mundën, të gjithë aktorët politikë po kontribuonin në manipulimet “e pritshme” që do të ndodhnin në zgjedhjet parlamentare të 26 majit. Nga njëra anë, zgjedhjet e vitit 1996 ishin një test i fortë për politikën e ndjekur gjatë atyre katër viteve nga Berisha dhe demokratët dhe, nga ana tjetër, ishin një test i fortë për politikën që kishin ndjekur socialistët si opozitë.

Zhvillimet e ndodhura në vitin 1997 i sheh si rrënjët kryesore të problemeve që ka kaluar Shqipëria pas rënies së komunizmit. Ai shprehet se, *“historia e rrënimit të zgjedhjeve në Shqipëri është trauma më e madhe që ky vend ka pësuar pas rënies së komunizmit. Te rrënimi i tyre duhen kërkuar sot rrënjët e shumë prej problemeve të mëdha që ka vendi, siç është mosreformimi i klasës politike, mbetja në pushtet e dy-tre emrave të politikës shqiptare, lidhjet e tyre me krimin e organizuar dhe nëntokën e mafies rajonale dhe botërore. Dhe, mbi të gjitha, vazhdimi i traditës së zgjedhjeve të vjedhura”*(në M.Baze. 2010, fq 5-6) .

Për keqfunksionimin e demokracisë në vend, Kadare konstaton me të drejtë në ngjarjet e vitit 1997, se “ndërtesa e shtetit shqiptar u shemb”në (I. Kadare, 2001,fq 23).

Për analistin Mero Bazenë librin Prapaskenat e vitit 1997 , kriza e e këtij viti që preku shtetin dhe shoqërinë shqiptare duhet analizuar në dy këndvështrime të cilat, sipas tij, kanë ndarë jo vetëm politikën shqiptare, por edhe atë ndërkombëtare. Ai thekson se, “shumë vende evropiane ishin të gatshme ta shikonin atë si një krizë të skemave piramidale, prodhuar nga padija e drejtuesve të rinj të qeverisë shqiptare. Përballë tyre

ishite teza solide dhe e qartë e politikës amerikane se, e gjitha ishte një krizë e zhvillimit të demokracisë” (në M. Baze, 2010, fq 351). Sipas Frrok Çupit, situata e krijuar në Shqipëri pas rënies së firmave piramidale kishte bërë që, pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria, për të tretën herë, të kthehet në vëmendjen e politikës evropiane. Herën e parë, me incidentin e Kanalit të Korfuzit, të dytën, me daljen nga Traktati i Varshavës dhe së fundmi, me situatën e krijuar si pasojë e manipulimit të votave, të kundërshtarëve politikë nga ana e qeverisë.

Kjo bëri që kancelaritë e Europës të shkruajnë se, kemi të bëjmë me “*precedentin ‘Albania’*” (në F. Çupi, 2005, fq 288). Ky përcaktim politik i Europës, erdhi si rrjedhojë e sjelljes së dhunshme të qeverisë kundër zgjedhjeve parlamentare, aq sa e frikësoi politikën europiane, por po kaq dhe i shërbeu asaj. Madje kjo frikë u shoqërua me kalendarin e ngjeshur të zgjedhjeve në Europën Lindore, të cilat vinin pas Shqipërisë. Sipas autorit, shërbimi që i bëri “precedenti Albania“ Perëndimit, është modeli paralajmërues ndaj Perëndimit për ç’mund të ndodhte në Europën Qendrore dhe Lindore.

3.2 Përpjekjet e presidentit Berisha për zgjidhjen e situatës

Ngjarjet e ndodhura si dhe situata e jashtëzakonshme, detyroi presidentin Berisha të fillojë dialogun me të gjitha partitë politike. Kjo me qëllim që të gjendej një zgjidhje optimale pa ndërhyrjen e forcave ushtarake. Për këtë qëllim, presidenti zhvilloi një takim zyrtar me përfaqësues të PS-së, ku u shpreh se ishte gati të pranonte çdo kërkesë të socialistëve në mbështetje të rendit kushtetues dhe në kompetencat e tij.

Me gjithë garancitë e dhëna nga presidenti për të mosrikandiduar në zgjedhje dhe se në rast të fitores nga ana e socialistëve presidenti do të jepte dorëheqjen, socialistët e

kundërshtuan prerazi ofertën e presidentit për mosrikandidimin e tij në rast të fitores së PS-së, me argumentin se nuk e kishin kërkuar një gjë të tillë dhe se nuk dëshironin të krijonin një vakum konstitucional, por shkarkimin e qeverisë me pretekstin se kjo kërkohej nga studentët e grevës së urisë, në Vlorë. Kërkesën nga ana e socialistëve për të ushtruar presion mbi grupin parlamentar të PD-së dhe Këshillit Kombëtar të PD-së për të miratuar dorëheqjen e qeverisë, pasi klauzola ligjore nuk ia lejonte presidentit të drejtën e shkarkimit të qeverisë, presidenti nuk e pranoi. Ngritja e një qeverie teknike jopartiake - kërkesa e radhës nga ana e socialistëve - sërish u hodh poshtë nga presidenti, me argumentin se është përvoja më e keqe e tranzicionit. Kjo bëri që socialistët të deklarojnë se nuk duan në asnjë mënyrë koalicion qeverisje me PD-në dhe se ishin dakord për krijimin e një qeverie të re të PD-së, me kushtin që emrat e kryeministrit dhe të ministrave të konsultoheshin më parë me opozitën.

Mosdakordësimi mes presidentit dhe përfaqësuesve të opozitës për dy kërkesat, njëra për rikthimin e parave të humbura në firmat piramidale, të cilat asnjë qeveri nuk mund t'i kthente, dhe që PS duhej të distancohej nga militantët dhe dhuna, u lanë për t'u konsultuar në takimin e radhës, takim i cili nuk u zhvillua pas njoftimit të socialistëve se nuk dëshironin vazhdimin e dialogut me presidentin.

Mbështetur në këndvështrimin e studiuesit A. Krasniqi (2005) sipas të cilit, referuar dialogut protokollar të këtij takimi të presidentit me përfaqësuesit e opozitës, dallohet lehtë demagogjia dhe tragjikja e një politike që udhëhoqi shkatërrimin e Shqipërisë.

Kjo është e dukshme në faktin se, PS mbeti e vetmja parti politike pretenduese e pushtetit në Europë që nuk pranoi të distancohej dhe ta dënonte dhunën. Po kështu edhe qëndrimin dualist dhe demagogjik të saj, ku edhe pse për vite i kërkonte presidentit distancimin nga PD-ja, në takimin e zhvilluar me presidentin ata me insistim i kërkuan

të kundërtën. Me gjithë deklaratat në shtyp e në mitingje për kërkesat dhe për t'i dhënë zgjidhje konkrete situatës në të cilën ndodhej vendi, në takimin me presidentin PS heshti, sepse nuk kishte zgjidhje.

Sipas autorit, ata që e kritikonin presidentin si diktator, që kundërshtonin zyrtarisht vullnetin e tij për mospërdorimin e ushtrisë, që deklararin se paratë e humbura të fajdet duhet t'i kthente qeveria, në takimin zyrtar me presidentin u shprehën dakord kundër këtij optionsi. Kjo, sipas autorit, ishte fytyra e vërtetë e PS-së jashtë çdo morali dhe parimi politik, duke bërë demagogji dhe mashtrime që i sollën Shqipërisë, në pak muaj, bilance dhe pasoja katastrofike.

Situata e krijuar më vend e detyroi presidentin që më 8 mars të thërriste një tryezë të partive politike për zgjidhjen e situatës së krizës. U vu re një qëndrim jo konstruktiv i socialistëve të cilët, sapo paraqisnin kushtet e tyre, kur shihnin se ishin drejt realizimit, tërhiqeshin për konsultime në selinë e tyre. Kjo sepse çdo gatishmëri të PD-së dhe të presidentit për zgjidhje politike, e shihnin me mosbesimin se çfarë mund të fshihej pas tyre. Në mbledhjen e 8 marsit, në kryesinë e PD-së presidenti raportoi në lidhje me situatën e krijuar në vend dhe formulën e një zgjidhjeje politike, që do t'i jepte stabilitet vendit. Gjithashtu, ai raportoi për mbështetjen unanime që kishte marrë nga jashtë vendit, nëpërmjet komunikimit me kancelarin Kohl, kryeministrat Prodi e Simitis, se zgjidhja e ofruar prej tij ishte e pranueshme.

Por ofertat e të dy krahëve të politikës, fatkeqësisht, nuk arritën të japin një kompromis aq të nevojshëm për vendin në çastet që po kalonte. Dhe kjo jo vetëm për pasojë të një mungese të përbashkët të klasës politike për të arritur kompromisin.

Kjo mungesë kompromisi iu dha mundësinë ish-drejtuesve të lartë ushtarakë të regjimit komunist, të cilët ishin liruar nga funksionet e tyre, që së bashku me funksionarë të koalicionit të majtë të vihen në krye të komiteteve të mbrojtjes që u krijuan në jug të vendit, si pasojë e rebelimit që kishte shpërthyer.

Mungesa dialogut për të arritur në një marrëveshje politike mes palëve, si dhe situata kaotike e krijuar kryesisht në jug të vendit, i detyroi kancelaritë europiane të ngarkonin me detyrën e moderatorit për Shqipërinë F.Vranitzkyⁱⁱⁱ, si negociues në fillimin e dialogut, me qëllimin që të krijohej mundësia e integritit të qytetarëve shqiptarë me normalitetin demokratik. Qëndrimet e dyanshme si të të huajve ashtu edhe të politikanëve shqiptarë, hidhnin hije dyshimi mbi aftësinë e tyre për të gjetur një zgjidhje optimale për kushtet në të cilat ndodhej vendi - nën presionin e bandave të armatosura - si dhe në qëndrimet ndaj komiteteve të mbrojtjes që ishin krijuar.

Në përpjekjet e saj për evituar konfliktin politik të armatosur, klasa politike shqiptare nënshkroi marrëveshjen e 9 marsit 1997, e cila ishte një platformë e daljes nga kriza politike e propozuar nga presidenti, drejtuar të dhjeta partive pjesëmarrëse, dhe që shënon përpjekjet politike për të dominuar me mjete politike daljen nga kriza politike në të cilën kishte rënë shteti, si dhe përpjekjen për të ndërprerë tentativën e rindarjes sociale të Shqipërisë.

Kjo përpjekje e klasës politike gjeti dhe përkrahjen e faktorit ndërkombëtar dhe u përshëndet nga të gjitha kancelaritë evropiane. Këto shprehën përkrahjen për një impenjim të sigurt të forcave politike për realizimin e kësaj zgjidhje të krizës politike. Ky qëndrim iu përcoll Tiranës zyrtare nga ministri i Jashtëm italian, Lamberto Dini. Me gjithë përpjekjet e klasës politike shqiptare për zgjidhjen e kësaj krize, ka patur qëndrime dhe argumente të ndryshme në lidhje me aktin e 9 marsit, duke e

cilësuar si formë presioni ushtarak të bandave të opozitës si dhe presion politik i Perëndimit. Në këndvështrimin e zgjidhjes së krizës, kjo marrëveshje u krijoi mundësinë të gjithë forcave politike të përfshihen në të, duke u krijuar qeveria e pajtimit kombëtar. Me gjithë kritikën që i janë bërë, kjo marrëveshje pati meritën e eliminimit të përpjekjeve të një konflikti veri-jug dhe u dha mundësinë për zgjidhje problemeve që do të dilnin më vonë.

Mungesa e përfaqësimit të shoqërisë civile në këtë marrëveshje, si palë e tretë në bisedimet e partive politike për zgjidhjen e krizës, tregoi se klasa politike shqiptare ende nuk e kishte vlerësuar si duhet rolin e shoqërisë civile. Këtë e tregon fakti se kërkesa e tyre për përfshirje në tryezën politike u hodh poshtë.

Duke mbajtur në konsideratë të gjitha përpjekjet e klasës politike për zgjidhjen politike të krizës së krijuar, duhet theksuar se mungesa e dialogut dhe e kompromisit politik është tipari kryesor që vërehet. Po kështu, edhe ndikimi i kastës së vjetër të ish-komunistëve, të cilët ende kishin influencë qoftë nëpërmjet partisë komuniste, por edhe me lidhjet që kishin individë të përfshirë në jetën politike të vendit. Në këtë rast, mund të thuhet se kemi dy vizione të ndryshme të formimit të institucioneve nga grupimet kryesore të elitës politike: në të majtë e në të djathtë.

Kjo referuar qëndrimit të Fondacionit Amerikan për Europën Lindore, i cili me anë të një letre drejtuar ambasadës shqiptare në Uashington, e nënshkruar nga zëvendëspresidentja E. Visan vërente “ Pas rënies së komunizmit në Europën Lindore, ish-komunistët dhe aleatët e tyre të pas Luftës së Ftohtë, disa grupe ndërkombëtare me interesa të posaçme i shfrytëzojnë komplotet politike dhe financiare për të minuar demokracitë e reja europiano-lindore. Ky koalicion monstruoz përbën rrezikun më të tmerrshëm për vendet europiano-lindore dhe ballkanike, dhe Shqipërinë në veçanti .

Është naivitet i madh të mos kuptosh se komiteti i shpëtimit të Vlorës dhe udhëheqësit e tyre janë të frymëzuar nga mafia e tipit komunist dhe të KGB-së” (në A. Krasniqi, 1997, fq 197).

3.3 Qëndrimi ekstremist i elitës politike në ngjarjet për zgjedhjet e 1996-s

Manipulimi i zgjedhjeve të 26 majit nga ana e demokratëve bëri që Partia Socialiste të tërhiqte të gjithë komisionerët e saj në qendrat e votimit. Pavarësisht kësaj, PD i fitoi zgjedhjet, ndërsa PS braktisi parlamentin. Tërheqja e komisionerëve të opozitës nga komisionet e votimit, për socialistët ishte një pranim i humbjes së tyre përpara se të dilte rezultati përfundimtar. Tërheqja e opozitës krijoi një situatë tragjike jo vetëm për vetë opozitën, por edhe për demokracinë e re shqiptare, ku pas këtij veprimi fshiheshin qëndrime, kompromise dhe shantazhe që morën peng demokracinë shqiptare.

Qëndrimi i kundërt i liderit të opozitës së atëhershme me veprimin e partisë së tij, që ai e mbajti në një analizë të zgjedhjeve bërë nga burgu ishte: “Është një veprim i nxituar tërheqja e anëtarëve dhe vëzhguesve të opozitës nga komisionet e votimit, pasi në këtë mënyrë do të mund të kishin evidentuar të gjitha parregullsitë e zgjedhjeve të 26 majit 1996”, konstatim që hedh dyshime mbi urdhrin e dhënë për tërheqjen e komisionerëve nga qendrat e votimit, një tërheqje që solli një situatë tragjike të demokracisë shqiptare, marrjen peng nga pakica e saj. Deklarata e liderit të opozitës Nano në analizën e bërë prej tij për zgjedhjet, nxjerr në dukje një të vërtetë të madhe dhe të dhimbshme, pasojat e së cilës do t’i paguanin shqiptarët.

Sipas studiuesit Krasniqi asnjë prej liderëve të PS-së apo dhe të koalicionit të opozitës nuk kishin të drejtë apo forcë për të imponuar një qëndrim të tillë kaq ekstrem, por të gjitha faktet për këtë qëndrim flasin për një vendim që erdhi nga jashtë strukturave të

drejtuese të opozitës. Ja si shprehet autori: “Nga njerëz që e flasin shqipen me përkthyes”. Parë në këtë këndvështrim, varianti më i mundshëm është ai i botuar në shtypin grek, “një person i lartë i afërt me administratën amerikane dhe një lider i lobit grek në SHBA, kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme në korrent me zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Sipas tij, janë bërë disa qindra telefonata nga Athina dhe nga adresa private nga Perëndimi për të arritur në përfundimin ekstrem për të bojkotuar procesin e numërimit të votave, para se të mbaronte procesi zgjedhor” (në A. Krasniqi, 1997, fq 22).

Duke iu referuar këndvështrimit të autorit, qëndrimi ekstrem i Partisë Socialiste në zgjedhjet e 26 majit ka të bëjë me faktin se, opozita duke patur probleme të shumta brenda vetes duket se zgjodhi si rrugë shpëtimi sulmin e ashpër dhe bojkotues kundër institucioneve demokratike, gjë e cila, minimalisht, do ta lejonte atë të ishte prezente në jetën politike. Por vendimi i Parlamentit Shqiptar i 1995-s, që iu hiqte të drejtat e përfitimit të detyrave të larta zyrtare si dhe të drejtën për të kandiduar si deputetë ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit dhe ish-funksionarëve të lartë të diktaturës, vendim që mbështetej në të drejtën morale të popullit shqiptar për t’u çliruar nga mbeturinat e komunizmit dhe eksponentët e tij, ndikoi që shumë prej drejtuesve të opozitës së majtë të mos kishin të drejtë kandidimi – një hap ky i ndërmarrë edhe nga shtetet e tjera demokratike që kishin patur një regjim më pak diktatorial se Shqipëria, si: Gjermania Lindore, Polonia etj. Në këto kushte ish-funksionarët e Sigurimit të Shtetit nuk u lejuan të drejtonin në jetën civile dhe ushtarake. Vendimi i marrë nga Parlamenti bëri që të humbnin të drejtën për të kandiduar 150 eksponentë të ish-Policisë Sekrete (në A. Krasniqi, 1997, fq 38).

Sipas ndërkombëtarëve, këto ishin zgjedhje me legjitimitet të cunuar. Ky deformim i zgjedhjeve nga ana e partisë në pushtet dëmtoi rëndë një ndër elementet bazikë të demokracisë. U përdor një retorikë antikomuniste nga ana e PD-së kundër PS. Nisur nga këto zhvillime, ish-kryetari i PS-së Nano paraqiti nga burgu një “mocion” ku kërkonte që të zhvillohej debati në KPD për reformimin e PS-së dhe për ndërmarrjen e hapave konkretë në terren, në mënyrë që të hidhej poshtë ajo që mocionistët e quajtën “skenari diversionist i Berishës” (në *L. Progni*, 2008, 212). Në kushtet e një krize dhe klime të vështirë politike, si dhe faktit të të qenit në opozitë, PS-ja i druhej asaj se do t’i duhej shumë kohë për të ardhur në pushtet. Gjithashtu, edhe në kushtet e një luftë të ashpër brenda PS-së, Nano thekson se pjesëmarrja e përfaqësuesve të PS-së në dialog pa kushte është një qëndrim që nuk i shërben vetë partisë, nisur edhe nga farsa elektorale e 26 majit.

Ndërkohë kishte filluar rënia e firmave piramidale dhe protestat e qytetarëve në forma spontane dhe, në pak ditë, ato u kthyen në një revoltë popullore. Në krye të kësaj revolte u vu PS, pasi qëndrimi i saj ishte në anën e protestuesve. Këto protesta popullore u kthyen në revoltë kundër qeverisjes së PD-së.

PS merr vendimin dhe, më 31 maj, i gjithë grupi parlamentar socialist futet në grevë urie në ndërtesën e PS-së, si një formë ekstreme ndaj opozitës, por edhe si një përpjekje e saj për të tërhequr vëmendje. Kryetari i qeverisë dhe presidenti iu bënë thirrje socialistëve të merrnin pjesë në raundin e dytë të zgjedhjeve dhe të hiqnin dorë nga qëndrimet ekstreme dhe greva e urisë.

Jemi në kushtet e një acarimi të marrëdhënieve të Berishës me SHBA-të, për shkak të ndikimit të lobit grek në SHBA (në *M. Baze*, 2010, fq 61). Interesante, sipas autorit, ishte se problemin real me Perëndimin e kishte PD-ja, e cila, sipas autorit, mendonin se

Perëndimi i kishte shitur – kjo referuar një interviste të Dritëro Agollit te gazeta “Zëri i Popullit”, ku ai sulmon Perëndimin. Në përpjekjet e klasës politike shqiptare nën vëzhgimin e SHBA-ve dhe të ambasadorit italian në Shqipëri u përfshinë edhe partitë e tjera të polit të qendrës. Ata kërkonin pjesëmarrje në zgjedhje, në zonat ku do të përsëriteshin. Nuk u arrit asnjë marrëveshje, përkundrazi, situata u acarua edhe më tej.

Me rritjen e revanshit të protestave që kishte si objektiv qeverinë e kohës, presidenti e kishte të qartë se protestat kërkonin qendrën e pushtetit, që ishte ai. Fuqia e protestës e kishte kaluar fuqinë e politikës për ta vendosur nën kontroll. Ndërkohë, PS nuk kishte fuqinë dhe besueshmërinë e duhur për të negociuar me protestuesit, pasi ishte e përçarë: kishte lindur brenda tyre një luftë midis radikalëve të saj, që donin të viheshin në krye të protestave dhe disa të tjerëve, që strukeshin nën termin “të moderuar”.

“Partisë më të madhe opozitare i kishte humbur mekanizmi i përfaqësimit, dhe partia në pushtet kishte mjaft probleme brenda saj. Mbështetur në këto fakte, beteja e 26 majit ishte më shumë një betejë për t’u shkëputur përfundimisht nga komunizmi dhe për forcimin e demokracisë. Si një betejë me të tillë objektiv, ishte themelore për socialistët që për të fituar duhej të rrezikonin gjithçka, pasi humbiste nga radhët e veta komunistët dhe rrezikonte të mbetej jashtë jetës politike për shumë kohë. Pikërisht këtu duhen kërkuar rrënjët e qëndrimit ekstrem të socialistëve për bojkotimin e zgjedhjeve, fillimin e protestave, si dhe akuzat dhe kurthet e, në fund, kryengritja e armatosur” (në A. Krasniqi , 1997).

Referuar qëndrimit të faktorit ndërkombëtar dhe veçanërisht raportit të vëzhguesve të ODHIR-it, i cili ishte kundër legjitimitetit të këtyre zgjedhjeve, u krijuan dyshime serioze mbi punën e këtij organizmi ndërkombëtar. Disa ditë pas raundit të parë të zgjedhjeve, në shtypin shqiptar u dhanë të dhëna mbi emrat dhe lidhjet që kishin me

vendin tonë disa prej vëzhguesve të OSBE-së. Sipas studiuesit (A. Krasniqi, 1997) në numrin prej 42 vëzhguesish të OSBE-së, delegacioni më i madh është ai i komunistëve norvegjezë. Një status i dyfishtë si vëzhgues të OSBE-së dhe të PSSH-së hedh një hije dyshimi për tërë mjegullnajën e madhe 24 orë pas zgjedhjeve. Përveç kësaj, në listat e vëzhguesve të OSBE-së, sipas autorit, figuronin dhe emra të implikuar me ish-regjimin e Enver Hoxhës, të cilët u legalizuan me një status të dyfishtë vëzhgimi. Dyshimet për vërtetësinë e këtij raporti të ODHIR-it përforcohen referuar vendimit për përsëritjen e zgjedhjeve, marrë prej përfaqësuesve norvegjezë dhe anglezë, të cilët u prezantuan në shtyp të nesërmen e zgjedhjeve pa dijeninë e përfaqësuesve të tjerë të delegacionit të OSBE-së, në një kohë që raporti përfundimtar me të dhënat vëzhguese nuk ishte përpiluar nga gjysma e delegacionit dhe nuk kishte mbërritur ende në Tiranë.

Nga qëndrimi i Prof. Victor-Yves Ghebali i Institutit të Studimeve Ndërkombëtare në Gjenevë, prezantuar para Komitetit të Punëve Ndërkombëtare të Zyrës Krahasese Zviceriane, shkëpusim: *“ODHIR-i ka qenë viktimë e manipulimeve politike”* (në A. Krasniqi, 1997, fq 47) duke nënkuptuar lidhjet e shumta të tyre me komunistët dhe socialistët. Edhe në raportin e vëzhguesve të OSBE-së dhe strukturave të tjera të saj, pasi vëzhguan zgjedhjet dhe procesin elektoral, thuhet: *“Legjitimiteti i Parlamentit të ri shqiptar nuk mund të diskutohet”*, duke e pranuar se, *“legjislacioni shqiptar krijonte bazat për zgjedhje të lira dhe të drejta”*. Unanimisht ata deklaruan se, *“zgjedhjet e majit u zhvilluan në përputhje me ligjin elektoral”*.

Analiza e Xhonatan Sanli, vëzhgues i zgjedhjeve të 26 majit, konkludon se, *“duke i krahasuar me zgjedhjet e zhvilluara gjatë 12 muajve të fundit në Armeni, Gjeorgji, Belarusi dhe Rusi, ku të gjithave iu dha një kartelë e pastër shëndetësie, shkeljet dhe parregullsitë në Shqipëri ishin minore”*. Të njëjtin përfundim dha edhe grupi i

vëzhguesve të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, i cili i cilësoi zgjedhjet të lira dhe të drejta, krahasuar me vendet e tjera ish-komuniste.

Edhe pse nga klasa politike ra dakord për ripërsëritjen e zgjedhjeve në 17 zona, kjo sipas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe që u përshëndet nga përfaqësuesit e opozitës, ky mirëkuptim u ruajt deri dy ditët e fundit, kur PS dhe aleatët e saj u dakordësuan me ndërmjetësimin e misionit diplomatik të BE-së dhe SHBA-ve. Pra paktet kanë qënë të përkohëshme, dhe nuk kanë prodhuar institucione të qëndrueshme, dhe më tepër janë kryer nga trysnia ndërkombëtare. Opozita në vend për të fituar kohë për shtyrjen e votimit nëpërmjet kryerjes së hetime nga ana e Gjykatës Kushtetuese, kërkuar nga kjo e fundit që vendimi i KQZ-së të shpallej i paligjshëm së bashku me dekretin e presidentit. Ky veprim bëri që opozita të hiqte dorë nga konkurrenca e raundit të tretë, por dhe t'u jepte mundësinë kandidatëve të PD-së të fitonin së bashku me ta edhe parti të tjera të vogla të qendrës së djathtë.

Me 28 maj opozita lajmëroi se do të organizonin protesta, skema e të cilave ishte përgatitur me kujdes nga PS për të provokuar policinë. Rënia e policisë në grackën e opozitës, i dha mundësinë opozitës të përshkallëzonte protestat dhe të shkelte normat ligjore të shtetit.

Për E. Biberajn: *“Zhvillimi i diskutueshëm i zgjedhjeve tregonte se elitat politike të Shqipërisë paskomuniste nuk kishin përvetësuar rregulla të pranueshme lidhur me zgjedhjet dhe demokracinë procedurale në përgjithësi. Si Partia Demokratike në pushtet, ashtu edhe opozita, sidomos Partia Socialiste, ishin përgjegjëse për parregullsi zgjedhore (E. Biberaj, 2001. fq 416).*

3.4. Pastrimi i parave dhe firmat piramidale, krimi godet shtetin

Parë nga një këndvështrim tjetër, me rënien e tyre firmat piramidale jo vetëm e futën Shqipërinë në një kaos dhe anarki por, ato sipas studiuesve shërbyen dhe si ofiçina të pastrimit të parave. Në një studim të tijin Naim Meçalla shprehet “Ekzistojnë prova, se këto firma kanë bërë pastrim parash dhe se janë marrë me aktivitete të tjera të jashtëligjshme.”(në N. Meçalla, 2013, fq 205) Duke qenë se këto firma ishin një investim i jashtëligjshëm. Në to, investitorëve u premtuhej një përqindje shumë e madhe interesi mbi shumën e investuar, përqindje që nuk përputheshin me asnjë logjikë ekonomike. Personat që merren me organizimin e këtyre firmave, janë ata që përfitojnë më shumë, ndërkohë që investuesit apo huadhënësit që futen në lojë, më vonë dalin të humbur. Pra “efekti i piramidës” lidhet me një bazë të gjerë huadhënësish dhe kur arrihet në një kulm, paratë e dhëna hua dhe përqindjet e premtuara nuk mund të paguhen më. Pikërisht ky është dhe çasti kur këto skema shemben. Në Shqipëri, sipas studiuesit, në kulmin e këtyre firmave, “vlera nominale e detyrimeve të tyre arrinte në pothuajse gjysmën e GDP-së së vendit” (N. Meçalla, 2013, po aty).

Rreth dy të tretat e popullsisë investuan në këto firma dhe, sipas autorit, grupe të ndryshme kriminale shqiptare, në bashkëpunim me organizatat kriminale ndërkombëtare, në vitin 1997 organizuan shembjen e shtetit shqiptar. Zotërimin e shtetit e morën këto grupe kriminale, të interesuar që ta mbanin situatën të destabilizuar jo vetëm në Shqipëri, por dhe në rajon, në mënyrë që të kontrollonin trafiqet. Në një raport të CIA-as, i botuar në vitin 2001 thuhej se, ”trazirat që mbërthyen Shqipërinë në vitin 1997 ishin orkestruar nga mafia italiane dhe ajo shqiptare”. Pastrimi i parave në masë dhe skemat investuese piramidale çuan në destabilizimin politik të Shqipërisë, efektet e të cilit vazhdojnë të ndihen ende. Në rast të instrumentalizimit të parave të

pista, tregjet mund të reagojnë në mënyrë spektakolare ndaj fjalëve dhe statistikave të rreme duke provokuar paqëndrueshmëri dhe destabilitet. Rasti shqiptar në vitin 1997, sipas autorit, është ”unikal“ (në N. Meçalla, 2013, fq, 206), pasi krimi i organizuar goditi shtetin.

3.4.1 Demokracia shqiptare në rrezik, përpjekjet për të stabilizuar situatën.

Kriza e thellë që la pas rënia e firmave piramidale, si dhe thellimi i krizës financiare u shoqëruan dhe me krizë politike, krizë e cila tregoi dhe bëri të dukshme kufijtë në të cilët shtrihej dhe pushteti apo ndikimi i vërtetë i administratës së PD-së. Fakti që qendra e shpërthimit të pakënaqësisë dhe rebelimit kundër qeverisë së presidentit Berisha ishte Vlora, dhe më pas qytete të tjera të Shqipërisë së Jugut, është një tregues i shtrirjes së këtyre kufijve.

Sipas studiueses Miranda Vicker (2007) veprimtarët e strukturave të vjetra jo zyrtare të Partisë Socialiste do të bëheshin përherë e më shumë autoritet-shprehës në këtë qytet. Kjo anarki u thellua dhe më tej kur të gjithë zyrtarët që ishin të emëruar në këtë qytet, kryesisht nga veriu, ose ia mbathën, ose u nxorën jashtë me forcë nga bandat ushtarake vendore, jo vetëm në Vlorë, por dhe në qytetet e tjera të Shqipërisë së Jugut. Rritja e shkallës së protestave, grabitja e armëve si dhe mungesa e aftësisë së qeverisë për të vepruar në mbrojtje të rendit kushtetues dhe të qetësisë publike, bëri që protestuesit ta kuptojnë fuqinë e tyre në rritje, ndërsa fuqia dhe pushteti i PD-së sa vinte dhe dobësohej. Kërkesa e këtyre grupeve të armatosura, ishte për largimin e presidentit, edhe pse presidenti dëshironte të qëndronte në pushtet me çdo mënyrë. Në këto kushte, presidenti urdhëroi përqendrimin e trupave qeveritare në Tiranë dhe posaçërisht rrethimin e selisë së PS-së, element që u interpretua si një përpjekje nga ana e presidentit për të vendosur një diktaturë zyrtare.

Rizgjedhja e Berishës si President i Republikës në 5 mars 1997, në kushtet kur Parlamenti ishte i kontrolluar nga PD, u bë subjekt i kritikave publike jo vetëm në vend, por edhe nga ana e faktorit ndërkombëtar. Ndërsa situata në vend vazhdonte të ishte kritike, dominuan edhe veprimet e dhunshme kundrejt shtypit. Kur gazeta “Koha Jonë” u hap me kryeartikullin “Tirana si Algjeria: tri bomba në dhjetë orë” (G. KJ, 1997), pas këtij momenti kemi djegien e zyrave të gazetës “Koha Jonë”. Qeveria e Berishës u përpoq të rifitonte kontrollin mbi Jugun e vendit, duke bombarduar qytetin e vogël të Delvinës që ishte në duart e kryengritësve, një tentativë e dështuar, përpjekje që jo vetëm nuk e zgjidhi situatën, por e përkeqësoi atë, duke çuar në grabitjen masive të depove të Ushtrisë dhe të Marinës në Jug. Pas kësaj përpjekje të dështuar të Berishës, shumë qytete të Jugut ranë në duart e rebelëve, të cilët në kushtet e kaosit dhe të anarkisë, të armatosur lëvizën me shpejtësi drejt qyteteve të tjera, si Tepelenë, Përmet, Berat, Kuçovë, deri në afërsi të Tiranës, ku përkrahësit e Berishë ende bënin ligjin.

Në analizën e saj M. Vicker (2008) thekson se, ”në Shqipërinë Veriore e mbështetur fort te përbërja fisnore, politika ishte ende çështje që lidhej me personat që donin ata. Presidenti Berisha ishte një malësor verior, ndaj edhe mbështetësit e tij as që e vinin në dyshim se këto që po ndodhnin ishin pjesë e një komploti komunist dhe amerikan, të frymëzuar nga media” (në M. Vicker, 2008, fq 383).

Pas lirimit të liderit të opozitës nga burgu i Bënçës dhe kthimit të tij në selinë e PS-së, në Shqipëri mbërrin një komision i nivelit të lartë të Bashkimit European, me qëllim gjetjen e rrugës së frenimit të valës së refugjatëve që kishte shkaktuar situata e anarkisë së krijuar në vend. Rënia e qeverisë “Meksi” pasohet nga formimi i qeverisë së përkohshme të Pajtitimit Kombëtar, e kryesuar nga Bashkim Fino. Përveç kërkesës për ndihma humanitare, në të njëjtën kohë u ngrit edhe çështja e ndërhyrjes ushtarake, por

që NATO kishte refuzuar të ndërhynte pas kërkesës së Berishës, i cili kishte argumentuar se po përballej me një rebelim komunist. Ky refuzim, sipas studiueses Vicker, erdhi si pasojë e zhgënjimit për qeverisjen e Berishës, Ministrat europianë të NATO-s e cilësuan situatën si problem të brendshëm të Shqipërisë, dhe se dërgimi i forcave nga jashtë nuk do ta zgjidhte problemin. Por kjo nuk do të thoshte se, për Perëndimin, stabilizimi i situatës së brendshme nuk ishte problem, ndaj më 15 prill 1997, në Durrës zbarkoi një task-forcë ndërkombëtare me mision të kufizuar.

Në këtë situatë klasa politike në vend ishte e paralizuar, pasi nuk kishte asnjë lloj pushteti, pasi ligjin e bënë bandat, ndërsa task-forca ndërkombëtare nuk gjendej aty ku duhej. Qeveria e Pajtimit Kombëtar nuk kishte mundësi të përmbushte detyrat në kushtet e anarkisë dhe paralizës së klasës politike, ndërsa në radhët e opozitës ekzistonte bindja se Berisha ishte i orientuar nga terrori me qëllim mbajtjen e pushtetit. Po sipas studiueses, pavarësisht faktit se gjysma e popullsisë ishte e gatshme të pranonte këdo, vetëm që Berisha të largohej nga pushteti, Berisha u detyrua të pranonte kërkesat e opozitës dhe të ndërkombëtarëve për një qeveri shumëpartiake dhe për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare. Presidenca ishte institucioni ligjor i pushtetit qendror në Shqipëri dhe, nëse Presidenti do të largohej me mënyra të tjera përpos atyre të procesit zgjedhor, kaosi politik do të ishte shtuar.

Zgjedhjet e vitit 1997 ishin pika e kthesës së qorrsokakut politik ku ishte futur politika shqiptare, ndaj dhe ishin shansi për të kthyer opozitën në qeverisje, dhe për të filluar dialogun me komitetet rebele të jugut të vendit.

Ekzistonin mosmarrëveshje për ligjin zgjedhor, i cili duhej të ishte i pranueshëm, gjë që PD e kundërshtoi, pasi ky ligj bazohej kryesisht mbi përfaqësimin proporcional sesa atë mazhoritar-zonal, që ishte zbatuar deri atëherë. Kjo situatë e trembi PD-në, pasi në bazë

100

të marrëveshjes së arritur partitë politike u dakordësuan që 115 deputetë të zgjidheshin me sistemin mazhoritar, ndërsa 40 me përfaqësim proporcional. Por mbështetësit e PD-së ishin të kufizuar në zona relativisht të vogla dhe PD i trembej zbehjes së saj elektorale, sipas sistemit proporcional. Mbajtja e këtyre zgjedhjeve, pavarësisht ecurisë së tyre, ishin një hap shumë i rëndësishëm, pasi rivendosja e rendit ishte esenciale për demokracinë. Pavarësisht faktit se demokratët dëshironin të mbanin vendet e fituara në parlament me zgjedhjet e 1996-s, Berisha pohoi se do të njihte rezultatin e zgjedhjeve.

Zhvillimi i zgjedhjeve të qershorit 1997, me gjithë kushtet dhe incidentet që i shoqëruan, u përshëndetën nga faktori ndërkombëtar. Pjesëmarrja masive e popullatës në to, tregoi se shoqëria shqiptare dëshironte të qartësonte të shkuarën dhe të kontribuonte për të ardhmen dhe zgjidhjen e problemeve. Në këto kushte, pavarësisht kontestimeve, PD e pranoi humbjen, edhe pse u ankua për pamundësinë e zhvillimit të fushatës në jug të vendit. Humbja e këtyre zgjedhjeve në Tiranë nga PD, sipas studiueses, rrëzonte ndonjë pretendim serioz për manipulimin e tyre.

Votimi për republikën apo për rikthimin e kushtetutës mbretërore, ishte një tjetër ngjarje që shënjoi këtë vit të mbushur plot me ngjarje dramatike për Shqipërinë, dhe që nxori në pah përpjekjet e pasardhësit të Mbretit Zog, Leka. Por kjo fushatë nga ana e tij, shumë shpejt, do të rezultonte e dështuar. Kjo për shkak të situatës tepër të rënduar që mbizotëronte në vend, por dhe për shkak se politika shqiptare ishte ende e përcaktuar gjerësisht nga cikli i hakmarrjes. Shumë nga mbështetësit e inkriminuar të Berishës iu ngjitën Lekës për të shpëtuar veten e tyre, nga frika e ndonjë ndëshkimi nga ana e qeverisë socialiste. Në këto kushte, i ndier i frikësuar, Leka tërhiqet në Johannesburg për të udhëhequr oborrin e tij në mërgim, ashtu si i ati. Pas kësaj situate PD pëson një hemorragji në nivelet më të larta të saj dhe administratë, pasi njerëzit e saj ishin të

implikuar në punë të pista. Përmendim arratisjen e Agim Shehut, zëvendësministër i Brendshëm, pasi ishte personi që akuzohej më shumë nga politikanët për dhunën e përdorur në protestat e opozitës, në fushatën elektorale për zgjedhjet parlamentare të 1996-s, si dhe të protestave për shembjen e firmave piramidale. Një ditë më pas, ish-ministri i Brendshëm Behlul Çelo ikën në Greqi. Po kështu, edhe një numër i madh zyrtarësh të tjerë.

Kjo situatë erdhi si pasojë e një sërë faktorësh të ndërthurur së bashku. Sipas Vickers 2008, *“mungesa e një ekonomie tradicionale në Shqipëri për disa vjet, shteti de facto një partiak dhe aparati shtetëror tejet i korruptuar, kishin krijuar kushtet ideale për veprimtari kriminale. Për disa vjet Partia Demokratike ishte zhytur në tregti të paligjshme të armëve, karburantit, drogës, me anë të një kompanie që quhej Shqiponja e cila shkeli dhe sanksionet e Kombeve të Bashkuara ndaj ish- Jugosllavisë në fund të vitit 1995, kur pjesë të biznesit të saj iu transferuan biznesit të kompanisë private Vefa Holding, e cila gjithashtu ishte kompania më e madhe e investimeve piramidale”* (në M. Vicker, 2008, fq 398).

Në këto kushte kur situata politike ishte tepër e tensionuar, me një rend në kaos, me zhvillim ekonomik po ashtu në kaos dhe ku ligjin e bënin bandat e armatosura, shteti nuk ishte në gjendje të garantonte dhe kontrollonte sigurinë e lëvizjes në vend. Tabloja e përgjithshme e situatës ishte ajo e një shkatërrimi tërësor.

Por procesi i mundimshëm për të qytetëruar politikën shqiptare dhe konsoliduar demokracinë, pësoi një kthim të fortë mbrapa. Pas vitit dramatik 1997, vrasja e Azem Hajdarit dhe arrestimi i deputetëve të opozitës në fund gusht 1998, e tensionoi edhe më tepër gjendjen, por edhe mbështetësit e PD-së. Në këto kushte, edhe pse PD-ja që kur ishte formuar qeveria socialiste kishte luajtur rol shkatërrimtar me qëllim përmbysjen e

102

saj, organizoi protesta në rrugë, bojkotoi institucionet parlamentare, me pretendimin se qeveria ishte jo e ligjshme, pasi kishte dalë nga zgjedhje jolegjitime, dhe se kishte ardhur në pushtet me ndihmën e bandave të armatosura dhe bandave mafioze të udhëhequra nga komunistët. Për pasojë, ajo nuk ishte një opozitë reale parlamentare funksionuese, çka i sillte një dëm të madh demokracisë duke e rrezikuar funksionimin e saj. Rritja e tensioneve politike mes dy kampeve, tregonte se mundësia për të dialoguar mes palëve kundërshtare ishte e pamundur, kështu që vendi kërcënohej sërish nga mundësia e kaosit politik, institucional dhe civil. Kjo u bë e dukshme kur mbështetësit e Berishës organizuan një grusht shteti në shtator të 1998, por që dështoi për shkak të mungesës së dëshirës së popullit shqiptar për t'i përjetuar sërish ato ngjarje dhe dhunën e tmerrshme që kishin kaluar gjatë 1997-s.

E gjithë kjo situatë, megjithëse edhe qeveria socialiste nuk ishte shumë efiçente, erdhi si pasojë e një apatie që populli shqiptar kishte krijuar ndaj një klase politike jotolerante, ndaj ishte vetë populli shqiptar që duhej të gjente mënyrat për t'i shpëtuar këtij shkatërrimi ekonomik dhe politik të vendit. Kjo bëri që popullata të krijonte një apati ose indiferentizëm ndaj klasës politike dhe debatit politik, pasi askush nuk e dëshironte më një situatë tragjike si ajo e 1997-s.

Parë nga këndvështrimi se zgjedhjet e vitit 1997 ishin të një rëndësie të veçantë për disa arsye, le të bëjmë një analizë të këtyre zgjedhjeve si një pikë kthese për demokracinë shqiptare në disa pika.

Së pari, zgjedhjet e vitit 1997 ishin zgjedhje që nuk kishin si qëllim ndryshimin e sistemit politik, por rotacionin e pushtetit politik. Kishin si qëllim dhënien fund të krizës së rëndë politike dhe sociale, si dhe të sillnin stabilitet politik dhe ekonomik.

Vlen të theksohet se në këto zgjedhje klasa politike duhej të plotësonte disa detyra. Njëra prej tyre ishte përgatitja dhe mbajtja e zgjedhjeve, pavarësisht situatës dhe kushteve në të cilat ndodhej vendi. Nisur nga fakti se Shqipëria ndodhej në një situatë kaosi, e përçarë, me ekonomi me humbje të mëdha dhe me struktura e institucione shtetërore që nuk funksiononin, mbajtja e zgjedhjeve të lira e të ndershme do të ishte një luks i madh, ndaj dhe zgjedhjet e vitit 1997 ishin më shumë zgjidhje e situatës së kaosit politik, ekonomik dhe shoqëror, në të cilën ndodhej vendi si pasojë e keqpërdorimit të pushtetit nga ana e klasës politike.

Klima e thellë mosbesuese, debati i ashpër dhe konfliktet që shoqëruan këtë situatë zgjedhore, i çoi të dyja partitë kryesore të ndërmernin veprime ekstreme, ku Partia Socialiste u mbështetet në komitetet e shpëtimit publik (në A. Krasniqi, 2009, fq 144) dhe nuk lejoi kandidimin real të demokratëve në shumë rrethe të jugut të Shqipërisë, ndërsa demokratët mbajtën nën kontroll Tiranën dhe disa qytete kryesore të veriut të vendit, duke sjellë kështu një pasojë politike të dëmshme për shoqërinë shqiptare: ndarjen e vendit në bastione politike, socialistët në jug dhe demokratët në veri.

Një tjetër element që duhet theksuar për zgjedhjet, është fakti se të gjitha partitë politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje, sipas studiuesit (në A.Krasniqi,) në krahasim me zgjedhjet e një viti më parë, pra të 1996-s, pësuan rënie drastike të votës në rang kombëtar dhe të kredos politike, si kundërpërgjigje ndaj klasës politike, por që nëpërmjet taktikave dhe manovrave elektorale, me anë të marrëveshjeve e koalicioneve elektorale kemi një rinovim të parlamentit. Nga këto zgjedhje në grupin e ri parlamentar të PD-së, po sipas(Krasniqit 2009, fq 118), krahas emrave dhe figurave të njohura të larguara prej saj, të cilët në vitet 1990-1995 kishin qenë kryetarë apo ministra, ish-të përndjekurve politikë, në vend të tyre u futën për herë të parë në

parlament edhe emra të rinj, si Topalli, Bode, Minarolli, Xhaferri, Demi, të cilët pas 1997-s do të luajnë një rol të rëndësishëm në PD duke mbajtur poste të rëndësishme drejtuese. Gjithashtu, bien në sy dhe emra nga bota e kulturës dhe e artit, si dhe të fushave të tjera, të arsimit, bankave apo dhe të naftës.

Në krahun socialist, nga këto zgjedhje, nga dhjetë deputetët që morën mandatet tre ishin nënkryetarët e PS-së, katër të tjerë ishin politikanë të karrierës, ndërsa tre zgjidheshin për herë të parë. Nga partitë e tjera politike bie në sy fitimi i mandatit vetëm nga kryetarët e partive, siç është rasti i S. Godos, i cili pavarësisht se ishte themeluesi i PR ishte hera e parë që fitonte mandatin e deputetit.

Analizë. Kriza e vitit 1997 dhe reagimet e klasës politike (paftësi e klasës politike)

Analiza biografike duke qënë se është një metodë që konsiston në studimin e kontekstit të tij në ngjarjet politike dhe shoqërore, studimi i krizës së vitit 1997 dhe ndikimi i saj në ngjarjet politike dhe shoqërore është fokus i kësaj analize.

Në kontekstin politik rezulton se ngjarjet e vitit 1997, janë cilësuar shansi i humbur i politikës shqiptare , por dhe që patën pasoja të rënda shoqërore. Është periudha kur Shqipëria iu largua proceseve demokratike dhe rrugës së integritit të saj.

Në analizë të situatës politike e shoqërore të Shqipërisë së kësaj periudhe kritika i adresohet klasës politike si aktori kryesor në këto ngjarje. Në analizë të ngjarjeve që iu paraprinë kësaj situate, merren disa kushte apo premisa që i paraprinë siç ishte, dështimi i qeverisjes demokratike për të miratuar kushtetutën në 1994. Ky dështim krijoj mundësinë drejtuesve të rinj politikë që të qeverisnin në vakum institucional në drejtimin e shtetit, duke krijuar modelin e drejtimit partiak, element që deformoi

funksionimin e partive politike, institucioneve, të cilat ishin të garantuara nga kushtetuta, duke dëmtuar në këtë mënyrë themelin e shtetit demokratik.

Mosmiratimi i kushtetutës nga analiza e sudimeve rezulton se klasa politike ishte përgjithësisht pasive, në kushtet kur vendi pas rënies së regjimit komunist ishte i domosdoshëm në mënyrë që të ndërtohej shteti demokratik mbi baza të shëndosha kushtetuese dhe institucionale.

Shmangia e Parlamentit nga procedura e miratimit, dhe kalimi në referendum popullor pa miratimin e parlamentit, ishin procese që e deformuan miratimin e kushtetutës, gjithashtu burgosja e liderit të opozitës që konsiderohej i pa drejtë nga pozita, iu dha mundësinë që të ndërtonin një politikë diskerdituese për projekt kushtetutën.

Si përfundim mos miratimi i kushtetutës pati impakt negativ jo vetëm në elektorat por dhe për klasën politike. Kjo çoi në prodhimin e një fenomeni tepër negativ për klasën politike dhe qytetarët, prodhimin e mungesës së dhënies së drejtësisë, element që është i pranishm dhe sot aktualisht në shoqërinë shqiptare. Pasojë e kësaj është dhe ndërtimi i një shteti të dobët dhe të nënshtruar nga politika, duke përdorur aparatin shtetëror të komandimit, dhe për pasojë ushtrim intensiv të pushtetit, gjë që u pasqyrua me prishjen e ekuilibrit shtetëror dhe shoqëror në vend.

Një tjetër arsye që i përshpejtoi ngjarjet e 1997 ishte dhe zhvillimi i zgjedhjeve në maj 1996, duke iu dhënë mundësinë klasës politike që ti shfrytëzonte për qëllimet e saj politike. Konteksti i zhvillimit të tyre dhe i ndikimit që patën në jetën politike dhe shoqërore analizohet në dy aspekte themelore. Së pari ishin testi i parë ku testohej klasa politike pas rënies së komunizmit në angazhimin e saj në proceset demokratike dhe integruese të vendit, dhe së dyti prekja e votës së lirë, si fenomeni që prodhoi pasoja

tepër të rënda për zhvillimin e demokracisë jonetëm për periudhën por kur u zhvilluan këto zgjedhje, por edhe për të gjithë zgjedhjet e mëvonëshme.

Klasa politike dështoi që në testin e parë për funksionimin e institucioneve demokratike ku janë zgjedhjet e lira si garancia themelore e sistemit të ri politik që ishte vendosur, kjo për pasojë prodhoj një klasë politike të përçarë, dhe mosbesim në partitë politike.

Në analizë të zhvillimeve politike të 1997 dhe të ndikimit të tyre në mjedisin politik dhe shoqëror, rezulton se paaftësia e klasës politike për të zhvilluar zgjedhje të lira dhe të ndershme është dëmi më i madh që i është shkaktuar shtetit dhe shoqërisë shqiptare pas rënies së komunizmit. Ky dështim në zhvillimin e zgjedhjeve të lira është cilësuar si burimi i problemit të mos qarkullimit të elitës politike.

Keq funksionimi shtetit demokratik bëri që ngjarjet e 1997 të rrëzonin shtetin dhe demokracia të ishte e rrezikuar. Me gjithë përpjekjet e presidentit Berisha për të zgjidhur situatën e krijuar, si dhe garancitë që dha ai për moskandidimin e tij, rezulton se janë një sërë faktorësh të tjerë që ndikuan në këtë moment si, mos dakordësimi i opozitës për kërkesat e shtruar për kthimin e parave të humbura në firmat piramidale, dhe distancimi nga dhuna të PS dhe i militantëve të saj, pasi PS ishte e vetjma parti pretenduese e pushtetit që nuk u distanca nga dhuna. Ky qëndrim i kushtoi shtetit shqiptar dhe shoqërisë shqiptare bilance dhe pasoja katastrofike. Në analiza e të kushteve dhe të ndikimit të që kishin këto ngjarje në jetën politike e shoqërore, mungesa e kompormisit politik mes klasës politike që ishte aq i nevojshëm për situatën, ishte tipari thelbësor i saj. Përpjekjet nga ana e klasës politike si asaj në pushtet dhe asaj opozitare për të mbajtur dhe për të marra pushtetin me cdo kusht, prodhuan fenomenin e përdorimit të fortë të komandimit dhe të ushtrimit me forcë të pushtetit.

Ngjarjet e 1997 në analizë të tyre rezultojnë se, dhe ndikimi i kastës së vjetër komuniste ishte akoma i fuqishëm, pasi kishin influencë nëpërmjet mbështetësve të ish regjimit komunist por që votonin për PS si përfaqësuese e së majtës, dhe lidhjeve me individë që ishin përfshirë në jetën politike të vendit, për të destabilizuar vendin dhe dobësuar demokracinë.

Pikërisht ndikimi i individëve që kanë qënë të lidhur me ish regjimin dhe partinë komuniste, ata përfituan nga rënia e shtetit si pajojë e krizës financiare dhe kanalizimit të konfliktit ekonomik, në një konflikt politik, me pasoja të rënda për të ardhmen e demokracisë dhe të shoqërisë, duke vënë në pikëpyetje jonetëm të ardhmen e demokracisë, pro dhe rrezikun e inkriminimit të klasës politike.

Analiza biografike e zgjedhjeve të vitit 1997, tregon se pavarësisht ngjarjeve që do të shoqëronin më pas, do të ishin një pikë kthese nga kaosi ku ishte futur politika e shoqëria shqiptare, si dhe iu dha shansi opozitës për tu kthyer në qeveri.

Ndikimi që patën këto zgjedhje në mjedisin politiko-shoqëror është tepër i madh, pasi u shoqëruan me fenomene negative politiko shoqërore. Nga analiza e tyre, zgjedhjet pavarësisht incidentetve dhe problemeve që i shoqëruan, u përkrahën nga faktori ndërkombëtar. Në aspektin shoqëror, pjesëmarrja masive e qytetarëve në votime rezultojnë se është shenjë e mobilitetit social për të dalë nga kriza dhe për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve.

Parë në këndvështrimin e analizës biografike të kontekstit dhe të zhvillimit të këtyre zgjedhjeve si dhe të ndikimit të tyre në mjedisin politiko shoqëror rezultojnë se, zgjedhjet e 1997 ishin të një rëndësie të veçantë për demokracinë shqiptare në disa këndvështrime. Së pari ato nuk ishin zgjedhje që kishin për qëllim ndryshimin e

sistemit politik por rotacionin politik të pushtetit, dhe dhënies fund të krizës politike dhe sociale që kishte mbërthyer vendin . Së dyti nisur nga pikëpamja e ndikimit të tyre në mjedisin politik e social rezulton se, klima në të cilën u zhvilluan këto zgjedhje ishte mosbesuese, me konfliktualitet politik, që çoi në veprime ekstreme nga ana e partive politike. Këto zgjedhje nxorën në dukje një pasojë mjaft të rëndë dhe të dëmshme për politikën e shoqërinë shqiptare, ndarjen e vendit në bastione politike PSnë jug të vendit, ndërsa PD në veri të Shqipërisë. Këto zgjedhje u shoqëruan dhe me ulje drastike të votës për partitë kryesore politike PD-PS, në krahasim me zgjedhjet e 1996, por që përfundim të tyre rezultuan me përfshirje në politikë të emrave të rinj, si përpjekje e partive politike për të rinovuar vetveten e parlamentin me emrat të rinj, të cilët vazhdojnë dhe sot të jenë pjesë aktive e politikës.

KAPITULLI IV

Formësimi i klasës politike shqiptare, karakteristikat e saj

4.1 Reformimi i komunistëve me Nanon, ardhja në krye të PS e Edi Ramës

Në Kongresin X të PPSH-së, më 12 qershor 1991, u ndryshua emri, në PPSH dhe kjo e fundit u riemërua Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ndryshimet në PPSH vinin në një situatë kur kishte pak muaj që ishte rrëzuar sistemi komunist dhe drejtuesit e saj menduan për mundësitë e përshtatjes së kësaj partie në kushtet e reja. Shpërbërja e partisë, siç ndodhi në vende të tjera të Lindjes, nuk ishte një opsion për komunistët shqiptarë. Ata po mendonin vetëm se si kjo parti të vazhdonte të kishte peshën e saj kryesore në zhvillimet që do të pasonin në Shqipëri, pas shpalljes së pluralizmit politik.

Lideri komunist Ramiz Alia detajoi me kujdes ndryshimet që i duheshin partisë, qoftë në emrin e ri të saj, qoftë në lidhshmëri. Përfundimi i një pjese të madhe të anëtarëve të Byrosë Politike ishte hapi i parë para këtij kongresi dhe situata ishte më e favorshme. Në Kongresin X të PPSH-së u përjashtua nga partia edhe pjesa e mbetur e Byrosë Politike. Sigurisht që për Ramiz Alinë nuk ishte e lehtë, por ai po vepronte në një terren kur Byroja Politike ende nuk ishte e sigurt nga tmerrin e skenarit të Rumanisë, ku u vra diktatori i këtij vendi, Nikola Çausheku. Ishte ende një opsion ose të paktën, kështu po mendohej ta paraqiste Ramiz Alia. Anëtarët e Byrosë Politike iu bindën me pak rezistencë vendimit për përjashtim dhe një elitë e re komunistësh të reformuar erdhi në krye të partisë me zëvendësime të bëra nga propozimet e vetë Alisë, për hapjen e PK referuar situatës dhe në Bllokun Lindor.

Debatet në kongres edhe për emrin e ri të partisë

Kishte disa versione për emrin, pasi ishte përjashtuar versioni i vazhdimësisë me të

njëtin emër. Ishte opion edhe Partia e Progresit të Shqipërisë, propozim që garantonte vazhdimësinë për militantët, pasi inicialet nuk ndryshonin. Në fund të debatit, emri i ri u vendos dhe u pranua nga të gjithë delegatët e kongresit.

Askush nuk pati mundësinë, ndoshta as dëshirën, të ndryshojë rrjedhën. Fatos Nano u zgjodh kryetar i partisë së riemëruar, si propozim i R.Alisë. U zgjodh edhe një grup drejtuesish të tjerë të rinj, që u përkisnin niveleve të dyta e të treta të qeverisjes komuniste, për ti dhënë asaj një imazh të ri, megjithë kundërshtimet që u bënë (në Progni.Luljeta, 2009 fq 93).

Një tjetër hap ishte ai i riemërimit të strukturave të PPSH-së

Në atë kongres u vendos ndryshimi i emërimit të strukturave drejtuese dhe të posteve të ndryshme, por të gjitha ndryshimet po kryheshin në funksion të kohezionit brenda partisë, ruajtjes së elektoratit të PPSH-së. Kjo ishte porosia kryesore e Ramiz Alisë. Posti i Sekretarit të parë të Komitetit Qendror të PPSH-së, zëvendësohej me emërtimin Kryetar i Partisë. Komiteti Qendror i Partisë, zëvendësohej me emërtimin Komiteti i Përgjithshëm Drejtues i Partisë. Byroja Politike e Partisë u zëvendësua me Kryesinë e Partisë, dhe të tjera forume ndryshuan emërtimet e tyre.

Në këto forume u zgjodhën edhe një grup intelektualësh, të cilët u vendosën në postet e rëndësishme të partisë, si fasadë për përmirësimin e imazhit. PS dhe drejtuesit e saj trashëguan nga PPSH-ja elektoratin dhe nisën punën për ndryshimin e imazhit të partisë. Më 22 mars të vitit 1992, Partia Socialiste humbi zgjedhjet parlamentare të parakohshme, përballë Partisë Demokratike, që fitoi në këto zgjedhje me një mbështetje të madhe në të gjithë vendin. PS ishte në procesin e reformimit dhe ky proces do të duhej të përfshinte, medoemos, ndarjen me të shkuarën komuniste.

Në raportin e mbajtur në Kongresin e Parë të PS-së, kryetari Fatos Nano tha “PS nuk duhet të lejojë që të aderojë në të askush që ka përlyer figurën e saj, megjithëse mund të

jetë dakord me programin dhe statutin e partisë. Distancimi i plotë do të thotë distancim teorik dhe praktik, që do të jetë proces në vazhdim. Të denoncohet çdo tentativë për mbyajtjen e demokracisë si brenda radhëve të partisë edhe në shoqëri, çdo tentativë për vendosjen e një diktature të re, mbi gërmadhat e së vjetrës.” Sërish nuk pati një ndarje të qartë.

Kongresi zgjodhi forumet e reja, drejtuese të partisë. Në krye të PS-së u rizgjodh Fatos Nano. U larguan nga drejtimi disa prej figurave të PPSH-së, që ishin zgjedhur në krye të PS-së në krah të Fatos Nanos, si Spiro Dede. Njëri prej nënkryetarëve, Servet Pëllumbi, u zgjodh sërish nënkryetar i PS-së. Namik Dokle, ish-anëtar i Komitetit Qendror, kryeredaktor i gazetës së PS-së, “Zëri i Popullit”, u zgjodh gjithashtu nënkryetar i partisë dhe kryetar i grupit parlamentar të PSSH-së.

PS-ja nisi kështu rrugën e gjatë të reformimit. Fatos Nano e drejtoi këtë parti për 14 vjet, katër prej të cilëve ishte në burg. Gjatë këtyre viteve, PS qëndroi pesë vjet në opozitë dhe nëntë të tjerë në pushtet (një vit para zgjedhjeve të 22 marsit 1992 dhe tetë të tjerë pas zgjedhjeve të vitit 1997.) Përgjatë këtyre viteve nuk u ndal asnjëherë lufta për pushtet brenda kësaj partie, e përqendruar mes grupit të Fatos Nanos dhe Ilir Metës. Kjo betejë përfundoi në janar të vitit 2004, kur Ilir Meta u largua nga kjo parti bashkë me një grup deputetësh dhe themeloi Lëvizjen Socialiste për Integritet. Kjo ndarje ishte edhe një ndër arsyt e humbjes së PS-së në zgjedhjet parlamentare të korrikut të vitit 2005. Pas humbjes, Fatos Nano dha dorëheqjen nga post i kryetarit të PS-së dhe, në vend të tij, u zgjodh Edi Rama. Periudha kur mund të vihen re disa ndryshime pozitive në përpjekjet për të afruar në politike intelektualë, është ajo gjatë qeverisjes së vendit nga Partia Socialiste, pasi ish-kryetari i kësaj partie Fatos Nano, herë pas here ofroi në qeveri dhe parti, intelektualë në zë të fushave të ndryshme. Një ndër ta është edhe kryetari aktual i PS-së, Edi Rama. Edi Rama në krye të PS-së.

Pas dy vitesh në krye të PS-së, Edi Rama kishte një plan të qartë për reformimin e partisë sipas koncepteve të tij. Në fillim u duk pak e vështirë që Edi Rama ta fitonte mbështetjen e elektoratit të kësaj partie. Megjithatë, ai nisi shpejt të zbatojë strategjinë e tij për të ndryshuar partinë. Në tetë vjetët e PS-së në opozitë, Rama u përball shpesh me situata të vështira, për shkak të lëvizjeve të kundërshtarëve të tij brenda PS-së. Megjithatë, ai shprehu vendosmërinë e tij për të çuar deri në fund projektin për partinë e tij socialiste. Edi Rama ia doli të nxjerrë jashtë loje shumë prej ish-drejtuesve të rëndësishëm të kësaj partie, duke nisur nga mandati i parë në opozitë për të përfunduar me këtë të fundit, pranverën e vitit 2013, kur Rama la jashtë listës së kandidatëve për deputetë një prej modeleve të rëndësishme drejtuese të kësaj partie, Arben Malajn. Këtu mori fund çdo përpjekje brenda PS-së për të bërë rezistencë ndaj liderit.

Ndryshimet thelbësore të Ramës në krye të PS-së, nisin me vitin 2007. Një mbledhje e KPD-së së 13 marsit të po këtij viti vendosi ndryshimin e emrit të këtij forumi dhe riemërimin e tij në Asamble Kombëtare e PS-së. Në kongres do të ndryshohej edhe përbërja e këtij forumi. Asambleja u mbush me drejtuesit e lëvizjes “Mjaft”, kryesuar nga Erjon Veliaj. Të tjera ndryshime thelbësore në mënyrën e funksionimit të partisë, i dhanë formën përfundimtare PS-së. PS e humbi edhe atë element që për shumë njerëz cilësohej si demokraci e brendshme e partisë, debatet brenda grupeve kundërshtarë të saj.

Më 9 prill 2007 u mbledh kongresi i PS-së mbi bazën e mbledhjes së Asamblesë Kombëtare të PS-së, dalë nga mbledhja e KPD-së së 13 marsit. Në kongres u paraqit nga kundërshtarët e Ramës “Rezoluta për mirëkuptim”. Rezoluta u rrëzua në kongres - një kongres ky që zhvillohej, për herë të parë, me dyer të mbyllura.

Një grup zyrtarësh të kësaj partie kontestuan procesin, duke e cilësuar të parregullt. Ata pretendonin se në votime morën pjesë një numër më i vogël i anëtarësisë, i

pamjaftueshëm për të legjitimuar Ramën si kryetar të PS-së. Dy orë para përfundimit të procesit kishte dhënë dorëheqjen kryetarja e Komisionit të Zgjedhjeve të Partisë, Zamira Caka. Ajo tha pas dorëheqjes se e kishte marrë këtë vendim, pasi ishte kundër disa procedurave që cenonin legjitimitetin e procesit zgjedhor në PS. Megjithatë, Edi Rama u zgjodh kryetar i PS-së me 97% të votave.

Në kongresin e 2 qershorit 2007 u miratuan edhe ndryshimet në statutin e partisë. Sipas këtyre ndryshimeve, Sekretari i Përgjithshëm pushon se ekzistuari si funksion dhe kompetencat e tij i merr kryetari i Asamblesë Kombëtare.

Sipas statutit të ri, kongresi rritej në numër, nga 650 delegatë në 1500 delegatë, bëheshin 150 anëtarë asambleje dhe në çdo forum 50% duhet të ishin gra. Në nivel lokal, PS-së iu shtuan zyrtarë të rinj. Në çdo qark u zgjodh një sekretar qarku dhe një nënsekretar.

Me sloganin “Ndarje me politikën e vjetër”, kongresi i 2 qershorit bëri “pastrimin” e partisë nga ata që për momentin ishin kundërshtarë të Ramës në PS. U zgjodh Asambleja e re Kombëtare dhe sekretarët e rinj. Në Asamble dhe në Kryesi u zgjodhën shumë të rinj, që vinin edhe nga OJF dhe Bashkia e Tiranës.

Figurat e rëndësishme të PS-së filluan të ndjenin humbjen e influencës, por një nga më të njohurit dhe më të hershmit e radhëve të PS-së, Gramoz Ruçi, u rikuperua. Ai u zgjodh kryetar i Asamblesë Kombëtare të PS-së. Mbetën brenda forumeve edhe të tjerë, si Majko, Xhafa, Fino, Klosi etj., por me një peshë shumë të vogël në vendimmarrjen e partisë. Dalëngadalë, në tetë vjet ata u zëvendësuan me Erjon Veliajn etj, si proces i hapjes së partisë ndaj shoqërisë civile.

Kur u zgjodh në krye të PS-së, Edi Rama pati premtuar se do të bashkonte të majtën. Pak ditë pas zgjedhjes ai organizoi tryezën e opozitës, me pjesëmarrjen e Ilir Metës së LSI-së, Skënder Gjinushit të PSD-së dhe Paskal Milos së PDS-së. Bashkimi i së majtës

ishte një ndër premtimet solemne të Edi Ramës, sapo mori postin e kryetarit të partisë. Por tryeza me Metën dhe aleatët e tjerë të opozitës funksionoi vetëm deri pas zgjedhjeve të shkurtit të vitit 2007, kur Rama u rikonfirmua në postin e kryetarit të bashkisë së Tiranës edhe me votat e LSI-së. Nisi një betejë e fortë politike midis Ramës dhe Metës, kryesisht në momentin e ndryshimeve në Kushtetutë, ndryshime që penalizuan LSI-në. Ishte fjala për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, pikërisht ndryshimi i sistemit zgjedhor.

Pas zgjedhjeve të vitit 2009, Meta hyri në koalicion me Berishën dhe këtu nis e intensifikohet beteja e Edi Ramës dhe Erjon Veliajt kundër Ilir Metës. Kjo betejë akuzash kulmoi me protestën e 21 janarit 2011, ku si pasojë e përplasjes së dhunshme mes protestuesve të Ramës dhe policisë së qeverisë Meta-Berisha, mbetën të vrarë katër persona.

Më 1 prill të vitit 2013, rreth tre muaj para zgjedhjeve parlamentare, ndodhi ajo që dukej se kurrë nuk do të kishte gjasa të ndodhte. Edi Rama dhe Ilir Meta shpallën koalicionin e tyre nën sloganin “Rilindje”. Ata lanë pas akuzat ekstreme mes tyre dhe u bashkuan për të fituar zgjedhjet e 23 qershorit me një mazhorancë prej 83 deputetësh, brenda së cilës kishte gjithfarë lloj. Rilindja nisi të qeverisë me imazhin e Ilir Metës të Edi Ramës e Erjon Veliajt. Rilindja po vazhdon. Në grupin e saj të deputetëve ka të ndryshëm. Aty është modeli Gramoz Ruçi, i trashëguar nga koha e Ramiz Alisë; Fatmir Xhafa, i formuar politikisht në kohën e Fatos Nanos; Pandeli Majko, kryeministri i krizave socialiste, tani deputet i thjeshtë i saj; Taulant Balla, shefi i protokollit të Nanos ish-kryeministër.

Edi Rama ka mbledhur rreth vetes njerëz që nuk kanë as dy vite histori të përbashkët politike me PS-në. Vetë Rama erdhi në krye të PS-së më ndihmën vendimtare të pjesës më radikale të PS-së, të cilët i përkasin më së shumti elitave të paraviteve '90 dhe që

vazhdojnë të militojnë në PS. Në prag të zgjedhjeve të vitit 2005, Partia Socialiste, ai gjithashtu iu drejtua biznesit dhe shoqërisë civile për krijimin e një imazhi të ri.

Pas humbjes në këto zgjedhje, PS e prisnin një sërë zhvillimesh brenda saj, pasi kryetari Nano dha dorëheqje dhe partia mbeti në dorën e kryetarit aktual, Edi Rama. Pas ardhjes në krye të PS-së, ky i fundit nisi të spositoje ngadalë nga vendimarrja në PS pjesën kryesore të lidërshiptit. Në krah të Edi Ramës, u pozicionuan elementë me potenciale të papërfillshme intelektuale. Emra që smund t'i lidhesh shumë me historinë e Partisë Socialiste duke mbetur jashtë lidërshiptit socialist, ata që e transformuan PS-në nga Partia e Punës në partinë me demokracinë e brendshme më të zhvilluar në Shqipëri. Gjatë qeverisjes së PS-së dhe të vendit në tetë vite, megjithëse kishte shumë anë negative, ish-kryetari socialist Fatos Nano, u shqua për përfshirje të potencialeve intelektuale në qeverisje dhe në parti. Gjatë kësaj kohe u evidentua njëkohësisht edhe një tolerancë më e madhe edhe me kundërshtarët brenda PS-së, duke i shërbyer në këtë mënyrë rritjes së nivelit politik brenda vetë partisë që udhëhiqte mazhorancën. Si rezultatit të kërkimit, në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se procesi i hapjes së dy partive të mëdha, të cilat e cilësuan procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë në pranverën e vitit 2005, si një hapje dhe demokratizim të partive të tyre, ka prurje në nivele të ulëta, gjë që ka shkaktuar një ulje të konsiderueshme të nivelit të elitave politike në Shqipëri.

4.2 Tiparet e klasës politike gjatë tranzicionit, sjellja i elitës dhe i parlamentit

Gjatë këtyre 25 viteve të tranzicionit vihet re një tipar shumë i rëndësishëm i sjelljes së elitës politike shqiptare: ushtrimi i pushtetit në mënyrë vetjake. Kjo vërehet qartë në

mosfunksionimin e institucioneve dhe administratës, të cilat, parimisht, janë të kontrolluara nga organe të pavarura.

Ky ushtrim i pushtetit ka prodhuar gjithmonë përplasje të vazhdueshme mes qeverisë dhe këtyre institucioneve. Mungesa e një opinionit publik të mirëinformuar ka krijuar mundësinë e abuzimit me pushtetin nga ana e klasës politike, thuajse gjatë gjithë periudhës post-komuniste në Shqipëri.

E gjithë politika e kësaj periudhe ka qenë e zhurmshme, agresive dhe e shoqëruar me konflikte të brendshme, pasi ka qenë gjithmonë një klasë politike e drejtuar dhe e udhëhequr nga vullneti i liderit për të dominuar mbi pjesën tjetër të grupit që mendonte ndryshe nga lideri, duke i shndërruar partitë politike në formacione të drejtuara nga një individ, i cili për të marrë pushtetin bën çdo gjë, duke i personalizuar partitë politike. Eksperienca e klasës politike shqiptare e ka treguar këtë në jo pak raste. Kjo ka krijuar një tipar të klasës politike, pra një klasë politike që vazhdon të mbajë ende gjallë “tiraninë” (në S. Ngjela, 2001) në ushtrimin e pushtetit.

Paaftësia e klasës politike për të zhvilluar zgjedhje të lira, institucione që funksionojnë të pavarura nga politika apo një politikë të bazuar mbi një rrafsh ligjor dhe institucional, nuk krijon mundësinë e zhvillimit të një gare konkurruese, por të një “lufte” (në S. Ngjela, 2010, fq 173). Shembull konkret i kësaj është se, gjithmonë, kemi patur një fitues të zhurmshëm apo të ardhur me dhunë në pushtet, që e ka trajtuar kundërshtarin politik si armik dhe jo si një rival i cili ka humbur votat e zgjedhësve.

Për të rezultat i këtij mentaliteti politik të elitës politike shqiptare jo vetëm në dekadën e parë të tranzicionit por për fat të keq, dhe sot vazhdon ky tipar i klasës politike është se pushteti përdoret si revansh kundrejt kundërshtarit politik. Ky mentalitet i klasës

politike ka dëmtuar dhe moralin e politikës, pasi niveli i arsytimit politik është hakmarrje dhe urrejtje për tjetrin që e ka rrëzuar nga pushteti nëpërmjet votës, duke e cilësuar largimin nga pushteti si një padrejtësi që i është bërë, dhe jo si një alternativë tjetër qeverisëse. Kjo situatë e ka shoqëruar klasën politike shqiptare gjatë gjithë kohës, duke ngadalësuar proceset demokratike në vend.

Tranzicioni postkomunist në të gjitha vendet e Lindjes është dashur të kryhet në dy drejtime kryesore, atë politik dhe ekonomik. Kjo është dhe veçoria dalluese e termit “tranzicioni demokratik”. Në kushtet e Shqipërisë ky tranzicion në sferën politike – pra, kalimin nga sistemi njëpartiak në sistemin e demokracisë liberale të konsoliduar – paraqet tipare të një tranzicioni më të vështirë sesa në vendet e tjera postkomuniste të cilat gjatë sistemit komunist kanë patur ose i kanë njohur marrëdhëniet me ekonominë kapitaliste – pra, ishin të mbështetura mbi pronën private dhe parimet e tregut të lirë – gjë e cila në Shqipëri ishte e ndaluar, pra vështirësitë e tranzicionit janë të lidhura dhe me trashëgiminë politike, ekonomike, kulturën politike dhe mentalitetin që ka shoqëria. Transformimet që do të duhej të kryheshin në mjedisin politik, ekonomik dhe shoqëror shqiptar ishin më të vështira sesa në vendet e tjera postkomuniste, pikërisht për arsyet e sipërpërmendura.

Pikëpamja se, tranzicioni i zgjatur në periudhën postkomuniste në Shqipëri më shumë sesa në vendet e tjera postkomuniste, s’ka qenë tjetër gjë veçse një “lojë e elitës politike shqiptare“ (në F. Tarifa, 2009, fq 51) që i ka shërbyer klasës politike për të zgjatur qëndrimin në pushtet të atyre që qeverisin apo për të siguruar ardhjen në pushtet të opozitës, me justifikimin apo dhe objektivin për të nxjerrë vendin nga tranzicioni, kundërshtohet nga studiuesi Tarifa . Sipas tij, Shqipëria i paraqet të gjitha tiparet e një vendi në tranzicion, por që ka bërë shumë hapa përpara në rrugën e transformimit të saj

nga një vend autoritarist dhe me ekonomi të centralizuar, në një shoqëri kapitaliste dhe demokratike, pavarësisht se Shqipëria vazhdon të ketë një sistem politik demokratik të pakonsoliduar, që është larg modelit të demokracisë liberale. Konsolidimi demokratik është edhe objektivi i vërtetë i çdo tranzicioni postkomunist. Nisur nga kjo pikëpamje e shprehur nga disa studiues shqiptarë, Fatos Tarifa argumenton:

Tranzicioni ka një emër që është ai (postkomunist). Kjo, sipas këndvështrimit tij, është evidente, pasi Shqipëria nuk është më një vend komunist. Nuk shpjegohet se cilat janë ngjarjet politike që i dhanë fund këtij tranzicioni. Dhe nëse ky tranzicion ka përfunduar, përse ngurrohet t'i jepet përgjigje pyetjes së shtruar nga studiuesi "Nëse Shqipëria nuk është një vend në tranzicion, çfarë përfaqëson ajo. Një vend të konsoliduar demokratik?" (në F. Tarifa, 2009, Revista Polis nr 9)

Sipas koncepteve të ekonomisë sipas Tarifës, arsyetimi mbështetet në faktin se, 80% e GDP-së prodhohet nga sektori privat. Ky argument, sipas autorit, është i mangët pasi shkalla e privatizimit të një ekonomie kombëtare nuk është, doemos, tregues i shkallës së konsolidimit demokratik. Sipas autorit, duke iu referuar studiuesve Linz & Stepan, një demokraci e konsoliduar presupozon jo vetëm një ekonomi tregu, por dhe ekzistencën e pesë kushteve, që janë në ndërvarësi dhe ndërveprim me njëra-tjetrën. Këto kushte janë: shoqëria civile, shoqëria politike, shteti ligjor, një burokraci shtetërore që mbështet dhe nuk pengon procesin demokratik, shoqëria ekonomike.

Matja e treguesve teknikë të BERZH-it, sipas autorit, nuk mund të merren të shkëputur nga realiteti i atyre që ndodhin në vend. Sikurse nuk mund të gjykojmë për një vend nëse është demokratik apo jo, nisur thjesht nga fakti që zhvillon zgjedhje legislative dhe se ka një parlament. (në F. Tarifa, 2009)

Që niveli i zhvillimit ekonomik nuk është parakusht për të kapërcyer tranzicionin postkomunist , autori argumenton se, nga studimet më të mira krahasuese të kryera deri sot nga autorë të shquar të shkencës politike dhe sociologjisë politike, në mënyrë konsistente është provuar se shkalla e zhvillimit dhe konsolidimit demokratik në çdo shoqëri është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, autori e bazon në argumentin e tij në analizat e studiuesve Juan J. Linz & Alferd Stepan, është bërë tashmë aksiomatike në shkencën politike të krahasuar se shoqëria ekonomike është një parakusht mbështetës për konsolidimin demokratik. Ky arsyetim bëhet bazuar mbi dy teza themelore, ku teza e dytë i kundërqëndron argumentit të mësipërm. Teza e parë thekson se kurrë nuk ka ekzistuar dhe nuk mund të ekzistojë një demokraci e konsoliduar që ka një ekonomi të komanduar (me përjashtim ndoshta, të periudhave të luftës), ndërsa teza e dytë thekson se kurrë nuk ka ekzistuar dhe nuk mund të ekzistojë një demokraci moderne e konsoliduar me një ekonomi të varfër.

Referuar standardeve demokratike duke pohuar se nuk janë aq të rëndësishme sa të përcaktojnë nëse një vend ish-komunist si Shqipëria e ka kaluar (apo jo) fazën e tranzicionit, sipas autorit këtu qëndron gabimi më i përhapur ndër autorët shqiptarë. Një argumentim i bazuar në indeksin e demokracisë është i rëndësishëm, por nuk është parakusht për të përcaktuar nëse një vend është apo jo në tranzicion.

Ky argumentim është përdorur, (Tarifa, 2009) për vende me një sistem politik jodemokratik që nuk kanë qenë sisteme komuniste, për të shpjeguar se “midis demokracisë dhe të kundërtave të saj ekziston një gjendje e ndërmjetme“. Po sipas autorit, ky është një konkluzion i gabuar, pasi çdo tranzicion postkomunist synon të krijojë një sistem demokratik dhe jo ndonjë gjendje të ndërmjetme midis demokracisë dhe sistemit totalitar komunist. Ky argumentim nuk shpjegon se cila është kjo rrugë e

panjohur në postkomunizëm mund të jetë çdo gjendje e ndërmjetme ose kalimtare midis komunizmit dhe demokracisë, por jo domosdo një demokraci e konsoliduar.

Tranzicioni lidhet me shkallën e lirive. Sado që shkalla e këtyre lirive në Shqipëri nuk është “në nivelet më të mira të mundshme, referuar një sistemi demokratik përsëri për” nga treguesit e këtyre lirive, tranzicioni mund të quhet i kapërcyer. Autori (Tarifa, 2009) argumenton se, *“ajo që bie në sy është një kontradiktë logjike, pasi edhe pse shkallët e lirive demokratike nuk janë njëlloj të zhvilluara dhe të mbrojtura si në një sistem të vërtetë demokratik, përsëri shqiptarët e kanë kapërcyer tranzicionin”*.

Nga pikëpamja juridike, Shqipëria e ka kaluar tranzicionin, sepse ka një kushtetutë dhe një legjislacion që në shumë aspekte është i përafërt ose i njëjtë me BE-në. Në këtë aspekt autori argumenton se, pavarësisht se Shqipëria ka një legjislacion të ri dhe një kushtetutë të miratuar disa vite më parë 1998, ende nuk ka një shtrat ligjor në të cilin të gjithë aktorët politikë kryesorë, veçanërisht qeveria demokratike dhe aparati shtetëror, t’i përgjigjen rregullisht shtetit ligjor. Autori Tarita 2009 argumenton se, “tranzicioni postkomunist vazhdon derisa shteti ligjor dhe bashkë me të, funksionimi i shtetit mbi baza demokratike të rutinizohen dhe konsolidohen përtej një stadi, ku një “kthim mbrapa” bëhet praktikisht i pamundur. Mbështetur në këtë pikëpamje mund të thuhet se gjatë kësaj periudhe, shteti shqiptar ka patur disa “kthime mbrapa” me termin “kthim mbrapa” nënkuptojmë ngjarjet dhe situatat e përkohshme që kanë ndikuar apo vonuar tranzicionin postkomunist në vend.

Një vend thuhet se e ka kapërcyer tranzicionin postkomunist kur anëtarësohet në BE. Autori argumenton se, sipas kësaj logjike, të gjitha vendet ish-komuniste që u anëtarësuan në BE e kanë kapërcyer tranzicionin postkomunist kur u anëtarësuan. Ka vende të cilat, dhe pse janë pjesë e BE-së, ende janë në tranzicion. Por autori ngre

pyetjet: Ç'do të ndodhte nëse në BE do të anëtarësohen vende, si Serbia, Mali i Zi apo Ukraina, që janë në hapat e parë të tranzicionit në shumë drejtime? Kjo do të thotë se ato e kanë kapërcyer tranzicionin? Autori thekson se, “mendojmë se procesi i anëtarësimit në BE është, së pari, një vendim politik për vendet e ish-kampit socialist dhe nuk mbështetet vetëm në standarde ekonomike, ashtu sikurse ka qenë dhe mbetet një vendim politik dhe gjeostrategjik edhe anëtarësimi i tyre në NATO” (në Tarifa, 2009).

Anëtarësimi në BE i vendeve ish-socialiste kryesisht i detyrohet progresit të shtetit ligjor më shumë sesa reformave ekonomike, pra i referohet më shumë suksesit të tranzicionit politik. Parë nga ky këndvështrim, ne mendojmë se nëse anëtarësimi i Shqipërisë në BE do kohë, kjo nuk shpjegohet me faktin e pamjaftueshmërisë së reformave ekonomike në vend, por me cilësinë e politikës në vend, pra me cilësinë e shtetit ligjor, të institucioneve të tij, cilësinë e qeverisjes, cilësinë e proceseve politike dhe cilësinë e jetës politike në vend. Është pikërisht faktori politik dhe jo ai ekonomik që ka krijuar në opinionin e BE-së se Shqipëria “nuk është gati” për t'u anëtarësuar. Kjo është arsyeja që vazhdon ta mbajë vendin në procesin e tranzicionit.

Argumenti i fundit është përkrahësit e tranzicionit të përfunduar, sipas të cilit tranzicionet e një shoqërie u ngjajnë tranzicioneve që ndodhin në jetën e një njeriu. Autori argumenton se, “kjo analogji nuk qëndron sepse sistemet shoqërore nuk krijohen, nuk zhvillohen apo vdesin si qeniet e natyrës, por ato u nënshtrohen ligjësave të tjera. Jeta e një sistemi shoqëror mund të zgjatë sa jeta e një individi ose edhe më shumë sesa ai”(Tarifa, 2009). Autori i referohet një studimi të kryer nga Adam Michnik, i cili flet për një fazë të dytë të revolucionit postkomunist, referuar realitetit polak. Ai argumenton se, pavarësisht anëtarësimit të saj në NATO dhe në BE, Polonia

që është dhe vendi i tij, vazhdon të jetë ende në tranzicion, një vend ku edhe sot ndeshen dy Poloni me njëra-tjetrën, një Poloni e dyshimeve, e frikës dhe e hakmarrjes që lufton me një Poloni të shpresës, të kurajës dhe të dialogut. Sipas autorit, ky karakterizim i përshtatet mjaft mirë realitetit të Shqipërisë postkomuniste, ku, në të kundërt siç përmendin disa autorë të tjerë shqiptarë, tranzicioni nuk ka përfunduar.

Tranzicioni natyrisht e ka një fund, por ai ka të bëjë më konsolidimin e shtetit demokratik dhe të mbarë shoqërisë shqiptare. Bazuar në pikë pamjen e përfundimit të tranzicionit (Tarifa, 2009) thekson se, “derisa demokracia në Shqipëri të jetë maturuar dhe konsoliduar në atë pikë sa kthesat mbrapa do të bëhen të pamundura, ne do të kemi dy Shqipëri, të cilat ndeshen me njëra-tjetrën”. Pra, një Shqipëri që sheh mbrapa dhe që ushqen frikën dhe hakmarrjen, dhe një Shqipëri që sheh nga e ardhmja me shpresë dhe optimizëm.

Funksionimi i parlamentit është shprehje e drejtpërdrejtë e nivelit të elitës politike, si edhe garancia që të funksionojë sistemi politik, nëpërmjet të cilit shoqëria shikon se si mund të ekzaminojë mënyrat e marrjes së pushtetit, të funksionimit dhe të kontrollit të tij. Por klasa politike që ka dalë në skenën politike pas shembjes së sistemit komunist, nuk ka mundur që t’i japë këtij institucioni një funksionim normal brenda standardeve të një parlamenti përëndimor, për shkak të përçarjes së elitë politike.

Progresi ka qenë i pakët në arritjen e konsensusit konstruktiv ndërmjet partive politike për zbatimin e reformave të nevojshme për ecurinë e Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Puna e parlamentit është dominuar nga një agjendë politike afatshkurtër e cila ka polarizuar debatin (në Progres Raporti , 2007).

Dështimi i klasës politike për t'u dhënë shqiptarëve një parlament normal pas rënies së sistemit komunist, sipas studimeve, ka ndodhur sepse asnjëherë nuk kemi mundur të zgjedhim një parlament që të funksionojë në mënyrë të vërtetë. Pra, të ndërtojnë “parlamentarizëm“ (në S. Ngjela, 2009, fq 184), që në fund të fundit t'u japin shqiptarëve një parlament ku e gjithë forca e pushtetit politik sistemohet dhe kontrollohet, si dhe garantohet mirëqeverisja e jetës institucionale dhe shoqërore e vendit duke mos e lejuar klasën politike të bjerë në abuzivizëm me pushtetin e deleguar nga sovrani.

Mungesa e menaxhimit të shoqërisë shqiptare ka ardhur si pasojë e një parlamenti të dobët, i cili nuk ka funksionuar normalisht dhe nuk ka krijuar konceptet moderne të menaxhimit të shoqërisë. Kjo mungesë e mosfunksionimit normal të parlamentit, si dhe mungesa e frymës moderne të menaxhimit ka çuar në një stanjacion në qarkullimin e elitave. Nëse nuk kemi qarkullim të elitave, atëherë vlerat shoqërore që prodhon shoqëria jonë mbesin në vend dhe çojnë në degradimin e shoqërisë, pasi i mohojnë të drejtën individit intelektual t'i kërkojë shoqërisë që të qeveriset prej tij. Elitat qarkullojnë, pasi vetë sistemi i demokracisë, me frymën që ai përcjell, e vë në lëvizje elitën. Mirëpo efikasiteti i elitës politike dhe menaxhimi i shoqërisë nga ana e saj matet me anë të produkteve dhe efektshmërisë së punës që ajo kryen në zhvillimin e ekonomisë, forcimin e institucioneve, rritjen e mirëqënies qytetare etj.

Sistemet qeverisëse që ka kaluar vendi ynë kanë një histori të hidhur në raport me parlamentin, pasi gjatë gjithë kohës së funksionimit të këtyre sistemeve parlamenti pothuajse ka qenë formal në krijimin e një mentaliteti të ndëshkimit të elementeve të opozitës, pasi në të gjitha parlamentet shqiptare të paskomunizmit nuk është lejuar të funksionojë normalisht opozita, dhe ky ka qenë një ndër defektet më të mëdha të

tranzicionit në vend, duke penguar iniciativën e lirë dhe edukuar politikanë që nuk e pranojnë kundërshtimin. Kjo mungesë e kulturës së parlamentarizmit në klasën politike shqiptare ka sjellë si pasojë krijimin e një klase politike që nuk e kupton parlamentarizmin dhe që i ka shndërruar ata në “kukulla” ose të “papërfillur” (në S. Ngjela, 2010, fq 185).

Ekzistenca e liderëve të cilët me të marrë pushtetin e përdorin atë për të garantuar karakterin tiranik të pushtetit të tyre, pasi siç thekson (Ngjela, 2010) “Kështu ka vepruar Berisha kur ishte president deri në 1997-n, kështu ka vepruar dhe Nano deri në 2005-n dhe po kështu po vepron sërish Berisha pas zgjedhjeve të vitit 2005”. Dhe kjo sepse mosfunksionimi i parlamentit e ka lënë shtetin shqiptar jashtë institucionalizimit demokratik të tij. Me mungesën e të drejtave të opozitës në parlament, askush nuk mund të pretendojë se demokracia funksionon, apo se qeveris sipas mandatit të dhënë. Dhe kjo për fat të keq, ka qenë situata në pothuajse pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, ndaj situata mbetet e tensionuar e për rrjedhojë, ka sjellë një menaxhim jo të mirë të shoqërisë shqiptare.

Shoqëria shqiptare ka qenë për një kohë të gjatë e pamenaxhuar nga elita politike e ish regjimit, edhe klasa politike që erdhi në pushtet pas viteve '90 nuk mundi ta realizonte normalisht çështjen e funksionimit institucional, dhe kjo ka sjellë një mungesë në qarkullimin e elitave politike, për shkak të këtij keqmenaxhimi, duke prodhuar institucione të politizuara, jo efektive, në lidhje me administratën shtetërore.

Kur një shoqëri nuk drejtohet nga elita e saj më e mirë, mbetet e bllokuar në zhvillimin e saj, gjithashtu një shoqëri që nuk arrin të realizojë funksionimin institucional dhe zgjedhjet e lira e që, nëpërmjet votës, të bëjë qarkullimin elitare. Autori vë në dukje duke cituar James Burhanm: “Një elitë, pasi ka konsumuar aftësinë e saj, ka humbur

besimin dhe është rrëzuar miti, e ka të pamundur të drejtojë, ndaj është e papërshtatshme për të qëndruar në qeverisje” (në S. Ngjela, 2010, fq 187).

Kjo bëhet pengesë për zhvillimin dhe menaxhimin e shoqërisë, ndaj klasa politike shqiptare duhet ta kuptojë se mungesa e elementit themeltar të garantimit të qarkullimit të elitave është parlamentarizmi. Statusi i parlamentarizmit dhe i kushtetutshmërisë ndihmojnë dhe garantojnë realisht qarkullimin e elitave. Në të kundërt, do të ndodhemi përpara një procesi ku shoqëria prodhon një qarkullim të nënshtruar të elitave. Autori konkludon në faktin se, në pesëmbëdhjetë vjetët e fundit me parlamentet shqiptare, liderët politikë të partive kanë krijuar me kast flukse të nënshtruara të mazhorancave që, në vend që të na japin atmosferën moderne të menaxhimit të shoqërisë, na kanë dhënë atmosferën e krizave, përplasjeve irracionale dhe të pazhvillimit shoqëror. Prandaj qarkullimi i elitave sot është një imperativ i domosdoshëm për zhvillimin e shoqërisë shqiptare, ku elitat të mos emërohen por të përzgjidhen pasi kanë konkurruar dhe ku individët përfaqësues të tyre të jenë identifikuar si personalitete të spikatura të shoqërisë.

Për sa kohë që nuk do të krijohen kushtet për zhvillimin e iniciativës së lirë, liritë e individit, garancia për krijimin e vlerave të reja individuale përballë shoqërisë, si dhe procesi i formimit dhe i qarkullimit të elitave politike mbetet i bllokuar dhe, për pasojë nuk qarkullojnë. Dhe kjo po ndodh në shoqërinë shqiptare, pasi nuk funksionon sistemi, sepse nuk lejohet nga politika autoritare dhe konfliktuale e klasës politike shqiptare. Bllokimi i institucionit të parlamentit nga karakteri tiranik i politikës shqiptare gjatë tranzicionit, ka ndikuar dhe në ngadalësimin e qarkullimit të elitave, pasi është pikërisht parlamenti ku bëhet vlerësimi dhe spikatin elitat.

Duke qenë se parlamenti është arena e elitës politike për të rregulluar statusin e tij dhe të deputetit, është e nevojshme perfeksionimi i mënyrës së debatit parlamentar dhe sidomos i procesit ligjvënës. Kur flasim për lartësim të figurës së deputetit, i referohemi garantimit pavarësisë. Pra, ai duhet të shkëputet nga presioni politik dhe të mos jetë nën presion dhe krejtësisht i ndërruar, por t'i përkasë popullit që e ka mandatuar, pasi fryma perëndimore e politikës ka të bëjë me natyrën individuale të ligjvënies dhe të asaj që sjell qeveria. Serioziteti që deputeti ka në formulimin dhe miratimin e ligjeve në parlament, është drejtpërdrejt serioziteti që shoqëria paraqet ndaj ligjit. Pra, procesi ligjvënës të mos jetë rutinë, për inerci, tipare këto që të gjitha parlamentet viteve të fundit i kanë patur fenomene të tyre.

Vlerat perëndimore në politikën shqiptare ekzistojnë, por janë spontane. Ato duhet të kthehen në fenomen. Krijimi i ndjesisë të shoqëria shqiptare, se qeverisen në mënyrë abuzive nga qeveritë e tyre, ka ardhur si pasojë e faktit të mungesës së parlamentit, si qendra e përmbledhjes qeverisëse, por dhe si përgjegjësisë që del nga funksionimin normal i parlamentit, që e ka për detyrë të respektojë frymën e sovranit, pasi prej tij është mandatuar.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, politika shqiptare është paraqitur e përçarë dhe konfliktuale, e pastabilizuar dhe jodemokratike, madje, shpeshherë, ka krijuar dhe përshtypje negative të partnerët ndërkombëtarë, por edhe të vetë shqiptarët brenda dhe jashtë vendit. E gjithë situata e krijuar në shoqërinë shqiptare në ngritjen e vlerave perëndimore dhe të shtetit modern në vitet e tranzicionit, ka ardhur si pasojë e mungesës së shtetit si një entitet serioz dhe modern që përkrah dhe garanton shtetasit e vet dhe, për pasojë, as shteti, as shtetasit shqiptarë nuk kanë personalitet ndërkombëtar,

dhe kjo bie si peshë për shtetasit shqiptarë që punojnë në Perëndim. E gjitha kjo të çon te parlamenti, si qendra që garanton çdo vlerë.

Të paktën në 25 (njëzetë e pesë) vitet e fundit, qeveritë që kanë ardhur në pushtet janë karakterizuar nga papërgjegjshmëria dhe, për pasojë, kanë sjellë prapambetje dhe mosmenaxhim të shoqërisë. Por, në fund të fundit, si një vend që po përpaket të ndërtojë vlerat perëndimore, duke qenë se jemi republikë parlamentare, duhet që t'i qëndrojmë deri në fund kësaj vlere që kemi krijuar, në mënyrë që të krijohet edhe arena e politikës me të dyja anët e saj, procesin zgjedhor dhe parlamentin, të cilat ende nuk janë ngritur në vlerat perëndimore. Prandaj nuk funksionon as demokracia dhe shoqëria ndihet e pashpresë, pasi nuk kanë parë asnjëherë një parlament me seriozitet normal ku bëhet përballja e ideve për menaxhimin dhe administrimin e shoqërisë. Dhe ky proces ndodh vetëm në këto dy arena politike.

Një ndër defektet më të mëdha të klasës politike shqiptare të periudhës postkomuniste është se, në vend që të krijojë përplasje idesh në jetën parlamentare si pjesë normale e konkurrencës për të ardhur në pushtet, ajo ka krijuar një lodhje shoqërore, pasi nuk qeveris por bën vetëm zhurmë dhe luftë individësh, në një kohë që duhet të krijojë dhe mundësojë funksionimin e parlamentarizmit si arena e përplasjeve të ideve. Kjo gjendje e parlamentit vjen si rezultat i mospasjes së një procesi të rregullt zgjedhor dhe korrekt, ku parlamenti shfaqet si një arenë ku vetë qytetarët, e kuptojnë se nga vota e tyre e lirë respektohet e drejta e tyre, si dhe nga përplasja e ideve dhe programeve të subjekteve politike, shoqërisë i krijohet dhe i konsolidohet mundësia dhe e drejta për të zgjedhur më të mirin. Pra, një konkurrim i lirë i ideve dhe i programeve i krijon mundësinë shoqërisë të zgjedhë më të mirin.

4.3 Statusi i elitës politike dhe kontributi i saj në jetën politike shqiptare

Ndryshimi i sistemit komunist në vitet '90, e gjeti të papërgatitur jetën politike shqiptare për këto ndryshime. Për t'u përshtatur me këto ndryshime dhe me vendosjen e sistemit të ri demokratik, duhej bërë zëvendësimi i elitës politike që u largua dhe vendin e tyre e zunë një shtresë individësh që kishin pak lidhje me diktaturën dhe strukturën e saj, apo edhe individë që nuk kishin fare lidhje me të.

Kjo shtresë elite që nuk kishte lidhje me diktaturën vinte nga fusha të ndryshme të shoqërisë shqiptare të kohës, nga jeta akademike, mjekësia, arti, kultura apo edhe individë të profesioneve të lira. Vendosja e pluralizmit dhe themelimi i partive politike, kryesisht të PD-së apo edhe i partive të tjera solli si nevojë për jetën politike shqiptare dhe në parlamentin e parë pluralist 1992-1996 pikërisht këtë shtresë të elitës shqiptare që, për fat të keq, pas zgjedhjeve të 1996-1997-s, përfshirja e kësaj shtrese elite në jetën politike të vendit erdhi duke u reduktuar. (në R. Lami, 2013)

Po t'i referohemi këndvështrimit Veberian (M. Veber, Politika si shkencë dhe si profesion, 2006, fq 43) si çdo profesion tjetër, kërkojnë disa aftësi dhe cilësi profesionale që duhet t'i kombinosh së bashku me politikën. Duke mos patur eksperiencën e nevojshme, shumë shpejt nga politika filluan të largohen ata individë të cilët filluan të zhgënjehen dhe e kuptuan se politika si profesion nuk është e përshtatshme për ta. Sipas analistit (në R. Lami 2014, fq 98) pikërisht këtu fillon procesi i diferencimit të funksioneve të elitës shqiptare drejt një elite politike profesioniste. Në të njëjtën kohë, thekson studiuesi, në gjirin e partive politike fillojnë të shfaqen taktikat dhe strategjitë e lidërshiptit politik, lobingjet, grupet politike për të dominuar mbi të tjerët, proces i cili mundësoi tre momente të rëndësishme në procesin e seleksionimit historik të tyre.

Momenti i parë lidhet me fillimet e organizimit të partive politike, periudhë kjo që studiuesi e cilëson si "paradigma e ekspertëve". (R. Lami, 2013, 99) Kjo periudhë përkon me tërheqjen nga ana e partive politike të specia në listëve dhe teknikëve të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore. Për ilustrim është përdorur kabineti qeveritar i 1991-shit, i cilësuar si "kabinet ekspertësh apo qeveri specialistësh, ose si politikë teknikienësh". Kjo përfshirje e kësaj shtese të teknikienëve apo e specialistëve duhet vlerësuar nga këndvështrimi i nevojës imediate që paraqiste koha për t'u shkëputur nga diktatura, si dhe për të menaxhuar situatën e rëndë në të cilën ndodhej vendi në atë kohë të ndërrimit të sistemit.

"Paradigma e intelektualëve" (R. Lami, 2013, po aty) ka të bëjë me përpjekjen e PD-së në fillimet e saj në zgjedhjet e 1991-1992-shit, e cila për të siguruar sa më shumë mbështetje në shoqëri tërhoqi në gjirin e saj intelektualë nga më të shquarit e vendit. Në periudha të ndryshme kohore, kryesisht në periudhat kur partive politike u binte mbështetja në shoqëri, ata kanë hartuar dhe aplikuar taktika dhe strategji që t'u mundësonin përmirësimin e imazhit dhe të rifitonin mbështetjen. E tillë ishte përpjekja e PS-së në 1996-1997-n kur i duhej të vinte në pushtet, apo ajo e PD-së në vitin 2005, kur nëpërmjet Komitetit të Orientimit të Politikave (KOP) tërhoqi në zgjedhjet e këtij viti intelektualë e artistë të shquar të jetës shqiptare.

Momenti i tretë, sipas studiuesit (në R. Lami, 2013, 99), është "Paradigma e shoqërisë civile" Në këtë periudhë, thekson autori, e majta shqiptare ose më saktë PS në vitet 1997, 2001, 2009, u përpoq të përfshinte në ekipet e saj qeverisëse individë të përfshirë në organizata të ndryshme joqeveritare (OJF) përgjatë viteve të tranzicionit.

Këto taktika të klasës politike për të tërhequr në gjirin e saj individë, janë parë si përpjekje e tyre për të gjetur zgjidhje emergjente në kushtet e nevojës për të

130

përmirësuar imazhin e, për shkak të mungesës së traditës demokratike, në ndërtimin e një karriere normale në politikën shqiptare, të elitës politike të këtyre 25 viteve të tranzicionit shqiptar .

Ky lloj modeli ka ndikuar në politikën shqiptare në konceptimin e politikës dhe të doktrinë që ajo përfaqëson, pasi shihet si prirje për t'i depolitizuar ekipet qeverisëse, duke i prirur ato më shumë drejt reformave standarde sesa politikave me natyrë doktrinare. Qarkullimin e elitave në tranzicion e ka ngadalësuar edhe krijimi i kultit të liderit apo të partisë-shtet, duke mos mundësuar ndërtimin e një karriere politike mbi bazën e meritokracisë. Këtë tipar të partive politike e arsyeton me fakti se, “partitë politike gjenden ende në tranzicion, prandaj përpëliten midis autoritarizmit dhe demokracisë, midis qenies së tyre parti ideologjike dhe dëshirës për t'u bërë formacione të hapura politike dhe me mbështetje të gjerë në publik” (në S.Pëllumbi. 2001,fq 18).

Përfshirja apo dhe zgjedhja e drejtuesve të rinj dhe pa përvojën e duhur partiake, në vend të figurave të shquara dhe themeluese të partive politike në qeveri dhe në aktivitetet partiake, është vlerësuar si përpjekje për përmirësimin e imazhit në opinionin publik, apo edhe si përpjekje për të rritur e zgjeruar më shumë përkrahësit e lidershit të partive politike. Figura të tilla, pa përvojën dhe eksperiencën e duhur, i gjejmë të përfshira në strukturat e partive politike apo dhe ato qeverisëse. Parë nga ky këndvështrim, të krijohet përshtypja se këta individë nuk mund të konkurrojnë liderët aktualë të partive politike, duke i shndërruar këto të fundit në “parti-lider apo parti-private” (në H. Feraj, 2003, fq 98). Dhe kjo është tipar i të gjitha partive politike shqiptare.

Ky monopolizim i partive politike nga liderët e tyre ka sjellë si pasojë një fenomen që vërehet gjithnjë e më shpesh në politikën shqiptare, duke katapultuar apo futur në

politikë e parlament persona që në këto parti kanë qenë në kontradiktë me ato grupe sociale që mendohet se normalisht do të përfaqësonin.

Kështu në zgjedhjet vendore 2000 “PS në këto zgjedhje kandidoi një numër të madh biznesmenësh, traditë që përkon me ideologjinë e djathtë, ndërsa në zgjedhjet e 2005-s, 2009-s përsëritet i njëjti paradoks nga PD, duke kandiduar kandidatë që vinin nga radhët e shoqërisë, traditë kjo e së majtës” (në R. Lami, 2013, fq101). Kjo ë shtë shenjë e mosorientimit aksial të partive politike dhe mungesë vizioni nga ana e tyre.

Kjo metodë ndikon në sjelljet e partive politike dhe qëndrimet e tyre në nivelin e përfaqësimit të grupeve sociale. Duke u rritur pushteti i liderëve partiakë në dëm të strukturave partiake, e bën procesin e vendimmarrjes partiake të personalizuar, duke krijuar akumulim të pushtetit partiak në pak oligarkë, të cilët, shpeshherë, janë të pavotuar dhe nga strukturat e partisë.

Si përfundim, mund të themi se gjatë tranzicionit të dy dekadave të fundit, elita politike shqiptare ka qenë më e interesuar për pushtetin personal dhe interesat që lidhen me të, sesa në artikulin dhe prezantimin e programeve dhe të platformave politike të pozicionuara sipas formës korrekte dhe ideore së cilës këto parti i përkasin. Lufta për pushtet ka ndikuar në zbehjen e interesit të klasës politike shqiptare, për të ndërtuar institucione e qeverisje demokratike e, mbi të gjitha, për qytetarët, mbi baza ideologjike. Kjo paaftë si e klasë s politike të kë tyre 25 viteve , ka çuar në ndë rtimin e një marrë dhë nie të brishtë mes shtetit dhe qytetarë ve , duke ulur besimin e qytetara ve tek klasa politike e saj.

4.4 Formësimi i klasës politike gjatë tranzicionit dhe karriera politike e saj

Duke iu referuar si pikënisje të argumentimit vitit 1991, për t'u bërë pjesë e jetës politike shqiptare konkurruan 7 kryetarë të atëhershëm dhe të tanishëm në zgjedhjet parlamentare të mbajtura. Në zgjedhjet e 1991-shit kryetari i atëhershëm i PPSH-së humbi përballë kandidatit demokrat, ndërsa rezultatin më të thellë e ka siguruar Sali Berisha, në 1991, në Kavajë, ku mori 88,90% (në A .Krasniqi, 2009, fq 335) të votave ndaj kandidatit të atëhershëm. Në këto zgjedhje konkurruan edhe Fatos Nano përballë demokratit Sokrat Nesturi. Lefter Xhuveli si kandidat i PPSH-së fitoi përballë regjisorit demokrat Edmond Budina. Fituan, gjithashtu, dhe Mitro Çela e Neritan Ceka si kandidatë të PD-së përballë kandidatëve komunistë Skënder Gjinushi e Teuta Dilo. Pas zgjedhjeve, Gjinushi krijoi partinë e tij, Partia Socialdemokrate, ndërsa Xhuveli krijoi Partinë Agrare. Ceka u bë kryetar i Partisë Aleanca Demokratike. Sabri Godo konkurroi në Berat, si kryetar i Partisë Republikane, përballë kandidatit demokrat Agron Musaraj dhe kandidatit Përparim Ruzi të PPSH-së. Në qytetet e Korçës dhe të Tiranës kandiduan kryetari i ardhshëm i PD-së Eduart Selami dhe Tritan Shehu.

Edhe pas zhvillimit të zgjedhjeve të 1992-shit Berisha, Nano, Gjinushi, Ceka konfirmohen sërish si deputetë, ndërsa jashtë parlamentit mbetën Xhuveli dhe Alia. Ndërkohë fituan mandatet e tyre deputetë të rinj që vinin nga lista shumemërore, si Ilir Meta, i cili në 2004 do të themelonte LSI-në.

Viti zgjedhor 1996 shënon një etapë të re për jetën politike, pasi disa deputetë, për shkak të ligjit të kontrollit të figurave që u miratua nga parlamenti i dalë nga zgjedhjet e 1992-shit, nuk mundën të kandidonin, mes tyre edhe lideri i opozitës Nano, Gjinushi, ndërkohë që në krahun e djathtë konfirmohen Genc Pollo dhe Sabri Godo.

Në parlamentin e dalë nga zgjedhjet e parakohshme të 1997-s siguruan vendet parlamentare pothuajse të gjithë liderët politikë, duke filluar nga Berisha që rikthehet me anë të listës shumemërore e T. Shehu gjithashtu. Nano fiton në Tepelenë, ndërsa Gjinushi në Vlorë, përballë kandidatit tjetër të së majtës. Ndërsa kryetarët e partive të tjera, përmes listave shumemërore dhe marrëveshjeve të minutës së fundit, siç ishte rasti në Elbasan i kreut të PAD-së, Ceka, përballë socialdemokratit Bahri Myftari. Në zgjedhjet e 2001-shit mandatin parlamentar e fituan pothuajse të gjithë kryetarët e partive politike që konkurruan, me përjashtim të Genc Pollos, si kryetar i PDR-së. Ndërsa në zgjedhjet e 2007-s sërish janë po të njëjtat kandidatura që fitojnë mandatet parlamentare përmes listave shumemërore apo edhe mandate direkt, si Ilir Meta në Skrapar e Nard Ndoka në Shkodër. Të gjitha këto raste janë tregues se si klasa politike ka përdorur manovrat politike në përfitim të kandidimeve në zona të sigurta apo dhe në përfitim të listave shumë emërore, kanë ruajtur pozicione të sigurta kandidimi. Manovrat në momentin e fundit janë një tjetër tipar që klasa politike e ka përdorur në shërbim të ruajtjes së pozitave të tyre zyrtare për të zgjatur sa më shumë ato.

Sikurse konstatohet, është fakt se tradicionalisht kandidatët apo dhe kryetarët e partive politike garojnë në zona të sigurta elektorale, ose kryesojnë listat shumemërore të partive politike. Si rezultat është e dukshme tendenca e kryetarëve të partive politike, për të që në gjithmonë fitues në dëm të qarkullimit të elitës politike, duke mos u dhënë hapësirat e nevojshme të rinjve në politikë.

Përdorimi i skemave të taktikave paraelektorale apo dhe hyrja në koalicione me partitë e mëdha, ka dhënë gjithmonë rezultat pozitiv duke u garantuar dhe partive të vogla mandate parlamentare. Vlen për t'u theksuar se gjithmonë kur kandidatët kanë garuar në zona të diskutueshme, kanë humbur mandatin, prandaj dhe klasa politike ka

preferuar gjithmonë të jetë e prirur drejt sistemit proporcional, me lista kandidatësh ku në krye gjithmonë qëndron kryetari i partisë, ose kanë aplikuar metoda që t'u garantojnë mandatin parlamentar duke penguar në këtë mënyrë qarkullimin e elitës politike.

Karriera politike dhe parlamentare ka treguar se konstatimet e mësipërme janë të qëndrueshme. Për këtë analizë, duke iu referuar studimit të (në Afrim Krasniqit 2009, fq 338) në lidhje me karrierën politike dhe parlamentare të elitës politike nga viti 1991-2009, rezulton se, deputeti me më shumë mandate për periudhën e dhënë është Namik Dokle i PS-së, me gjashtë mandate, ku vetëm njëri është siguruar me lista shumemërore, ndërsa të tjerët me zgjedhje direkt, kryesisht në Kukës dhe Cërrik. Sipas autorit, nga 33 deputetët e marrë në analizë rezulton se deputetët që kanë më shumë mandate janë socialistë dhe janë gjashtë deputetë. Deputetët të cilët kanë më shumë se katër mandate nga këta 33 të marrë në analizë (rreth gjysma e tyre) janë të PS-së ose ish-socialistë që kanë siguruar mandat me një parti tjetër. Deputetët nga pesë mandatet janë kryesisht ish-kryeministra apo dhe ministra socialistë, si Nano, Meta, Ulqini, Mexi e Ruçi. Vlen për t'u theksuar se ndër këta deputetë të PS-së të cilët kanë një karrierë të gjatë politike dhe parlamentare, gjashtë prej tyre kanë kandiduar dhe janë zgjedhur nga Partia e Punës në zgjedhjet e vitit 1991 dhe janë: Ruçi, Nano, Dokle, Brokaj, Islami, Hysa, Xhuveli.

Në këtë listë të analizuar prej 33 deputetësh, nga krahu demokrat deputetët me më shumë se tre mandate janë kryetarët dhe ish-kryetarët e kësaj force politike: ish-kryeministri Mexi apo dhe ish-kryetarët e parlamentit. Në analizë bie në sy dhe prezenca e deputetëve të cilët nuk kanë patur poste të larta drejtuese në parti.

Veçori e ruajtjes së mandatit nga ana e deputetëve gjatë periudhës së marrë në analizë, është edhe fenomeni i kandidimit të deputetëve në më shumë se një parti politike. Nga analiza e bërë del se tre deputetë, Meta, Brokaj e Legisi, janë zgjedhur deputetë nga dy parti politike. Ndërsa nga e djathta, tre deputetë, Shehu, Imami, Ceka, janë zgjedhur gjithashtu deputetë nga dy parti të ndryshme politike. Nga partitë e tjera politike deputetët që janë zgjedhur nga dy parti të tjera politike janë: Xhuvëli, Milo, Laço.

Në listën e 33 deputetëve me më shumë mandate parlamentare bëjnë pjesë drejtues të lartë të gazetës “Zëri i Popullit” (Dokle, Ulqini, Braçe), si dhe figura që kanë qenë drejtues apo themelues të FRESH-it (Meta, Majko, Legisi). Interesant është fakti se në listën e analizuar të 33 deputetëve bien në sy vetëm dy emra të përfaqësimit të grave, që janë Topalli dhe Meksi, çka tregon dominancën e meshkujve në jetën politike shqiptare. Deputetët të cilët gjatë periudhës së marrë në analizë nuk e kanë ndryshuar asnjëherë zonën e tyre elektorale janë: Arbnori, Berisha, Meta, Hysa, Majko dhe Braçe.

Është interesant fakti se nga këta 33 deputetë të marrë në analizë, të cilët kanë më shumë mandate, 29 prej tyre kanë qenë ose kryetarë partie, kandidatë për kryetar, nënkryetarë, sekretarë, sekretarë të përgjithshëm, kryeministra, kryetarë parlamenti apo ministra. Pra si faktor kryesor i zgjedhjes, përveç meritës personale dhe në parti apo edhe angazhimeve të tjera, edhe pozita e lartë drejtuese ka qenë diktuese dhe i ka ndihmuar ata të fitojnë vende të sigurta në listat proporcionale të partive politike ose kandidimin në zona të sigurta elektorale. Ajo pjesë e tyre që kanë humbur në konkurrimin mazhoritar, ka marrë mandatin e deputetit përmes listës shumemërore të partisë që bëjnë pjesë. Kryesisht, këtu futen kryetarët e partive të vogla politike dhe figurat e dyta të të gjitha partive politike.

Në përfundim të analizës thekson se, *“asnjë prej listës me 33 deputetë që kanë më shumë mandate parlamentare nuk ka studiuar shkenca politike, dhe nuk kanë patur ndonjë botim apo analizë politike. Mes tyre ka autorë që kanë botuar në fushat specifike ku kanë studiuar, por që shumica e këtyre botimeve i përkasin periudhës përpara se këta individë të futen në politikë. Nga këta 33 deputetë, gjysma e tyre nuk kanë gradë shkencore, që do të thotë një aktivitet të spikatur profesional dhe, si të tillë, politikën e konsiderojnë si profesionin e vetëm të suksesshëm”* (në A. Krasniqi 2009, fq 340).

Deri në vitin 2009 Shqipëria, sipas autorit, rezulton si i vetmi vend në Europë që ende nuk kishte arritur të krijonte besim politik, të ndërtonte mekanizmat dhe institucionet e nevojshme që të garantonin jo vetëm zhvillimin e zgjedhjeve të lira e demokratike, pasi gjatë gjithë periudhës nga 1992-shi deri në zgjedhjet e 2007-s të gjitha proceset zgjedhore ose janë kontestuar, ose janë vënë re parregullsi, ose janë manipuluar nga politika. Krahas këtyre, zgjedhjet kanë shënuar edhe rotacionin e pushtetit politik, ku ky rotacion herë ka qenë i dhunshëm, si ai i vitit 1997, herë paqësor në vitin 1992 dhe rotacion pushteti i shoqëruar me tensione të larta politike, siç ishte ai i vitit 2005. Në tërësinë e tyre zgjedhjet nga klasa politike shqiptare kanë qenë të kontrolluara dhe të manipuluar, duke u përdorur metoda dhe forma elektorale në favor të partisë që ishte në pushtet. Në këtë mënyrë, në të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara deri në 2009-n me përjashtim të atyre të vitit 1992, klasa politike shqiptare ka dështuar që t’i ofrojë zgjedhësit shqiptar një zgjidhje politike të qëndrueshme, të besueshme dhe afatgjatë. Dhe si pasojë e këtyre problemeve janë provokuar kriza të herëpashershme politike goftë në parlament apo edhe në sistemin politik, duke i faturuar shoqërisë shqiptare kosto të lartë financiare dhe të besueshmërisë të klasa politike.

Gjatë periudhës së tranzicionit hendeku i madh i krijuar mes klasës politike dhe shoqërisë shqiptare, ka vënë përballë vullnetin e lirë të qytetarëve shqiptarë me vullnetin e klasës politike për zhvillimin e proceseve zgjedhore dhe funksionimin e partive politike. Hendeku mes klasës politike dhe shoqërisë shqiptare është theksuar dhe më shumë nga paaftësia e institucioneve kushtetuese dhe mekanizmave institucionale për të bërë të mundur administrimin e zgjedhjeve e për pasojë, shmangien krizave politike të panevojshme.

4.5 Reminishencat e vjetra politike të elitës politike në tranzicion

Zhvillimet politike gjatë tranzicionit kanë qenë të shoqëruara me probleme, në të shumtën e rasteve të krijuara nga vetë politikanët me papërgjegjshmërinë e tyre. Gjatë dy dekadave të para të tranzicionit ka qenë e vështirë të vëreheshin përmirësime të dukshme kur në krye të drejtimit të shtetit qëndronin ende politikanë që politikën e kanë konsideruar biznes dhe jo si një kontribut për zhvillimin dhe ecjen përpara të shoqërisë shqiptare. Në dallim nga vendet e rajonit ku në skenën politike shihen fytyra të reja në drejtim, në vendin tonë për afro dy dekada qëndrojnë të njëjtët politikanët. Referuar ish-presidentit të Shqipërisë Alfred Moisiu *”Politikanët të cilët për gati 18 vjet po e mbajnë vendin pothuajse në vendnumëro, nuk kanë të drejtën morale të kërkojnë role kryesore në skenën politike të Shqipërisë. Kudo në rajon shohim fytyra të reja në drejtim. Vetëm te ne vazhdon të jetë e gjallë ndjenja e trashëguar nga e kaluara mbi jetëgjatësinë politike, duke i konsideruar partitë si pronë personale dhe jo si attribute të demokracisë. Kjo nuk është gjë tjetër veç se reminishencë e së kaluarës”*(në A. Moisiu, 2009).

Analiza e trashëgimisë politike është treguesi më mirë për ecurinë e ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit. Ajo hedh dritë mbi modelin e

zhvillimit të shtetit, institucioneve, qasjen e partive politike dhe drejtuesve të tyre në drejtimin e shtetit. Ajo hedh dritë mbi mentalitetin, kulturën e shoqërisë shqiptare për të ndërtuar ose jo një model të një shoqërie të hapur, të lirë dhe demokratike. Disa probleme janë të qarta për t'u kuptuar më shumë nga perspektiva e kulturës politike, sesa nga burimet apo domosdoshmëria për të këmbëngulur për demokraci dhe konsolidim. Koncepte politike, të tilla si: demokracia, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, pjesëmarrja politike, pluralizmi politik janë procese që marrin kohë, nuk ndërtohen me fjalë, por me veprime dhe besim në to. Shoqëritë demokratike mbartin një sërë vlerash dhe traditash, të cilat janë kultivuar përmes proceseve shumë dinamike të zhvillimit të vet shoqërisë. Kërkesa për vlera demokratike lidhet ngushtë me përpjekjet e shoqërisë për t'i arritur këto vlera.

Nëse i referohemi traditës politike në Shqipëri, ajo ka një mangësi të madhe për sa u përket elaborimit të vlerave dhe kulturës demokratike. Studiuesit nuk evidentojnë ndonjë proces të mirëfilltë të demokratizimit të elitës politike dhe të shoqërisë shqiptare, në gjithë rrjedhën e ekzistencës së Shqipërisë si shtet. Teoritë e shquara të demokracisë pohojnë se, *“demokracia kërkon një grup të veçantë të vlerave politike dhe orientimeve nga qytetarët e saj”* në (në L. Daimond, 2008).

Demokratizimi i vendit pas përmbysjes së regjimit komunist shkaktoi një ndryshim të rëndësishëm të elitës politike. Politikanët shqiptarë të pas viteve 1990 kishin mangësi të theksuara në përvetësimin e normave qytetare dhe juridiko-shtetërore sipas kërkesave të kohës për orientimin e ri politiko-ekonomik të vendit. Kjo mangësi e formimit të drejtuesve të rinj politikë u plotësua me vijimin e traditës së vjetër, sipas së cilës në vend të nënshtrimit ndaj sistemit dhe respektimit të ligjit e shtetit, drejtuesit dolën mbi sistemin dhe krijuan një shtet të ndryshëm nga sa pritej dhe institucione të varura nga

politika, me mungesa të vizioneve dhe normave të qarta ideologjike, pasojë kjo mungesë së normave demokratike të cilat nuk i trashëguan.

Në vitin 1991, Shqipëria iu fut një rrugë ku e shkuara nuk e ndihmonte dot. Për të realizuar procesin e vështirë dhe kaq shumë të rëndësishëm të tranzicionit nga totalitarizmi në demokraci, elita ish-komuniste mori monopolin e procesit - e vetmja elitë politike dhe intelektuale e mundshme për kohën, por që ishte produkt i pashmangshëm i regjimit të kaluar. Në kohën e ndryshimit të sistemeve, rreth 75% e popullsisë së vendit ishte nën moshën 40 vjeç (NRIIA). Kjo moshë e re e popullsisë tregonte se çdo tre në katër shqiptarë kishin lindur gjatë viteve të periudhës komuniste, duke mos njohur asnjë përvojë tjetër në jetë (në P. Misha, 2006, fq 143).

Argumentet dhe faktet flasin për një vazhdimësi të traditës komuniste në zhvillimin e elitës dhe të politikës nga ana e drejtuesve të rinj. Një ndër argumentet bazë që e fakton këtë vazhdimësi apo reminishencë të theksuar të së kaluarës, është dhe mënyra e funksionimit të partive politike në Shqipëri. Duke qenë se partitë politike janë mjete përfaqësimi, ato artikulojnë interesat, nevojat dhe vlerat e qytetarëve. Mënyra e formimit të partive në Shqipëri pas viteve '90 na shpjegon pse partitë politike janë konfiguruar në këtë mënyrë dhe përse kanë mbetur, deri diku, peng i së shkuarës. Pasi elitat drejtuese kanë shtypur me ç'të mundin mendimin ndryshe dhe eliminimin e tij nga partia.

Elitat drejtuese të partive e kanë shtypur me ç'kanë mundur mendimin ndryshe dhe eliminimin e tij nga partia. Përse? Lideri i partisë Psdhe PD, vijon me traditën autoritariste të liderit të pazëvendësueshëm i cili, edhe kur largohet, deri edhe vetëm emri i tij mundet të sjellë trazira në parti. Përse? Kjo vjen në përgjigje të dëshirave për të pasur sa më shumë pushtet, dhe këto dëshira janë shfaqur nga të dyja kahet e

partive politike që kanë qenë në drejtim të vendit. Tendenca e monopolizimit të pushtetit ka deformuar jo vetëm partinë, por mbi të gjitha institucionet dhe shtetin të tërësi, elemente që janë qartazi trashëgimi e thellë e së kaluarës.

Të dyja partitë kryesore PD dhe PS të jetës politike në vend paraqesin tiparet e tyre në këtë drejtim. Partia Socialiste kishte në natyrën e saj drejtimin e centralizuar. Shumica e udhëheqësve të PS-së, i përkasin kastës së ish-burokratëve komunistë dhe kjo ishte një e metë e saj. Partia Demokratike nuk evoluoi apo avancoi në këtë drejtim. Duke qenë se lindi si një opONENTE kundër regjimit komunist, mbeti për një kohë relativisht të gjatë peng i këtij misioni duke mos përmbushur dot qëllimin për të qenë një parti realisht demokratike në mënyrën dhe funksionimin e saj. Nga analiza e luftës politike që zhvillohet në Shqipëri, ajo duket se nuk është tërësisht e çliruar nga urrejtja ndaj kundërshtarit politik, ushqen një klimë politike thellësisht të polarizuar aq sa është reflektuar edhe në jetën shoqërore. I mungon toleranca për të lejuar zhvillimin e aftësive politike, që janë të domosdoshme për zhvillimin e pranimin kompromiseve dhe të marrëveshjeve politike.

Ndërtimi i aparatit burokratik në të dyja partitë kryesore ka tipare të veçanta: militantët e Partisë Socialiste kishin shërbyer në aparatin e shtetit të diktaturës dhe formimi i tyre kulturor e profesional ishte i ndërtuar dhe zhvilluar sipas një tradite pune të përshtatshme për ato struktura shtetërore, ndërsa militantët e Partisë Demokratike ishin pa përvojë ose të konvertuar si të tillë. Modeli i të shërbyerit jo shtetit por partisë është një element i hasur ndjeshëm tek të dyja partitë kryesore, gjatë periudhës që ato kanë qenë në pushtet. Kjo ka ardhur si pasojë e ndërtimit të modelit të shpërblimit të militantëve me vende pune, dhe nuk ka vetëm një rast sporadik, përkundrazi, të dyja partitë kryesore e kanë ruajtur fuqimisht këtë traditë të vjetër.

Fragmentarizmi i spektrit politik shoqërohet me mungesë të dialogut, tolerancës, të mendimit ndryshe, me monopolizim të vendimmarrjes apo identifikim të partisë me liderin. Studiuesi Tushi (2000) shprehetse, partitë politike në Shqipëri janë kryesisht “vegla të udhëheqësve të tyre”.

Për studiuesin Afrim Krasniqi 2015 *“vendi ynë bën pjesë në ato vende ku ka vazhdimësi apo vijueshmëri të elitave mes sistemit të vjetër dhe sistemit të ri. Ky argument është i bazuar në studime të kryera dhe nga autorë të huaj, një tipar që duket qartë edhe në vendet e tjera të Europës Lindore. Në Shqipëri disidenca komuniste u eliminua shumë shpejt nga regjimi komunist dhe gjithë pjesa intelektuale. Pra, elita që ishte shkolluar dhe formuar në Perëndim, u zëvendësua me pseudo-intelektualë të bindur ndaj pushtetit komunist. Eliminimi i meritokracisë si dhe zhdukja e mundësisë për të patur një karrierë mbi merita, bëri që regjimi komunist t’i emëronte individët në krye të institucioneve shtetërore duke u bazuar mbi bindjen politike. Shoqëria civile u zëvendësua me modele të regjimit, duke e zbehur këtë nocion të kultura qytetare e shqiptarëve. Ndryshimet demokratike dhe vendosja e sistemit të ri u shoqërua edhe me liritë e munguara prej dekadash të populli shqiptar”^{iv}.*

Të gjitha studimet e tranzicionit demokratik janë të mendimit se, ky proces transformimi të gjithanshëm, duke përfshirë këtu dhe elitat e pushtetit, e ruajti” formën piramidale” (A.Krasniqi, 2015) të këtyre elitave në sistemin e emërimit dhe promovimit të tyre, pasi vetë ndryshimi i sistemit u stimulua nga regjimi komunist.

Reminishenca të regjimit të vjetër në politikën shqiptare vazhdojnë të jenë të dukshme gjatë gjithë tranzicionit, pasi mënyra e promovimit të politikanëve, emërimet në administratën publike, në partitë politike janë të kryera të gjitha me anë të njohjeve personale ose partiake, duke deformuar në këtë mënyrë jo vetëm funksionimin e

institucioneve publike, por duke u bërë pengesë në zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë. Kjo mënyrë e të funksionuarit të klasës politike, ka krijuar një shtresë politikanësh të varur nga emërimet dhe jo nga meritat e tyre, çka e ul efencën e ushtrimit të detyrës së tyre.

Sipas autorit (në A, Krasniqi, 2015) brezi i viteve '60-'70 ishte dominues në politikë individë me karrierë të njëjtë kohore në diktaturë dhe në demokraci. “ Ky tipar i politikës së vjetër, sipas autorit, ë shtë një ndër arsyet kryesore se përse sistemi i ri nuk arriti të krijojë një elitë të re, të hapur, konkurruese profesionale dhe kurajoze”. Reminishencat e politikës së vjetër shfaqen në politikën shqiptare në ndërtimin e një politike konfliktuale në zhvillimin e zgjedhjeve dhe të debatit politik, apo dhe në atë për pushtetin dhe fatin e tij, kur një ngjarje e caktuar cenon rendin dhe stabilitetin në vend. Të tilla situata politika shqiptare ka kaluar disa herë gjatë tranzicionit, por gjithmonë klasa politike shqiptare, në mënyrë të ngjashme me atë të regjimit komunist, i ka shfrytëzuar ato, sa herë që e ka ndjerë që po i rrezikohet pushteti, duke ngritur skenarë, ndërmarrë fushata të ndryshme protestash dhe grevash apo dhe me peticione e sulme personale ndaj kundërshtarit politik. E gjithë periudha e tranzicionit është shoqëruar me tipare të tilla të klasës politike, element i cili ka prodhuar vetëm vonesa në procesin e konsolidimit të sistemit demokratik dhe të integritetit të vendit. Sipas autorit, në elitën politike shqiptare të majtë apo të djathtë, mbetjet e regjimit të vjetër janë ende aktive, pasi të njëjtët individë firmosin për interesat e vendit në procesin integruar dhe janë po këta të cilët kanë firmosur kundër disidencës komuniste, kundër opozitës apo dhe për proceset bojkotuese, duke u promovuar kështu si mbështetës të liderit të partisë, të qeverisë dhe të pushtetit, në të dy krahët e politikës.

Kjo mënyrë funksionimi e elitës politike, të krijon bindjen se elitat e mirëfillta janë anashkaluar ose nuk kanë patur hapësirën e nevojshme për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Kjo është e dukshme në mungesën e peticioneve apo dhe të lëvizjeve të ndryshme qytetare kundër korrupsionit, në të gjitha nivelet e administratës dhe të pushtetit, në ndikimin e partive politike në interesin kombëtar dhe të pasuritë kombëtare.

E gjithë klasa politike duke qenë jo profesioniste dhe e varur nga lideri, ka marrë vendime e ndikuar nga paria politike, vendime që kanë qenë më shumë në interes të partive politike sesa të qytetarëve.

Analiza e gjithë këtyre tipareve të klasës politike, nxjerr në dukje se sa deformuese është kjo lloj politike, për vlerat demokratike të shoqërisë; se sa e thellë është gjurma apo diferenca e shoqërisë shqiptare për t'u formësuar me kulturë demokratike; se sa e madhe është distanca mes ndërtimit të një shoqërie të lirë, e cila është e bazuar mbi meritokracinë dhe një shoqëri të mbyllur mes elitave moderne dhe parive orientale. Kjo ka çuar në dështimin e konceptit demokratik të parimit të “qeverisjes së qytetarëve nga qytetarë, për qytetarë“, gjatë tranzicionit në Shqipëri dhe është shndërruar në parimin qeverisje të pakicës nga pushteti, për pushtetin.

Dhënia më shumë hapësirë formave dhe mjeteve demokratike, duke përfshirë elitat publike në hapësirat demokratike nga politikanët shqiptarë është parë si një kërcënim për pushtetin e tyre. Zgjerimi i hapësirës demokratike në funksionimin e elitave politike do të sillte uljen e politikës konfliktuale, politikë e cila ka mbajtur peng gjatë tranzicionit politikën shqiptare, duke bërë të dukshëm dallimin mes elitave reale dhe atyre të promovuara, si dhe do të sillte një vendimarrje më të arsyeshme politike.

Një tjetër tipar që klasa politike shqiptare trashëgoi nga e kaluara është se, “kush erdhi pas eliminoi atë që ishte para tij”, shprehet Frrok Çupi (2005). Nuk ka mbetur askush deri më sot, shkruan ai në gusht të 1996-s, të paktën që nga periudha e mbretërimit të Ahmet Zogut, i cili kishte perfeksionuar mekanizmin e eliminimit të intelektualëve dhe kundërshtarëve. Të njëjtën gjë bëri dhe regjimi komunist me mbretërorë e kuislingë që ishin paraardhësit e tij. Edhe qeveritarët post-komunistë, që u quajtën demokratë, po këtë gjë bënë. Tani shprehet autori, ka një shpresë se mund të përfundojë kjo taktikë e eliminimit politik. Me mocionin dërguar në Partinë Socialiste, kryetari i saj Fatos Nano, një intelektual i kompletuar dhe i burgosur politik, u kërkon bashkëpunëtorëve të vet modernizimin e Partisë, si dhe eliminimin e politikës primitive eliminuese. Duke përdorur pozitën e tij prej të burgosuri politik, ai deklaron se nuk do të ketë hakmarrje. Kjo, me sa duket, kërkoi që të vërë fre politikës eliminuese të vendosur nga Zogu, Hoxha dhe Berisha. E kaluara komuniste në politikën shqiptare kë lënë një gjurmë të madhe edhe në kulturën politike të shqiptarëve.

Studiuesi dhe akademiku (në Rexhep Qosja 2005, fq 30) e analizon këtë tipar të politikës shqiptare nëpërmjet dy figurave kryesore të tranzicionit shqiptar, Sali Berishën dhe Fatos Nanon, të dy “liderë” që politika shqiptare i trashëgoi nga e kaluara komuniste. Akademiku Qosja shprehet se, “*shqiptarët më së pari janë lodhur nga liderizmi i pështirë i Berishës*”(Rexhep Qosja, 2005,fq 32). Daljet e shpeshta, zëri i tij që dëgjohet në rrugë, në Kuvend, sheshe, në selinë partiake apo dhe në fushata zgjedhore. Akademiku e cilëson liderin Berisha si një njeri që nuk kritikon por që rrënon, që do t’i dalë gjithkund vetëm e tija, një politikan që nuk e njeh kompromisin në politikën e tij, por që e quan veten demokrat dhe që për gati trembëdhjetë vjet në krye të PD-së e ka bërë gati private. Për të nuk vlejnë rregulloret e punës apo të

Kuvendit. Ai e merr fjalën jo vetëm kur ia jep kryesuesi i Kuvendit, por kur i teket atij. Akademiku madje thekson se, *“e kam parë kur ka diskutuar një herë me lejen e kryetarit të Kuvendit dhe dy herë pa lejen e tij”* (në R. Qosja, 2005, fq 34).

Po të mos ishin SHBA-të, BE-ja, Këshilli i Sigurimit të OKB-së që, sipas akademikut, nuk i pranojnë qeveritë e paligjshme, Sali Berisha do të kënaqej duke bërë grushte shteti.

Sali Berisha cilësohet nga autori si një lider i konsumuar, duke bërë titull e kërcënuar dhe që vazhdimisht akuzon për korrupsion, krim të organizuar, vjedhje votash bashkëpunim me mafien, por që gjithnjë mbesin retorikë, sado që në botën shqiptare këto dukuri ekzistojnë. Përfshirja e liderëve partiakë sidomos në zgjedhjet vendore dhe ato qendrore, që flasin në emër të kandidatëve, pasi njëshi është i padiskutueshëm, është tipar edhe i politikës aktuale të të dy kaheve politike. Flasin për varfëri dhe papunësi, por që në fushata harxhojnë me miliona.

Berishën e kategorizon si zjarrvënësin e jetës politike shqiptare, duke filluar nga viti 1997, ku Berisha, sipas tij, u dogj vetë, kurse në vazhdimësi po djeg mundësitë e PD-së, duke spastruar nga radhët e saj të pabindurit. Brenda një kohe të shkurtër, sipas autorit, Berisha ka përjashtuar nga PD individët me merita, të aftët, që ishin që në themelimin e saj, *“është meritë e tij pse prej PD-së janë bërë dhe tri parti të tjera demokratike”*. Akademiku shprehet se, nuk ka dyshim që teknologjia e mbajtjes së pushtetit partiak që zbaton Sali Berisha, është mësuar në shkollën komuniste (në R. Qosja, 2005, po aty).

Politikës shqiptare dhe vetë shqiptarëve nuk u mjaftonte vetëm Sali Berisha, por dhe Fatos Nano. Ndryshe nga i pari, ky i lodhi shqiptarët më ngadalë, por që ishte një

lodhje rrënjësore, gjithnjë duke iu referuar autorit (R. Qosja, 2005). Në rast se i pari i lodhi shqiptarët me luftë politike, Nano i lodhi shqiptarët në luftën jo vetëm kundër PD-së, por dhe në luftën brenda PS-së, një luftë e udhëhequr nga Ilir Meta. Në qoftë se në fillimet e tij Nano ishte më i moderuar në sjelljen e tij politike, me kalimin kohës ai filloi t'i ngjajë kundërshtarit të tij. Dhe jo vetëm në gjuhën komunikuese, por edhe me sjelljen autoritare.

Në ndryshim nga Berisha i cili kundërshtarët e tij i rrëronte, Nano duke i baltosur ata i vdes moralisht në opinionin publik, duke i larë hesapet me kundërshtarët e tij politikë në mënyrë origjinale të tij. Edhe ky si Berisha, për 13 vjet në krye të PS-së, e ka privatizuar PS-në dhe kjo është e dukshme, sipas autorit, me shprehitë e tij, si *“unë si kryeministër, unë si kryetar i partisë apo dhe si përfaqësues i mazhorancës”*(në R.Qosja, 2005, po aty).

Qeverisja e vendit me zëvendësministra është tipar që vetëm ai e përfaqëson, apo dhe të vazhdojë të qeverisë kur propozimet e tij në Kuvend për ministra nuk kalojnë. Të tillë kryeministra në botën demokratike dorëhiqen. Etja për lidërsip dhe autoritarizmi i tij duhen parë si shkaqet kryesore që shkaktuan konflikt me socialistëve. Nano, i pushtuar nga vetëmjaftueshmëria, liderizmi dhe autoritarizmi, prodhoi konflikte brenda PS-së, duke u bërë pengesë në rrugën e transformimeve të nevojshme jo vetëm në PS, por edhe të proceseve demokratike në vend, po aq sa Berisha. Akademiku Qosja e cilëson politikanin Nano si një politikan i cili teknologjinë e mbajtjes së pushtetit e ka mësuar në të njëjtën shkollë me Berishën, pra në *”shkollën komuniste”*, por që ato mësimet i përdor në mënyrë më të rafinuar se Berisha.

Sikurse është e dukshme, etja për pushtet e të dy *“liderëve”* është shprehje e qartë e shkollës komuniste nga e cila rrjedhin, dhe një gjurmë e thellë që vjen nga e kaluara në

politikën shqiptare, dhe kjo ka patur pasojat e saj për shoqërinë dhe politikën shqiptare. Për periudhën që këta dy lider udhëhoqën partitë e tyre, sipas autorit, pra për gati 12 vjet, ka qenë e pamundur që të vendoset një baraspeshë në jetën politike shqiptare. Me politikën e tyre ata nuk i krijuan Shqipërisë kurrfarë baze shpirtërore apo morale si kusht i qëndrueshmërisë së shtetit, përkundrazi, patën efekte çmoralizuese në shoqërinë shqiptare.

4.6 Performanca e elitës politike gjatë tranzicionit

Tranzicioni ka qenë një periudhë e vështirë për politikën shqiptare, pasi pjesa më e madhe e kësaj ka patur një produkt, kurba e kredibilitetit të të cilëve ka ardhur gjithnjë e në ulje në opinionin publik. Gjatë kësaj periudhe “politika shqiptare më shumë ka prodhuar kriza sesa zgjidhje, kjo për shkak të krizës që vetë politika po kalon për shkak të torturës, pasi i mungojnë dijet autentike për t’u ndeshur në fushën e politikës moderne, mungesë dijesh që i ka vënë sot ata në pozitë të vështirë” (në G.Tushi, 2010,fq 254). Natyrisht, duke e mbështetur në argumentin e studiuesit, ka një mos në përputhje të kapacitetit të duhur politik dhe intelektual për t’u përshtatur me imperativat e kohës. Parlamenti si tempulli i debatit politik si dhe jeta parlamentare mjafton që ne të kuptojmë nga pikëpamja cilësore se nuk është realizuar ndonjë hap cilësor për pritshmëritë e shqiptarëve për të patur një klasë politike me klasin që kërkon politika moderne e kohës.

Performanca e politikës nuk matet me strukturën moshore të klasës politike, por me kontributet e secilit prej këtyre politikanëve, me vendosjen e politikanëve të provuar e me karrierë të suksesshme, me vendosjen e personaliteteve publike dhe që kanë kredibilitet të njohur, siç ndodh dhe në politikën klasike botërore, ku në Parlament apo në Senat dhe në Dhomat e Lordëve shkojnë kjo kategori e individëve.

Futja në politikë e individëve që e fillojnë karrierën politike jo për të progresuar deri në fund, por e fillojnë si fillestarë, natyrisht edhe parlamenti kthehet nga një sallë ku zhvillohet politika profesioniste, në një aulë ku rrallë dëgjohej fjala, logjika dhe argumenti, një sallë ku diskutimet dhe tonet e ashpra të përdorura përmes polemikës politike nuk të thonë asgjë. Në politikën shqiptare ka paradokse të cilat vijnë për shkak të mungesës së kulturës politike të mbushur me improvizime të momentit dhe jashtë standardeve. Një politikë e konceptuar jashtë standardeve dhe parametrave, që vendos në krye të saj, në Parlament apo në strukturat e tjera, njerëz pa kulturën e nevojshme specifike, pa një përvojë jetësore që është shumë e rëndësishme, është një politikë pa produkt dhe jo bashkëkohore.

Në parlament, sipas autorit Tushi (2010), ka deputetë që për nga niveli i diskutimit të japin idenë se kanë kohë që janë shkëputur nga leximi. Niveli mediokër nuk do shumë mund për t'u zbuluar, pasi të mjafton vetëm fakti që në diskutimet e tyre nuk përdorin as termat specifike të fushës për të cilën diskutojnë, por dhe në rastet kur i përdorin bëjnë gabime në përdorimin e tyre. Pra nuk është normale që qytetarët të cilët presin zgjidhje, mendime dhe ide të vlefshme dhe alternative nga e tyre elita politike, të dëgjojnë prej tyre diskutime të nivelit mediokër që janë të përcipta, pa ide dhe synime politike të qarta, koherente dhe të dobishme për shoqërinë.

Klasa politike duhet ta kuptojë se mungesa e kulturës së nevojshme apo pamjaftueshmëria e saj është një çështje thelbësore e saj, pasi duke u bërë pjesë e parlamentit, ku zhvillohen të gjitha betejat politike, në këtë kontekst, nuk mund të shkohet në betejë pa njohuritë dhe kulturën e nevojshme. Në të kundërt, nuk do të jenë në gjendje të bëjnë analizën e nevojshme apo të japin qartësi të një vizioni. Klasa politike duhet të shqetësohet dhe ta kuptojë që mjetet e analizës profesioniste nuk mund

të jenë ordinere dhe joprofesioniste në kuptimin politik dhe sociologjik të tyre, ndaj mungesa e këtyre elementeve ka impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e veprimit politik që ndërmerret.

Niveli i ulët i kulturës, i analizës politike dhe i performancës mediokre nuk kthehen në interpretime të besueshme të realitetit shoqëror, ekonomik dhe social. Kjo është shumë e rëndësishme të kuptohet nga të gjithë ata njerëz që kanë vendosur të merren me politikë.

Nisur nga ky këndvështrim, jo vetëm politika profesioniste por dhe vetë qytetarët duhet të shqetësohen për cilësinë e klasës politike që votojnë, pasi nuk ka dyshim që ka ardhur koha që qytetarët të mos qëndrojnë indiferentë ndaj staturës politike dhe morale të klasës politike. Është e rëndësishme për të diskutuar dhe folur rreth tyre, pasi ata që do të përzgjidhen do të jenë pjesa më elitare e shoqërisë dhe në vazhdim do të jenë elita politike e vendit. A duhet të përmirësohet struktura dhe kualitetet e klasës politike? Patjetër që po. Politika shqiptare, në përgjithësi, në përzgjedhjet që ka bërë ndër vite gjatë tranzicionit, nuk ka treguar apo shfaqur dëshirën për të implementuar në praktikë konceptin e përzgjedhjes së elitës politike parlamentare.

Pavarësisht premtimeve për riqarkullim të elitave politike, “partitë politike në përzgjedhjet e tyre e kanë përzgjedhur klasën politike bazuar mbi parime pragmatiste, duke e menduar se është thjesht një klasë zanatçinjsh duke menduar se do ta mësojnë politikën në praktikë” (në G. Tushi, 2010, fq 334). Mirëpo tani ka ardhur koha që politika profesioniste të largohet nga mentaliteti i përzgjedhjes së elitës politike dhe të orientohet nga parimet elitare dhe meritokratike, që kanë role me përgjegjësi në qeverisjen e vendit. Duhet bërë përpjekje për të përmirësuar elitën politike. Si fillim, partitë politike duhet të braktisin mentalitetin e të konceptuarit ngushtë të klasës

150

politike dhe të vlerësojnë faktin e ndërtimit të një elite politike. Në të vërtetë ka ardhur koha e ndërrimit të kursit që ka patur politika shqiptare, të të paturit një klasë politike dosido, dhe ta ndërtojë një elitë politike të bazuar mbi parimet e teorisë universale moderne, sipas së cilës klasa politike duhet të jetë e përzgjedhur, e seleksionuar, e formuar dhe akademike.

Gjatë tranzicionit në jetën politike shqiptare është vënë re një lloj unifikimi i termave “klasë” dhe “elitë” (G. Tushi, 2010, fq 335) dhe shpesh janë konsideruar e njëjta gjë. Sipas autorit kjo ka sjellë që, për afro dy dekada, në parlamentin shqiptar të ketë edhe individë të huaj (G. Tushi, 2010 po aty) në botën e politikës, me aftësi të kufizuara dhe që nuk janë në gjendje as kulturore, as oratorike që ta meritojnë staturën politike. Një ndër arsytet që politika jonë nuk ka qenë në nivelet e duhura të suksesit politik, ka ardhur si rezultat i vet përzgjedhjeve që politika ka bërë, duke qenë shkaktoare e pasojave negative që kanë çuar në prishjen e ekuilibrave politikë - dhe kjo ka qenë e dukshme jo pak herë gjatë tranzicionit në Shqipëri - gjithashtu, duke ndikuar dhe në deformimin e mekanizmit të përzgjedhjes së deputetëve si pjesë e elitës politike të vendit. Nisur nga parimet e saj shpeshherë tautologjike, politika shqiptare i ka ngatërruar me qëllim termat “klasë politike” dhe “elitë politike”, pasi i ka munguar koncepti dhe veprimi elitar. Përgjithësisht, politika shqiptare është bazuar në parime dhe motive të ngushta subjektive, militanteske dhe reduksioniste në përzgjedhjen e klasës politike. Ky veprim ka sjellë si pasojë cenimin e cilësisë së jetës parlamentare, si dhe një lloj ngadalësie në perceptimin e imperativave politikë, rrugët e shpejta të ndryshimit, deformimin e vlerave politike, që në këto dekada të tranzicionit për shkak të zhvillimeve historike kaotike dhe të dhunshme, ka sjellë një “disproporcion social” gati konfliktual që shfaqet bujshëm në nivelin e një pjese të mirë të klasës

politike dhe që janë ende ekzistuese dhe kanë zënë vend edhe në parlament. Ky është një proces që ka qenë me kosto të mëdha dhe që i duhet dhënë fund, pasi ata që janë me të vërtetë elitarë qëndrojnë në hije të jetës politike dhe sociale të vendit në punët e tyre, ndërsa ata që janë mediokër dhe pa vlera vendosen mekanikisht në parlament apo në klasën politike shqiptare.

Mungesa e një politike të moralshme nga klasa politike është një tjetër tipar që e ka shoqëruar performancën e klasës politike gjatë kësaj periudhe. Një sistem demokratik duhet të ketë themele të forta të një shoqërie demokratike dhe një sistem politik me moral, ndryshe ai bëhet pengesë për zhvillimin e kësaj shoqërie. Fatkeqësisht, gjatë tranzicionit klasa politike shqiptare në jo pak raste është bërë pengesë në këtë proces. Politikanët të cilët drejtojnë partitë politike apo dhe që përfaqësojnë popullin e që nuk i mbajnë premtimet, nuk lejojnë funksionimin e institucioneve të shtetit, rendin pas interesave të tyre personale dhe klanore, janë të korruptuar dhe pa moral, krijojnë modele të “sjelljes politike“ (S. Pëllumbi, 2010, fq 152) që ndikojnë negativisht mbi të gjithë qytetarët dhe mbi të gjithë shoqërinë. Në këtë kontekst ndjesia etike e përkushtimit dhe e sakrificës së qytetarëve është lëkundur, duke marrë formën e indiferentizmit dhe të pragmatizmit hileqar. Mosbesimin ndaj partive politike, përfshirë dhe ndaj “partisë së zemrës “ (në S. Pëllumbi, 2010, po aty), fillon të rritet e të kalojë nga një qëndrim kritik, deri të braktisja dhe kalimi në formë demonstrative në kampin kundërshtar. Ky tipar i performancës së klasës politike shqiptare është evident në të dy kahet e politikës, dhe vjen si pasojë e mosfunksionimit demokratik të partive politike shqiptare, administrimit të tyre në mënyrë autoritare dhe kthimit të partive politike në parti të kryetarit.

Me vendosjen e pluralizmit në Shqipëri u krijuan shumë parti, për të mbushur hapësirat sociale dhe politike është e kuptueshme se shoqëria shqiptare kishte një dëshirë për shpërthimin e lirive të munguara politike dhe ekonomike. Mirëpo krijimi i shumë partive politike, përveçse e kompletoi mjedisin shoqëror shqiptar me ngjyrimet politike të realitetit në vend, kur pritej që sistemi politik të shkonte në zhvillimin e tij të natyrshëm, ndodhi e kundërta, pasi për afër dy dekada klasa politike shqiptare ndoqi rrugën e zhvillimit ekstensiv të partive politike. Ky fenomen i zhvillimit ekstensiv të partive politike të të dy krahëve, të djathtë e të majtë. Sipas autorit sot në mjedisin politik shqiptar ka 120 parti të regjistruara duke filluar nga dy partitë e mëdha PD dhe PS e duke vazhduar me partitë e vogla, të cilat (S. Pëllumbi, 2010, fq 153) në mënyrë figurative i quan parti “autobus”, ”furgon”, ”taksi”, “biçikletë” dhe “parti-këmbësor” që kanë vetëm kryetarin e tyre, dhe nuk prezantojnë asnjë interes publik, por janë rezultat i konflikteve politike brenda secilit krah politik dhe që janë përdorur nga politikanët si mjete për të hurë në jetën politike dhe nuk jën përdorur si attribute të demokracisë, pasi funksionojnë vetëm me kryetarin e tyre.

Parë nga ky këndvështrim i zhvillimit spontan dhe arkaik i pluralizmit politik, si ky që dallohet në mjedisin politik shqiptar, kuptohet se vjen si pasojë e një liberalizmi ekstrem i cili shkon në të kundërt të intensionit fillestar, pasi fregmentarizon përgjegjësinë politike por dhe përçan shoqërinë, duke i lënë vendin amullisë dhe luftës për mbijetesë, duke çuar në një fenomen apo tipar të partive politike që studiuesi e cilëson si “çngjyrosje e partive” (S. Pëllumbi, 2010, 145). Ky term ka të bëjë kryesisht me faktin se shumica e këtyre partive identifikohen me kryetarin e tyre, saqë edhe demokracia e brendshme e tyre lidhet me kryetarin. Duket si një lloj privatizimi që u është bërë partive, duke bërë që partitë politike në Shqipëri, pa përjashtim, të vegjetojnë

mes autoritarizmit dhe demokracisë, mes tipareve të tyre ideologjike dhe dëshirës për t'u bërë parti të hapura elektorale, që mbështeten te publiku dhe që nuk u kushtojnë rëndësi strukturave dhe forumeve të veta.

Në analizën e dy partive të mëdha të spektrit politik shqiptar (në Servet Pëllumbi 2010, fq 155), një aktor i rëndësishëm i jetës politike në vend, në librin e tij Bashkëbisedim për politikën konkludon se, *“pas vitit 1997 u quajt si novacion futja e konceptit parti elektorale, në kuptimin e përshtatjeve të strukturave organizative të partisë me strukturat e administrimit zgjedhor. Kjo u konceptua më tej në praktikë si një parti që mjafton të ketë një program elektoral, madje edhe një program i djathtë qeveritar mund të jetë program edhe për një parti (Nano) të majtë. Filloi kështu, sipas autorit, një fushatë hapjeje për bizneset dhe biznesmenët. U bë instrumental edhe karakterizimi i PS-së si parti biznesi, ku çdo novacion reflektohej në veprimtarinë e përditshme të partisë. Programi bazë i parimeve, mbi të cilat ajo u ngrit dhe u reformua u la mënjanë bashkë me programin social, që është specifik vetëm për PS-në. U përgatit kështu terreni për të ardhur tek adaptimi i “rrugës së tretë” të Toni Blerit, të sintetizuar në parullën , Përtej së majtës dhe së djathtës” (në Pëllumbi. Servet ,2010, fq 155).*

Ndërkohë, sipas autorit, u fut një koncept tjetër partie, ai i partisë që nuk ka nevojë që kryetari të jetë politikan, që partia të përdorë simbole, flamur, dokumente identifikimi partiake, apo mbledhje forumesh dhe organizatash. Nuk u harrua që ndërrimi i konceptit për partinë të shoqërohej dhe me ndryshime statutoire. Me një përjashtim, edhe pse pas gjashtë vjetëve të largimit të ish-kryetarit Nano, anëtarët e PS-së vazhdojnë ta marrin kartën e anëtarësisë me firmën e ish-kryetarit. Vërehet shndërrimi i partive politike nga parti me struktura, simbole, organizim, pra nga parti masive, në

parti elektorale apo gati gati parti të drejtuar nga një grup i ngushtë njerëzish (cadre party).

Në Kongresin e vitit 2005, PS angazhohet në miratimin e një programi ku dallohet qartë programi i një partie të majtë, anëtare e Internacionales Socialiste dhe e Partive Socialiste Europiane dhe që angazhohet për t'iu përmbajtur koncepteve karakteristike për të majtën europiane, të ekonomisë së tregut, të shtetit social dhe atij juridik. Pozicion ky i natyrshëm i PS-së. Ndryshimet statutores që u bënë në këtë Kongres, që në pamje të parë duket se u japin më shumë të drejta anëtarëve të partisë. Në fakt, roli i tyre njëjtësohet me atë të përkrahësit, pasi do të vazhdojnë kandidaturat që vijnë nga “lart”, pa ndonjë konkurrencë tipike për demokracinë e drejtpërdrejtë dhe pa ndonjë etikë më të lartë përfaqësimi. Në të njëjtën kohë, lartohet në mënyrë piramidale “kulti i kryetarëve” të votuar sipas parimit “një anëtar një votë”, por që mënjanon konferencat e partisë dhe, siç thuhet, është lehtësisht i manipulueshëm duke filluar nga listat e atyre që ftohen për të votuar. Sipas autorit, statuti i partisë në praktikë nuk trajtohet si i tillë pra, si baza e veprimtarisë jetësore të partisë sepse: së pari, ndryshojnë në çdo kongres, gjë që ul shkallën e besueshmërisë, dhe së dyti, nuk zbatohen nene kyçe të tij, gjë që bën formale gjithë këtë punë përsosjesh dhe ndryshimesh. Ndaj autori e mbyll diskutimin e me frazën “*Nga vëzhgimet e mia PS rrezikon të kthehet në OJF*” (në S. Pëllumbi, 2001, fq 149).

Një tjetër parti e rëndësishme e jetës politike në vend është dhe PD, partia e dytë më e madhe në vend. Edhe kjo parti, referuar këndvështrimit të autorit, ofron një tjetër lloj çnjosjeje apo “humbje të identitetit politik të saj”. Kjo ka ardhur si rezultat i përdorimit të standardeve të dyfishta, të abuzimit me programin, statutin dhe rreshtimet politike. Krijimi i saj si një parti antikomuniste - në fillimet e saj PD vepronte më

shumë në këtë drejtim, sesa si parti e djathtë, si një forcë që e kishte hapësirën e vet sociale, bazën dhe rregullat e funksionimit. Kjo, sipas autorit, la gjurmë të thella në të ardhmen e saj, pasi PD-ja vazhdonte të quhej një front antikomunist kur figurat kryesore të saj vinin nga radhët e PPSH, madje dhe vetë kryetari i saj. Së dyti, partitë nacionaliste të “platformave historike” që u rikrijuan pas vitit 1992, si Balli Kombëtar dhe Lëvizja e Legalitetit, u përçanë dhe u mënjanuan nga vete ndikimi i PD-së, ku, me përjashtime sporadike, nuk u bënë asnjëherë pjesë e PD-së dhe as aleatë të qëndrueshëm të saj. Së treti, partitë e vogla, rreth 20 të tilla, që pretendonin se ishin të pozicionuara djathtas, po ashtu nuk u panë me interes, madje shumë prej tyre luftoheshin me argumentin se i merrni elektoratin PD-së. Së katërti, të përndjekurit politikë, që fillimisht quheshin pjesë e natyrshme e bazës sociale të PD-së, realisht nuk u mbështetën prej saj për t’u integruar në shoqërinë demokratike. Madje, me trajtimin e diferencuar dhe vënien kundër njëri-tjetrit, PD i përçau dhe i mbajti larg strukturave të pushtetit. Së pesti, fakti se PD-në, si parti e së djathtës shqiptare, e mjegulloi më tej rruga e gabuar që filloi të ndiqte për krijimin e bazës së vet sociale. Ish-pronarët i mbajti me premtime që nuk mbaheshin, për kthimin e pronave, ndërsa shtresat që po rrënoheshin nga reformat e ekonomisë së tregut, për t’i bërë bazë të vetën i futi në qorrsohak. Së fundi, duke abuzuar me lëvizjen e lirë PD lejoi pushtimin e pronave të të tjerëve, sidomos në periferi të qyteteve, për të vendosur të ardhur të shumtë që mendohej se ishin përkrahës të liderit të PD-së. Kjo, sipas autorit, iu kthye në bumerang. Sipas një analize të tij të fundit, PD u kthye në një parti të mashtrimit e manipulimit social, sepse për hir të krijimit të bazës së vet sociale ajo nuk u ndal as para krijimit të konflikteve artificiale, ndarjeve jug-veri, duke e cilësuar veriun si bastion të PD-së.

Kjo, sipas autorit, është një tjetër çngjyrosje dhe për këtë citon një nga figurat e njohura të PD-së, Aleksandër Biberajn “Qytetari, demokrati, intelektual nuk mund të pajtohet me këtë situatë, ndaj si alternativë të vetme shoh riformatimin e së djathtës së vërtetë, me njerëz të rinj e të panjollësor”(në S.Pëllumbi, 2001,fq 150).

Në Indeksin e Demokracisë për vitin 2010, në *ëikipedia* u renditën 167 vende të botës sipas situatës në të cilën ndodhej zbatimi i demokracisë. Masa e zbatimit të demokracisë, sipas autorit, u mbështet në pikëpamjen se nuk janë vetëm liritë politike dhe qytetare ato që përcaktojnë ”masën” (në B. Gjongecaj, 2013, fq 229) e demokracisë së një vendi. Këto janë liri esenciale, por jo gjithçka, dhe aq më tepër të shoqëruara me dimensionet e pjesëmarrjes politike, të kulturës politike dhe, veçanërisht, me mënyrën se si qeveriset një vend. Këto liri esenciale nuk të japin të kuptosh se sa substanciale është demokracia e këtij vendi, por se në çfarë cilësie është e shprehur ajo. Indeksi i Demokracisë së çdo vendi përcaktohet mbi bazën e pesë kriterëve: procesi elektoral, liritë civile, qeverisja, pjesëmarrja politike dhe kultura politike, të cilat janë në varësi reciproke njëra me tjetrën dhe që formojnë një korpus logjik, në kuptimin se, zbehja, cenimi apo mungesa e një dimensionit sjell rënien dhe dobësimin, ashtu sikundër forcimi i një prej dimensioneve, cili do qoftë ai, do të çonte në një nivel më të lartë të demokracisë si e tërë, si një sistem”.

Sipas autorit, Shqipëria nuk u klasifikua as si një vend me demokraci të plotë, as si një vend me demokraci të paplotësuar, por si një regjim hibrid – pra, si një regjim ku bashkëjetojnë elementë të pakallur të ish-regjimit komunist dhe elementë të fituar në periudhën e tranzicionit të pambarimtë.

Fqinjët tanë, si Mali i Zi, Serbia, Maqedonia nuk klasifikohen si regjime hibride, por si demokraci të paplotësuar, çka do të thotë demokraci më afër atyre përfundimtare. Kjo e

ul dhe më tepër performancën e klasës politike shqiptare jo vetëm në opinion publik ndërkombëtar, por dhe në atë vendas, të cilët ndihen të zhgënjyer nga kjo klasë politike që asnjëherë nuk e qeverisi këtë vend dhe këta qytetarë me ndjenjën e përgjegjësisë dhe të detyrës së një klase politike në shërbim të qytetarëve të vet.

Një tjetër fenomen që po e gërryen gjithnjë e më shumë shoqërinë shqiptare është dhe korrupsioni, i cili e lodh dhe e thyen shtetin. Korrupsioni, në rastin shqiptar, është bërë *“pjesë organike e shtetit, forma përmes të cilit ekziston vetë shteti”*. (në B. Gjongecaj, 2013, fq 241) Korrupsioni gjatë këtyre dy dekadave të tranzicionit e ka vënë shpeshherë në rrezik dhe vetë ekzistencën e shtetit, por sado të rënda dhe gjithëpërfshirëse të duken apo të jenë këto kriza, në çastin që ato zgjidhen, nuk sjellin gjë tjetër përveçse konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë e të jetës së qytetarëve.

Gjatë periudhës së tranzicionit shteti shqiptar ka treguar në jo pak raste se si korrupsioni ka vënë në diskutim ekzistencën e shtetit. I *“dalë nga shtrati i tij i natyrshëm , pra nga shtrati i një shteti normal, korrupsioni ka pushtuar shtetin shqiptar në çdo nivel të tij”* B. Gjongecaj, 2013, po aty). Si pasojë e këtij fenomeni shteti shqiptar sot gjendet përballë një dyshimi të thellë që po gërryen dhe tret te shoqëria shqiptare vetveten, vullnetin shtetformues të qytetarëve nga njëra anë dhe korrupsionin që e ka pushtuar, nga ana e tjetër. Këto dy fenomene janë në një luftë të përhershme me njëra-tjetrën. Korrupsioni zbeh te qytetari vullnetin e tij për të patur një shtet të fortë, shkatërron vullnetin për të qenë të barabartë para ligjit, si dhe ul përpjekjet e qytetarëve për t’u përpjekur për të sakrifikuar një pjesë të interesit personal, për të patur një shtet demokratik.

Performanca të ulët të klasës politike shqiptare të dy dekadave të fundit, ka bërë të mundur lindjen e mendimit se çdo kontribut i qytetarëve të këtij vendi në taksa,

tatime, siguracione apo dhe çdo gjë tjetër shkon në xhepat e pushtetarëve. Ky mendim ka demoralizuar interesin e tyre për të reaguar, për të patur përpjekje për përmirësimin e institucioneve apo për të denoncuar shkeljet e ligjit. Këto ndërmarrje qytetare perceptohen nga qytetarët shqiptarë si një përpjekje e kotë apo dhe harxhim energjish që nuk e forcojnë shtetin, që nuk prodhojnë zhvillim por vetëm hakmarrje të tillë që po u gjende në përballje me të rrezikon kokën, dhe këtë shoqëria shqiptare e ka provuar në jo pak raste. Ky dualizëm mes shtetformimit dhe korrupsionit, e ka demoralizuar qytetarin shqiptar dhe po e ftoh atë me shtetin e tij.

Vullneti i shoqërisë shqiptare për shtetformim i shtypur nga pesha e korrupsionit, duke mos e lënë shtetin dhe shoqërinë të ecë përpara, është shndërruar në një pengesë serioze në procesin e demokratizimit të vendit, duke përçarë dhe një mesazh negativ të shoqëria, nëse nuk je i përfshirë në korrupsion, nuk mund të mbijetosh. Ky është një shpërblim mjaft i hidhur që klasa politike shqiptare u ka dhënë qytetarëve të vet në dy dekadat e fundit, njëkohësisht edhe shërbimi më negativ që klasa politike shqiptare u ka dhënë qytetarëve dhe vendit të tyre. Në vend që ata të përpiqen ta forcojnë e ta çojnë më tej këtë dëshirë të shqiptarëve për shtetformimin e tyre demokratik, e kanë zëvendësuar atë me mënyra dhe kombinacione të stilit korruptiv të jetesës. Përpjekjet për ndërtimin e shtetit dhe të institucioneve demokratike në vend janë zëvendësuar me një lloj "lufte të ftohtë, me kamera, video dhe regjistrime të ndryshme" (në B. Gjongecaj, 2013, fq 243).

4.7 Prurjet e reja në politike, përpjekje për ta ridimensionuar elitën politike

Komiteti i Orientimit të Politikave, ishte përpjekja e liderit demokrat Berisha për të zgjeruar Partisë Demokratike me një rreth më të gjerë të intelektualëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme, me anëtarë të botës akademike dhe shoqërisë civile.

Qëllimi i kësaj hapjeje të PD-së ndaj intelektualëve dhe shoqërisë civile, ishte përgatitja e saj për të ardhur në pushtet dhe afirmimi i këtyre individëve me vlera do të ishte një kredo e lartë për të. Funksionet e këtyre intelektualëve ishin nga më të ndryshmet. Objektivi i ngritjes së këtij forumi sipas liderit demokrat ishte hartimi i programit dhe i politikave të PD-së në të gjitha fushat e veprimit të qeverisjes së ardhshme të PD-së, ku anëtarët e këtij forumi ishin të lirë të jepnin mendimet dhe sugjerimet e tyre për të gjitha çështjet që shqetësonin shoqërinë dhe vendin, si dhe do të orientonte PD-në në qëndrimet që ajo duhej të mbante në lidhje me këto politika. Komiteti i Orientimit të Politikave të PD-së i vitit 2005, në vetvete, ishte një përpjekje për të ridimensionuar jo vetëm politikën, por edhe afrimin drejt politikës të intelektualëve që ishin shkolluar në Perëndim. *Por çfarë ndodhi me objektivat e KOP-it?*

Në një artikull të Eljona Ballhysës në “Gazetën Shqiptare”, autorja analizon rezultatet e KOP-it i cili, sipas saj, ka shërbyer si “trampolinë” (E. Ballhysa, 2008) për zhvillimin e karrierës profesionale dhe politike të shumicës së anëtarëve të këtij komiteti. Pavarësisht faktit se anëtarët e këtij komiteti ishin intelektualë të trajnuar, kishin studiuar e punuar në vende dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare, pas fitores së korrikut 2005 KOP-i ndaloi së funksionuari, dhe anëtarët e këtij komiteti u katapultuan në politikë

dhe vazhduan karrierën e tyre në poste të larta shtetërore, institucione dhe në qeveri, por edhe në fushën e biznesit.

Pra KOP-i me sa duket më shumë është përdorur si një mjet për të katapultuar në politikë këta individë, sesa për të orientuar zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse të PD-së.

Ndërsa krejt ndryshe është rrjedhshmëria në PS. Sipas studiueses Luljeta Progni, paraqitet një tjetër përpjekje për të qarkulluar elitën e saj në rrjedhën e saj jetësore.

Niveli në rënie i elitave politike ka bërë që sot Partia Demokratike të udhëhiqet, përveç Berishës, nga njerëz që deri pak kohë më parë s'kanë patur histori të përbashkët me këtë parti.

Në prag të fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, Partia Demokratike krijoi Komitetin e Orientimit të Politikave. U thirrën ekspertë të fushave të ndryshme për të krijuar një imazh të ri për PD, në prag të këtyre zgjedhjeve. Pak prej anëtarëve të KOP-it fituan mandatin e deputetit dhe aktualisht janë në Kuvend.

Në qeverinë Berisha zunë vënd edhe disa anëtarë të KOP, por kjo nuk pati ndonjë rezultat të dukshëm. Duket qartë se misioni i KOP në PD mbaroi pikërisht me fitoren e zgjedhjeve të tre korrikut 2005.

PD humbi zgjedhjet lokale dhe u shfaq menjëherë nevoja emergjente për ndryshime thelbësore në PD dhe qeveri. Në PD vazhdojnë të vendosin ata drejtues që mbajnë peng demokratizimin e kësaj partie, dhe për pasojë lejojnë shumë pak, depertimin e potencialve intelektuale brenda saj, duke e lënë situatën në vend-numëro. Ata që pretendojnë të zënë vëndet kyçe në drejtimin e PD-së, nuk përfaqsojnë as vlerat e kësaj partie, as historinë e saj.

4. 8 Funksionimi i partive politike, si bashkudhëtare të formimit të elitës politike dhe shtetit demokratik

Dekretimi i ligjit për pluralizmin dhe krijimin e partive të tjera politike në 1990-n, krijoi kushtet për lindjen dhe funksionimin e një sistemi partiak konkurrues dhe institucional. Pavarësisht faktit se partitë e krijuara në vitet 1990 nuk kishin përvojën e duhur për organizimin dhe funksionimin e tyre, ato ia arritën të hartojnë programet dhe dokumentet e tyre themeluese, të bazuara mbi konceptet liberale. Gjatë viteve 1991-1992, sipas autorëve (Kransiqi, Hackaj, 2014), në partitë politike shqiptare bashkëjetojnë konceptet moderne të politikës dhe të organizimit partiak me konceptet e traditës vendore, të imponuara nga mentaliteti, trashëgimia dhe rrethanat lokale. Përgjatë viteve 1992-1998 kemi një rritje të numrit të partive politike, ku nga dy pati kryesore në 1990-n në vitin 1996 kemi 65 parti politike, prej të cilave 12 patën përfaqësim në parlamentin e kohës (në A. Krasniqi, 2006).

Kjo rritje e numrit të partive sipas autorëve ka ardhur si pasojë e problematikave dhe i konflikteve të brendshme në partitë politike, duke çuar në fraksionime dhe krijimin e partive të reja në të dy krahët e politikës. Funksionimi i partive politike është i sanksionuar me Kushtetutë. Po si ka evoluar demokracia partiake në partitë politike pas viteve '90? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje do t'i referohemi analizës së kryer nga studiuesit (në A. Krasniqi, A. Hackaj 2014, fq 43) për tri partitë politike PD, PS, LSI të përzgjedhura për studim. Tipari kryesor i tyre është shkarja graduale drejt modelit të partisë-lider, dhe të adaptimit të mekanizmave të funksionimit dhe të strukturave të brendshme, karakteristike për një parti elektorale. Kjo ka bërë që partitë dhe strukturat e tyre të mobilizohen vetëm në prag fushatash elektorale, të përgjithshme dhe ato vendore. Nga studimi rezulton se partitë politike, përfshirë edhe ato dy kryesoret PD

dhe PS, morën të gatshëm statute të partive simotra europiane dhe i adaptuan ato në realitetin shqiptar, duke premtuar një model partiak modern dhe të ndryshëm nga pritshmëritë dhe kultura minimale politike në vend. Gjatë ecurisë së punës së tyre, partitë u ndodhën në situata kur zgjidhja statutore nuk përputhej me interesin politik ditor. Për pasojë, krijuan praktika ad-hoc të reja për trajtimin e konflikteve, element i cili bëri që partitë politike shqiptare të devijonin ndjeshëm nga modelet perëndimore, dhe gati të njëjta me ato të përdorura gjatë periudhës së partisë-shtet, duke bërë përjashtime, diskriminime, heqje nga listat elektorale të kandidatëve apo edhe denigrim të figurave kritike, duke e bazuar mendimin ndryshe si qëndrim armiqësor politik. Të tilla situata kanë reflektuar partitë kryesore, si PS-ja dhe PD-ja, në periudha të ndryshme të ecurisë së tyre politike gjatë tranzicionit.

Në fund të dekadës së parë të tranzicionit, pas mbajtjes së kuvendeve kombëtare të partive politike PS dhe PD, si dy partitë më me influencë në jetën politike shqiptare, edhe partitë e tjera filluan të kujdesen për përmirësimin e imazhit publik, duke reformuar statutet dhe programet e tyre, duke iu lënë hapësirë më të madhe procedurave transparente dhe hapësirë më të madhe kritike për publikun. Në këtë fazë merr hov përpjekja e partive për të zëvendësuar aktivitetet e mbyllura partiake me konferenca, deklarime publike dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejta në debatet politike. Në këtë periudhë në dy partitë kryesore merr hov gara politike. Në PS figura të pushtetshme politike dhe ekzekutive humbin në garë përballë ish-kryetarit të partisë, ndërsa në PD pati dorëheqje të çastit të fundit për shkak të klimës së ashpër të krijuar. Në këtë fazë PS arriti ta evitojë fraksionimin, duke integruar pjesë të palët humbëse me shumicën fituese, ndërsa në PD ndarja u bë dhe më e thellë dhe u kristalizua me përjashtimin e disa deputetëve, të gjithë zyrtarisht të pafajshëm pasi nuk kishin shkelur apo cenuar

asnjë normë disiplinore apo statutore. Kjo ndarje në gjirin e PD-së rezultoi me krijimin e një partie tjetër, Partia Demokratike e Reformuar, ndërsa në PS kjo ndarje do të ndodhte në 2004-n, me krijimin e Lëvizjes Socialiste për Integrim.

E përbashkëta e të dyja forcave politike dhe e lidërshipt të tyre, është se ato nuk arritën të mësojnë nga gabimet e së shkuarës dhe, për shkak të mostrajtimit me efikasitet të konflikteve dhe gabimeve të së kaluarës, u penalizuan në zgjedhjet e para parlamentare me të cilat do të përballeshin: PD në 2001-shin dhe PS në vitin 2005.

Gjatë dekadës së dytë të tranzicionit, përveç zhvillimeve “plurivalente” (në Krasniqi, Hackaj, 2014, fq 44) në sjelljen politike të lidërshipt partiak, vërehen elemente pozitive, sesi partitë politike hoqën dorë nga programe ideologjike të skajshme dhe arritën kompromise të rëndësishme politike - vlen të theksohet zgjedhja e presidentit konsensual, si dhe vendimet për disa reforma të rëndësishme - dhe se si mundësuan në krijimin e elitave të reja politike brenda secilës palë politike. Ndryshimi i pjesshëm i elitave dhe i ekipeve drejtuese u pasua dhe me fenomenin e dobësimit të pushtetit të anëtarësisë dhe të rritjes së ndikimit të institucioneve partiake, pra të grupeve parlamentare, kryesive të partive apo edhe të sekretariateve.

Parë nga këndvështrimi i traditës organizative të partive politike dhe nga profili i liderëve të tyre politikë, mund të themi se evolucioni i tyre reflekton profilin e liderit të tyre dhe më pak atë të grupeve drejtuese, si grupi parlamentar, sekretariatet apo këshillat kombëtarë të çdo partie.

Nisur nga kjo pikëpamje, një analizë e funksionimit të traditës organizative të dy partive kryesore politike në vend sipas (në Krasniqi, Hackaj, 2014, po aty) sqaron se PS ka patur një traditë më të mirë të praktikave dhe përpjekjeve organizative të brendshme,

bazuar mbi bazën e dokumenteve dhe normave zyrtare. Ka patur ndryshime të herëpashershme të statutit në vitet 1996, 1997, 1999, 2003, 2004, 2005 dhe 2009, ku ndryshime kanë prekur strukturën e përgjithshme, organizimin e brendshëm, format e zgjedhjes së strukturave dhe procesin ankimues. Kjo ka ardhur si pasojë e mentalitetit dhe trashëgimisë që PS pati në drejtim të referimit të dokumenteve dhe të arkivimit të dokumentacionit, traditë që në PD nuk gjendet, element ky që bën dhe ndryshimin mes këtyre dy forcave politike në drejtim të modelit organizativ.

Në dallim nga PD, demokracia e brendshme ka qenë më funksionale në PS, sidomos pas viteve 1996-1997. Pas kësaj periudhe, ishin anëtarët e PS-së që krijuan një traditë demokratike të brishtë, e cila kulmin e saj e pati me mbledhjen e KPD-së, ku u bënë publike mbledhjet e kryesisë, dhe ku grupi parlamentar pati një rol më të madh në vendimet partiake, ndërsa nëngrupet politike arritën të konkurronin për postet më të larta drejtuese në PS.

Sipas autorëve, në PD zhvillimet e mësipërme nuk vërehen që nga viti 1997, pasi kjo parti krijoi dhe i qëndroi besnike formës së mirënjohur minimaliste klasike të organizimit partiak, duke u bazuar në prezantimin e një programi bazik, ku janë të përfshirë edhe programi politik dhe organizativ i saj. Edhe kjo parti ka bërë ndryshime në rrjedhën jetësore të saj, duke bërë modifikime në kongreset kombëtare të viteve 1993, 1995, 1997, 1999, 2005, 2009 dhe ku ndryshimet konsistojnë në fokusimin dhe përcaktimin e elementeve thelbësore të funksionimit të demokracisë së brendshme.

Një profil krejt tjetër paraqet partia LSI, si një parti e re dhe në konsolidim e sipër, duke iu referuar konceptit të funksionimit të partisë me një histori “unike” (Krasniqi&Hackaj, 2014) pas 2009-s ku pas debatit për kalimin e saj nga e majta në të djathtë, një pjesë kritike e ekipit drejtues të LSI-së u mënjanua apo u përjashtua. Ky

është dhe rasti i vetëm i debatit mbi standardet e demokracisë së brendshme në këtë parti, pasi kjo reflekton dhe pamundësinë e kësaj partie për të zgjidhur debatin brenda rregullave statutore, të cilat parashikojnë dhe vënë në dispozicion principet dhe instrumentet ligjore demokratike, sikurse janë votimi konkurrues apo dhe respektimi i pakicës. Sipas autorëve, në profilin e saj LSI është identifikuar si parti e krijuar nga ish-kryeministri Meta. Në këtë këndvështrim elementet e demokracisë së brendshme të anëtarëve në raport me themeluesin shihen si të tepërta dhe formale, nganjëherë dhe jo të nevojshme.

Profili i saj deri më tani del si një parti e “personalizuar” nga kryetari i saj, pra modeli i partisë-lider. Është parti relativisht e vogël, kështu që dhe nivelet hierarkike janë më të pakta. Modeli i funksionimit të këtyre partive kufizohet nga përfaqësimi i pjesshëm parlamentar, me bashkim me një nga partitë e mëdha për të arritur në qeverisje - rastet e 2008-s dhe 2014-s. Ky model jep rezultate në një optikë afatshkurtër, pasi nuk ofron garanci për të ardhmen, për shkak se suksesi i partisë njësohet me aftësinë e individit drejtues për të negociuar maksimalisht gjatë ndarjes së pushtetit.

Funksionimi i demokracisë partiake është një mundësi shumë e mirë për të kryer shkëmbimin e elitave politike, pasi mundëson mbi bazën e analizës së demokracisë së brendshme partiake, për t’i dhënë rëndësi përcaktimit të instrumenteve të termave kryesorë të referencës, të cilat janë të nevojshme për të kryer identifikimin e instrumenteve praktike të demokracisë së brendshme.

Në dallim nga partitë europiane, ndryshimi në partitë shqiptare gjendet në detajet e përkufizimeve, në rëndësinë që u jepen instrumenteve të veçanta gjatë zbatimit të tyre, në garancitë e zbatimit, si dhe në ekzistencën e mekanizmave plotësues të zgjerimit apo kufizimit të ushtrimit eficient të demokracisë së brendshme.

Një tipar shumë të rëndësishëm që partitë politike paraqesin është të paturit e një lider të “fortë”(në Krasniqi&Hackaj, 2014) që del mbi institucionet partiake, duke penguar kështu një proces shumë të rëndësishëm që mundëson qarkullimin apo ndryshimin e elitës politike. Për shembull, kryetarit aktual të PS-së i ka mbaruar mandati si kryetar prej dy vjetësh dhe PS ende nuk i ka mbajtur zgjedhjet për kryetarin e ri, me argumentin se, kur fitohen zgjedhjet nuk është e nevojshme të rikonfirmohesh. Vlen të theksohet se asnjë zë në gjirin e PS-së nuk është ngritur për moszbatimin e statutit të partisë, çka tregon tiparin e një elite të varur nga kryetari i partisë. Ndërsa PD-ja, pas humbjes së 2013-s dhe zgjedhjes së kryetarit të ri demokrat, gati për një vit ka funksionuar pa zgjedhur strukturat e tjera të përcaktuara në statut, me argumentin e fokusimit në punën e qeverisë së re dhe të kritikës ndaj keqqeverisjes së tyre. Po i njëjti fenomen vërehet dhe në LSI - pra, një anashkalim i strukturave partiake.

Referuar listave të kandidatëve të zgjedhjeve të fundit politike, është i dukshëm fakti se kryetarët e partive politike kanë përfshirë në listat e kandidatëve emra të rinj pa karrierë të provuar në parti dhe strukturat e tyre. Është i dukshëm fakti se kryetarët e partive politike kanë futur në listat e kandidatëve emra të pakonsultuar me strukturat, apo që të jenë produkt i një votimi. Edhe në rastet kur është mbledhur Këshilli Kombëtar, ka qenë formal.

Tendenca e identifikimit të partisë politike me liderin e saj nuk është e panjohur në mjedisin e klasës politike shqiptare. Zëvendësimi i strukturave të zgjedhura, qofshin këto qendrore apo lokale, me struktura që i qëndrojnë afër liderit partiak të emëruar prej tij, ul efikasitetin dhe rëndësinë e strukturave partiake të përcaktuara me statut, dhe rrit peshën e grupit parlamentar, duke krijuar një lloj tendence të re në gjirin e mjedisit

politik, të përparimit apo ndryshimit të partive politike – pra, nga parti të veprimit me aktivitet në bazë, në parti me aktivitet më shumë mediatik.

Marrja e vendimeve në nivelet e larta të partive politike na ndihmon të kuptojmë ndryshimin që po ndodh në partitë politike shqiptare në lidhje me format e organizimit dhe ligjërimin politik të liderëve politikë. Parë nga ky këndvështrim mund të themi se qasja që po dominon dhe vihet re është koncepti i partisë elektorale që aktivizohet kryesisht në prag zgjedhjesh, dhe jo koncepti i partisë si një strukturë e organizimit demokratik. Ky fenomen që po karakterizon partitë politike shqiptare bie ndesh me statutet e tyre, sipas (Krasniqi&Hackaj 2014, fq 129) bie ndesh me statutet e partive politike shqiptare. Kjo formë e funksionimit të partive politike shqiptare, duke qenë e paligjëruar, përbën një devijim nga parimet politike të demokracisë së brendshme dhe funksionimit demokratik të partive kryesore politike shqiptare.

Zbehja e proceseve të ekzistencës dhe funksionimit të strukturave të brendshme dhe statutore të partive politike, mënjanimi i debatit, përqendrimi i kompetencave në rast të ndarjes së pushtetit që ushtron partia në parlament, janë tregues i shkarjes së partive politike nga një stad i ndërmjetëm drejt një partie elektorale. Kjo ka çuar në një rënie të interesit idealist të anëtarëve të partisë dhe të angazhimit apo të motivimit të tyre partiak, si dhe rritjes së modelit të kontratës së përkohshme të partive politike me elektoratin e tyre. Si pasojë e këtij fenomeni, partitë në prag të fushatave elektorale rritin intensitetin e organizimit të strukturave, të debatit për ndarjen e pushtetit dhe të administrimit të humbjes.

Largimi nga modeli i partive tradicionale si “parti të bazës” (në Krasniqi, Hackaj, 2014, fq 128) dhe kalimi në parti e programua vetëm për fushata elektorale dhe qeverisje, ka sjellë si pasojë lënien mënjane të përgjegjësisë së partive politike si organizata të

168

krijuara për të përfaqësuar grupe të caktuara sociale dhe një ngarkesë të caktuar ideologjike. Ky fenomen i largimit të partive politike nga modeli tradicional dhe rendja drejt një politike pragmatiste, duke kërkuar votat nga çdo votues i mundshëm, si dhe dhënia prioritet mbledhjes së votave nga ligji i ri elektoral ka bërë që partitë politike të shndërrohen nga origjina e tyre e masave në parti larg identiteteve ideologjike, ndërsa partitë e vogla politike të shndërrohen në parti lokale dhe etnike.

Ky model klientelist i ndjekur nga partitë politike shqiptare ka sjellë si pasojë dy fenomene me të cilat po përballlet sot mjedisi politik dhe shoqëror shqiptar. Së pari në periudhën afatshkurtër partitë bëhen popullore dhe më elektorale, duke u shoqëruar nga tendenca e partive të vogla për t'i mbijetuar sistemit politik me anë të politikës klienteliste, krahinore e fetare; ndërsa, nga ana tjetër, e shoqëruar me rritje të autoritetit të liderit politik. Së dyti, partitë e treta politike identifikohen gjithnjë e më shumë me liderin politik dhe të klientelës së tij politike dhe ekonomike mbështetëse, duke u kushtuar gjithnjë e më pak rëndësi parimeve dhe normave të demokracisë së brendshme të partive.

Të tilla modele të partive politike klienteliste ka kohë që ekzistojnë në mjedisin politik shqiptar, duke u pranuar dhe mbështetur dhe nga partitë e mëdha. Në analizë të këtij fenomeni, sipas studiuesve (Krasniqi, Hackaj, 2014, po aty), si pasojë e reformave të imponuara nga jashtë dhe luftës ndaj korrupsionit, modeli klientelist abuzues do të ndeshet me kundërshti institucionale dhe publike, duke mbetur një fenomen tranzicioni i përkohshëm. Ndërsa modeli tjetër i shndërrimit të partive politike në përfaqësi klienteliste pozitive, pra në mbështetje dhe në identifikimin e grupeve të vogla sociale, krahinore dhe ekonomike, parashikohet të jetë më jetëgjatë dhe të shërbejë si një fazë

tranzicioni nga një model aktual klientelist negativ, në modelin e partive politike moderne.

Në shoqëri tradicionalisht të mbyllur siç është shoqëria shqiptare, modeli klientelist gjen përputhje lidhur dhe me vetë cilësitë që paraqet organizimi fisnor, krahinor si dhe me elemente të tjera të organizimit para-demokratik. I gjithë ky proces që ka shoqëruar partitë politike dhe shoqërinë shqiptare të tranzicionit, vjen dhe është në kundërshtim me nevojën që partitë politike kanë për të përfaqësuar dhe identifikuar qartë programin e tyre social dhe të përfaqësimit, në mënyrë që të nxjerrin në pah diferencat në qëndrimet dhe premtimet e tyre, për hartimin e politikave korrigjuese si dhe të reformojnë vendimet e gabuara të pushtetit të palës tjetër. Në këtë mënyrë dhe elektorati do të kishte mundësinë e votimit të alternativës dhe vizionit më të mirë qeverisës, element që në gjithë këto vite i ka munguar politikës shqiptare dhe qytetarëve shqiptarë. Funksionimi i partive politike është tipari thelbësor i jetës politike shqiptare, pasi janë pikë risht partitë politike ato që qarkullojnë elitën politike.

Parë nga këndvështrimi i të ardhmes së demokracisë në partitë politike shqiptare, sipas autorëve, një element të cilit i duhet kushtuar vëmendje është dhe zëvendësimi i votuesve demografikë tradicionalë. Sipas këndvështrimit (A. Kraniqit, A.Hackaj, 2014) të gjithë votuesit nën moshën 24 vjeç kanë lindur në demokraci dhe pas 10 apo 15 vjetësh votuesit më të vjetër do të kenë kaluar gjysmën e jetës në demokraci dhe gjysmën në diktaturë, për rrjedhojë, ndryshimi i brezave pritet të ndryshojë dhe perceptimet dhe prirjet qytetare ndaj politikës dhe partive politike në zgjedhjen e ofertave politike. Sa më shumë të ndryshohen brezat dhe të rriten standardet, sa më shumë të forcohet kultura demokratike e shoqërisë shqiptare dhe të dominojë logjika e

jetës institucionale dhe e shtetit të së drejtës, aq më pak hapësirë do të ketë për partitë politike me organizim të brendshëm jo-optimal dhe jo demokratik për të mbijetuar. Partitë do të jenë të detyruara të rishikojnë sjelljet dhe ofertat e tyre dhe të krijojnë një kontratë të re besimi me qytetarët, po kështu edhe me anëtarët e tyre. Ndryshimi në sjelljen politike vjen kur ndryshon edhe logjika e brezave, pasi brezi i cili ë shtë rritur dhe edukuar pas vendosjes së demokracisë në Shqipëri rinatyrisht e ka më të lehtë të pranojë dhe të përshatet me parimet dhe me metodat demokratike dhe liberale . Kjo, sipas autorëve është e pranuar edhe nga vetë partitë politike.

Për të përmirësuar klimën e mjedisit politik nevojitet, së pari, përmirësimi i demokracisë së vetë partive politike si organizata. Kjo pikëpamje kërkon identifikimin, adaptimin dhe sanksionimin e rregullave të reja në procesin e vendimmarrjes dhe funksionimit të tyre. Partitë duhet të jenë më të hapura dhe transparente, të krijojnë hapësira ku çdo individ i interesuar të mund të verifikojë normat e funksionimit dhe të shprehë hapur mendimin e tij.

Analizë e argumentave formësimit të elisë politike

Analiza faktoriale si metoda që përdoret për të shpjeguar faktorin ndër variablat e ndryshëm, pra shërben për të identifikuar faktorin që ka ndikuar në formatizimin e karakterit të klasës politike shqiptare të tranzicionit, duke analizuar disa aspekte të klasës politike.

Duke qënë se tranzicioni ka si karakteristikë, bashkëjetesën e elementëve të dy gjëndjeve pasi është faza kalimtare nga një gjëndje në tjetrën, atëherë është analizuar bashkëjetesa e dy tipareve , të tipareve të vjetra të ish regjimit komunist, si mentaliteti, trashëgimia politike, institucionale dhe social- kulturore dhe atyre të reja që janë

demokratike, që u formuan në karakterin e klasës politike shqiptare gjatë tranzicionit, si nevoja për garancinë e ndërkombëtarëve në çdo marrëveshje apo kompromis politik të bërë mes palëve politike, shenjë kjo e mungesës së besimit reciprok tek palët politike.

Mënyra vetiake e sjelljes politike së elitës politike në ushtrimin e pushtetit, si tipar i rëndësishëm i sjelljes politike të klasës politike vërehet në mosfunksionimin e institucioneve të administratës, dhe të organeve të pavarura, gjë që ka çuar në përplasje të vazhdueshme mes qeverive dhe institucioneve.

Mënyra e sjelljes politike agresive e shoqëruar me konflikte të brëndëshme, në një klasë politike gjithmonë të udhëhequr nga vullneti i liderit duke e dominuar grupin pra, i ka shndërruar partitë politike në formacione politike të udhëhequra e të drejtuara nga individë apo elementë të cilët kanë mbajtur të gjallë në mjedisin politik autoritarizmin në ushtrimin e pushtetit.

Paaftësia për të zhvilluar zgjedhje të lira, të bazuara mbi rrafsh institucional e ligjor në mënyrë që të zhvillohet një garë konkuruese, e jo një luftë politike në mjedisin politik, ka prodhuar pothuajse gjithmonë fitues të zhurmshëm. Si rezultat i këtij faktori klasa politike, e ka përdorur gjithmonë pushtetin si mjet revanshi ndaj kundërshtarit politik, duke ulur nivelin e arsyetimit politik.

Pikëpamja e një tranzicioni të zgjatur, nga analiza e studimeve të kryera rezulton se, ka qënë një mënyrë e zgjedhur nga elita politike postkomuniste, dhe që i ka shërbyer kësaj elite për të qeverisur sa më gjatë, duke e përdorur si justifikim ose për të zgjatur qeverisjen ose për të ardhur në pushtet. Pavarësisht këtyre sjelljeve Shqipëria ka bërë hapa përpara në rrugën e transformimeve demokratike, dhe pavarësisht faktit që mbetet ende larg sistemit të demokracisë liberale që kërkon të ndërtojë. Konsolidimi

demokratik presupozon jo vetëm kalimin e fazës së tranzicionit por dhe ekzistencën e konsolidimit të elementëve apo të kushteve, që janë ndërvepruese me njëra tjetrën në një shoqëri demokratike të konsoliduar dhe që shprehen në funksionimin e shoqërisë civile, shoqërisë politike, shtetit ligjor, burokracinë shtetërore që mbështetet dhe nuk e pengon procesin demokratik, shoqëria ekonomike.

Në referim të standardeve të demokracisë , padyshim që ato janë të rëndësishme , por jo aq sa të përcaktojnë ose të jenë parakusht për të përcaktuar nëse një vend është në tranzicion, dhe në rastin konkret Shqipëria. Sipas analizave ky argument është përdorur për ato vende të cilat kanë sisteme jo demokratike, por nuk kanë qënë sistem konunist si Shqipëria, dhe ky lloj argumenti është përdorur për të shpjeguar se, mes demokracisë dhe të kundërtave të saj, ekziston një gjëndje e ndërmjetme. Por në rastin konkret sipas studimeve kryera rezulton i gabuar, pasi tranzicionet postkomuniste kanë si qëllim ndërtimin e një sistemi demokratik, dhe jo atë të një gjëndje të ndërmjetme mes sistemit komunist dhe atij demokratik, por jo domosdo një demokracie konsoliduar. Nga pikëpamja që e lidh me shkallën e lirive demokratike në Shqipëri mund të thuhet se tranzicioni është i kapërcyer por nga studimet rezulton se, ka një kontraditë logjike, pasi edhe pse shkallët e lirive demokratike nuk rezultojnë njëlloj të zhvilluara dhe të mbrojtura si në sistem demokratik të konsoliduar, përsëri tranzicionin që lidhet me këtë pikë e kanë kaluar.

Në pikëpamjen juridike Shqipëria mund të thuhet se e ka kapërcyer tranzicionin, pasi ka kushtetutë demokratike, legjislacionin të përafërt dhe të përshtatur me vendet e Bashkimit Europian, por rezulton se ende nuk ka një shtet ligjor në të cilin klasa politike, dhe aparati shtetëror t'i përgjigjet rregullisht shtetit ligjor. Ky fakt argumenton dhe pse tranzicioni vazhdon ende, pasi deri sa në Shqipëri funksionimi i

shtetit mbi baza demokratike të bëhen rutinë dhe të konsolidohen edhe më tej këtij stadi. Zhvillimi historik i postkomunizmit në Shqipëri rezulton me disa ngjarje në të cilat ekzistenca e shtetit ligjor ka patur momente që është tronditur dhe që kanë ndikuar vonuar tranzicionin postkomunist. Lidhur me pikëpamjen e kapërcimit të tranzicionit me procesin e antarësimit në BE, pra që antarësimi i vendit në BE do të thotë kapërcim i tranzicionit, studimet tregojnë kanë treguar se, ka dhe vende ish komuniste të antarësuara në BE që ende janë në tranzicion.

Një pikëpamje mjaft e rëndësishme që ka rezultuar nga analiza e kryer është se antarësimi në BE i vendeve ish socialiste, ka të bëjë më shumë me faktin se ky proces ka të bëjë me faktin e progresit të shtetit ligjor, se sa me reformat ekonomike, pra i referohet më shumë tranzicionit politik se sa atij ekonomik. Nisur nga kjo pikëpamje rezulton se, Shqipërisë do ti duket ende kohë për t'u antarësuar në BE, dhe kjo nuk ka të bëjë thjeshtë me pamjaftueshmërinë e reformave ekonomike, por me cilësinë e klasës politike në vend, me shtetin ligjor, të institucioneve, qeverisjen e proceset demokratike.

Si konkluzion mund të themi se është pikërisht faktori politik dhe jo ai ekonomik që ka ndikuar në krijimin e opinionit se Shqipëria nuk është ende gati për t'u antarësuar. Dhe kjo është dhe arsyeja e një tranzicioni që po e mban vendin peng. Natyrisht që edhe tranzicioni e ka një fund, por referohet me funksionimin e shtetit demokratik dhe të shoqërisë shqiptare, ku të mos ballafaqohen dy realitete, ku njëri të ushqejë hakmarrjen dhe tjetri të shohë nga e ardhmja. Vetëm kur këto realitet të mos ballafaqohen kanë marrë fund kthimet prapa në proceset demokratike, atëherë dhe tranzicioni mund që të quhet i kapërcyer.

Faktor tjetër shumë i rëndësishëm natyrisht që ka ndikuar në këtë proces është dhe funksionimi i parlamentit, si shprehje e drejtëpërdrejtë e nivelit të klasës politike. Dështimi nga ana e klasës politike shqiptare gjatë gjithë tranzicionit, për t'u dhënë qytetarëve shqiptarë një parlament me funksionim normal, brënda satandarëve perëndimore, sipas studimeve ka ardhur si pasojë e faktit se, asnjëherë nuk kemi mundur të zgjedhim një parlament që të funksionojë në mënyrë të vërtetë pra të dalë nga vota reale e qytetarëve. Pra sipas kësaj pikëpamje, forca politike e pushtetit politik të dhënë, të jetë sistemuar dhe kontrolluar, në mënyrë që të pengojë klasën politike që të mos abuzojë me pushtetin e dhënë nga populli. Kjo ka çuar në keqmenaxhim të shoqërisë, pasojë e një parlamenti të dobët, jo cilësor, duke mos krijuar konceptin modern të menaxhimit të shoqërisë, atë të përgjegjësisë përparë qytetarëve që i kanë mandatuar, duke sjellë si pasojë dhe stanacion të elitës.

Nuk ka patur një qarkullim normal të elitave apo të vlerave të cilat ka prodhuar shoqëria. Por kanë mbetur në vend duke sjellë si pasojë një degradim shoqëror, pasi i është mohuar intelektualit që t'i kërkojë shoqërisë që të qeveriset prej tij. Vetë sistemi demokratik në frymën e tij e përcjell, dhe vë në lëvizje elitën, mirëpo efikasiteti i punës së elitës në menaxhimin e shoqërisë matet me punën e kryer në funksion të shoqërisë që ajo menaxhon. Duke qënë një shoqëri që për një kohë të gjatë është keqmenaxhuar, edhe klasa politike e pas viteve 90', nuk arriti ta realizonte funksionimin normal të institucioneve, duke sjellë vonesë mungesë në qarkullimin e elitave.

Kur shoqëria nuk drejtohet nga elita e saj më e mirë, ajo mbetet e bllokuar duke u bërë pengesë në zhvillimin shoqëror, ndaj dhe duhet garantuar qarkullimi i elitave, dhe këtë e garanton parlamentarizmi. Prandaj parlamentarizmi, kushtetueshëmria ndikojnë

në qarkullimin e elitë dhe në statusin e tyre. Duke qënë se parlamenti është arena e elitës politike është e nevojshme përmirësimi i debatit parlamentar dhe sidomos ai i procesit ligjvënës.

Për të rritur besimi tek qytetarët klasa politike duhet që vlerat perëndimore të mos jenë spontane, por të jenë fenomen i zakonshëm për politikën shqiptare, në mënyrë që shoqëria shqiptare të mos ketë ndjesinë që po qeveriset në mënyrë abuzive.

Gjatë gjithë këtyre viteve klasa politike shqiptare është paraqitur e përçarë, konfliktuale e pastabilizuar jo demokratike ku gjithë qeveritë që kanë ardhur në pushtet janë karakterizuar nga papërgjegjshmëria, duke sjellë keqmenaxhim shoqëror dhe prapambetje. Rezulton se një nga defektet më të mëdha të klasës politike të periudhës postkomuniste është paaftësia e saj për të krijuar konkurrencë idesh në jetën parlamentare, si pjesë normale e konkurrencës demokratike, për të marrë pushtetin, por ka krijuar trysni shoqërore pasi nuk ka qeverisur por kanë bërë luftë individuale në vend që të mundësojë funksionimin e parlamentarizmit si arena e konkurrencës demokratike të ideve . Kjo i ka mohuar shqiptarëve mundësinë për të zgjedhur idetë e programet më të mira politike të subjekteve në menaxhimin e shoqërisë.

Nisur nga pikëpamja se në ç'shikallë ka qënë kontributi i elitës politike postkomuniste për shoqërinë shqiptare mund të themi se, ndryshimi i sistemit pas 90' e gjeti të papërgatitur jetën politike shqiptare me ndryshimet që po ndodhnin, ndaj duhej bërë zëvendësimi i elitës së vjetër politike që u largua me sistemin komunist, me një elitë të re e cila përbëhej nga një shtresë individësh që kishin pak lidhje me strukturat e saj, por kishte dhe individë që nuk kishin fare lidhje me të, dhe kjo vinte kryesisht nga bota akademike, arti, kultura, dhe nga profesione të lira . Rezulton se në fillim të pluralizmit shqiptar, parlamenti i parë pluralist të jetë i përbërë pikërisht nga kjo shtresë e elitës

176

shqiptare , por që për fat të keq ngjarjet dhe proceset e mevonëshme në jetën politike shqiptare, dhe sidomos pas 1997 përfshirja e kësaj shtrese erdhi duke u zvogëluar. Mështetur në pikëpamjen Veberiane që politika si shkencë dhe si çdo profesion tjetër kërkon disa cilësi profesionale që duhet ti kombinosh sëbashku me politikën për ta ushtruar atë, duke mos patur eksperiencën e nevojëshme shumë shpejt nga politika filluan të largohen ata individë që u zhgënjyen dhe që e kuptuan që politika si profesion nuk ishte i përshtatshëm për ta.

Nisur nga kjo pikëpamje mund të themi se në këtë moment duhet parë dhe fillimi i procesit të diferencimit të elitës shqiptare, me krijimin e një shtrese elite politikanësh profesionistë, argumenti i funksionimit të elitës politike.

Ky fenomen ka sjellë si pasojë momente të cilat klasa politike i është drejtuar shoqërisë për të tërhequr në gjirin e saj, në faza të ndryshme individë të cilët në momente të caktuara, i kanë dhënë tipare specifike klasës politike, që në fillim të pluralizmit shqiptar, ku politika e kohë tërhoqi në gjirin e saj specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme të menaxhimit shoqëror, duke nisur dhe nga nevoja që paraqiste koha për tu shkëputur nga komunizmi. Më vonë me kalimin e kohës klasa politike në periudha të ndryshme iu drejtua elitës intelektuale për të rimëkëmbur apo rifituar mbështetjen politike të masave, të përfshiheshin në gjirin e klasës politike individë që vinin nga shoqëria civile, pikërisht për të përmirësuar imazhin e saj. Këto janë pasojat si rezultat i kristalizimit të një elite politike në mungesë të traditës demokratike, të ndërtimit të një karriere politike jo të bazuar në meritokracinë.

Krijimi i kultit të liderit është pasojë direkte e një karriere politike pa meritë, duke penguar qarkullimin e elitave mbi bazën e meritokracisë, dhe duke e mbajtur dhe klasën politike vetë në tranzicion dhe sot, duke u përpëlitur mes ideologjisë politike dhe

177

demokracisë ose autoritarizmit. Ky fakt i liderzimit të partive politike ka sjellë si pasojë katapultimin në politikë dhe parlament të personave që kanë qënë në kontraditë me shtresën sociale që mendohet që normalisht duhet të përfaqësonin.

Ky model ka ulur përfaqësimin e grupeve sociale dhe ka ndikuar në qëndrimet e partive politike . Si konkluzion mund të themi së gjatë këtyre viteve të tranzicionit elita politike ka qënë më e interesuar për pushtetin personal dhe interesat që lidhen me të, se sa për artikullimin e prezantimin e programeve e platformave politike të pozicionuara sipas formatit korrekt ideor të secilit krah politik që i përkasin, duke sjellë për pasojë uljen e aftësisë dhe të interesit të klasës politike për të ndërtuar institucione dhe qeverisje demokratike të mbështetura mbi baza politike dhe ideologjike dhe në shërbim të qytetarëve .

Në formësimin e klasës politike të këtyre viteve si dhe në karrierën politike të saj në analizë të faktorëve që kanë ndikuar në të rezulton se, janë një sërë faktorësh që në ndërveprim me njëri tjetrin i kanë dhënë formatin kësaj klase politike. Në këtë pikëpamje që nga viti 1991 rezulton që për tu bërë pjesë e klasës politike kanë konkuruar 7 kryetarë të atëhershëm në zgjedhjet parlamentare të mbajtura. Në këtë pikëpamje të analizës zgjedhjet e 1996 shënuan një etapë të re në formësimin e klasës politike, pasi pas miratimit të ligjit të kontrollit për figurat, disa individë mes tyre dhe ish kryetari i opozitës Nano nuk mundi të konkurojë, ndërsa nga e djathta shqiptare kemi konfirmime të kandidaturave. Edhe në zgjedhjet e 1997 kemi rikonfirmime të të gjithë lidervë politikë, pavarësisht kushteve e rrethanave në të cilat u zhvilluan. Zgjedhjet e vitit 2001 rikonfirmohen sërish pothuajse të gjithë kryetarët e e partive politike për në parlament, sërish dhe në 2007 janë po të njëjtat kandidatura që

nëpërmjet listave shumëëmërore apo dhe mandatit direkt siç ishte ai i Ilir Metës konfirmohen.

Analiza e gjithë këtyre faktorëve nxjerr në dukje se klasa politike ka përdorur dhe vazhdon të përdorë metoda e taktika politike, qoftë duke kandiduar në zona të sigurta, qoftë përmes listës shumëëmërore, për të ruajtur pozicione të sigurta kandidimi në zona të sigurta.

Nisur nga kjo pikëpamje rezulton se, kryetarët e partive politike, por dhe kandidatët për deputetë tradicionalisht garojnë në këto zona të sigurta, duke sjellë për pasojë gjithmonë të njëjtët fitues, në dëm të qarkullimit të elitës politike, duke mos u lënë hapësirë kandidatëve të rinj për në politikë.

Në këtë pikëpamje të karrierës politike dhe parlamentare të klasës politike nga studimet rezulton se, që nga 1991 deri në 2009 deputeti me më shumë mandate i përket të majtës shqiptare (Namik Dokle), ku vetëm një mandat e ka nga lista shumëëmërore. Rezulton se nga 33 deputetë të marrë në analizë rreth $\frac{1}{2}$ e tyre janë në PS ose e kanë siguruar me një parti tjetër, ku duhet theksuar se ndër këta deputetë të PS që kanë kartirë të gjatë politike e parlamentare gjashtë prej tyre janë zgjedhur që në vitin 1991, në zgjedhjet e këtij viti të kandiduar nga Partia e Punës. Ndërsa analiza e faktorëve të formësimit të krahut politik të së djathtës nxjerr në dukje se, nga kjo listë e 33 deputetëve, kryetarët e kësaj force politike janë ata që kanë më shumë se tre mandate, por që bie në sy dhe prezenca e deputetëve që nuk kanë patur poste të larta drejtuese në parti. Fenomen tjetër që rezulton i dukshëm është dhe kandidimi i individëve me më shumë se një parti politike, si nga e djathta dhe nga e majta . Por është interesant fakti se nga 33 deputetë të analizuar 29 prej tyre ose kanë qënë kryetar partie, kandidat

për kryetar, nënkryetar, sekretar i përgjithshëm, kryeministra, zëvendëskryeministra ose ministra.

Pra si faktor kryesor i zgjedhjes përveç meritës personale, ka shërbyer dhe pozita e lartë drejtuese, duke qënë diktuese për vënien e tyre në lista apo në kandidimin e tyre në zona të sigurta. Pasi në rast të humbjes në mazhoritar, kanë fituar me listën shumëëmërore, dhe ky fenomen është i pranishëm në të dy kahet e politikës.

Faktor tjetër i analizës është dhe formimi i tyre, ku prej kësaj liste të 33 deputetëve të analizuar dhe që kanë më shumë mandate parlamentare nuk kanë studiuar shkenca politike , apo të kenë kontribut shkencor në fushën e analizës politike . Gjysma e tyre nuk kanë tituj shkencorë dhe grada shkencore, dhe si të tillë politikën e kanë të vetmin profesion.

Shoqëria civile si një faktor shumë i rëndësishëm për jetën politike rezulton se mes saj dhe klasës politike të jetë krijuar një hendek, që përballur vullnetin e lirë të qytetarëve dhe vullnetin e klasës politike për të zhvilluar proceset demokratike. Analiza e këtij faktori sjell si konkluzion se, ky hendek mes klasës politike dhe shoqërisë civile është theksuar gjithnjë e më shumë, nga paaftësia e klasës politike për të ndërtuar institucione kushtetuese, mekanizma për të shmangur krizat e panevojëshme që klasa politike ka prodhuar në këto vite të tranzicionit. Zhvillimet politike të tranzicionit rezultojnë të jenë shoqëruar me probleme të mëdha, në të shumtën e rasteve të krijuara nga vetë politikanët me papërgjegjshmërinë e tyre. Qasja voluntariste e cila e thekson kryesisht rolin e elitës politike, e cila përfshihet në proceset e gjithanëshme të njohjes të zhvillimeve politike, dhe që duhet të karakterizohet nga zotërimi në një shkallë e lartë të disa karakteristikave si dialogu, kompromisi, kultura politike etj. Bazuar në këtë pikëpamje klasa politike shqiptare e tranzicionit paraqet probleme të karakterit unik për

180

nga problematika dhe vështirësitë që kjo klasë politike ka prenzatuar në performancën e saj.

Në këtë pikëpamje në dallim nga vendet e tjera të EL, klasa politike për afro dy dekada e gjysëm e kanë zotëruar të njëjtët politikanë, të cilët e kanë lënë vendin në vendnumëro. Tipari i kësaj klase politike është mbajtja e ndjenjës së jetëgjatësisë politike, duke e konsideruar partinë si pronë dhe jo si një atribut të demokracisë.

Analiza e trashëgimisë politike hedh dritë mbi modelin e zhvillimit të shtetit e të partive politike, të institucioneve dhe të aftësisë së shoqërisë shqiptare për të ndërtuar modelin e një shoqërie demokratike, ku nisur nga prespektiva e kulturës politike, shoqëritë demokratike mbartin vlera e tradita që janë kultivuar përmes procesesh dinamike të zhvillimit të demokracisë dhe që lidhen ngusht dhe me përpjekjet e vetë shoqërisë për të arritur këto vlera. Nëse i referohemi traditës politike në Shqipëri, vendi ynë paraqet mangësi në elaborimin e këtyre vlerave të kulturës demokratike. Nisur nga kjo pikëpamje klasa politike shqiptare e pas viteve 90', kishte mangësi të theksuar anë përvetësimit të këtyre vlerave dhe të normave juridiko- shtetërore, që paraqiste orientimi i ri politik dhe ekonomik që mori vendi. Kjo mangësi i dha mundësinë vijimit të traditës së vjetër të formimit të drejtuesve të rinj politikë, të cilët në vend që të respektonin sistemin dhe ligjin e shtetit, dolën mbi sistemin dhe ndërtuan një shtet të pabarabartë dhe institucione të varura nga politika.

Në 1991 kur Shqipëria u fut në procesin e demokratizimit, dhe e shkuara nuk mund ta ndihmonte për të realizuar proceset që kërkonte tranzicioni nga komunizmi në demokraci, ndaj elita ish komuniste mori monopolin e procesit si e vetmja elitë politike dhe intelektuale e mundshme për kohën, dhe ishte një produkt i pashmangshëm për kohën, referuar qasjes psikologjike të Pareto, ku shpjegohet se formimi i elitave i

181

referohet disa faktorëve themelorë sociologjik, si rrjedhim elitat shihen jo vetëm si produkt i forcave ekonomike dhe i atyre që kane aftësi organizative për të sunduar, por janë dhe rezultat i vetive që fitohen gjatë historisë. Në këtë pikëpamje studimet dhe argumentat flasin për vijimësi të traditës komuniste në zhvillimin e elitës dhe të politikës, nga ana e drejtuesve të rinj politikë. Sipas analiës së kryer funksionimi i partive politike në Shqipëri është një ndër argumentat bazë dhe që e fakton këtë vijimësi apo reminishencë të theskuar të së kaluarës komuniste. Kjo mënyrë e formimit dhe e funksionimit të partive politike, shpjegon dhe pse partitë politike janë konfiguruar dhe kanë mbetur peng i së shkuarës së tyre, duke qënë se elita drejtuese e tyre ka shtypur mendimin ndryshe ose e ka eliminuar apo përjashtuar nga partia e tij. Mbështetur në këtë pikëpamje analiza e dy partive kryesore politike në vend PD-PS shpjegon traditën autoritariste të funksionimit të partive politike. Ky tipar i përbashkët i dy partive politike rezulton se, në traditën autoritariste të PD me liderin e pazëvendësueshëm, dhe tek PS në natyrën e drejtimit të centralizuar, duke monopolizuar pushtetin partiak e deformuar partinë e institucionet partiake e shtetërore në tërësi, element i qartë i trashëgimisë së thellë të së kaluarës.

Krijimi i modelit të shërbyerit partisë e jo shtetit është tipar i hasur ndjeshëm tek të dy partitë kryesore politike PD-PS e në partitë e tjera, gjatë kohës që secila ka qënë në pushtet, dhe kjo ka ardhur si pasojë e fenomenit të ndërtimit të modelit të shpërblimit të militantëve partiak me vende pune. Ky fenomen ka çuar në fragmentarizim të politikës i cili është shoqëruar me mungesë dialogu, tolerance të mendimit ndryshe, me monopolizim të vendimmarrjes apo të identifikimit të partisë me liderin.

Sipas analiës vendi ynë bën pjesë në ato vende ku vijimësi e elitave mes sistemit të vjetër dhe sistemit të ri politik është e dukshme, tipar ky që gjendet dhe në vendet e

tjera të EL, por në Shqipëri duke qënë se disidenca komuniste pothuajse u eliminua shumë shpejt, pra elita e formuar në perëndim ishte zëvendësuar me intelektualë të bindur të regjimit komunist, faktor ky që eliminoi meritokracinë, duke zhdukur mundësinë për një karrierë të bazuar në meritën, pasi regjimi i emëronte individët bazuar mbi pikëpamjen politike. Kjo lloj reminiscence e së kaluarës, gjatë tranzicionit në politikën shqiptare ka qënë mjaft e dukshme, pasi mënyra e prononcimit të politikës, emërimet në administratën publike, apo në partitë politike, janë kryer kryesisht të bazuar tek njohjet personale ose partiake, duke deformuar funksionimin e institucioneve publike dhe demokracinë. Pasojë i këtij fenomeni në klasën politike është dhe krijimi i një shtrese politikanësh të varur nga emërimet dhe jo nga merita e tyre, çka ka ulur efikasitetin në ushtrimin e pushtetit. Nga studimet rezulton se, e gjithë klasa politike ka qënë jo profesioniste, e varur nga lideri, dhe ka marrë vendime e ndikuar nga paria politike, vendime të cilat kanë qënë në interes të partive politike dhe pushtetit të tyre dhe jo të qytetarëve.

Ndërthurja e këtyre tipareve të klasës politike nxjerr në dukje faktorin se sa ka ndikuar kjo lloj politike në deformimin e vlerave demokratike të shoqërisë, dhe se sa e thellë është diferenca e shoqërisë për t'u formësuar me kulturën demokratike, dhe se sa e madhe është diferenca mes një shoqërie të ndëruar mbi meritokracinë dhe një shoqërie të mbyllur, mes elitës moderne dhe parive. Prandaj është e nevojshme zgjerimi i hapsirave demokratike në funksionimin e elitave politike, gjë që do të sillte për pasojë uljen e konfliktualitetit politik, duke bërë të qartë e të dukshëm dhe dallimin mes elitës reale dhe asaj të promovuar.

Analiza biografike e dy figurave kryesore politike të tranzicionit Sali Berishës dhe Fatos Nanos, rezulton se ishin dy lider që politika shqiptare i trashëgoi nga e kaluara

komuniste. Akademiku Rexhep Qosja i cilëson si individë që teknologjinë e mbajtjes së pushtetit e kishin të mësuar në shkollën komuniste. Rezulton se nën ushëheqjen e këtyre dy liderve drejtimi i partive politike kryesore është karakterizuar nga autoritarizmi, liderizmi, vetmjaftueshmëria, duke sjellë për pasojë të politikë të tyre prodhimin e konflikteve jo vetëm brënda partive të tyre respektive por dhe një pasojë tepër negative për politikën shqiptare në përgjithësi të tranzicionit, duke bërë që në politikën shqiptare gjatë kohës që ata udhëhoqën partitë e tyre të mos ketë një barazpeshë në jetën politike.

Në performancën e saj klasa politike rezulton se, kurba e kredibilitetit të saj ka ardhur gjithnjë në ulje në opinionin publik, kjo për shkak të mungesë së vizionit politik, që klasa politike ka prezantuar. Debati politik nga pikëpamja cilësore rezulton pa pritshmëritë që shoqëria shqiptare ka patur tek klasa politike e saj, apo dhe pritshmëritë që duhet të ketë klasa politike moderne e kohës. Mungesa e kulturës politike ka bërë që debati dhe jeta politike të karakterizohet nga improvizime të momentit e jashtë standardeve . Kjo mungesë e kulturës politike dhe e performancës së klasës politike, bën që që mos kenë aftësitë e nevojshme profesionale për interpretime të besueshme profesionale për realitetin shoqëror, ekonomik dhe social të shqorëisë shqiptare.

Nisur nga kjo pikëpamje duhet që vetë shoqëria shqiptare të mos qëndrojë indiferente ndaj kësaj performance të klasës politike. Reagimi qytetar ndaj nivelit të klasës politike duhet të jetë më i madh, dhe klasa politike duhet të jetë e orientuar nga parimet elitare dhe jo nga ato pragmatiste. Mungesa e një politike të moralshme është një tipar që e ka shoqëruar gjithë klasës politike të tranzicionit, duke bërë që klasa politike të bëhet pengesë për zhvillimin e demokracisë me korrupsionin, mos funksionimin e institucioneve dhe krijimin e modeleve negative të sjelljes politike.

Fragmentarizimi i mjedisit politik nuk ka ardhur si pasojë e liberelizmit, pra i qëllimit të përfaqësimit që ka liberalizmi, por ky fragmentarizim i përgjigjet politikës së përçarë, duke sjellë si rezultat identifikimin e partisë me kryetarin duke i privatizuar ato, dhe duke i lënë në përplasje të tyre mes ideologjisë dhe dëshirave të kryetarëve, dhe mes demokracisë dhe autoritarizmit. Në këtë pikëpamje nga analiza e dy partive të mëdha rezulton se, futja e konceptit parti elektorale, pra duke i përshtatur strukturat e administrimit dhe ato organizative sipas kësaj qasje mjafton që një parti të ketë një program, pra një program i djathtë mund të jetë program për një parti të majtë, tipar të cilin PS e perzantoj nën sloganin “ përtej të majtës dhe të djathtës “, kjo çoi në dejvivimin e saj nga programi i majtë dhe specifike për këtë dejvivim të PS është hapja e saj ndaj biznesit e biznesmenëve. Mos respektimi i karakteristikave dhe i koncepteve të së majtës dhe të djathtës është tipar i përbashkët i të dy partive kryesore politike PD dhe PS, dhe si rezultat kemi që patitë politike prezantojnë humbje të identitetit.

Tipar i përbashkët e dy partive kryesore politike PD-PS është humbja e identitetit politik të tyre. PD e para parti politike opozitare, ka një humbje të identitetit të saj politik të cilin e prezanton në zbatimin e standardeve të dyfishta, qoftë në abuzimet e saj me programin dhe në rreshtimet politike. Në këtë pikëpamje PD ishte një parti që u krijua për të luftuar komunizmin, pra ishte parti antikomuniste, por figurat kryesore drejtuese të saj vinin nga radhët e ish Partisë së Punës. Përçarja e së djathtës nacionaliste , si rezultat i politikës së PD, ku PD mes tyre nuk pati asnjëherë aleat të qëndrueshëm . Lufta e PD në raportet e saj me partitë e vogla të pozicionuara djathtas është tjetër tipar i humbjes së identitetit, luftë e cila ishte e bazuar nën argumentin se i marrin elektoratin PD.

Trajtimi i ish të përndjekurve politikë si një shtresë shumë e rëndësishme e bazës sociale të PD, duke i mbajtur ato larg pushtetit, si dhe trajtimi i çështjes së ish pronarëve dhe të kthimit të pronave, abuzimi me lëvizjen e lirë të qytetarëve, si dhe mos mbajtja e pretendimeve të dhëna, duke sjellë si nevojë riformatimin e së djathtës .

Përpyqjet e klasës politike për ta ridimensionuar klasën politike me individë të cilët vinin nga shtresa të gjëra të intelektualëve, specialistë të ndryshëm, apo dhe të shoqërisë civile. Nga analiza e fakteve më shumë rezulton si përpjekje për të rifituar elektorat se sa përpjekje për të prurje e hapësira të reja në politikë. E tillë ishte përpjekja e PD për të ridimensionuar politikën dhe drejtuesit e saj me anë të KOP (Komiteti i Orientimit të Politikave) për hartimin e programit të saj, ku do të jepnin sugjerimet dhe mendimet e tyre për vendin dhe shoqërinë. Nga analiza rezulton se pas 2005 kur PD i fitoi zgjedhjet KOP –i ka ndaluar së funksionuari. Anëtarët e tij u futën në politikë dhe vazhduan karrierën politike . Si përfundim mund të themi se KOP më shumë shërbeu për të futur individë të rinj në PD se sa të ridimensiononte politikën e saj, pasi futja e këtyre individëve në PD nuk është se dha ndonjë rezultat të dukshëm në ridimensionimin e saj, përkundrazi pati përshtatje të plotë të tyre me këtë politikë.

PS bëri përpjekje për ta riqarkulluar elitën e saj gjatë rrjedhës së saj jetësore, ku kongresi i 1992 në një farë mënyre e rikonformoj vazhdimësinë e saj komuniste, pasi figurat drejtuese të saj ishin ose anëtarë të ish KQ(Komiteti Qëndror) ose antëtarë të ish Partisë së Punës. Gjatë liderizmit të Nanos karakteristikë ishte lufta e brëndëshme për pushtet, ku kulmoi në 2004 me themelimin e LSI(Lëvizja Socialiste për Integrim).

Ardhja në krye të PS të Edi Ramës dhe planit të tij për riformatim të PS, u duk në përpjekjen e tij për të çuar deri në fund projektin e riformatimit të partisë. Lënia jashtë lojës politikë të intelektualëve dhe drejtuesve të rëndësishëm politikë të PS, i dha fund

186

përpjekjeve për rezistencë ndaj liderit Rama brenda PS. Ndryshimet thelbësore të programit të PS, afrimi në Asamblenë Kombëtare të PS të drejtuesve që vinin nga OJF, si dhe ndryshimet thelbësore në funksionimin e PS i dhanë formën përfundimtare PS nën liderizmin e Ramës, element që sipas studimeve rezulton me humbje të demokracisë së brëndëshme në PS. Nën pretekstin e reformimit të PS dhe ndarjes së saj nga politika e vjetër E. Rama e reformoi PS dhe eliminoi politikisht gjithë ata të cilët i cilësonte si kundërshtarë, duke zbehur rëndësinë e institucioneve partiake.

Bashkimi i së majtës shqiptare është një premtim i pa mbajtur i Ramës, mbetet i parealizuar dhe aktualisht. Tipar i rëndësishëm që vlen për t'u theksuar aktualisht në PS përfaqsim apo bashkëjetesë të elementëve të komunizmit Ruçi dhe të figurave politike të tranzicionit su Xhafa, Majko, Balla etj. Në përpjekjet e saj PS gjatë rrjedhës jetësore, nën drejtimin e Nanos u dallua për një afrim të potencialeve intelektuale, si dhe u evidentua një tolerancë më e madhe për kundërshtarët, ndryshe nga Rama, pasi vetë Rama erdhi në krye të PS me përkrahjen e pjesës radikale të saj, që i përkisnin më shumë elitave të paraviteve 90'. Si përfundim mund të themi se hapja e partive politike e ka ulur dukshëm nivelin e elitës politike pas 2005 në të dy partitë kryesore politike PD-PS.

Një tjetër faktor shumë i rëndësishëm i analizës është dhe funksionimi i partive politike si organizatat të cilat formojnë dhe qarkullojnë elitat politike. Rezulton që në periudhën e parë në momentet e themelimit të tyre, megjithëse ishin pa përvojën e duhur partitë politike arritën që të hartojnë programet e tyre, aktet dhe dokumentat e tyre të themelimit. Kjo periudhë e jetës organizative të partive politike shfaq elementë të bashkëjetesës së koncepteve moderne të organizimit me ato të traditës vendore, që ishin të trashëguara e të imponuara nga rrethanat në të cilat u formuan. Rritja e numrit

të partive politike në mjedisin politike shqiptar, ka ardhur si pasojë e konflikteve të brëndëshme të tyre duke çuar në fraksionim dhe në krijimin e partive të reja politike në të dy krahët e politikës. Mënyra e funksionimit të partive politike kryesore paraqet tipare të përbashkëta si parti lider, parti elektorale, që organizohen vetëm në prag të fushatave elektorale me të gjithë mekanizmat e tyre.

Praktika e organizimit parti shtet PD-PS për pasojë krijoi përjashtime, diskriminime, heqje nga lista për deputetë, duke i cilësuar individët me mendim ndryshe armiq dhe këtë tipar e kanë prezantuar të dy partitë kryesore politike në periudha të ndryshme të tranzicionit. Mosreflektim ndaj gabimeve të së kaluarës, si dhe mostrajtimi me efikasitet i konflikteve i kanë penalizuar të dy forcat politike PD në zgjedhjet e 2001 ndërsa PS zgjedhjet e 2005.

Gjatë dekadës së dytë kemi një ndryshim të sjelljes politike të lidërshit politik, dhe ky ndryshim është i dukshëm në arritjen e kompromisit siç ishte rasti i zgjedhjes së presidentit konsensual, si dhe mundësimi i krijimit të elitave të reja politik. Gjatë kësaj periudhe kemi ndryshim të pjesshëm të elitave dhe të ekipeve drejtuese, por ky ndryshim u shoqërua me një fenomen i cili ishte ulja e rolit të antarësisë dhe rritja e rolit të institucioneve partiake si, grupi parlamentar, apo sekretariatet.

Në analizë të evolucionit të tyre, partitë politike reflektojnë profilin e lidërshit të tyre dhe më pak të organizmave drejtues. Nisur nga kjo pikëpamje e analizës së dy partive kryesore, PS paraqitet me një traditë më të mirë organizative, dhe në dallim me PD ka patur një demokraci të brëndëshme më funksionale, kjo e bazuar në dokumenta dhe norma zyrtare. Nga analiza e kryer në drejtim të modelit organizativ rezulton se PS i referohet dokumentave dhe arkivimit të dokumentacionit si pasojë e trashëgimisë që PS

trashëgoi, traditë që kjo nuk gjëndet në PD, element që përbën dhe ndryshimin mes tyre.

Nga analiza e modelit organizativ të PD rezulton se, gjatë dekadës së parë PD i qëndroi besnike formës së njohur minimaliste klasike të organizimit, duke prezantuar një program bazik përfshirë këtu dhe programin politik dhe ai organizativ, por që gjatë rrjedhës jetësore të saj ka bërë modifikime që kanë për qëllim funksionimin dhe përcaktimin e elementëve thelbësorë të funksionimit demokracisë së brëndëshme.

Partitë e profilit parti lider e paraqet LSI , pasi është parti e personalizuar, pasi lidhet me emrin e kryetarit që e krijoj dhe paraqitet si një parti me një histori unike, sidomos pas 2009 kur u zhvillua debati i kalimit të saj nga e majta në të djathtë. Tek kjo parti një pjesë e ekipi drejtues ose u mënjanua ose u përjashtua . Ky është dhe rasti i vetëm që brënda kësaj force politike ka patur debat. Kjo forcë politike paraqitet me nivele të pakta hierarkike, dhe me një model përfaqësimi të pjesshëm parlamentar në bashkim me partitë e mëdha. Modeli i kësaj partie jep rezultate afatshkurtëra, dhe nuk ofron mundësi për të ardhem, pasi suksesi i saj është i njëjtësuar me aftësinë e liderit për të zhvilluar negociata maksimale gjatë ndarjes së pushtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se funksionimi i demokracisë së brëndëshme tek partitë politike është një mundësi shumë e mirë për të shkëmbyer elitat politike, mbi bazën e analizës së demokracisë së brëndëshme për ti dhënë rëndësi instrumentave kryesor të referencës pra të meritokracisë.

Prezantimi i tiparit parti me lider të fortë rezulton se, PS ka dy vite që mandati i kryetarit ka mbaruar dhe akoma nuk ka mbajtur zgjedhje. PD pas humbës së 2013 për

një vit ka funksionuar pa zgjedhur strukturat, me argumentin se është e fokusuar tek keqqeverisja e vendit.

Futja në lista e kandidatëve pa karrierë në parti, të pakonsultuar me strukturat, ose dhe kur është bërë ka qënë formale, elementë të cilat ulin efikasitetin e strukturave partiake të përcaktuara në statut. Vendimmarrja na ndihmon që të analizojmë qasjen që dominon tek partitë politike, ku vihet re koncepti i partisë elektorale, pasi organizohen vetëm në prag të fushatave elektorale, fenomen që bie ndesh me statutin e partive politike dhe duke qënë një formë e pa legjitimuar, është shprehje e devijimit nga parimet politike të demokracisë së brëndshme dhe të funksionimit demokratik të tyre. Bazuar në këtë pikëpamje partitë politike po largohen nga modeli tradicional i tyre dhe po kalojnë drejt modelit parti elektorale, duke lënë mënjëanë përgjegjësitë ndaj bazës prej të cilës janë krijuar dhe se përse janë krijuar, dhe se cilat struktura sociale përfaqësojnë duke u bërë parti pragmatiste dhe larg interesave dhe identiteteve të tyre ideologjike. Krijimi i modelit klientelist i partive politike është shoqëruar me dy fenomene tek partitë, ku së pari në periudhën afat shkurtër partitë bëhen popullore dhe më pak elektorale, dhe kjo kryesisht nga partitë e vogla politike të cilat me anë të politikës klientelise, krahinore përpiqen për të mbijetuar sistemit politik. Së dyti partitë e treta identifikohen gjithnjë e më shumë me liderin politik dhe të klientelës politike, duke u kushtuar gjithnjë e më pak parimeve dhe normave të demokracisë së brëndëshme. Modeli klientelist abuzues nga studimet rezulton si, një model që bie në kundërshti me institucionet publike duke mbetur një fenomen i përkohshëm, ndërsa modeli klientelist pozitiv, pra ai i identifikimit të partisë me grupet sociale që përfaqësojnë është afat gjatë dhe shërben si një fazë tranzicioni i partive politike nga modeli klientelist negativ, në atë të modelit të partive politike moderne.

Krijimi i partive politike moderne dhe i një klasë politike me vizion i jep mundësinë elektoratit që të votojë alternativën më të mirë qeverisëse, faktor ky që i ka munguar klasës politike në gjithë këto vite të tranzicionit. Partitë politike janë qarkullueset e elitave politike. Nisur nga kjo pikëpamje ndryshimi i brezave të votueseve sjell dhe ndryshimin e perceprimeve , dhe të prirjeve të qytetërëve ndaj shtetit dhe politikës për përzgjedhjen e alternativës qeverisëse apo të ofertës politike. Prandaj partitë politike do të jenë të detyruara që të adaptojnë sjellje të reja që do të jenë në përshtatje me parimet dhe me metodat demokratike të demokracisë liberale. Ky faktor do të çonte në përmirësimin e klimës politike dhe të përmirësimit të demokracisë së brëndëshme në partitë politike, ku duhet adaptimi dhe sanksionimi i rregullave të reja të vendimmarrjes, dhe të funksionimit të tyre duke krijuar kështu hapësira për funksionimin demokratik dhe qarkullimin elitar.

KAPITULLI V

Ndikimi i kulturës politike, efektet e saj në ndërtimin e marrëdhënieve shtet-shoqëri

5. 1 Mungesa e kompromisit politik mes klasës politike shenjë e mungesës së vizionit politik të elitës politike.

Që pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri, kriza të shpeshta e kanë shoqëruar politikën shqiptare, pasojë e të cilave është dhe humbja e drejtpeshimit shoqëror. Kjo humbje e drejtpeshimit shoqëror ka ardhur si rezultat i mungesës së transparencës, vjedhjes dhe manipulimit të votave, ndërtimit të institucioneve të dobëta dhe jo të pavarura, të cilat të marra së bashku kanë çuar në një fenomen që e karakterizon demokracinë e brishtë shqiptare si regjim hibrid .

Mungesa e tryezave politike të organizuara apo të iniciuara nga klasa politike, është ndoshta tipari kryesor që e ka shoqëruar politikën shqiptare të tranzicionit, por veçanërisht periudha nga viti 1992 deri në vitin 1997 është periudha më e gjatë e tranzicionit, gjatë së cilës nuk ka patuar as marrëveshje politike, as konsensus politik mes mazhorancës dhe opozitës. Gjatë kësaj periudhe, rastet e vetme kur klasa politike iu afrua kompromisit ishin diskutimet e ligjit elektorale në tryezën e shtatorit 1995 dhe atë të gushtit 1996. Por që në fillimet e këtyre tryezave politike u pa qartë mungesa e dëshirës dhe e vullnetit politik. Kjo mungesë e vullnetit politik është e dukshme në rastin e tryezës së iniciuar nga Partia Republikane, shtator 1995, ku morën pjesë 13

parti politike të mazhorancës dhe opozitës. Që në fillimin e saj, kjo tryezë u bojkotua nga PD-ja, por në seancat vendimtare PD mori pjesë dhe ishte përcaktuese në fatin e tryezës së bisedimeve. Fakti që në këtë tryezë merrnin pjesë partitë, si Partia Socialiste, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia e Ballit Kombëtar, të cilat asnjëherë më parë nuk ishin takuar apo dhe të kishin biseduar me njëra-tjetrën (në A. Krasniqi, 2008, fq19), është tregues i mungesës së tolerancës dhe i kompromisit që ekzistonte në klasën politike shqiptare që në hapat e parë të jetës pluraliste të politikës.

Tryeza e shtatorit 1996 kishte një element tjetër, që e bënte më specifike: ndërmjetësohej nga Instituti Republikan Amerikan, takim në të cilin morën pjesë të gjitha partitë politike dhe ku u ra dakord për një paketë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor. Sipas studiuesit (A. Krasniqi, 2008, po aty) rastet e tjera të tryezave ishin disa takime formale dhe, megjithëse kishin natyrën e takimeve zyrtare dhe në to është diskutuar për çështje konkrete të politikës, në asnjë rast nuk pati një marrëveshje politike të shkruar apo të pranuar verbalisht. Përkundrazi, palët mbanin qëndrime të skajshme duke refuzuar bisedimet dhe ofertat për bashkëpunim për vështirësitë me të cilat po përballej vendi.

Të vetmet pika takimi të klasës politike shqiptare gjatë gjithë tranzicionit, mes mazhorancës dhe opozitës, janë ato kur marrin pjesë në delegacione të përbashkëta ndërkombëtare dhe palët bëjnë lëshime dhe pranojnë kompromise, pasi janë nën tryshninë e ndërkombëtarëve, shenjë kjo e papjekurisë politike të klasës politike shqiptare, që e tregojnë edhe sot. Sa herë u duhet të arrijnë marrëveshje apo kompromise mes dy kampeve, kërkohet garancia e faktorit ndërkombëtar për zbatimin e saj, në mungesë të besimit dhe vullnetit politik të klasës politike. Kjo mungesë e

kompromisit mes klasës politike në këto dy dekada të tranzicionit politik shqiptar ka bërë që hendeuku i bashkëpunimit dhe largësia mes forcave politike të thellohet.

Rrënjët e mungesës së kompromisit politik janë që në fillimet e demokracisë në Shqipëri, të cilat patën disa pika kulmore, duke filluar me vitin dramatik 1997, ku klasa politike në vend që t'iu jepte zgjidhje problemeve dhe situatës në të cilën ndodhje vendi, iu largua përgjegjësisë duke nxjerrë justifikime nga qeveria dhe përfitime nga pala tjetër opozitare. Kriza e vjedhjes së votës në 2008-n, tragjedia e Gërdecit, 21 janari etj, janë disa nga kulmet e jetës së trazuar politike shqiptare.

Mënyra e funksionimit të partive politike shqiptare, sidomos e dy partive kryesore PD dhe PS, është jo transparente. Parimet demokratike të organizimit dhe funksionimit nuk funksionojmë, pasi rregullat e përfaqësimit dhe të konkurrimit nuk zbatohen. Në shumicën e rasteve njerëzit që përfaqësojnë këto parti janë të emëruar nga kryetari dhe jo të dalë nga konkurrimi i lirë dhe transparent, element i cili ka bërë që kompromisi të mos arrihet edhe brenda vetë familjes politike, çka e bën dhe më të vështirë arritjen e tij edhe me bazën e gjerë apo me spektrin politik opozitar. Kjo mungesë e kompromisit jo vetëm ndërmjet partive politike por dhe ndërmjet vetë familjes politike, ka rezultuar me fraksionime të të dy krahëve politikë, ka rezultuar si një humbje energjish të vet partive politike, të cilat që me goditjen e parë që kanë marrë janë shkërmoqur, siç ishte rasti i PS-së në 2005-n apo i PD-së në 2013-n. Kjo mungesë kompromisi e klasës politike ka ardhur si rezultat i shndërrimit dhe tjetërsimit të partive politike, të mungesës së transparencës, të krizave të herëpashershme, të cilat kanë provuar se politika shqiptare e dy dekadave të fundit nuk ka qenë promotore e zhvillimit dhe reformimit.

Mungesa e dialogut dhe e bashkëpunimit politik të klasës politike shqiptare është një element i pasqyruar në dy krahët e politikës, ku partitë politike në mënyrë të ndërsjellë

nuk kanë besim te njëra-tjetra në nismat dhe nevojën që ka politika për dialog. Sipas Krasniqit, referuar ish-kancelarit austriak Franz Vranicky, i cili në 1997-n në emër të OSBE-së negocioi bisedimet mes partive politike në këtë periudhë, veçojmë: *“Më e lehtë ishte të rrëzoje një qeveri, sesa të takojë së bashku dy udhëheqësit e partive kryesore, ndërsa në fund të turit të shqiptar ai tha se, kishte parë dhe takuar engjëj që dukeshin si djaj, dhe djaj që dukeshin si engjëj”* në (në A. Krasniqi, 2008, fq 243) .

Konfliktualiteti dhe mungesa e kompromisit dhe e dialogut politik që paraqet klasa politike shqiptare, është premisë për të mbajtur në krizë raportet e qytetarit me shtetin, si dhe bëhet pengesë në zhvillimin e reformave dhe të ecurisë së proceseve demokratike.

Sipas autorit, edhe raportet ndërkombëtare e theksojnë ndarjen e madhe që ekziston në lidhshimin e partive politike. Sipas tij, në një udhëzues të OSBE/ODHIR të vitit 2001 përmendet fakti se dy liderët kryesorë, Nano dhe Berisha, nuk kanë folur me njëri-tjetrin prej dhjetë vjetësh, dhe se takimi i tyre i parë u bë në vitin 2002, i imponuar nga presioni i faktorit ndërkombëtar. Por që dialogu mes tyre nuk zgjati më shumë se gjashtë muaj.

Në këtë pikëpamje mungesa e mentalitetit bashkëpunues, të kulturës politike të trashëguar si Q dhe shkalla e lartë e konfliktualitetit politik ka sjellë si pasojë konfliktualitetin, dështimin dhe debatet shterpë të klasës politike shqiptare. Por në momentin e vlerësimit të përgjegjësisë së këtij konfliktualiteti politik, të dy aktorët kryesorë fajësojnë njëri-tjetrin, si Berisha dhe Nano, i njëjti fenomen vazhdon edhe sot, tek liderët rinj të politikës.

Shkalla e ulët e emancipimit demokratik të elitës politike, mungesa e dialogut dhe fryma përjashtuese e shtetit, janë tiparet kryesore të klasës politike shqiptare gjatë gjithë kësaj periudhe. Sipas A. Krasniqit, psikologjia për të treguar me gisht paraardhësin dhe për t'u vetëshpallur si shansi më i madh për ndryshim, ka qenë dhe mbetet një nga dukuritë më konfliktuale të shoqërisë shqiptare. (në A. Krasniqi, 2008)

Ky konfliktualitet i klasës politike shqiptare, siç e shpreh dhe Servet Pëllumbi (2001): *“Më shumë është një luftë për protagonizëm individual i liderëve politikë për të treguar pushtetin e tyre apo dhe për të treguar veten si shpëtimtarë të partisë që përfaqësojnë, dhe të vendit”* metodë kjo që ka dhënë si rezultat mospërsosjen dhe konsolidimin e demokracisë, por që e ka çuar në një polarizim të shoqërisë, pasi konfliktualiteti është përcjellë deri në bazë. Besnik Mustafaj (1995) shprehet se, *“shoqëria shqiptare vuan nga një polarizim të tepruar dhe radikal në të gjitha nivelet”*.

Ndërsa ish-shëfi i zyrës së OSBE-së në Shqipëri, lidhur me shkallën e lartë të konfliktit politik në Shqipëri, sidomos pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2000, është shprehur se, ka krijuar një stërngopje me polarizim, se shqiptarët nuk janë tërësisht të kënaqur as me njërin e as me tjetrën parti. Shqiptarët po kërkojnë një forcë të re të tretë politike. E gjithë periudha e tranzicionit shqiptar është shoqëruar me një mungesë të konkurrimit të palës së tjetër në mënyrë të lirë, që përbën thelbin e konkurrimit demokratik dhe tregon se të dyja palët politike i kanë lënë vendit një kostoje dypalëshe. Liderëve politikë kjo u ka mundësuar ruajtjen të paprekshme të pozitave të tyre në krye të forcave politike që ata drejtojnë. Për një kohë të gjatë në klasën politike shqiptare fenomeni i dorëheqjes nga karriera politike ka qenë një tabu dhe, fatkeqësisht vazhdon të mbetet e tillë.

Konfliktet mes forcave politike normalisht duhet të zgjidhen në rrugë institucionale, në mënyrë që të mos prodhohen kriza. Por, duke qenë se në Shqipëri, fatkeqësisht, politika shqiptare ka prodhuar institucione të dobëta, ato kanë qenë të paafta për t'u dhënë zgjidhje këtyre krizave. Sipas studiuesit Krasniqi (2008) në dekadën e parë të tranzicionit konstatohet me shqetësim të madh fakti se partitë politike e kanë ndërtuar aktivitetin e tyre politik në funksion të eliminimit apo dhe të mënjanim të tërësor të kundërshtarëve politik, ku gjatë viteve të qeverisjes konservative të së djathtës 1992-1997, sipas tij qeveria bëri përpjekjet maksimale për të dobësuar opozitën, madje edhe për të nxitur shpërndarjen e saj politike. Autori i është referuar letrës përshëndetëse të ish-presidentit Berisha dërguar Kongresit të PS-së të vitit 1996, në të cilën u sugjeron atyre, jo pa cinizëm, shpërndarjen e saj dhe krijimin e një partie mbi baza socialdemokrate. I njëjti sugjerim iu bë një vit më vonë demokratëve kur socialistët erdhën në pushtet, të cilët mendonin se PS dhe vendi nuk kishin nevojë për një opozitë të tillë. Fatkeqësisht, e njëjta retorikë dhe metodë vazhdon dhe sot në luftën për pushtet mes palëve politike. Ideja e qeverisjes së vendit pa praninë e opozitës është tregues që klasa politike shqiptare ende vazhdon të ketë në mentalitetin e saj elementë të mendësisë së vjetër qeverisëse, pasi ky mentalitet i të qeverisurit pa praninë e opozitës nuk është demokratik dhe i jep ngjyrim apo nuanca totalitariste qeverisjes së vendit.

Mungesa e respektimit të marrëveshjeve mes klasës politike është një tjetër tipar i konfliktualitetit politik, që ka nxitur dhe një mungesë të besimit të ndërsjellë të aktorëve politikë mes pozitës dhe opozitës. Arsyeja kryesore e krijimit të këtij fenomeni të klasës politike shqiptare është se, të dyja palët politike nuk kanë qenë të afta të mbajnë apo dhe të respektojnë angazhimet politike të marra në angazhimet dhe bisedimet publike me palën tjetër. Shkelja e njëanshme apo dhe e dyanshme e

marrëveshjeve politike ka qenë arsyeja kryesore e klimës së mosbesimit në politikën shqiptare. Edhe pse ishin nënshkruar marrëveshje apo dhe marrë angazhime politike, palët politike kanë treguar se, *”disa orë pas miratimit, ato shkeleshin apo liheshin mënjatë nga aktorët politikë”*. (në A. Krasniqi, 2008, fq 247). Të tilla marrëveshje që janë ndërmarrë dhe shkelur nga partitë politike janë disa, si ajo e vitit 1997 me komunitetin San Egidio (1997), e qershorit 2002 për Komisionin bipartizan për reformën zgjedhore etj.

Këta janë shembuj që tregojnë mënyrën se si klasa politike shqiptare dialogun politik e ka konceptuar më shumë si mjet për të fituar besueshmëri politike. Ata e kanë keqpërdorur dialogun politik dhe e kanë konceptuar atë vetëm si një mundësi nga ku mund të nxjerrin përfitime politike, pa analizuar nga pikëpamja e humbjes politike dhe kjo ka bërë që në, pothuajse dy dekadat e tranzicionit, dialogu politik të mos funksionojë.

Klasa politike shqiptare është e ushqyer me mosbesim dhe me frikën se tolerimi i kundërshtarit politik - duke nënkuptuar se gjithmonë kjo është taktika e tij për të arritur qëllimet apo synimet e veta me mjete dhe rrugë të tjera dhe jo me konkurrencë politike - është një element që ka kushtëzuar faktin që dialogu politik të mbetet formal.

Dekada e parë e tranzicionit në Shqipëri përgjithësisht është shoqëruar me imponim të dy forcave kryesore politike PD dhe PS për të pranuar e për të ndarë përkohësisht pushtetin, të detyruara nga krizat e thella politike, ekonomike, edhe pse nuk kanë pranuar asnjëherë të kenë një bashkëqeverisje, element që tregon se në klasën politike shqiptare është mbizotërues mentaliteti se, ai që fiton është dhe zotërues i gjithçkaje, madje dhe i pushtetit, dhe se opozita është kundërshtari i rrezikshëm politik - mentalitet

që ka qenë prezent në të gjitha forcat politike dhe lidheshit e tyre. Dhe kjo është një gjurmë e thellë e së kaluarës diktatoriale që ka kaluar vendi ynë.

Parë nga kjo pikëpamje e mungesës së dialogut dhe të klimës së ndërsjellë mosbesuese, një tjetër tipar i klasës politike lidhur me dialogun është nevoja e përhershme për një ndërmjetës, rol të cilin, në përgjithësi, e kanë luajtur organizata të ndryshme ndërkombëtare, si OSBE, trupa diplomatike perëndimore apo dhe SHBA-të. Pothuajse të gjitha krizat që Shqipëria ka kaluar janë ndërmjetësuar nga faktori ndërkombëtar, si ajo e 1997-s, e 1998-s për kushtetutën, ajo e komisionit bipartizan për reformën zgjedhore e deri te zgjedhja e Presidentit me ndërhyrjen e BE-së. Të vetmet momente të bashkëpunimit politik që dolën jashtë kuadrit të mungesës së komunikimit mes palëve politike janë viti 1998, ku politika shqiptare ishte nën presionin e brendshëm të protestave dhe kërcënimit e opozitës për bojkotimin e parlamenti dhe zgjedhja konsensuale e presidentit Moisiu në vitin 2002. Por dhe pas kësaj zgjedhjeje, të dyja palët politike PD dhe PS nuk i janë kthyer dialogut dhe komunikimit, për ta bërë këtë proces normal të edukatës politike të klasës politike, edhe pse, më shumë mbetet si një nevojë e detyruar nga faktorë dhe kushte të detyruara politike, ose mbetet në vullnetin e liderëve politikë.

5.2 Vrazhdësia e gjuhës politike, si shenjë e mungesës së njohjes së komunikimit politik

Në rrugën e zhvillimit të demokracisë dhe ndikimin që elita politike ka në këtë proces, patjetër që një element që tregon përgjegjshmërinë dhe përgatitjen e klasës politike është dhe gjuha që përdorin personazhet politike. Përgjithësisht, gjatë gjithë periudhës së tranzicionit klasa politike shqiptare është shquar për një gjuhë agresive, jo tolerante dhe, shpeshherë, jo demokratike.

Kjo intolerancë gjuhësore e klasës politike është e shprehur qartë, në një mënyrë radikale dhe sugjестive të mundësive politike, duke e mbushur komunikimin politik me fraza sulmuese dhe stereotipe ideologjike. Pra, një paraqitje e “tipit bardhezi”. (në K. Bajraba, A. Gasparini, 2001, fq 108)

Sipas autorit, një tipar tjetër domethënës i gjuhës së përdorur është dhe dhuna verbale e shoqëruar me forma të ndryshme, duke filluar nga mosdëgjimi i palës kundërshtare, mllefi i fortë e radikal, fyerje, e duke arritur në ekstrem duke mos pranuar të flasin me kundërshtarin politik. Takimet e krerëve të partive kryesore politike ishin dhe mbeten ende edhe sot një eveniment i jashtëzakonshëm për jetën politike shqiptare. Kjo gjuhë e përdorur nga klasa politike shqiptare shpeshherë ka shërbyer si një prelud dhe për dhunë fizike në parlament, gjë që pengon në zhvillimin dhe në vlerat ee demokracisë parlamentare. Kërcënimet ndaj kundërshtarit politik, tallja me personalitetin e tij, përdorimi i kësaj gjuhe të ashpër politike edhe në media, janë tipare që tregojnë se klasa politike, si rezultat i edukimit patriarkal që ka shoqëria shqiptare, janë me prejardhje psikanalitike duke formuar një model pranimi “ky, ose ai”. (në K. Bajraba, A .Gassparini, 2001, po aty)

Retorika e ashpër nuk ndihmon komunikimin, por sundimin përmes një toni të ashpër, të sigurt dhe të kënaqur nga vetja të liderit politik, duke mos patur asnjë lloj qëndrimi kritik ndaj vetes dhe punës së kryer. Kjo për fat të keq, e ka shoqëruar politikën shqiptare gjatë gjithë tranzicionit. Mënyra e komunikimit të këtyre liderëve në fjalimet e tyre me fraza, të tilla si “unë ju siguroj“, “unë ju premtoj“, “unë ju këshilloj“ (në K. Bajraba, Agassparini, 2001) i japin një mesazh opinionit shoqëror sikur këta liderë politikë synojnë një sundim të përvetshëm. Në, fakt, është një mënyrë komunikimi që nuk jep përgjigje, pasi nuk shtron as pyetje të cilave t’u jepen përgjigje. Ndaj dhe në

kontekstin socio-politik nuk ka unitete politike me qytetarët, të cilët luajnë një rol aktiv në jetën politike.

Parë nga ky këndvështrim, i përdorimit të një gjuhe të ashpër dhe gati totalitare të politikanëve, të cilët nëpërmjet mimikës së tyre mundohen ta përdorin si armë për të mundur kundërshtarin, për të aplikuar sipas tyre vendosjen e shtetit të së drejtës nëpërmjet shenjave, si lëvizje të dorës apo të kokës, nuk ka kurrfarë modeli demokratik komunikimi në jetën politike shqiptare që ta përballojë këtë stil të gjuhës ekzistuese. Në rast se politikanët shqiptarë do të përdornin një gjuhë racionale, atëherë komunikimi do të bazohej tek toleranca dhe dialogu. Përkundër një stili të ashpër dhe totalitar të përdorimit të gjuhës, e vetmja zgjidhje mbetet përdorimi i një gjuhe urbane të sofistikuar dhe ironike e përdorur me kozmopolitizëm dhe që do të mund të sillte dhe një lloj vlerë simi nga faktori ndërkombëtar, i cili do të mund të arrinte të siguronte një model të politikanit të moderuar shqiptar me një komunikim të frytshëm. Mirëpo ky model politikani, për fat të keq, përbën një model të izoluar, pasi përfaqëson një model të folurit që, në fakt, lidhet me një hierarki të vlerave të cilat fatkeqësisht për shoqërinë shqiptare janë kthyer në një subkulturë urbanepasi i përkret një pjese ose shtrese të caktuar të shoqërisë e të elitës politike shqiptare.

Stili demokratik i një gjuhe të sofistikuar vërehet në atë që quhet “*dislokim kuptimi dhe që përfaqëson një lloj synimi për të manipuluar opinionin publik teksa ky i fundit është i përjashtuar nga komunikimi dhe vihet në rolin pasiv të vëzhguesit të lojës politike*. Gadamer thekson se, politika veçanërisht në periudha të tranzicionit, ka prodhuar një lloj dukurie normativiteti, pra të përdorimit të gjuhës si vegël të politikës si nga politikanët edhe nga media e shkruar dhe vizive” në (në K. Bajraba, A.Gasparini, 2001). Kjo, ka çuar në një retorikë politike, që ka kaluar nga fondi zanafillor i gjuhës

në një model vertikal të komunikimit në shoqëri, ku politika nuk e përdor gjuhën e saj për të shpjeguar, interpretuar apo argumentuar, por e përdor për të provokuar apo për të mobilizuar opinionin publik.

Përdorimi i një gjuhe racionale dhe që nuk i përket të shkuarës totalitare do të çonte në forcimin e demokracisë, pasi individit që dëshiron ta përdorë këtë gjuhë duhet të ketë parasysh dhe traditën europiane të komunikimit publik. Në këtë këndvështrim të komunikimit kemi dy paradigma të retorikës sunduese, që vijnë që nga koha e grekëve të lashtë: njëra është shkolla sofiste dhe tjetra, është ajo e Aristotelit. Pavarësisht se nuk kanë të bëjnë me studimin, po trajtojmë disa nga tiparet e këtyre dy paradigmave - pra ajo sofiste dhe arsitoteliane.

Është një retorikë që nuk e detyron atë që e praktikon të flasë për diçka në mënyrë konkrete, ka si qëllim që të arrihet efekti me dëgjuesit nëpërmjet çdo mjeti gjuhësor, shpesh dhe me shenja gjuhësore që nuk kanë lidhje semantike me gjërat reale dhe që kombinohen në mënyrë të vullnetshme. Ndërsa retorika sofiste duket se funksionon mbi bazën irracionale dhe të shpërdorimit të detyrës, ku gënjeshttrat dhe mashtrimet shtrihen në të gjitha nivelet dhe që retorikën politike shqiptare e gjen në të gjitha nivelet. E bazuar mbi një retorikë që udhëhiqet nga parime etike na paraqitet retorika arsitoteliane, pra argumentimi racional e udhëheq në komunikim e në politikë. Sipas kësaj mënyre të komunikimit, pjesa e elementeve irracionale duhen përjashtuar nga gjuha, ndërsa gjuha e tolerancës politike, e demokracisë, e paqes të bëjë çmos që strategjia e aktivitetit jo të dhunshëm të bëhet praktikë, gjithnjë kur flitet për tolerancë komunikuese dhe për shoqëri pluraliste.

Parë nga modelet e këtyre dy paradigmave, duke e përcaktuar komunikimin racional si premisë të gjuhës së marrëveshjes dhe dialogut, klasa politike do të mund t'i përafrohet

botës demokratike dhe të shumë përmasave në të cilën njeriu fisnikëron veten dhe të tjerët.

Parë nga këndvështrimi i vlerave dhe forcës që ka gjuha në një shoqëri demokratike, si dhe të rolit të saj në politikën moderne shqiptare, vihet re një keqpërdorim dhe një nivel i mjeruar i “gjuhës politike” (në G. Tushi, 2001, fq 265). Një gjuhë që e ka shoqëruar politikën e tranzicionit shqiptar gjatë gjithë kohës, sidomos gjatë fushatave të shfrenuara dhe të dala jashtë kontrollit etik për nga përmbajtja demokratike.

Përgjithësisht politika tradicionale shqiptare dhe veçanërisht ajo e periudhës së tranzicionit, ka qenë e ashpër dhe jo tolerante, ku shpeshherë përdorimi i gjuhës jo demokratike nga politikanët shqiptarë ka rënë aq poshtë sa ka arritur fundin, duke u kthyer në një debat të fortë e jo etik. Kjo lloj atmosfere në mjedisin politik shqiptar ka dhe shkaqet e veta, që janë jo gjuhësore. Dhe këtë e kupton çdokush, pasi në mungesë të një vizioni politike demokratik politikanët shqiptarë përdorin një gjuhë jo etike, brutale, gjuhë që ka një ndikim të madh në mjedisin shoqëror.

Kjo gjendje e gjuhës dhe e sjelljes së klasës politike shqiptare e cila për fat të keq ka çuar në një degradim moral dhe profesional, ka çuar në një bezdi qytetare, që shoqëria e merr si dhuratë nga klasa politike e saj. Një klasë politike me një gjuhë të shfrenuar dhe të paekuilibruar jo vetëm që dëmton performancën e klasës politike, por bëhet një pengesë serioze për qytetarin që të arrijë të kuptojë se ku qëndron në të vërtetë thelbi i debatit politik - esencën e çështjes të artikuluar nga “gjuha politike” që përdoret. Kaq intensiv është i folurit me tone ofenduese dhe banale, sa që është bërë e vështirë për qytetarin të arrijë të dallojë se ku është argumenti, ku fillon shpifja dhe ku mbaron retorika gjuhësore e përdorur si mjet për të fshehur objektin e vërtetë të konfliktit politik, pas “ambalazheve” gjuhësore të politikanëve (në G. Tushi, 2001, fq 166).

Gjuha e përdorur nga politikanët e ka humbur sensin e argumentit politik dhe shoqëria shqiptare është përballur me një klasë politike fjalamane, abuzive me të vërtetat, që shkel rregullat e komunikimit politik, element ky që ka çuar në degjenerime të përkohshme të gjuhës politike, sidomos kur objekti i debatit politik ka qenë delikat. Edhe pse, në vetvete, duket më tepër si qëllim, pasi mjedisi përbërës nuk e justifikon këtë gjuhë të përdorur dhe të artikuluar keq dhe jo vetëm krijon një imazh negativ për vetë politikën, por e rëndon gjendjen psikologjike të qytetarëve shqiptarë.

Kjo gjuhë e përdorur nga politikanët shqiptarë nuk është gjuhë politike, pasi esenca e saj nuk ka të bëjë me të vërtetën politike. Është një gjuhë që ka marrë forma të shëmtuara, që nuk tregon të vërtetën e debatit politik që lidhet drejtpërdrejt me të menduarit, nuk tregon as standardet elementare mbi të cilat bazohet të folurit politik i politikanëve, duke e cenuar rëndë nevojën për krijimin e një standardi gjuhësor elitare të klasës politike shqiptare gjatë gjithë tranzicionit.

Parë në këndvështrimin e krijimit të një standardi apo të një norme gjuhësore të klasës politike shqiptare, është i nevojshëm krijimi i një modeli aristotelian sipas të cilit individët që merren me politikë dhe me punët e shtetit duhet të kenë jo vetëm formim politik, por edhe gjuhësor dhe etik. Nga ky këndvështrim, vrazhdësia e gjuhës së klasës politike shqiptare, si dhe lufta për gjetjen e argumentit dhe përdorimin e përshtatshëm të gjuhës kanë nevojë për një formim intelektual, pasi politikanët shqiptarë flasin pa kujdes etik.

Përdorimi i kësaj gjuhe politike nuk është e keqja më e madhe e problemeve me të cilat përballlet politika shqiptare, edhe pse, natyrisht, duhet frenuar përdorimi i një gjuhe banale dhe jo të përshtatshme, në mënyrë që të zhvillohet një politikë e qytetëruar. Përdorimi i gjuhës politike pa përgjegjësi dhe pa forma etike çon në uljen dhe

ashpërsimin e komunikimit politik si qëllim të gjuhës në vetvete, duke ndikuar në debatin publik të qytetarëve, të cilët ndikohen nga gjuha e përdorur prej klasës politike të tyre, si dhe duke shtuar opinionet denigruese dhe militanteske më fyerje dhe sharje reciproke.

Kjo lloj gjuhe ka një ndikim negativ në cilësinë e jetës publike. Duke qenë se politika është fushëbeteja e debatit, politikanët duhet të ndeshen me një gjuhë etike mes tyre, që shpreh formimin e tyre intelektual, shpreh forcë të kontrollit dhe të zotërimit të pushtetit të jashtëzakonshëm të gjuhës politike si një mjet që duhet shfrytëzuar dhe jo shpërdoruar nga klasa politike shqiptare.

5.3 Procesi zgjedhor si pikënisje e ndërtimit të demokracisë dhe elitës së re politike

Gjithë historia e proceseve zgjedhore në Shqipëri është e shoqëruar me problematikë që rrjedh nga historia e shtetit shqiptar, formimi i qytetarit, zhvillimi ekonomik si dhe me mungesën e theksuar të elitave politike e modeleve referuese politike (në A. Krasniqi, 2009, fq13).

Pas rënies së sistemit komunist për zhvillimin e zgjedhjeve të para pluraliste në vend, ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste, partitë opozitare patën pak kohë në dispozicion për të organizuar përgatitjen për zgjedhjet që do të zhvilloheshin, duke u ndeshur me një sërë pengesash dhe vështirësish, të cilat u dhanë mundësinë komunistëve në pushtet që të përpunonin strategjinë për të ngadalësuar procesin e ndërtimit dhe të formimit të elitës së re politike. Kjo ka të bëjë me faktin se rrethi i elitës politike të partisë opozitare do të ishte më i gjërë dhe me plural nëse do të kishin më tepër kohë dhe do të perfshiheshin edhe shtresat tradicionale antikomuniste apo

nga diaspora? Proceset e përzgjedhjes së brëndshme partiake të elitës politike do të ishin me demokratike? Në shënimet e tij, Preç Zogaj argumenton se kishte mjaft moskuptime (pra jo vetëm çështje kohe) midis të djathtës konservatore antikomuniste të diaspores disa prej të cilëve erdhën të përfshihen në PD) dhe kundërshtarëve të regjimit që përfaqësoheshin nga intelektualët e niveleve të ndryshme. Preç Zogaj 2014 shprehet se për të përgatitur zgjedhjet e para pluraliste, drejtuesit e PD-së dhe disa nga homologët e tyre të rinj të PP-së po i futeshin këtij deti në këmbë me një ndërmarrje që nuk ishte provuar kurrë më parë. Lufta e brëndshme në PD bëri që intelektualë të kultivuar e të shquar të refuzonin përfshirjen në kandidim për PD dhe futjen në jetën politike aktive, siç ishte rasti i refuzimit të Jusuf Vrionit për PD. Nga biseda e zhvilluar mes tij dhe Zogajt ky i fundit shprehet se “nuk ishte rroba e tij stili i ashpër ,vulgariteti dhe arrogance që shperhnin disa prej figurave të reja politike. Autori thekson se i kishte thënë që nuk janë të gjithë intelektualë, dhe se ai ishte shprehur me zë të shuar e të mbytur gabim,gabim,gabim. Nuk është zgjigje kjo. Autori thekson se i kishte thënë se, kështu është Shqipëria, vjen rrallë në shijen tonë, ose vjen ngadalë, ku ka shprehur brengat e tij dhe për sjelljen e PD. Ai nuk dukej në formë për të ndjekur stilin dhe ritmin tonë, shprehet autori. Në bisedën me Berishën Zogaj shprehet se nuk reagoi nga refuzimi ku sipas tij, ndoshta vuante dhe ai që elita e fashës së traditës dhe kulturës nuk ishte fort entuziaste me alternativën tonë “.

Në raportin e Institutit Kombëtar Republikan për Çështjet Ndërkombëtare të vitit 1991 theksohet “Zgjedhjet e lira janë një proces dhe për zhvillimin e tyre nevojiten ligje demokratike zgjedhore, fushatë zgjedhore e lirë, votime të fshehta e të rregullta” (NRIIA, 1991). Por, sipas vëzhguesve amerikanë, zgjedhjet u monopolizuan nga Partia e Punës dhe partitë opozitare nuk patën mundësinë e organizimit dhe të përgatitjeve për

konkurrim të barabartë dhe të ndershëm, pasi ato hynë në fushatë pa pasur as strukturat dhe kapacitetet teknike dhe as mundësitë e organizimit elektorale. Pra, duket qartë se, që në konkurrimin e parë me partinë në pushtet, opozita u fut në konkurrimin zgjedhor në kushte jo të barabarta, element që i ka shoqëruar të gjitha fushatat zgjedhore të tranzicionit shqiptar.

Me dekretin numër 7442 të datës 17 dhjetor 1990, i cili përcaktonte rregullat për “krijimin e organizatave dhe shoqatave politike”, i është hapur rruga dhe formësimit apo kristalizimit të klasës politike demokratike shqiptare. Në zgjedhjet e vitit 1991 morën pjesë 11 subjekte politike, ku pesë ishin parti politike, një shoqatë (OMONIA) dhe pesë organizata të dala nga PPSH-ja. Në kushtet e një votimi me sistem mazhoritar, PPSH-ja arriti i ta ruante monopolin e saj mbi procesin zgjedhor. Në këto zgjedhje morën pjesë 1074 kandidatë (në A. Krasniqi, 2009, fq 32). Nga këta, në përfundim të zgjedhjeve, 21 deputetë të PPSH-së dhe 8 sekretarë të parë të PPSH-së në rrethe arritën të fitojnë mandatin e deputetit. Duhet mbajtur parasysh se një ndikim të madh pati dhe eksodi i madh i shqiptarëve përmes ambasadave, në gusht 1990. Duke u bazuar në analizën e zgjedhjeve të vitit 1991, e kryer nga NRIIA (1991), rezulton se ka një pabarazi të theksuar në diferencën e votave mes një kandidati të PPSH-së dhe një kandidati të PD-së, ku një deputet i PPSH-së zgjidhet me mesatarisht 6 526 vota kurse një deputet i PD-së me një numër mesatar 10 134 vota. Pra, nëse një deputet i PPSH-së do të ishte zgjedhur me mesataren e një deputeti demokrat, atëherë PPSH-ja do të kishte sipas studimit 61 deputetë më pak se numri total i deputetëve që ajo fitoi. Ndërsa nëse një deputet demokrat do të ishte zgjedhur me një mesatare të bazuar në atë të votave të një deputeti të PPSH-së, atëherë PD-ja do të kishte fituar 116 deputetë. Nisur nga fakti që rezultati i zgjedhjeve ishte ndryshe nga përlllogaritjet e mësipërme, kjo

tregon që partia në pushtet ishte në dijeni të mbështetjes së saj në masën popullore, ndaj dhe zbatoi atë ligj elektoral për ndarjen e zonave elektorale, duke ditur se qytetet mbështesnin lëvizjen antikomuniste. Për këtë arsye krijuan atë disbalancë të theksuar në numrin e votuesve në zonat ku mbështetja e komunistëve ishte më e madhe. Në analizë të këtyre të dhënave për zhvillimin e këtyre zgjedhjeve rezulton se ndikimi ruajtjes së pushtetit nga ana e PPSH në krahasim me PD që sapo ishte krijuar, dhe diferenca e zhvillimit të konkurimit zgjedhor që në fillim të demokracisë. Pra kemi një mos zhvillim të zgjedhjeve në kushte të pa barabarta dhe jo të lira. Zhvillimi i procesit zgjedhor në kushte të barabarta dhe të lira mes forcave politike është çështje që në fillim të tij.

Qeveria e parë e koalicionit në tranzicionin shqiptar ishte ajo e kryesuar nga Ylli Bufi, qeveri që njihet ndryshe si “Qeveria e stabilitetit” (në A. Krasniqi, 2009, fq 42), e cila në përbërje të saj kishte parti parlamentare dhe joparlamentare. Masat që ajo mori, me reformimin e rëndësishëm që iu bë legjislacionit kushtetues, shërbyen si pikënisje për krijimin dhe ndërtimin e një sistemi politik me pushtete të ndara dhe të balancuara. Por, pavarësisht këtyre hapave, u shfaqën probleme serioze në trajtimin e çështjes së të përndjekurve politikë. Kontrasti i madh që ekzistonte mes disidentëve të komunizmit dhe shtresës tradicionale, që ishte akoma në pushtet dhe që po i përshtatej mënyrës së re të jetesës duke u bërë iniciatorja e lindjes së biznesit privat, e uli reputacionin e PD-së. Stimulimi i kritikave për bashkëqeverisje me komunistët nga ana e PD-së shërbeu si një pikënisje për shfaqjen e rigrupimeve politike në një sërë partish të tjera, kryesisht të mbështetura mbi baza nacionaliste dhe kombëtare të trashëguara që nga koha e monarkisë. Të gjitha ato do të shërbenin si mbështetëse të PD-së gjatë gjithë tranzicionit, pasi të gjitha ishin ish-anëtare dhe mbështetëse të PD-së.

Rreziku i bashkëqeverisjes së demokratëve me komunistët ishte arsyeja se përse lidershpi demokrat në këtë periudhë nisi përpjekjet për prishjen e koalicionit dhe daljen nga qeveria, duke kërkuar largimin e ish-funksionarëve të lartë të sistemit komunist nga strukturat shtetërore. Duke qenë se qeveria e koalicionit dhe Parlamenti kontrollohej nga komunistët, është e qartë se qëllimi i nismës së PD-së ishte tensionimi i situatës politike dhe rënia e formulës bashkëqeverisëse me komunistët. Vendimi i 4 qershorit 1991, i dalë nga tryeza e partive politike me qeverinë, përcaktoi krijimin e një kabineti qeveritar të ri. PD kërkoj që qeveria të përbëhej vetëm nga ministra të PS-së ose nga intelektualë të pavarur. Përkrahja e variantit të dytë nga PS-ja krijoi mundësinë e formimit të një qeverie teknike, në përbërje të së cilës të ishin ministra pa angazhime politike, por që në fakt kishin qenë dhe do të ishin aktivë në politikë edhe në të ardhmen.

Pas zgjedhjeve të vitit 1992, ligji elektoral i këtij viti kishte si qëllim t'u mundësonte partive të vogla që të fitonin mandate, në mënyrë që t'u hiqej monopoli partive të mëdha, PD dhe PS, për të kontrolluar jetën politike të vendit. Kjo ndihmoi daljen në skenë të një partie të tretë që ishte PSD-ja, ndërsa vendosja e kufirit 4 për qind për të hyrë në Parlament mënjanoi partitë e vogla politike.

Pas ardhjes në pushtet PD-së, prova e tyre elektorale ishte zhvillimi i referendumit për Kushtetutën, i pari në historinë e shtetit shqiptar, i cili u shoqërua nga ana e klasës politike me debate të ashpra dhe akuza të ndërsjella mes palëve. Kriza e vitit 1992 në PD, që u shoqërua me largimin e gjashtë deputetëve, mjaftoi që t'i hiqte asaj pushtetin e mazhorancës absolute. Krijimi i partive të reja si dhe rreshtimet e tyre në krah të kundërt me PD-në apo dhe pozicionet neutrale të disa partive, ishin shenjat paralajmëruese të iniciativës së re politike që kishte marrë përsipër të kryente PD-ja.

Ndryshimi i Komisionit Kushtetues, i cili më parë ishte i përbërë nga ekspertë të jurisprudencës, dhe futja në të e personave politikë, është tregues se, që në hapat e parë të ndërtimit të shtetit dhe të institucioneve demokratike, politika ka ndërhyrë në funksionimin e tyre.

Pamundësia e mazhorancës për të miratuar draftin Kushtetues ishte një hap mbrapa në vendosjen e institucioneve dhe forcimin e demokracisë, pasi e acaroi dhe më tepër situatën politike në vend duke qenë se Presidenti i kohës Sasli Berisha, ndërmoi një fushatë të gjerë mitingjesh në gjithë vendin. Kjo fushatë për referendumin u shoqërua me retorikë ideologjike, fjalime butaforike e pjesëmarrje të detyrueshme të nxënësve të shkollave apo dhe punonjësve të administratës shtetërore. Ndërsa partitë e tjera politike në koalicion apo dhe shoqata iu kundërvunë fushatës së qeverisë, duke shpallur si slogan "shndërrimin e Presidentit në mbret" duke paralajmëruar kthimin e diktatorit në pushtet. Fakti që demokracia shqiptare ishte shumë e re, vetëm dyvjeçare, me një kryetar të opozitës të burgosur dhe në kushtet kur me ish-komunistët ishin bashkuar dhe të burgosurit politikë, do të bënte që oferta ideologjike e pushtetit natyrshëm të kishte efektin domino, pra do të rrëzohej.

Në kushtet e mungesës së sondazheve, me mitingjet euforike të organizuara në mbështetje të Kushtetutës dhe mendimi se kishte përballë një opozitë të përçarë e bënte që të mendonte në fitoren e tij.

Por, sipas Këshillit të Europës, arsyeja e mosmiratimit të projekt-kushtetutës nuk kishte të bënte shumë me tekstin e saj, pasi ai nuk u diskutua në publik, por ishte mosmiratimi i gjendjes në të cilën ndodhej vendi në atë kohë (*Këshilli i Europës, 1995*).

Zhvillimi i zgjedhjeve politike të vitit 1996 përbën një ndër pikat apo momentet kryesore të zhvillimeve politike të gjithë tranzicionit shqiptar, pasi këto zgjedhje testuan jo vetëm forcat demokratike në përballjen e tyre të parë politike pas ardhjes në pushtet, por dëshmuuan dhe rëndësinë që zgjedhjet kishin për mjedisin e ri politik shqiptar dhe për demokracinë në vend. Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve është cilësuar si një shans i humbur për demokracinë shqiptare, pasi ato jo vetëm u shoqëruan me incidente dhe kontestime të mëdha, por edhe me bojkotin e opozitës, duke i lënë qeverisë përqindjen më të madhe parlamentare në të gjithë vendet e ish-Bllokut Lindor (*Këshilli i Europës, 1995*). Zhgënjimi që shkaktoi klasa politike me administrimin e zgjedhjeve si dhe me kërkesat e opozitës, solli dhe vënien në diskutim të partneritetit dhe të integritetit të qeverisë shqiptare me BE-në dhe SHBA-në.

Zgjedhjet e vitit 1996 kishin rëndësi të veçantë jo vetëm për klasën politike shqiptare, por dhe për faktorin ndërkombëtar, pasi ato ishin testi në të cilin do të vihej klasa politike, demokracia shqiptare dhe standardet e saj. Prandaj, mungesa e legjitimitetit të tyre ishte një shans i humbur për klasën politike dhe demokracinë e brishtë shqiptare.

Sipas studiuesit Afrim Krasniqi, në një studim të Institutit Republikan Amerikan (IRI), i publikuar më 30 maj 1996, në të cilin merren në analizë situata paraelektorale dhe tiparet e partive politike konkurruese në zgjedhje, nënvizohen pesë ngjarje të rëndësishme të pas vitit 1992, të cilat influencuan në këto zgjedhje. Ngjarja e parë që pati ndikim ishte arrestimi i kryetarit të opozitës në vitin 1993; e dyta, ishin zgjedhjet e pjesshme lokale, që u shoqëruan me akte dhune dhe cenimin e standardeve, dështimin e projekt-kushtetutës me anë të referendumit të vendosur nga Presidenti, votim që pati vështirësi të mëdha, si dhe shkarkimin e kryetarit të Gjykatës së Lartë nga Presidenti. Kështu, si rezultat, për vëzhguesit amerikanë, zgjedhjet e vitit 1996 ishin pika kulmore

e asaj rënieje që kishte filluar që në vitin 1993. Pra, që në hapat e parë të saj, demokracia shqiptare dhe klasa politike ishin në përballje me standardet e demokracisë, të cilat i humbën.

Zgjedhjet politike të vitit 2001 shënojnë një tjetër pikë thelbësore në testimin e klasës politike shqiptare, pasi këto zgjedhje do të ishin të parat zgjedhje, të cilat do të organizoheshin nga PS-ja që pas vitit 1991 dhe ishin zgjedhje që do të dëshmonin aftësinë e politikës shqiptare për të mundur dhe garantuar procesin zgjedhor me standarde të lira dhe demokratike, standarde të cilat në zgjedhjet e mëparshme nuk ishin arritur. Gjithashtu, edhe këto zgjedhje, nga ana e klasës politike u shoqëruan me mungesë të besimit reciprok, gjë e cila është e dukshme në konfliktet e brendshme politike të koalicioneve lidhur me raportet dhe procesin e bashkëpunimit me aleatët.

Nga analiza e kryer nga Afrim Krasniqi (2009) në të dy kampet politike, rezulton se PS-ja gëzonte mbështetje nga Perëndimi, pasi qeveria shikohej si faktor stabiliteti dhe partner i besueshëm me institucionet ndërkombëtare dhe konstruktiv në spektrin e brendshëm politik. Ndërsa opozita ishte mosbesuese dhe agresive ndaj sistemit elektoral. Pasja në shërbim të qëllimeve elektorale i të gjithë arsenalit shtetëror është tipar i pothuajse të gjitha qeverive në fushatat elektorale. Edhe në zgjedhjet e vitit 2001, PS-ja e kishte në dispozicion tërë këtë arsenal, dhe sipas Krasniqit, ajo vinte me një bilanc pozitiv arritjesh, përpos faktit që pati një harmonizim të bashkëpunimit mes krerëve kryesorë të kësaj partie, gjë e cila e bënte të kishte të gjitha mundësitë për fitoren elektorale. U keqinterpretuan apo dhe u keqkuptuan kritikrat ndërkombëtare ndaj opozitës, e cila nga ana e saj i cilësoi si mbështetje ndaj mazhorancës. Në kushtet e një përçarjeje të brendshme në PD, e cila ishte e izoluar nga faktori ndërkombëtar dhe e dominuar nga figura, me një mungesë programi apo vizioni të qartë politik për

rikthimin në pushtet, element të cilin kjo parti e paraqet dhe aktualisht në opozitë. PD-ja në zgjedhjet e vitit 2001 karakterizohej nga mungesa e qetësisë dhe e strategjisë elektorale për të ardhur në pushtet, gjë e cila e bënte që ta cilësonte betejën elektorale si një luftë për jetë a vdekje dhe me një mosbesim të theksuar në procesin elektoral. Këto bënë që kjo parti të zhvillonte një fushatë elektorale të bazuar në parulla ideologjike dhe antikomuniste. Por, vija e ashpër e drejtimit të PD-së dhe refuzimi i bashkëpunimit me aleatët, duke i cilësuar si tradhtarë të opozitës, bënë që me një vendim të nxituar të lidërshit të opozitës të refuzohej çdo ofertë për bashkëpunim elektoral. Në kushtet e konkurrencës jo vetëm me mazhorancën, por dhe me partitë e vogla të së djathtës, PD-ja vendosi që të kandidojë në zgjedhjet e vitit 2001 figurat kryesore të partive aleate në listën proporcionale, gjë e cila do të kishte një kosto elektorale për vetë PD-në. Në krahasim me skemën elektorale të PD-së në vitin 2001 me atë të PS-së të vitit 1992, sipas studiuesit *Krasniqi (2009)* duhet thënë se ka zhvillime të njëjta, por me dallimin se PS-ja përfitoi maksimalisht nga mandatet proporcionale duke futur 32 deputetë në Parlament, të cilët ishin politikanë profesionistë të karrierës dhe që ishin të aftë të bënin politikë aktive. Kjo përvojë në zgjedhjet e vitit 2001 nga ana e PD-së u injorua, për arsye të ndryshme, lidërshi i PD-së nuk i kushtoi rëndësi shumë listës proporcionale, pasi nuk besonte në fitore, dhe në një rast të tillë kjo nuk kishte shumë rëndësi, kjo pasi në rast të fitores së gjysmës së mandateve në mazhoritar, lista e proporcionalit do t'u kalonte aleatëve të partive të tjera politike, dhe shumë prej aleatëve të PD-së do të mbeteshin jashtë Parlamentit. Kjo përlllogaritje e PD-së bëri të mundur që aleatët e saj të ishin të interesuar jo vetëm për fitoren e zgjedhjeve, por edhe për përfaqësimin e tyre personal e politik në Parlament. Kjo solli si pasojë koston elektorale që duhej të paguante PD-ja duke iu marrë në tavolinë 14 deputetë nga aleatët, të cilët ishin politikanë të lartë e drejtues të këtyre partive.

Mungesa e figurave politike dhe me përvojë e autoritet publik në PD i detyroi demokratët të pranojnë një kompromis të brendshëm duke zgjedhur kandidatët nga dy kategori, që përbëheshin prej: një grupi intelektualësh liberalë, të cilët ishin edhe pa përvojë dhe njohuri politike, por që ishin një imazh i mirë elektorale, dhe grupi tjetër, të cilët ishin militantë politikë, që edhe pse nuk kishin formim politik dhe aftësi profesionale, ishin garanci e fitores së PD-së në zonat ku ata konkurronin.

Si konkluzion, mund të themi që zbatimi i strategjisë së gabuar për të gjetur zgjidhje të momentit nga ana e klasës politike është i gabuar dhe pa rendiment në zgjidhjen e konfliktit politik, pasi ofron zgjidhje të momentit dhe jo afatgjata. Ky është një ndër tiparet kryesore që e ka shoqëruar të gjithë klasën politike gjatë tranzicionit, në lidhje me gjetjen e kompromisit apo dhe në vendimmarrjet politike.

Megjithatë, fushata elektorale e vitit 2001 pati arritjet dhe problemet e saj. Sipas raporteve monitoruese ndërkombëtare në unison, përgjithësisht kishte përparim në krahasim me zgjedhjet e kaluara për sa i përket zhvillimit të fushatës dhe administrimit të zgjedhjeve. Ndonëse partia në pushtet arriti të krijojë një qeveri, ajo që kërkohet ishte një vullnet më i madh për të përmbushur plotësisht standardet ndërkombëtare. Në raport konstatohet se, “procesi zgjedhor ishte i tejzgjatur, konfliktual, i pasigurt dhe i fragmentarizuar“ (në Krasniqi, 2009, fq 218).

Viti 2005 shënon një tjetër test të rëndësishëm për klasën politike shqiptare dhe aftësinë e saj për të organizuar dhe administruar procesin zgjedhor, pasi ai kishte të bënte jo vetëm me stabilitetin politik, por dhe me aspiratat integruese euroatlantike. Rëndësia që kishin këto zgjedhje për zhvillimin e qëndrueshëm të procesit demokratik në Shqipëri u vlerësua nga faktori ndërkombëtar dhe politika vendase. Raportet ndërkombëtare e theksonin këtë moment si provë vendimtare të zhvillimit të demokracisë së

qëndrueshme. Për zhvillimin e zgjedhjeve që do të organizoheshin në vitin 2005, partnerët ndërkombëtarë të BE-së, KE-së, OSBE-së dhe SHBA-së, me anë të mesazheve publike, i ftonin shqiptarët dhe klasën politike të organizonin zgjedhje demokratike në këmbim të miratimit për MSA-në (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit) me BE-në dhe rritjen e shanseve për ftesën e anëtarësimit në NATO.

Për këtë qëllim, në vitin 2005 u shënuan ndryshime të rëndësishme në sistemin zgjedhor të votimit. Megjithatë, misioni i ODIHR-it theksoi: *“Fenomeni Dushk 2001 po përsëritet dhe përpjekje të tilla e vënë në provë ligjin përtej kufijve të pranueshëm, duke paralajmëruar se ato fenomene nuk duhet të përsëriten, me qëllim dëshmimin e një vullneti të qartë politik për zhvillimin e zgjedhjeve tërësisht demokratike dhe për të mbrojtur përmirësimet e arritura. Vëzhguesit deklaronin se tabloja kombëtare politike mbetej e mbizotëruar nga PS-ja, PD-ja dhe aleatët e tyre tradicionalë”* (në A.Krasniqi, 2009, fq 262).

Ndërkohë, konfliktualiteti i thellë politik në PS inicion krijimin e një partie të re politike, LSI-së. Ajo do të ishte një faktor i rëndësishëm i këtyre zgjedhjeve për balancat elektorale të vitit 2005. Po ashtu, në krahun e djathtë kemi krijimin e një koalicioni të gjerë me forca politike të së djathtës, në të cilin, në ndryshim nga viti 2001, u bë pjesë edhe Partia Demokratike e Reformuar. Gjatë zhvillimit të procesit elektoral, si para dhe gjatë zgjedhjeve, partitë kryesore bënë përpjekje për të ndryshuar apo dhe përmirësuar imazhin e tyre publik. U organizuan kongrese elektorale nga PS-ja dhe PD-ja, duke tentuar të përfshijnë në listat e tyre të kandidatëve emra të pakonsumuar në opinionin publik. Konkretisht, e tillë ishte dhe përpjekja e PD-së, nëpërmjet organizimit të një strukture të re të quajtur Komiteti i Orientimit të Politikave (KOP), në përbërje të të cilit kishte figura të reja e të shkolluar në Perëndim apo dhe

individë të cilët ishin të aktivizuar në grupet e shoqërisë civile. Një pjesë e tyre konkurroi dhe u përfshi në jetën politike dhe parlamentare, duke u bërë më pas edhe anëtarë të kabinetit qeveritar.

Misioni vëzhgues ndërkombëtar për zgjedhjet e vitit 2005 në përfundim të tyre konkludoi se, zgjedhjet ishin në përputhje vetëm pjesërisht me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare demokratike dhe shënuan disa përparime në zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Gara elektorale kishte konkurrencë dhe zgjedhësve iu ofruan mundësi të gjera zgjedhjeje mes një sërë partish politike. Megjithatë, procesi ishte i tejzgjatur dhe ndonjëherë i pasigurt - (OSBE/ODIHR, *“Raporti i Misionit të Vëzhguesve të Zgjedhjeve “ Varshavë, 7 nëntor 2005)*. Megjithatë, në raport përmenden dhe arritjet e fushatës së vitit 2005, ku vlen të theksohen ndryshimet konsensuale në legjislacionin zgjedhor për ndarjen e zonave elektorale, fushatë e qetë, puna e KQZ-së, regjistrimi i zgjedhësve etj.

Në dallim nga viti 2001, në zgjedhjet e vitit 2005 kishim 15 parti të përfaqësuara në Parlament, nga 12 të tilla në vitin 2001. Gjatë punimeve të Parlamentit 2001-2005 lindën tri parti të reja: LSI-ja, LDNJ-ja dhe PDS-ja, kjo e shoqëruar me transferim deputetësh nga njëra parti tek tjetra.

Në zgjedhjet e vitit 2005, KQZ-ja regjistroi 57 parti si subjekte zgjedhore, ku 10 prej tyre nuk paraqitën kandidatë në asnjërën listë zgjedhore, shenjë kjo e mos përfqëimit dhe mos qarkullimit të elitës politike. Fenomen tipik i zgjedhjeve të vitit 2005 ishte taktika elektorale e dhurimit të votës nga ana e partive të mëdha për partitë e vogla. Partitë e mëdha nënshkruan koalicione me partitë e vogla aleate. Në marrëveshjet e tyre, ato angazhoheshin që të regjistronin në listat nën siglën e secilës parti emra kandidatësh dhe nga kjo taktikë çdo parti regjistrohej edhe më vete, edhe në emër të

koalicionit. Pas votimit, për çdo parti, në bazë të numrit të votave bëhej dhe ndarja e mandatit. Kjo ishte një taktikë elektorale që u aplikua në zgjedhjet e vitit 2005 si përpjekje për të fituar një numër sa më të madh vendesh në Parlament nga ana e partive politike dhe e koalicioneve politike, përtej përcaktimit të parimit kushtetues. Në analizë të këtyre zgjedhjeve, ato shënuan një rritje të konkurrencës mes kandidatëve kryesorë politikë. Një nga risitë e këtyre zgjedhjeve është dhe se partitë politike në listat e tyre të kandidatëve futën emra nga nominal në mazhoritar, duke bërë që votuesit militantë të votonin pa qenë në dijeni se kjo votë ishte e vlefshme edhe për ta. Kështu u futën në botën e politikës emra nga fusha e biznesit, ushtrisë, policisë apo prokurorisë.

Zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, u vlerësuan nga OSBE/ODIHR si një përmirësim krahasuar me praktikën e mëparshme dhe se e plotësuan shumicën e standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, u identifikuan mangësi dhe u bënë një numër rekomandimesh për zgjedhjet e ardhshme. Raporti thekson se zgjedhjet treguan përparim të prekshëm, veçanërisht në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe procesin e identifikimit, kuadrin ligjor, votimin, numërimin dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Megjithatë, raporti shtoi se zgjedhjet nuk arritën standardet më të larta dhe se politizimi i numërimit dhe përgatitjes së tabelave përmbledhëse minoi besimin e qytetarëve te procesi zgjedhor.

5.4 Raporti mes elitës politike dhe shoqërisë civile

Në mjedisin politik dhe shoqëror shqiptar, koncepti për shoqërinë civile është disi një fenomen i ri. Por që intelektualët nuk i kanë munguar vendit tonë, kjo nuk ka dyshim. Ka një fenomen disi shqiptar të raportit mes politikës, intelektualit, shoqërisë civile dhe partive politike, ndryshe nga vendet e tjera të Bllokut të Lindjes. “Vihet re një argumentim se intelektualët nuk e kanë fort qejf angazhimin dhe kontributin e tyre

në politikë, por sipas studiuesit ky qëndrim i politikës nuk ka analogji me realitetin dhe politikën moderne. Sipas tij, është politika shqiptare e të gjithë krahëve që nuk e ka qejf fort elitën e re intelektuale dhe profesioniste, pasi nuk është në gjendje të jetë në kompeticion me të” (në Gëzim. Tushi , 2010).

Aludimet me faktin se shoqëria civile nuk merret me politikë dhe se nuk bën pjesë në strukturat e shtetit kanë të bëjnë me kompleksin e klasës së vjetër politike, e cila ndihet e kërcënuar përballë çdo afrimi të përfaqësuesve të shoqërisë civile në politikën intensive, për shkak të vlerave që përfaqësojnë. Vërehet përpjekja nga ana e klasës politike për ta përdorur shoqërinë civile si “tapë shpëtimi” sa herë që partitë politike kanë nevojë për të përmirësuar imazhin e tyre të besimit apo të krizave të vlerave që kalojnë. Shoqëria civile, intelektualët por dhe profesionistët, nuk kanë si objektiv thjesht “angazhimin politik” dhe nuk kanë parametrat e militantëve politikë.

Në mesazhin e tij drejtuar Konferencës së Parë Kombëtare “ Mbi çështjet zhvillimore të OJF në Shqipëri” ish presidenti A. Moisiu me 23 shtator 2002 thekson se, periudha e krijimit të Organizatave të para Jofitimpruresë përkon me moshën e transformimeve demokratike në vendin tonë. Ndonëse në një mjedis të ri politik e social, me një shoqëri autarkike të trashëguar dhe me një komunitet biznesi në krijim e sipër, në një kohë të shkurtër këto organizata u bënë një zë i fuqishëm mbështetës i proceseve demokratike. Ato i dhanë një frymë të re politikës shqiptare, duke ofruar përfaqësuesit më të shquar të këtij komuniteti, me vizion bashkëkohor e frymë civilizuese. Gjë që shpreh edhe një herë evoluimin e procesit politik në vendin tonë. Si “sektori i tretë” dhe si një fakt shumë i rëndësishëm nuk mund të anashkalohet por që padyshim merret në konsideratë në procesin e perfeksionit dhe të konsolidimit të institucioneve të shoqërisë sonë demokratike. Perceptimi i opinionit publik mbi këto institucione dhe rekomandimi i

rrugëbe për rritjen e efektshmërisë së qeverisjes në tërësi, është përcjellë dhe përcillet më dinjitet, profesionalizëm dhe guxim qytetar nga ana e organizatave Jofitimprurëse. Roli i shoqërisë civile në vendin tonë është një proces i gjatë dhe kompleks, që kërkon kapërcimin pa hezitim të fraksionimit të shfaqur më parë në këtë sektor, për interesa politike. Rritjen e ndikimit mbi komunitetin apo grupin social që përfaqëson, fokusimin më të mirë mbi politikat publike dhe të mbrojtjes së tyre, zgjerimin e edukimit publik mbi sundimin e ligjit, dhe atij patriotik mbi bazën e vlerave më të mira njerëzore dhe universale dhe të trashëgimisë sonë kombëtare më të mirë, ndërtimin e partneriteteve vepruese midis organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve shtetërore përkatëse. Nën shembullin e përvojave më të mira përëndimore, edhe komuniteti i biznesit mund ta mbështesë veprimtarinë e këtyre organizatave, për më tepër kur kuadri ligjor mundëson një gjë të tillë. Por që të arrihen objektiva madhore, duhet të rritet transparenca në funksionimin dhe në menaxhimin e brendshëm të organizatave jofitimprurëse, dhe të ngrihet në një stad të ri roli i bordeve drejtuese të tyre dhe të shmangët konflikti i interesave, sidomos trafik i influencës nga ana e politikanëve, të inkurajohet shtrirja e organizatave jofitimprurëse dhe e veprimtarisë së tyre edhe në qarqe e komuna, veçanarisht në zonat malore të vendit. Në këtë mënyrë veprimtaria e tyre dhe mjedisi në të cilin veprojnë këto organizata do të bëhet më konkurrues dhe, veprimtaria e tyre gradualisht do të kalojë nga veprimtari e drejtuar kryesisht mbi përparësitë e donatorëve, në një veprimtari të orientuar drejt shërbimeve publike dhe sociale, në interesat e komunitetit dhe të motivuar mbi baza profesionale dhe intelektuale. Kështu do të mundësohet jo vetëm konservimi i vlerave të krijuara me aq mundim, por edhe rritja e ndikimit të elitës së vendit në proceset ekonomike, politike, sociale, si dhe përzgjedhja më e mirë e rrugëve të zhvillimit dhe zvogëlimi i kostos së procesit të tranzicionit tonë drejt ekonomisë së tregut dhe shoqërisë së lirë”.

Pa dyshim që ka një problem të madh mes puritanizmit të shoqërisë civile dhe “pisllëkut” të politikës, ku sipas Tushit i cili i referohet Erhard Eplerit, një politolog gjerman, i cili thotë se politika është afërsisht si kënetë dhe nëse dëshiron të kalosh nëpër të do të bëhesh “pis” (në G. Tushi, 2010, fq 365). Kjo do të thotë se është e vështirë të futesh në kënetën e politikës dhe të mbetesh i pastër.

Në rast se shoqëria civile qëndron indiferente ndaj zhvillimeve, kjo është shpresë për individët që dinë të bëjnë politikë kafenesh dhe që jetojnë mirë vetë, po kështu edhe familjarët e tyre. Qëndrimet e politikanëve si “miq” të librave dhe intelektualë janë përpjekje për të marrë sa më shumë vota dhe për të ndenjur sa më gjatë në pushtet, qëndrim i cili ka krijuar bindjen në popull, se kërkojnë vota dhe jo afirmimin e vlerave dhe të kapaciteteve intelektuale për të qeverisur.

Megjithatë, ka filluar një garë e partive politike për të siguruar sa më shumë vëmendjen e shoqërisë civile, duke u përpjekur që nëpërmjet kësaj vëmendjeje të rikuperojnë dy probleme që ka sot politika shqiptare: atë të përmirësimit të imazhit politik të konsumuar si subjekte politike dhe rritjen ose kompensimin e kapaciteteve nominale të politikanëve të konsumuar. Këtë nevojë të tyre në të vërtetë, partitë politike po përpiqen ta servirin në nevojën për bashkëpunim me shoqërinë civile. Kjo është një përpjekje pozitive nga ana e klasës politike, por sa e sinqertë është kjo përpjekje nga ana e partive politike në këtë thirrje për bashkëpunim, duke tërhequr në strukturat e drejtimit dhe të menaxhimit të partive politike përfaqësuesit më të mirë të shoqërisë civile?

A është në të vërtetë objektivi i politikës për të shfrytëzuar në mënyrë pozitive ekselencën e shoqërisë civile, apo po mundohet ta përdorë reputacionin e saj të pastër për të përmirësuar imazhin e saj për qëllime pragmatiste në prag të një konkurimi

220

politik? Politikës shqiptare nuk i mungojnë individët me një karrierë të gjatë politike, por siç duket e ka kuptuar se fitoret politike kërkojnë ndryshime në programe, menaxhim dhe ide si dhe ndryshimin e një pjese jo të vogël të individëve që kanë një kohë të gjatë në politikë. Kjo, natyrisht, ka të bëjë dhe konsumimin e të gjithë komponentëve esencialë dhe me vlera për konkurrimet e ardhshme politike. Natyrisht që në partitë politike ka shumë individë, të cilët janë të dërmuar nga akuzat publike për korrupsion por që rrinë larg debatit për të qëndruar në heshtje e për të shmangur akuzat nëpërmjet harresës kolektive.

Një tjetër këndvështrim nga i cili duhet analizuar ky raport mes shoqërisë civile dhe elitës politike të vendit, si dhe i impaktit që jep ky raport në mjedisin shoqëror të vendit, mendojmë se është dhe aspekti i ndërtimit të këtij raporti krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe të Europës Lindore. Ndryshe nga vendet e tjera të rajonit dhe të Europës Lindore, ku sistem komunist nuk pati në të gjitha shtetet të njëjtin instalim të totalitarizmit komunist, kjo sipas studiuesit Tarifa (2009) argumenton se, shoqëria civile nuk u shkatërrua në të gjitha këto vende në të njëjtën shkallë. Këtë e tregojnë zhvillimet e ndodhura në vazhdimësinë e shoqërisë civile, si në Poloni, Hungari apo dhe në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri, ku ekzistenca e shoqërisë civile ishte e paimagjinueshme jo vetëm për shkak të komunizmit, por edhe si pasojë e trashëgimisë së sundimit osman. Ndërtimi i këtij lloj raporti të shtypjes dhe të represionit ndaj shoqërisë civile gjatë komunizmit, padyshim, la gjurmën e vet te shoqëria shqiptare si dhe ndaj intelektualëve shqiptarë, sidomos pas viteve '60 të shekullit XX, kur shtypja, represioni dhe vrasjet e tyre çuan në pothuajse eliminimin e plotë të disidencës antikomuniste.

5.5 Politika dhe politikanët shqiptarë, në përpjekje për të ndërtuar “shtetin modern”

Në përpjekjet për ndërtimin e një modeli të demokratik shtetformues të shqiptarëve të pas viteve '90, kanë hasur pengesa të mëdha në ndërtimin e institucioneve politike, shoqërore dhe kulturore. Institucionet shtetërore nuk e kanë fituar ende fuqinë e nevojshme për të prodhuar rezultatet e dëshiruara nga të gjithë, por dhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, pasi mentaliteti vjetër politik i trashëguar dhe në kulturën politike e shoqërore ka ndikuar në efikasitetin e klasës politike për ndërtimin e shtetit demokratik. Në fjalimin e mbajtur përpara Kuvendit të Shqipërisë në 5 shtator 2002 ish Presidenti A. Moisiu se, “ ne po bëjmë shumë politikë, por njerëzve të thjeshtë u ofrohen akoma pak ose aspak zgjidhje për hallet e tyre të jetës së përditëshme. Ka ardhur koha për të mos bërë politikë pa bukë, por për interesat e shtetasve, dhe interesat e tyre janë kryesisht ekonomike. Niveli ekonomik është treguesi më i qartë i suksesit të punës sonë”. Gjithashtu me 4 Tetor 2002 në një fjalim mbajtur në Konferencën Kombëtare Gjyqësore ish presidenti Moisiu thekson se “ Mbylljani derën politikës. Ajo ka punët e saja, ju tuajat. Sa më të vendosur të jeni në zbatimin e ligjeve, aq më të vlerësuar dhe të nderuar do të jeni nga e gjithë shoqëria, përfshi dhe politikanët”.

Zhvillimi ekonomik është i ulët dhe niveli i jetesës mbetet ende i ulët në krahasim me vendet e tjera. Shoqëria shfaqet hera-herës konfliktuale deri dhe në ekstreme (sidomos, në fushata zgjedhore), pasojë kjo e luftës politike e cila ka sjellë ngërç në zhvillimin e vendit. Prandaj vëmendja e gjithë shoqërisë shqiptare mbetet e drejtuar nga politika dhe në kërkim të një klase politikanësh të rinj. Ky lloj i ri politikanësh me veprimtarinë e tyre duhet të kontribuojnë në ndërtimin e një mjedisi politik që synon ushtrimin e pushtetit dhe jo sundimin me anë të pushtetit.

Partitë politike që u formuan pas rënies së sistemit komunist kishin si kusht funksionimin e shtetit demokratik dhe një lulëzim të partive politike pas çarjes së akullit të sistemit diktatorial një dukuri kjo e pashmangshme në një sistem demokratik dhe tipar themelor i demokracisë.

Kemi një dualizëm të sistemit partiak në parti të majta dhe të djathta dhe po t'i referohemi filozofisë së Duverger në (në D. Luis Seiller, 2013) në lidhje me krijimin e "qendrës", ai thekson se krijohet nga loja e dy faktorëve kryesorë: *fraksionizmi* dhe *mbivendosja*. Pra fraksionizmi, zhvillohet në dy drejtime të kundërta, drejt qendrës dhe ekstremeve, dhe nga qendra që lind si pasojë e centrizmit dhe që i shkëput të moderuarit. Lëvizjet në ekstreme i kundërshtojnë zakonisht kompromiset për ngjarje të papritura që sjell ushtrimi i pushtetit, dhe kjo lëvizje vazhdon deri në kufijtë e imponuar nga pragu elektoral i përfaqësimit sipas sistemeve elektorale.

Për të bërë sa më mirë këtë prezantim të këtyre tipareve, dëshiroj ta filloj me prezantimin e konceptit politikë, mjaft mirë i përshkruar nga M. Veber (2008) në librin e tij "Politika si shkencë dhe si profesion. Tre tiparet e pastër të sundimit legjitim".

Me anë të këtij prezantimi merret në analizë se ç'është politika, sa është kuptuar politika si profesion nga ana e politik-bërësve shqiptarë dhe cila kategori e politikanëve po mbizotëron sot në jetën politike shqiptare, gjithnjë duke iu përmbajtur filozofisë së Veberit.

Koncepti "politikë" është mjaft i gjerë dhe përfshin mjaft fusha të veprimtarisë drejtuese në mënyrë të pavarur. Me termin "politikë" në këtë studim dua t'i drejtohen asaj pjese të konceptit politik që ka të bëjë me drejtimin ose ndikimin e një formacioni politik që është "shteti".

Si mund ta definojmë termin “politikë”? Si përpjekje për të patur pjesë të pushtetit apo përpjekje për të ndikuar në shpërndarjen e pushtetit. *”Shteti, si të gjitha formacionet politike pararendëse të tij në historinë njerëzore, është një marrëdhënie që bazohet mbi sundimin e njerëzve ndaj njerëzve e cila mbështetet në përdorimin e dhunës legjitime. Me qëllim që shteti të ekzistojë dhe njerëzit nën sundimin e tij patjetër duhet t’i nënshtrohen çdo autoriteti të sunduesve”*(në M. Veber, 2008, fq 155).

Kur dhe përse i binden njerëzit shtetit? Përgjigjen e kësaj pyetje mund ta marrim duke shqyrtuar tri arsye të përligjes së legjitimitetit të një sundimi, autoriteti i së djeshmes apo autoriteti i zakonit. Në këtë tip të autoritetit gjen shprehjen e tij tipi i sundimit tradicional, që bazohet në zbatimin e tij në sajë të vlefshmërisë së vjetër dhe nëpërmjet gatishmërisë për ta respektuar. Tipi më i pastër i këtij sundimi është “Sulltani” (M. Veber, 2008, po aty). Të gjitha “Despotatet” kishin këtë karakter sundimi.

Sipas këtij tipi të sundimit, njerëzit nuk i binden personit mbi bazën e së drejtës së tij private por mbi bazën rregullit statutor, në të cilin përcaktohet se kujt duhet t’i binden dhe deri në ç’skallë duhet të binden. Obligimi në bindje është i shkallëzuar me varësinë e posteve më të ulëta, deri në ato më të larta, si dhe procedurë të rregulluar të ankimimit. Ndërtimi i një aparati burokratik nuk është i vetmi element që hyn në strukturën e një shteti modern, pasi asnjë sundim nuk mund të kryhet vetëm me formë burokratike. Kjo ndodh pasi krerët e lartë të formacioneve politike janë ose “Presidentë” ose “Monarkë” të zgjedhur. Koncepti i përgjegjësisë në aspektin burokratik, i “kompetencës”, mungon, pasi shkalla urdhëruese varet nga dëshira individuale e sovranit.

Tipi i sundimit karizmatik lidhet me përkushtimin afektiv ndaj personit që sundon dhe aftësive të tij, si mirësia, fuqia e mendjes dhe e ligjërimit. Tipat më të pastër të këtij

sundimi janë sundimi i profetit, demagogut të madh. Formacioni sundues që e shoqëron është shoqërizimi me shpurë ose me bashkësi. Njerëzit i binden atij plotësisht për hatër të cilësive personale dhe jo për shkak të pozitës së tij statutore apo dinjitetit tradicional. Në këtë tip sundimi mungon koncepti i "kompetencës" pasi shkalla përcaktuese e ndjekësit varet nga misioni i ngarkuar nga sovrani dhe aftësia e tij karizmatike dhe personale. Kjo mënyrë sundimi çon në krijimin e një administrate që karakterizohet nga sjellje irracionale. Autoriteti sundues "karizmatik", shprehet Veberi është një fuqi e vërtetë revolucionare e historisë.

Së pari duhet të analizojmë se, ç'kuptojmë me termin "modern" dhe "shtet modern"?

Për ta bërë më të qartë kuptimin e këtyre termave i referohemi pikëpamjes së Kristofer Pirson,(2009) i cili në librin e tij "Shteti modern" bën prezantimin e këtij koncepti.

Por për të kuptuar më mirë çështjen, duhet të shikojmë fazat apo etapat në të cilat ka kaluar ndërtimi i shtetit shqiptar. Dhe në kuadrin e këtij rrugëtimi historik të mund të kuptojmë se deri ku kemi arritur në ndërtimin e shtetit modern së bashku me tiparet që e kanë shoqëruar shtetin dhe politikën shqiptare. Periudha 25-vjeçare e shtetit shqiptar të pas rënies së sistemit komunist, është një ndër më të rëndësishmet, pasi me të lidhen disa nga etapat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, sikurse është periudha 1990-2000 dhe pas vitit 2000 e deri sot.

Duke marrë në analizë periudhën e parë të ecurisë së shtetit shqiptar, 1990-2000, është një periudhë mjaft intensive e shoqëruar me përmbysje sistemi, model ekonomik, hapja ndaj botës, vendosja e ekonomisë së tregut, emigracion i lartë dhe me krijimin e institucioneve demokratike të qëndrueshme. Në këtë periudhë u hodhën bazat e mëtejshme të ndërtimit të shtetit demokratik në Shqipëri, periudhë e cila do të ndikojë

në gjithë historinë e mëtejshme të shtetit e kombit shqiptar. Është periudha që përfundon etapa e parë e tranzicionit postkomunist në Shqipëri, pra ajo e tranzicionit institucional, sistemi i tregtisë së lirë, Kushtetuta, ndarja e pushteteve (A. Fuga, 2013). A kanë funksionuar të gjitha këto elemente të shtetit shqiptar ashtu si duhet? Kjo është një tjetër çështje, e cila do një studim dhe analizë më vete, por e rëndësishme është që shteti dhe shoqëria shqiptare reformohet dhe ecën përpara.

A kemi arritur ta ngremë shtetin modern? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, duhet të kuptojmë se ç'përcakton termi modern, pra kuptimin e "shtet bashkëkohor, shtet i aktualizuar". Referuar Kristofer Pirson, (2009) në librin e tij "Shteti modern" ai përshkruan një sërë tiparesh që identifikojnë disa elemente të shtetit modern

- Industrializimi që ka të bëjë me tranzicionin nga një shoqëri agrare në një shoqëri industriale.
- Tranzicioni demografik, transformimi i madh dhe shpërndarje e popullsisë.
- Komercializimi dhe kthimi në mall i marrëdhënieve ekonomike që diferencohen edhe më shumë nga aspektet e tjera të jetës sociale.
- Lindja e kapitalizmit, kalimi nga ekonomia feudale në atë kapitaliste.
- Zgjerimi i ndarjes së punës sociale – pra, diferencimi i funksioneve ekonomike dhe politike.
- Lindja e mënyrave shkencore të mendimit dhe zbatimi i tyre në prodhimin industrial dhe në jetën sociale në përgjithësi.
- Transformimi në konceptimet e racionalizimit dhe besimet për plasticitetin e botës sociale dhe materiale.

- Transformimi i mënyrave të komunikimit mes personave, mallrave dhe informacionit.
- Urbanizimi, zgjerimi i qyteteve kryesisht industriale dhe ndryshimi i marrëdhënieve mes qytetit dhe fshatit.
- Demokratizimi që ka të bëjë me zgjerimin në pjesëmarrjen politike, me institucione të reja politike dhe forma të reja të legjitimitetit politik. (në C. Person, 2009)

Sa prej këtyre tipareve i gjejmë të prezantuara në ecurinë 25-vjeçare të shtetit shqiptar? Për këtë duhet bërë një përshkrimi i ecurisë së shtetit tonë. Padyshim, shteti dhe shoqëria shqiptare i shpreh këto tipare të cilat i shërbejnë analizës se sa elita politike ia ka ofruar shoqërisë shqiptare, dhe se si kjo ka ndikuar në ndërtimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe shoqërisë . Por që kërkohet punë në përmirësimin dhe përsosjen e tyre dhe kjo nuk ka dyshim. Problemet që mund të ndeshen gjatë zhvillimit të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga përmirësimi i shërbimeve publike deri te demokratizimi i mëtejshëm i jetës institucionale e shoqërore në Shqipëri.

Dominimi i opinionit se, “ndërtimi i shtetit modern shqiptar paraqet probleme që kanë të bëjnë me, zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, të pakontestueshme nga palët, ndërtimin e një pushteti autokratik, nevojën e konsolidimit të institucioneve demokratike, acarimin e situatave parazgjedhore në 25 vjetët e fundit dhe zhvillimin e fushatave të tensionuara politike është rezultat i sjelljes politike të kësaj elite në raport me pushtetin. Sipas analistëve,” *në këto vite vihet re një fenomen, kur ka një kalim të pushtetit, ka prirje për larje hesapesh të padrejta nga ana e pushtetarëve, si dhe përdorimi i këtij pushteti si pronë vetjake*” (A. Stefani, Gazeta Shqip 2013).

Një tjetër fenomen që vihet re është edhe tranzicioni politik, që shpreh një mungesë të angazhimit qytetar dhe problemet që lë pas ky tranzicion. Sipas analistëve A.Stefani, S.Minxhozi, politika e pas viteve '90 e ka shpërfytyruar intelektualin shqiptar edhe pse shpjegimin e vështirësive të këtij tranzicioni nuk mund ta bëjmë vetëm me reduktimin në një shkak të vetëm, por janë një sërë faktorësh që, kryesisht, lidhen me klasën politike shqiptare dhe politikën e saj. Shteti i së Drejtës e bazon politikën e tij në ekzistencën e pashmangshme të shoqërisë dhe diversitetit.

Analizë argumentave të ndikimit që ka patur elita politike në raportin shtet shoqëri

Në analizë të ndikimit që ka patur mungesa e kompromisit politik si shenjë e mungesës së vizionit politik të saj në ndërtimin e marrëdhënies shtet shoqëri gjatë tranzicionit, rezulton se periudha më e gjatë ku kompromisi politik ka munguar tërësisht është ajo e viteve 1992-1997. Mbështetur në pikëpamjen voluntariste, kjo është shenjë e qartë e mungesës së vullnetit politik të elitës. Për pasojë kjo mungesë e kompromisit politik rriti vështirësitë me të cilat u përball vendi. Rezulton se të vetmet pika takimi të klasës politike gjatë gjithë tranzicionit, dje dhe sot janë ose delegacionet e përbashkëta ndërkombëtare ose arritja e kompromisit nën trysinë e garancinë e ndërkombëtarëve, tipar dallues i papjekurisë politike që ka sjellë si pasojë mungesën e kompromisit politik dhe thellimin e distancës dhe të hendekut të bashkëpunimit mes forcave politike këto dekada të tranzicionit. Për pasojë kjo mënyrë e të funksionuarit të politikës shqiptare për fat të keq ka kulmuar me disa ngjarje tragjike për shoqërinë shqiptare.

Referuar pikëpamjes institucionaliste për të analizuar korrelacionin pra drejtimin ndikimit, mes mënyrës së funksionimit të partive politike kryesore dhe ndikimit që ka

patur në raport me qytetarin dhe shtetin rezulton se, parimet demokratike nuk funksionojnë rregullat e përfaqësimit dhe të konkurimit, për pasojë ka bërë që dhe vetë brënda partive politike pra familjes politike e ka bërë të vështirë arritjen e kompromisit, por dhe mes klasës politike, duke çuar në humbje energjish nga vetë klasa politike. Ky faktor ka mbajtur në krizë raportet mes qytetarit dhe shtetit, duke u bërë faktor pengues për ecurinë e proceseve demokratike.

Mungesa e dialogut politik ka ndikuar dhe në qëndrimet e faktorit ndërkombëtar, duke i detyruar që t'i imponohen klasës politike. Mungesa e përgjegjësisë nga ana e klasës politike për bashkëpunim, ka sjellë për pasojë dhe dështimin e saj, dhe kur kërkohet që të bëhet vlerësimi i përgjegjësisë, palët fajsojnë njëra tjetrën, të vjetrit e të rinjtë e politikës shqiptare.

Ndërtimi i kësaj lloji të kultуре politike me një mentalitet konfliktual dhe në përpjekje për t'u shmangur përgjegjësisë, ka sjellë për pasojë moskonsolidimin e demokracisë dhe polarizim të shoqërisë shqiptare.

Shkalla e lartë e konfliktualitetit politik, ka sjellë si pasojë pakënaqësi tek të dy partitë kryesore politike PD-PS si dhe tendencën e shoqërisë për të kërkuar një forcë politike të tretë. Kostoja negative që palët politike i kanë lënë mjedisit politik shqiptar në lidhje me konkurimin demokratik, u ka mundësuar liderve politikë ruajtjen e pozitave drejtuese të tyre. Ky fenomen i sjelljes politike në korrelacion me liderët politikë, duke qënë se konfliktet nuk janë zgjidhur në mënyrë institucionale ka prodhuar institucione të dobëta e të paaferta për zgjidhjen e krizave.

Mungesa e përgjegjshmërisë nga ana e klasës politike për respektimin e marrëveshjeve mes klasës politike, në korrelacion me besimin e ndërsjelltë politik, ka rezultuar i

shoqëruar me një pasojë negative të këtij korrelacioni, pra me mungesën e besimit të ndërsjelltë ku shpeshherë ka rezultuar që të ketë shkelje të njëanëshme, apo dhe të dyanëshme të marrëveshjeve.

Nga analiza korrelative pra e drejtimit se në cilin kah vepron ndikimi i klasës politike, në atë të përmirësimit apo të uljes së këtij rapoti, mosbesueshmëria mes klasës politike tek njëra tjetra dhe kompromisi politik rezulton se, klasa politike është e ushqyer aq shumë me frikën e tolerimit ndaj kundërshtarit politik, sa që e ka ulur aftësinë e saj për të kuptuar, nëse kjo është mënyra apo taktika e tij për të arritur qëllimin e vet, dhe jo me anë të konkurrencës politike, duke sjellë për pasojë që dialogu të mbetet formal.

Referuar kulturës politike si faktor ndihmës që na ndihmon të kuptojmë rrugën që ka ndjekur historia jonë politike rezulton se, mentaliteti i vjetër si një gjurmë e thellë e së kaluarës diktatoriale në klasën politike ka sjellë për pasojë, mbizotërimin e tij duke bërë që si që fiton të jetë zotërues i gjithçaje, ndërsa kundërshtari të jetë i rrezikshëm politikisht. Parë në këtë pikëpamje kjo klimë mes klasës politike në korrelacion me dialogun politik ka sjellë një pasojë, nevojën e përherëshme për ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve mes klasës politike shqiptare.

Nisur nga pikëpamja se korrelacioni pra drejtimi i ndikimit do të rezultonte pozitiv me ndryshimin e mentalitetit të vjetër politik, i cili do të sillte për pasojë zhvillimin e dialogut politik të mirëfilltë politik, dhe do të ndryshonte mendësinë e të bërit politikë. Arritja e bashkëpunimit dhe e kompromisit politik, ka mbetur më shumë si nevojë e detyruar nga faktori ndërkombëtar se sa nga vullneti politik.

Përpjekja nga ana e klasës politike për të përmirësimin e vullnetit politik për të arritur kompromisin politik mes palëve, do të ulte konfliktualitetin dhe polarizimin e shoqërisë, gjithashtu do të rriste besimin qytetar tek klasa politike.

Një ndër aspektet ku kultura politike e ka shprehur dështimin e saj përballë qytetarëve shqiptarë është dhe përdorimi i një gjuhe radikale, duke e kthyer atë në një mjet të përdorur për të fyer, për të shprehur mllef, duke arritur deri në ekstrem, sa nuk pranon të flasë me kundërshtarin politik. Shpeshherë kjo intolerancë gjuhësore ka shërbyer dhe si shkak për të zhvilluar dhe konflikt deri fizik mes politikanëve, gjë që ia ka ulur vlerat demokracisë parlamentare, duke sjellë për pasojë që takimet e krerëve politike të jenë evente të jashtëzakonëshme të jetës politike shqiptare. Kjo mënyrë e komunikimit politik me një retorikë të ashpër, nuk e ka ndihmuar komunikimin mes tyre, pasi kjo lloj retorike nuk ka qënë kritikë ndaj punës së tyre. Duke qënë një mënyrë komunikimi që as nuk shtron pyetje dhe as nuk jep përgjigje, kjo nuk gjen unitet tek masa e qytetarëve, të cilët duhet të luajnë një rol aktiv në jetën politike.

Përdorimi i një gjuhe të ashpër dhe intolerante është shprehje e një modeli jodemokratik nga ana e klasës politike. Përdorimi i një gjuhe racionale në raport me këtë gjuhë të ashpër intolerante, do të sillte për pasojë rritjen e komunikimit e të dialogut politik, dhe do të sillte në jetën politike shqiptare modelin perëndimor të politikanit të moderuar në komunikim dhe të frytshëm, model i cili i ka munguar këto vite të tranzicionit në gjirin e klasës politike. Përdorimi i një gjuhe racionale do të çonte në forcimin e demokracisë, dhe të formimit europian të komunikimit publik.

Bazuar në këtë këndvështrim janë dy paradigamt e retorikës sunduese të komunikimit, retorika sofiste si stil gjuhësor që praktikon arritjen e qëllimit me çdo mjet gjuhësor, që nuk ka lidhje me gjërat reale. Kjo i ka shërbyer klasës politike për të arritur qëllimin e

saj tek dëgjuesit, duke u servirur atyre gënjeshtër, mashtrime në të gjitha nivelet e politikës shqiptare, duke shpërdoruar kështu detyrën, larg parimeve aristoteliane të komunikimit, që do të sillnin për pasojë një komunikim më tolerant në politikë, më demokratik, ku strategjia e aktivitetit jo të dhunshëm do të bëhej praktikë në politikë, ndërsa shoqëria do të ishte një shoqëri e prirur drejt tolerancës dhe komunikimit. Rezultatet e këtij komunikimi aristotelian, ku pjesa e elementëve irracional përjashtohet nga gjuha, ndërsa toleranca politike e demokracisë dhe e paqes në komunikim do të çonte në përafrimin me vlerat dhe botën demokratike.

Kjo sjellje gjuhësore e klasës politike dhe ndikimi negativ i kësaj gjuhe, joetike dhe joprofesionale nga ana e klasë politike, fatkeqësisht ka patur një drejtim uljes së këtij raorti, pasi sa më shumë është rritur intoleranca gjuhësore nga klasa politike, nga ana tjetër kjo ka çuar në prezantimin e një degradimi të performancës së saj. Përdorimi i kësaj gjuhe të ashpër, abuzive, që shkel rregullat e komunikimit publik dhe etik, e ka humbur sensin e argumentit politik dhe ka sjellë për pasojë degjenerimin e debatit politik, duke krijuar imazh negativ për vetë politikën, pasi qytetarëve u ka sjellë rëndesë psikologjike. Bazuar në këto fakte dhe në nevojën e krijimit të një standardi gjuhësor, duket që klasa politike të krijojë një standard dhe një normë gjuhësore etike, që të lidhet me të menduarit e drejtëpërdrejtë që lidhet me debatin dhe të vërtetën politike. Në këtë pikëpamje përdorimi i një standardi gjuhësor aristotelian ku, individët që merren me politikë duhet që të kenë një formim politik dhe gjuhësor etik, ku beteja për gjetjen e argumentit ka nevojë për një formim të tillë.

Si konkluzion mund të themi se kjo gjuhë e ashpër politike, agresive dhe jo etike ka sjellë për pasojë ndikim negativ të saj cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë, pasi kjo

klasë politike e ka përdorur si mjet për të mbajtur e zotëruar pushtetin, dhe nuk e ka shfrytëzuar si mjet për arritjen e argumentit në komunikimin politik.

Nga analiza korrelative pra të ndikimit të zhvillimit të procesit zgjedhor në konsolidimin e demokracisë dhe të elitës së re politike, analiza nxjerr në dukje një sërë faktorësh që i lidhin ato. Problematika e zhvillimit të zgjedhjeve është e lidhur me vetë historinë e shteti shqiptar, formimin qytetar dhe sidomos me kulturën politike të elitës politike, dhe modeleve referuese politike. Zhvillimi i zgjedhjeve të para pluraliste u dhanë mundësinë ish komunistëve që të rimerrnin pushtetin, pasi partitë politike opozitare, ndryshe nga vendet e tjera ish komuniste patën më pak kohë në dispozicion për tu organizuar. Në këtë pikëpamje zgjedhjet pluraliste në Shqipëri që në fillim të tyre u zhvilluan në kushte të pabarabarta, ç'ka e ka cënuar që në fillim procesin zgjedhor, ku në përfundim të këtyre zgjedhjeve vihet re një vijimësi e elitës ish komuniste, pasi 21 deputetë të PPSH dhe 8 Sekretarë të parë arritën të fitonin mandatin e deputetit.

Përshtatja e ish komunistëve me mënyrë e re të jetesës në demokraci, si dhe duke u bërë iniciatori i lindjes së biznesit privat, e uli reputacionin e PD si parti opozitare antikomuniste. Krijimi i partive politike të tjera nacionaliste si mbështetëse të PD ishte rezultat i stimulimit të kritikave për bashkëqeverisje me komunistët. Prishja e kësaj bashkëqeverisje me ish komunistët ishte një strategji e PD për të rënë kjo formulë bashkëqeverisëse dhe kriimin e një qeverie teknike me ministra të PS, ose intelektualë të pavarur që çoi në fakt në krijimin e një qeverie teknike, me ministra të papërfshirë në politikë, por që do të ishin aktiv në të ardhmen në politikën shqiptare.

Duhet theksuar se ndërhyrja në funksionimin e institucioneve, që në hapat e parë të ndërtimit të shtetit demokratik, e uli efikasitetin e tyre, dhe si rezultat kemi futjen në to të

personave politikë. Mosmiratimi i kushtetutës në 1994 ishte një hap tjetër prapa në forcimin e demokracisë dhe të institucioneve demokratike. Ky mosmiratim ishte pasojë e mosaprovimit të gjëndjes në të cilën ndodhej vendi në atë kohë, më shumë se sas mosdiskutimi i saj në publik. Që të dy këta faktorë kanë patur ndikimin e tyre negativ në këtë proces.

Zgjedhjet e vitit 1996 përbëjnë një moment të rëndësishëm për politikën shqiptare, pasi ishin testit i parë i klasës politike dhe i demokracisë, por që dështuan për shkak të mjedisit politik që i shoqëroi, kontestimin dhe bojkoti nga ana e opozitës, duke sjellë për pasojë që qeveria të kishte përqindjen më të lartë në parlament në të gjitha vendet e ish lindjes komuniste, por qeverisja pa opozitën e dëmton funksionimin e demokracisë dhe të parlamentit. Zhvillimi i zgjedhjeve të 1996 ishin një moment kryesor për zhvillimet politike që do ta shoqëronin tranzicionin, si dhe faktorët që influencuan në rënien e besimit tek PD, në korrelacion me njëra tjetrën këta dy faktorë patën një impakt negativ për demokracinë shqiptare, duke e vënë atë dhe klasën politike përballë standardeve të demokracisë me të cilat, demokracia dhe klasa politike dhe shoqëria shqiptare dolën të humbur. Strategjia e gabuar që ndoqi PD dhe lidhshipi i saj në këto zgjedhje i dha mundësinë partive të tjera politike, duke sjellë kosto elektorale në dëm të PD.

Në zgjedhjet e 2001 përgjithësisht kemi një përmirësim, por që procesi ishte i tejzgjatur, i pa sigurtë dhe i fragmentarizuar. Zgjedhjet e 2005 shënojnë ndryshime të rëndësishme në sistemin zgjedhor, por sërish dhe këto zgjedhje tabloja ishte e dominuar nga partitë kryesore politike PD-PS dhe aletatë e tyre. Konfliktualiteti politik brënda PS ndikoi në balancat elektorale, duke sjellë për pasojë humbjen e PS në krahun e majtë dhe krijimin e një koalicioni më të madh forcash të së djathtës.

Tendenca e partive politike për të përfshirë në politikë kandidatë të pakomsumuar politikisht(PD me KOP), ku një pjesë e tyre vinin nga shkollat perëndimore ose shoqëria civile, u përfshinë në politikë dhe u bënë anëtarë të kabinetit qeverisë që dolën nga këto zgjedhje. Si përfundim mund të themi se zgjedhjet e 2005 në raport me standardet ndërkombëtare, patën një përputhje të pjesëshme, pasi u shënuan përparime, u ofruan mindësi tek zgjedhësit me një sërë forcash politike, por që procesi ishte i tejzgjatur e ndonjëherë i pasigurtë. Në raport me zgjedhjet e 2001 patën përfaqësim më të madh politik, pasi 2001-2005 u formuan dhe tre parti të tjera politike LSI, LDNJ, PDS.

Taktika elektorale të 2005 e dhurimit të votës me anë të marrëveshjeve nga ana e klasë politike, për të patur sa më shumë përfaqësim në parlament dhe përtej përcaktimit kushtetues, iu dha mundësinë që të futen në parlament dhe në politikë emra që vinin nga biznesi, ushtria, apo nga policia. Kjo risi kishte të bënte me futjen e emrave nga lista nominale në atë mazhoritare, duke bërë që votuesit të votonin pa patur dijeni se kjo votë ishte e vlefshme për ta.

Në analizën e raportit mes shoqërisë civile dhe elitës politike, vërehet një korrelacion negativ në të, pasi rritja e aktivizimit të shoqërisë civile në jetën politike nga ana e klasës politike është parë si një ulje e mundësisë për të konkuruar me këtë shtresë të shoqërisë. Nëse shoqëria civile e rrit aktrivitetin e saj në angazhimin politik atëherë natyrisht politika do të përballej me intelektualë dhe profesionistë që nuk i kanë parametrat e militantëve politikë, që ka prodhuar klasa politike gjatë këtyre viteve të tranzicionit.

Ky korrelacion pra drejtim i negativ vjen për pasojë të raportit mes klasës politike dhe shoqërisë civile, ku klasa politike është përpjekur që shoqërinë civile ta përdorë si

235

barkë shpëtimi, sa herë që spektri politik ka patur nevojë për të përmirësuar imzhin e vet. Por indiferenca e shoqërisë civile ndaj zhvillimeve politike, u jep mundësinë individëve që nuk kanë kapacitetet e duhura për të ushtruar politikën. Shfaqja e tendencës nga ana e klasës politike për tu dukur si miq të intelektualëve e ka krijuar përshtypjen së është përpjekje për të marrë sa më shumë vota , dhe jo përpjekje për të afirmuar vlerat dhe kapacitetet intelektuale për të qeverisur. Kjo përpjekje nga ana e klasës politike për një vëmëndje të shtuar ndaj shoqërisë civile, ka ardhur si pasojë e nevojës themelore që ka klasa politike sot për të përmirësuar imazhin e vet politiktë konsumuar, dhe rritjen apo kompesimin e kapaciteteve nominale të konsumuar politikisht, faktor të cilin klasa politike është munduar ta servirë si nevojë për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Në krahasim me ish vendet e Bllokut komunist në Shqipëri shoqëria civile gjatë sistemit komunist pothuajse i shkatërrua plotësisht , saqë ishte e pamundur të mendohej një gjë e tillë, por që dhe gjurma e pushtimit osman ka lënë shenjën e tij në trashëgiminë që la.

Ndërtimi i shtetit modern paraqet vështirësi, pasi institucionet shtetërore nuk kanë mundur të fitojnë ende fuqinë dhe aftësinë e nevojëshme për të prodhuar rezultatet e dëshiruara nga qytetarët, pro dhe pritshmëritë e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Zhvillimi ekonomik është i ulët në krahasim me vendet e tjera, pasojë kjo e konfliktualitetit politik, që ka sjellë ndërç në zhvillimin e vendit. Prandaj shoqëria shqiptare është e orientuar, drejt një kërkimi për të gjetur një klasë politike të re, që me veprimtarinë e saj të kontribojë në ndërtimin e shtetit , të një mjedisi politik që ka për qëllim ushtrimin e pushtetit, dhe jo sundimin me anë të pushtetit.

Duke marrë në analizë periudhën e ecursisë së tranzicionit, dekada e parë rezulton që është mjaft intensive, pasi është e shoqëruar me krijimin e institucioneve demokratike, u hodhën bazat e nevojshme për funksionimin e shtetit demokratik, pra kjo është periudha e tranzicionit institucional dhe ekonomik. Ndërsa periudha e dytë e këtij tranzicioni ka të bëjë me përmirësimin dhe përsosjen e mëtejshme të shtetit demokratik, duke filluar me përmirësimin e konsolidimin e mëtejshëm të demokratizimit të institucioneve, demokratizimin e jetës shoqërore, përmirësimin e shërbimeve publike në vend.

Nga përshkrimi dhe analiza e faktorëve të çështjes së marrë në studim, hipoteza është e qëndrueshme. Analiza e nxjerr në pah ndikimin negativ që ka patur elita politike shqiptare e tranzicionit me sjelljen dhe mentalitetin vjetër politik, retorikën e ashpër politike, konfliktualitetin politik paaftësinë e saj politike për të ndërtuar një demokraci të qëndrueshme, dhe politika vizionare për shtetin e qytetarët duke ndikuar negativisht në ndërtimin e marrëdhënieve të brishta shtet shoqëri gjatë tranzicionit.

Përfundime

Studimi ka si objekt të trajtimit vlerësimin e ndikimit që elita politike ka patur në ndërtimin e marrëdhënieve shtet shoqëri si dhe analizën e faktorëve që kanë ndikuar në këtë drejtim. Me anë këtij studimi jemi përpjekur që ti japim përgjigje pyetjes se se, përse elita politike ndikoj në uljen e besimit qytetar tek ajo dhe cilët ishin faktorët që ndikuan në këtë drejtim. Punimi është i përqëndruar kryesisht në analizën dhe vlerësimin e drejtimit të ndikimit që ka patur elita politike në ndërtimin e raportit social shtet shoqëri.

Objekti i punimit është vetëm aspekti social i ndikimit, vlerësimi i kufinjve të këtij ndikimi bëhet nga prespektiva sociale e kulturore. Analiza e studimit është kufizuar gjithashtu duke mos u shtrirë në çështje të tjera që lidhen me politikat ekonomike apo institucionale. Për të bërë të mundur realizimin e studimit i gjithë punimi është i mbështetur mbi idenë se, modeli altimetrik mbi bazën e të cilit i formësua dhe u jetësua elita e re politike e pas viteve 90' i dha tiparet dhe problematikat të cilat klasa politike i ka prezantuar gjatë gjithë tranzicionit, pra një elitë jo fleksibël me tendencë të ngurtësisë ndaj problematikave dhe trysnive të kohës duke efektuar marrëdhënien mes shtetit dhe shoqërisë.

Zbatimi i kriterit altimetrik në zëvendësimin e funksionimin e elitës politike që bazohet në supozimin se “kush është në është në majë, dhe se kush është atje është i pushtetshëm, ka dhe ushtron pushtetin “ në funksionimin e klasës politike shqiptare gjatë tranzicionit, si dhe i modelit “luan” në klasën e re politike, pra një elitë që tendenca e së cilës është ngurtësia ndaj ndryshimeve, jo fleksibël për të përballuar

trysnitë, i ka dhënë tiparet klasës politike. Këtu ka një kundërvënie midis elitës meritokratike dhe elitës që është në krye pa meritë, po mendoj se argumentat e mëposhtëm mund ta plotësojnë më tepër këtë tezë të disertacionit. Pasi jo vetëm ky dimension i elitës politike është i rëndësishëm.

Rënia e sistemit komunist normalisht që u shoqëroua dhe me ndryshimin e sistemit ekonomik dhe politik, dhe në këtë pikëpamje zëvendësimi i elitës drejtuese ishte i pashmangshëm, pasi ndryshimi i strukturave ekonomike, politike do të sillnin si rezultat dhe ndryshime në elitën drejtuese e mbizotëruese të shoqërisë, në këtë pikëpamje gjen zbatim ndërthurja e dy pikëpamjeve elitiste për zëvendësimin e elitës pra ajo e faktorëve struktural dhe social psikologjik.

Në këtë pikëpamje Lëvizja Studentore mendojmë se është më shumë një ngjarje e cila u përdor nga një pjesë e caktuar e shoqërisë, pasi bazuar në pikëpamjen elitiste se zhvendosja e elitës drejtuese ndodh pavarësisht nga karakteri apo motivimi i elitës në rastet kur kemi përmbysje të sistemit, ndaj u promovuan në politikë individë të cilët nuk kishin qënë pjese e nomenklaturës së lartë komuniste, promovim nga i cili dolën figurat kryesore të elitës drejtuese politike të tranzicionit.

Zbatimi i modelit altimetrik në jetësimin apo dhe në qarkullimin e elitë politike, solli për pasojë dhe zbatimin e vendosjen e faktit se kush shtë në majë, është në majë, dhe se kur je në majë je i pushtetshëm dhe e ushtron pushteti, krijimi i këtij funksionimi tek elita drejtuese politike ishte kusht i rrethanave historike, politike e shoqërore, por që gjeti zbatim gjatë gjithë tranzicionit. Mungesa e përvojës demokratike të elitës së re politike në funksionimin e saj dhe në drejtimin e shtetit, është një ndër faktorët që ka ndikuar dhe ndikon në ndërtimin e një tradite demokratike, duke mos garantuar institucionalizimin e vlerave demokratike.

Zbatimi i modelit altimetrik në qarkullimin e elitës së re politike prodhoi si rezultat një klasë politike të klanizuar, të përçarë, në një luftë të ashpër për pushtet politik, brënda partive politike dhe institucioneve, duke sjellë për pasojë abuzimin me pushtetin, deformim të funksionimit të institucioneve shtetërore e politike si dhe, eliminimin e meritokracisë si një mënyrë tjetër në qarkullimin elitës dhe të funksionimit të saj dhe të institucioneve në vend.

Ushtrimi dhe përdorimi i pushtetit politik në funksion të interesave klanore politike, personale ndikoj në zhvillimin e një politike të shkëputur nga qytetari tipar ky i elitave të mbyllura, dhe me mungesë të ekuilibrit institucional dhe shoqëror, duke futur klasën politike dhe shoqërinë në një gjëndje të brishtë të raportit mes tyre.

Ky fenomen rrjedh dhe si pasojë e mungesës së institucionalizimit të vlerave demokratike, ku në krahasim me vendet e tjera të EL që i trashëguan, për klasën politike shqiptare është një dëm i madh pasi gjatë historisë së shtetit modern nuk është se ka një periudhë të referueshme të institucionalizimit të këtyre vlerave. Mungesa e një qasje institucionale si një faktor i rëndësishëm në krijimin e një realiteti të qëndrueshëm social , politik, i ka dhënë mudësinë klasës politike të jetë e udhëhequr nga tendenca e të qënurit mbi ligjin dhe mos zbatimin e tij , model ky që deformimin e shtetit të partive politike shqiptare.

Lufta e ashpër për pushtet ndaj kundërshtarit politik por dhe brënda partive politike prodhoi mungesë të meritokracisë, konfliktualitet, përçarje, pengim të mendimit ndryshe , duke penguar kështu potencialet e reja për të kontribuar në drejtimin e vendit dhe për pasojë vonimin e qarkullimit të elitës politike në vend.

Përpjekjet nga ana e klasës politike për të mbajtur dhe për të marrë me çdo kusht pushtetin, solli si pasojë prishjen e ekuilibrit shtetëror dhe shoqëror në krizën e vitit 1997, që u shoqërua me kosto jo vetëm demokratike e politike por dhe shoqërore. Kjo bazuar në pikpamjen e Xh. Sartorit se “ata që qeverisin janë të paaftë të merren me trazirat evogla, dhe me ndryshimet që një klasë sunduese inteligjente dhe e fortë duhet të kryejë me një kosto të shpërfillshme në pasuri, dinjitet njerëzor, marrin përmasat e një mënxyre shoqërore “. Ngjarjet e këtij viti duhet të shikohen si pika nistore ku shfaqet fenomeni i mosdhënies llogari nga ana e klasës politike, pasi qeverisja në vakum institucional, mangësi kjo e klasës politike në shtetformim, dha mundësi për keqpërdorim dhe deformim të aparatit shtetëror të komandimit, dhe u shoqërua me ushtrim të pushtetit dhe me prishje të ekuilibrit shtetëror, shoqëror duke i dhënë një goditje të madhe demokracisë, besimit qytetar tek shteti.

Funksionimi i parlamentit është shprehje e drejtpërdrejtë i modelit të klasës politike, ka dështuar që tu japë qytetarëve modelin e një klase politike që e udhëheq shoqërinë, kjo ka ardhur si pasojë e faktit që gjatë tranzicionit klasa politike, asnjëherë nuk ka mundur që të zgjedhë një parlament të dalë nga vota reale e qytetarëve, në mënyrë që të funksionojë, element që ka penguar qarkullimin normal të elitës.

Funksionimi i partive politike si tipari kryesor që ka ngjashmëri me tipin e demokracisë në një vend vlerësohet se tipari kryesor që gjatë evolucionit të tyre është se ato reflektojnë profilin e lidërshpit, dhe më pak atë të organizmave drejtues. Procesi i vendimmarrjes u ka dhënë partive politike tipin e partive paraelektorale, pasi oragnizohen vetëm në prag të zgjedhjeve, në kundërshtim me statutet e tyre. Partitë politike janë larguar modelit tradicional dhe kanë kaluar drejt modelit elektoral, duke ulur rëndësinë e krijimit të tyre dhe të arsyes së përse janë krijuar, pra për të

përfaqësuar shtresat e ndryshme të shoqërisë, dhe janë kthyer në parti pragmatiste, larg interesave të qytetarëve dhe të identitetit të tyre ideologjik. Krijimi i modelit klientelist abuzuas tek partitë politike, si një model që bie ndesh me funksionimin e institucioneve publike, mendojmë se është një fenomen i përkohshëm, ndërsa modeli klientelist pozitiv, ku partitë politike identifikohen me grupe sociale që përfaqësojnë është një model që do të ndihmonte partitë politike që të kryenin fazën e tranzicionit të tyre nga modeli klientelist negativ drejt modelit të partive politike moderne. Kjo do të ndihmonte klasën politike që të krjonte mundësinë për ndërtimin e një vizioni të qartë, dhe elektoratit që të votonte alternativën më të mirë qeverisëse, dhe të prezantonet interesat e të gjitha grupeve sociale të shoqërisë.

Vlerësimi i modelit të klasës politike si rezultat si procedurave demokratike apo i një klase politike që kontrollon pushtetin, rezulton në modelin e klasës sunduesedhe kjo vërehet mosfunksionimi i institucioneve të administratës dhe atyre të pavarura ku ka patur përplasje të vazhdueshme mes qeverive dhe institucioneve. Mënyra e ashpër e sjelljes politike dhe me konfliktualitet të brëndshëm, ka prodhuar një klasë politike të dominuar nga vullneti i liderit, shprehje e qartë e ushtrimit të pushteti, pasi dhe zhvillimi i zgjedhjeve gjatë gjithë tranzicionit ka prodhuar fitues të kontestuar nga palët politike.

Tranzicioni i zgjatur si një mënyrë e zgjedhur nga klasa politike për të mbajtur pushtetin sa më gjatë, ndërtimi i një shtrati ligjor në të cilin klasa politike ti përgjigjet rregullisht shtetit ligjor, janë tregues se modeli i klasës politike është ai i sundimit dhe jo i udhëheqjes së shoqërisë, dhe kjo është dhe një ndër arsytet e vonesës së antarësimit në BE, dhe jo faktori ekonomik, dhe është arsyeja që tranzicioni ende vazhdon në

Shqipëri, duke ndikuar në uljen e besimit qytetar tek klasa politike për angazhimin e tyre në proceset integruese të vendit në BE,

Zbatimi i modelit altimetrik dhe atij të sundimit të pushtetit në qarkullimin e elitës, bëri të mundur që në funksionimin e elitës së re politike të fillojë procesi i diferencimit të elitës shqiptare në krijimin e një shtrese elitë të politikanëve profesionistë. Ndërtimi i kultit të liderit pasojë kjo e një karrierë politike pa meritë, uli qarkullimin e elitës, zbehu meritokrainë, ul përfaqësimin social të grupeve. Si rezultat mund të thuhet se ndërtimi i modelit të klasës politike si një klasë që kontrollon dhe ushtron pushtetin, ka çuar në ndërtimin e një klase politike e cila ka qënë e interesuar për pushtetin dhe interesat e saj politike, më shumë se sa për të udhëhequr shoqërinë e cila i është besuar që të menaxhojë.

Klasa politike e tranzicionit ka përdorur dhe vazhdon të përdorë metoda e taktika për të ruajtur pushtetin, duke mos prezantuar tipare që tezat elitiste i prezantojnë si tiparet thelbësore të një klase politike që janë, vetëdija, koherenca, dhe bashkëpunimi. Bazuar në këtë pikëpamje klasa politike shqiptare paraqet probleme të karakterit unik, për nga problematikanë gjetjen e kompromisit e dialogut politik, shenjë e qartë e mentalitetit të vjetër së kaluarës së politike, vështirësi që kjo klasë politike ka prezantuar gjatë gjithë kësaj periudhe.

Padyshim që edhe trashëgimia politike e klasës politike e shoqërisë shqiptare hedh dritë mbi modelin e klasës politike, pasi ndikimi i faktorëve social psikologjik është i pashmangshëm dhe gjeti shprehje në funksionimin e partive politike, është një ndër argumentat bazë të këtij modeli të elitës politike. Analiza e funksionimit të partive politike nxjerr në dukje ndërtimin e modelit të shërbëtorit partiak dhe jo atij të shërbimit ndaj shtetit bazuar në pikpamjen liberale të funksionimit të individit përmes

shtetit. Analiza e qarkullimit të elitës nxjerr në dukje vijimësi të elitës mes sistemit të vjetër dhe atij të ri, fenomen ky që vihet re dhe në vendet e tjera të EL, e jo vetëm shqiptar, por që solli si pasojë krijimin e një modeli politikanësh të varur nga emërimet dhe jo nga merita personale.

Modeli i një klase politike të varur nga lideri dhe që merr vendime të diktuara nga paria politike, është një tjetër faktor që shpreh ushtrimin e pushtetit në favor të interesave personale politike dhe jo të qytetarëve. Për pasojë kjo ka ndikuar në deformimin e vlerave demokratike të qarkullimit normal të elitës, si dhe prezantimin e faktit se sa e thellë është diferenca mes shoqërive me kulturë demokratike të formësuar dhe një shoqërie të ndërtuar mbi meritokracinë, me një shoqëri të mbyllur mes elitës moderne dhe parive.

Rënia e kurbës së kredibilitetit të klasë politike në opinionin publik është shprehje e qartë e zhgënjimit të shoqërisë me klasën politike të saj. Kjo rënie është pasojë e një politike të pamoralshme nga pikëpamja e moralit politik, duke u bërë pengesë në zhvillimin e demokracisë, me korrupsionin, mosfunksionimin e institucioneve, e krijimin e modeleve negative të sjelljes politike, duke prodhuar fragmentarizim e përçarje të mjedisit politik, pasojë kjo e luftës mes autoritarizmit të liderve politikë dhe demokracisë.

Përpyjekjet për të ridimensionuar apo qarkulluar elitën politike rezultojnë të jenë më shumë një përpyjekje për të përmirësuar imazhin e ulur politik të klasës politike se sa një përpyjekje për të ridimensionuar elitën mbi bazën e proceduarve demokratike, përpyjekje e cila nuk dha rezultatet e pritshme për ridimensionimin e klasës politike, përkundrazi e ka ulur ndjeshëm nivelin politik të elitës, duke qënë ekskluzivitet i një grupi kontrolli të liderve politikë të partive politike shqiptare.

Ndikimi negativ që ka patur mungesa e kompromisit politik mes klasës politike, është tjetër faktor që vlerësohet se ka ulur besueshmërinë e shoqërisë tek klasa politike, ku përplasjet, mosfunksionimi i rregullave demokratike tek klasa politike e ka mbajtur në krizë raportin mes qytetarit dhe shtetit. Mungesa e dialogur politik e përgjegjësisë për bashkëpunim, shkalla e lartë e konfliktualitetit, ka sjellë pakënaqësi tek klasa politike e kryesisht tek dy forcat kryesore politike. Ndikimi negativ i liderve politikë i ka lënë kosto të lartë mjedisit politik për konkurimin demokratik, pasi krizat asnjëherë nuk janë zgjidhur në rrugë institucionale.

Në analizë të kahut të ndikimit të mosbesueshmërisë të klasës politike tek njëra tjetra dhe të kompromisit politik, rezulton se klasa politike është e ushqyer me frikën e tolerimit ndaj kundërshtarit politik, dhe kjo e ka ulur aftësinë e saj për të kuptuar nëse kjo është mënyra apo taktika për të ia arritur qëllimit, dhe konkurrenca jo politike duke bërë që dialogu politik të mbetet formal.

Kultura politike e klasës politike e ka shprehur apo shfaqur dështimin e saj në përdorimin e një gjuhe radikale, me intolerancë gjuhësore, dhe që ka shërbyer si mjet për të zhvilluar konfliktin politik, duke ulur vlerat demokratike dhe parlamentare. Kjo retorikë nuk ka qënë përdorim kritik ndaj punës së kundërshtarit politik, shprehje kjo e një modeli jo demokratik nga ana e klasës politike. Përdorimi i një gjuhe racionale do të sillte për rrjedhojë rritjen e komunikimit, të dialogut politik, si dhe të përdorimit të modelit perëndimor në komunimin e formimin evropian të komunikimit publik. Ky përdorim i gjuhës nga ana e klasës politike me ndikim negativ ka shprehur jo profesionalizëm, mungesë të etikës dhe fatkeqësisht ka ndikuar në drejtim të uljes së raportit të komunikimit politik e publik. Pra mund të themi se kjo gjuhë e ashpër politike, agresive dhe jo etike ka patur ndikim negativ tek cilësia e jetës së qytetarëve,

pasi klasa politike e ka përdorur si mjet për të mbajtur pushtetin dhe jo si mjet për arritjen e argumentit në komunikimin publik dhe politik.

Cënimi i zgjedhjeve që në fillimet e tyre është ndër faktorët kryesor që ka patur një ndikim mjaft negativ në raportin mes klasës politike e shoqërisë. Ndërhyrja që në hapat e parë të ndërtimit të shtetit demokratik në funksionimin e institucioneve solli për rrjedhojë uljen e efikasitetit të tyre. Mosmiratimi i Kushtetutës 1994, zgjedhjet e 1996 ishin dy aspektet kryesore me të cilat u përball klasa politike në dekadën e parë të tranzicionit, dhe dështimi që patën dha impakt negativ në shoqërinë shqiptare. Përmirësimi i tablosë së përgjithshme të zgjedhjeve në dekadën e dytë është pasojë e përmirësimit të procesit, por që konfliktualiteti politik sërish ka dominuar mjedisin politik kryesisht mes forcave kryesore politike.

Në analizë të drejtimit të ndikimit që ka patur raporti mes shoqërisë civile dhe elitës politike vërehet një drejtim negativ i ndikimit pasi klasa politike është përpjekur ta përdorë shoqërinë civile si mjet për përmirësimin e imazhit të cënuar politik të saj, më shumë se sa si alternativë. Nga ana tjetër indiferenca e shoqërisë civile i ka dhënë mundësinë individëve që nuk i kanë kriteret e duhura që të ushtrojnë politikën. Gjendje të caktuara shoqërore nuk zgjasin përgjithmonë, pasi shoqëritë të ndryshme kanë dhe pika të ndryshme të reagimit shoqëror, momente të cilat janë të paparashikuara, por që nuk është e thënë që nuk ndodhin. Ndërtimi i shtetit modern paraqet vështirësi pasi institucionet shtetërore nuk e kanë fituar ende forcën e nevojshme për të prodhuar rezultatet e pritshme nga qytetarët dhe për të plotësuar pritshmëritë e partnerëve ndërkombëtarë.

Mund të themi se, zbatimi i kriterit altimertik në funksionimin e klasës politike gjatë tranzicionit si dhe formësimi i një elite me tendencë të ngurtësisë ndaj ndryshimeve dhe

jo fleksibël për të përballuar trysnitë, i dha klasës politike tiparet dhe problemtikat të cilat i ka prezantuar gjatë tranzicionit, pra të bazuar në idenë e marrjes me çdo kusht të pushtetit dhe të mbajtjes me çdo kusht të tij. Pra një elitë politike e jofleksibël për të përballuar dhe siguruar një qarkullim normal të saj, për të ndërtuar shtetin dhe institucionet demokratike që të jenë në shërbim të qytetarëve dhe jo të interesave të saj politike, personale dhe ekonomike, duke efektuar negativisht në këtë mënyrë në raportin e saj me qytetarët, duke e ngrirë kontratën sociale me qytetarët e saj.

Klasa politike nuk u tregua e aftë që interesin e përgjithshëm të qytetarëve të cilët e kanë mandatur për ti udhëhequr, ta vendoste mbi interesat personale politike, duke ndërtuar një demokraci të brishtë, një shtet i qeverisur me sundim si dhe duke efektuar marrëdhënien mes shtetit dhe qytetarëve.

Si konkluzion mendojmë se nga vlerësimi dhe analiza e faktorëve të çështjes së marrë në studim, hipoteza është e qëndrueshme. Analiza e nxjerr në pah ndikimin negativ që ka patur elita politike shqiptare e tranzicionit me sjelljen dhe mentalitetin vjetër politik, retorikën e ashpër politike, konfliktualitetin politik paaftësinë e saj politike për të ndërtuar një demokraci të qëndrueshme, dhe politika vizionare për shtetin e qytetarët duke ndikuar negativisht në ndërtimin e marrëdhënieve të brishta shtet shoqëri gjatë tranzicionit.

LITERATURË

- Abrahams, C, Freed (2015) Shqipëria e Re / Nga Diktatura në Demokraci në Europë. Botimet DUDAJ
- Arsitoteli (2003) Botimet Plejad
- Baze, Mero (2010) “Viti ’97 - Prapaskenat e krizës që rrënuan shtetin”, Toena, Tiranë
- Bajraba, Kosta. Gasparini Alberto, (2001) “Rruga e modernizimit shqiptar - ngjarje, klasa politike, njerëz dhe marrëdhënie ndërkombëtare”, Instituti i Sociologjisë Ndërkombëtare GORIZIA
- Biberaj, Elez (2001) “Shqipëria në tranzicion - Rruga e vështirë drejt demokracisë”, Botimet ORA, Tiranë
- Bernd J. Fischer (2012) “Shqipëria që prej vitit 1989: trashëgimia hoxhiste”, në “Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme –vështrim drejt së ardhmes”, botim i AIIS, Tiranë,
- Alia, Ramiz.(1998) Ditari i Burgut. Shtëpia botuese Ppazisi AEBE Athinë
- Blushi, Ben. (2014) Hëna e Shqipërisë. Esse ide & debate.Shtëpia Boturse “UET Press”.
- Bogdani, Mirela, Loughlin John (2004)“Shqipëria dhe Bashkimi European. Integrimi European dhe perspektiva e pranimit”, botimet “Dajti 2000”, Tiranë
- Christopher, Person (2009)“Shteti modern”, Tiranë AIIS,

- Çupi, Frrok (2005) “E pashë shtetin duke rënë - dëshmi dhe esse”, Shtëpia Botuese “DRITERO”, Tiranë
- Daniel–Louis Seiler (2000) “Partitë Politike”, përkthyer nga Blerta Hyka. UET/PRESS, Tiranë
- Diamond Larry, (1998) ”*Political Culture and Democratic consolidation*”, June, fq. 2 online: http://www.march.es/ceacs/publicaciones/working/archivos/1998_118.pdf
- Diamond Larry & Gunther Richard (2001) *Political Parties and Democracy* . The Johns Hopkins University Press and the National Endowment for Democracy
- Dewey, John.(2000) Publiku dhe preblemet e tij. ISP& DRITA
- Duka, Apostol (2006) “Udhëkryqe të Historisë, rrëfyer nga miqtë dhe armiqët e Enver Hoxhës”, Shtëpia Botuese “Labova“, Tiranë
- Feraj, Hysamenin (2006)“Skicë e mendimit politik shqiptar”, Botimet “Pegi“, Tiranë
- Feraj, Hysamedin (2003)“Kriza e përkryer”, Eurorilindja Tiranë
- Fuga, Artan (2008) “Media, Politika, Shoqëria (1990-2000) Botimet Dudaj Tiranë
- Fuga, Artan (2003) “Majtas jo djathtas”, Botimet “Dudaj“, Tiranë
- Fuga, Artan (2001) “Ikja nga kompleksi i Rozafës. Politika e komunikimit në Shqipërinë e tranzicionit”, “Dukagjini“, Pejë.

- Frashëri, Mithat (Lumo Skëndo) (2008) “Elita shqiptare”, një studim mbi veprimtaritë kryesore të Mithat Frashërit (Lumo Skëndo) dhe pjesë të zgjedhura nga vepra e tij, përgatitur nga Uran Butka, Botimet “Plejad”.
- Gabriel A, Almond & Sidney, Vreba (1963) Political attitudes and democracy in five nations. First sage printing 1989
- Gumbell, Andrew (1997) “*Regjim gangsterësh që ne financojmë*”, “The Independent”, 14 shkurt 1997, botuar në revista “Përpyjekja”, Nr. 11-12, Tiranë shtator-dhjetor,
- Gjongecaj, Besnik (2013) “Në morgun e politikës, kur letërsia takon publicistikën”, ”GEER”, Tiranë
- Hobhouse, Leonard. (2000) Liberalizmi . ISP&DRITA
- John Monaghan & Peter Just, (2000) Antropologjia social kulturore, një hyrje e shkurtër. Botimet ideart .
- Rusoi, Zhan, Zhak “Origjina e pabarazisë sociale”, përktheu Qemal Veliaj
- Krasniqi, Afrim (1998) “Fundi i Siberisë Shqiptare” Botimet Albin . Tiranë
- Krasniqi, Afrim (2009) “Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008. Historia, proceset zgjedhore, partitë, kandidatët, fushatat elektorale” Konica Color Tiranë
- Krasniqi, Afrim, Hackaj, q Adrian (2013) “Shqiptarët dhe modeli social-europian. Demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare”, Botues Friedrich-Erbert – Stiftung

- Krasniqi, Afrim (1997) “Rënia e Demokracisë. Shqipëria në muajt janar-qershor 1997”, Botime EURO RILINDJA, Tiranë (ribotim)
- Lami, Roland, (2013) “Paqartësia e strukturimit të raporteve: Parti-politike. Ideologji”, Tiranë
- Misha, Piro, “Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin paskomunist shqiptar”, në “Tranzicione në pasqyrë”, “Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë”, Ciencias y humanismo
- Misha, Pirra (2015) Shqiptarët dhe modeli social europian, mangësitë, pengesat, sfidat, vizionet. Botimet Fridrich,Erbert,Stiftung. Tiranë
- Moisiu, S, Alfred ((2009) “Midis Nanos & Berishës” (2002-2009), Kujtime 3, Botimet Toena, vëllimi III, Tiranë
- Moisiu, S, Alfred (2002) “Të ndërtojmë shtetin - fjalime dhe intervista”, Botim i Zyrës së Shtypit dhe Informacionit pranë Presidentit të Republikës, Tiranë
- Meksi, Aleksandër (2010) “Dhjetor ’90 - dokumente dhe materiale “. Botim UET PRESS, Tiranë
- Naim, Mëçalla (2013) “Pastrimi i parave, elementet juridiko-penal dhe kriminologjik”, Botimet KLEAN,
- Ngjela, Spartak (2011) Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare 1957-2010, refleksione në kohë. Botimet UET PRESS.volumi I
- Ngjela, Spartak (2013) Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare 1991-1996, Botimet UET PRESS.volumi III

- Ngjela, Spartak (2006) Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës . esse.Shtëpia Botuese “Enrico Cuccia
- Roberto, Morozzo Della Rocca, (2000) “*Shqipëria - rrënjët e krizës*”, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë
- James Pettifer, Miranda Vickers (2007) “*Çështja shqiptare, riformësimi i Ballkanit*”, “Bota Shqiptare”,
- Tushi, Gëzim (2010)“Arsyetime politike”, Botimet TOENA, Tiranë
- Tarifa, Fatos, Tarifa Eneida , Krisafi, Ksenofon (2009) “Paradigma e Tranzicionit Demokratik”, OMBRA GVG,
- Tarifa, Fatos (2014) Politika si gramatikë dhe metaforë. Onufri, Tiranë
- Weber, Max “Politika si profesion. Shkenca si profesion. Tre tipet e pastra të sundimit legjitim”, përkthyer nga origjinali dhe redaktoi: Gaqo Bushaka, “Fan Noli”, Tiranë.
- Platoni (1978) “Politika”, ELTA Tiranë
- Pridham, Geoffrey (1990) Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe. This edition published in the Taylor & Francis e-Library, 2003.
- Progni, Luljeta (2013)“Pardesytë e bardha - të fshehtat e atyre që çmontuan diktaturën” shtëpia botuese “Gent-grafik”, Tiranë
- Progni, Luljeta (2009) “Trashëgimtarët - Partia Socialiste midis transformimeve dhe vazhdimësisë”, Botimet “Ideart”, Tiranë

- Pëllumbi, Servet, (2001) “Midis autoritarizmit dhe demokracisë - politika dhe shoqëria”, Vëllim 4, Tiranë
- Pëllumbi ,Servet (2001), “Pluralizmi politik”, Botimet “Morava Tiranë
- Pëllumbi, Servet (2010) “Bashkëbisedim për politikën”, Botimet “Morava”, (libri i tretë)
- Pëllumbi, Servet (2001)“Të mendosh ndryshe”, Botimet Dudaj ,Tiranë
- Sartori, Giovanni (1993) “Edhe një herë për teorinë e demokracisë” (pjesa e parë), “Debati bashkëkohor”, “Dituria”, Tiranë
- Qosja, Rexhep (2005) “Demokracia e Shpërdoruar, shqyrtim kritik mbi gjendjen e demokracisë në shoqërinë shqiptare”, “Toena”, Tiranë
- Zanaaj, Fatmir (2012) “Filozofia e së Drejtës” botime “Naimi” Tiranë
- Zogaj, Preç (2014) “Fillimet, ngjarje, dëshmi, refleksione nga vitet 1990-1992”, UET PRESS, Tiranë

Gazeta dhe revista

- Arkivi i Kuvendit të Shqipërisë
- Artan, Fuga, “Media, Politika, Shoqëria (1990-2000)”
- Armand, Shkullaku, gazeta “Mapo”, dt. 25 korrik 2013

- Andrea, Stefani, gazeta “Shqip”, dt. 23 korrik 2013
- Eljona, Ballhysa, “Gazeta Shqiptare”, datë 10. 8. 2008
- Edmond, Tupja, gazeta “Panorama”, dt. 25 korrik 2013
- Faqja zyrtare e kuvendit të Shqipërisë
- Mimoza, Koçi, “Gazeta Shqiptare”, dt. 23 korrik 2013, nr. 5293
- Mustafaj, Besnik, Fletorja Rezervat, Tiranë 1995
- Popa, Ylli, “Koha e humbur”, “Zëri i Popullit”
- Skënder, Minxhozi, gazeta “Shekulli”, dt. 17 korrik 2013
- Zyhdi, Dervishi, “Gazeta Shqiptare”, dt. 27 korrik 2013
- Gazeta “Koha jonë”, 3 mars 1997
- Ngjela Spartak, “Biseda me Azem Hajdarin për Kushtetutën e vitit 1994”, revista MAPO online: <http://mapo.al/2013/06/17/ngjela-biseda-me-azem-hajdarin-per-kushtetuten-e-vitit-1994/>
- ANSA/ATA, “Marrëveshja e San Exhidios”, qershor 1997
- European Commission, “*Central and Eastern Eurobarometer, public opinion and the European Union (19 countries' survey)*”, no. 6, mars 1996, burimi online.
- “National Republican Institute for International Affaris (NRIIA) - The elections in Albania“, April 1991
- Këshilli i Europës për Shqipërinë, “Raport mbi kërkesën për pranim“, 27. 6. 1995

- OSBE/ODIHR, “Raporti i Misionit të Vëzhguesve të Zgjedhjeve“, Varshavë, 7 nëntor 2000
- Universiteti European i Tiranës, POLIS nr. 9, “Tranzicioni dhe shkencat sociale”, 2010

ⁱ Bashkurti ,Lisen . ABC Story , dhjetor 2015

ⁱⁱ “Gazeta Shqiptare” nga Gjongecaj, dt. 28. 7. 2010

- Koha Jonë 14.3.1996, Intervistë me Dr shkencave ekonomike Sherif Bundo, nga A. Xhafka
- Zëri Popullit 13 .3.1996 Intervistë e nënkryetarit Servet Pëllumbi. Ne vështrojmë tek e ardhmja
- Rilindja Demokratike 5.4.1996 Sali Berisha , Fjala e tij në Kuvendin e III të PD

ⁱⁱⁱ Negociues për fillimin e dialogut, me qëllimin që të krijohej mundësia e integritetit të qytetarëve shqiptarë me normalitetin demokratik

^{iv} Afrim Krasniqi (Voice of Albania, 28. 5. 2015)

Website

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2007>

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2010>

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2012>

[Burimi. http://shtetiweb.org/2014/11/19/teoritë-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/](http://shtetiweb.org/2014/11/19/teoritë-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/)
